



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 8 NËNTOR 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
8. NOVEMBRA 2011. GODINE**

**NËNTOR – NOVEMBAR
2011**

E martë, më 8.11. 2011,

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në mbledhje janë të pranishëm 94 deputetë, andaj fillojmë me punë sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Në rend dite kemi:

- **Debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës**

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar në Kuvend kërkesën për debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit 2011 të Komisionit Evropian për Kosovën, natyrisht i mbështetur edhe nga deputetët edhe Qeveria.

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri, në cilësinë e propozuesit paraqet arsyetimin e kërkesës për debat.

ISMET BEQIRI: I nderuar, zoti kryetar,

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës dhe grupi ynë parlamentar ka kërkuar këtë seancë të veçantë, edhe me përkrahjen e grupeve të tjera parlamentare, me qëllim, ndër të tjera, që qytetarët tanë të njoftohen për atë se çka përmban Raporti i Progresit për Kosovën, i hartuar nga Komisioni Evropian për periudhën tetor 2010 - shtator 2011, çka po ndodhë me ne, si po na sheh dhe vlerëson bota demokratike me syrin real të tyre, me gjendjen tonë reale të ngecjeve të mëdha e jo me syzën e Qeverisë së Kosovës?

Kjo seancë dhe ky debat i sotëm duhet të shërbejë në drejtim të asaj që të thuhet para qytetarëve tanë se cila është e vërteta e këtij raporti për ne, për realitetin, për ngecjet tona, në mënyrë që ai të mos prezantohet ashtu siç po pretendohet të prezantohet si raport i të arriturave, por që qytetarët tanë të informohen drejt për këtë?

Fundi i fundit, qytetarët tanë e dinë më së mirë se si po jetojmë dhe ku po jetojmë, ata janë vlerësuesi më i mirë i gjendjes tonë.

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, ky raport ka qenë i pritshëm.

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Progresit për Kosovën, i hartuar nga Komisioni Evropian për periudhën tetor 2010 – shtator 2011, është një raport shqetësues për LDK-n dhe jo vetëm për LDK-n, por për të gjithë qytetarët e Kosovës, është raport që më së paku i shkon fjala progres, sepse

atë progres kemi dëshirë ta shohim, ta gjejmë, por ai si i tillë fatkeqësisht në Kosovë nuk ekziston ose fare pak, është minor.

Janë shqetësuese konstatimet e këtij raporti për të gjitha fushat e jetës sonë, përditshmërisë sonë, të tashmes sonë, pse jo edhe të ardhmes tonë evropiane.

Konstatimet e Raportit për mangësi serioze në zgjedhjet e fundit është diçka që për ne si LDK dhe shumë të tjerë, diçka e ditur, e bërë nga ne publike gjatë procesit zgjedhor dhe pas përfundimit të tij, marrja e pushtetit pa meritë, me vota të abuzuara, domosdoshmërisht ka prodhuar një Qeveri të tillë çfarë e kemi, të brishtë, të paqëndrueshme, me të meta dhe lëshimet e çdoditshme, dëshmitarë të cilave jemi të gjithë ne dhe numër i madh i tyre, janë të evidentuar në këtë raport të progresit.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së shkurt do t'i përmend vetëm disa prej tyre, sepse kolegët e mi deputetë të LDK-së, do të flasin më detajisht për fushat e caktuara e këtë besoj do ta bëjnë edhe deputetët e partive tjera. Normalisht, që presim që nga ata të partisë në pushtet këtë edhe thurje lavdesh, besa presim edhe që dikush të propozojë edhe ndonjë mirënjohje për rezultatet e arritura.

Të nderuar deputetë,

Raporti i Progresit edhe e thotë, mes tjerash, se ka pasur shkelje serioze gjatë zgjedhjeve të vitit 2010. Si rrjedhojë e procesit të tillë kemi një Qeveri të tillë, Qeveri harxhuese që po e dërgon vendin drejt kolapsit ekonomik dhe financiar, me politika të gabuara buxhetore, qeveri që përkeqësoi raportet me FMN-n dhe Komisionin Evropian, Qeveri e dështuar në reforma ekonomike dhe në krijimin e ambientit të përshtatshëm dhe të sigurt për biznes, qeveri që ka miratuar masat që kanë shkaktuar çrregullime të rënda në ekonomi, deficit të madh buxhetor. Kështu e thotë vetë raporti, qeveri ku qytetarët e saj vuajnë nga papunësia, sepse ajo është vetëm prioritet në letër i kësaj qeverie, qeveri që ka dështuar në procesin e privatizimit. Shembulli më i mirë dhe i freskët është dështimi i privatizimit të PTK-së. Kjo edhe është pritur, sepse që në start ky proces është zhvilluar me procedura antiligjore, jo transparente, pse jo edhe si proces antizhvillimor.

Të nderuar deputetë,

Kjo qeveri po instalon çdo ditë borde politike dhe partiake nëpër ndërmarrjet publike, po zëvendësohen profesionistë dhe njerëz me përvojë, me militantë partiak, qeveri e dështuar në reformimin e administratës publike, me punësime pa kriterë, qeveri e rritjes së numrit të ministrive, 19 ministri, 6 zëvendëskryeministra e numrin e zëvendësministrave, këta e dinë sa janë, po emrat nuk besoj që ua dinë as vetë. Qeveri, shkurt, për ta lakmuar dhe pasur zili edhe shtetet më të zhvilluara, qeveri megalomane, meqanumë, shumë e kushtueshme, që nuk e ka askush në regjion, qeveri ku ka ministra që punën në ministri e kanë hobi dhe sport e sportin politikë. Kemi thënë edhe themi se me një qeveri të tillë më së paku veprohet në drejtim të reformave në përgjithësi, në administratë publike, në veçanti. Integrimi ynë evropian është iluzion, sundimi i ligjit është vetëm frazë, tek ne kjo mungon, sundimi i ligjit është larg nevojave dhe dëshirës tonë. Korrupsioni në çdo pore të jetës është e keqja më e madhe e shtetit tonë, qytetarët tanë. Se jemi ndër kampion të kësaj të keqeje, tregon edhe raporti i fundit

i publikuar ditë më parë. Këtë raport nuk e kemi bërë ne, këtë raport në një formë e ka bërë Qeveria jonë, apo më mirë të them mos puna e tyre.

Ndërhyrje në politikë e në sistemin gjyqësor, po ashtu është vërejtje serioze për ne, për Kosovën, për Qeverinë. Presionet politike ndaj gazetarëve, veçmas gazetarisë hulumtuese është po ashtu shqetësim i radhës, rritja ekonomike e dobët e Kosovës dhe e brishtë, sistemi juridik ose sistemi juridik më mirë të themi vazhdon të vuajë nga qasja dhe efikasiteti i mangët. Nuk ka fushë të jetës që nuk ka vërejtje serioze, në prokurim publik, në punësim të rinjve, i cili është alarmant, i ulët, në shëndetësi, siguri, në punë, në arsim, hulumtim, bujqësi, mjedis, menaxhim të mbeturinave, në cilësi të ujit, energji, media, drejtësi, liri, siguri, vizat, azili, pastrimi i parave, të gjitha këto janë shqetësime, ndërhyrjet e pavenda, siç thuhet në raport të politikës, në emërimet e larta në polici dhe në operacionet e ndjeshme policore, mbrojtja e të dhënave personale e tjera.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që të paraqes disa rekomandime në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, që besoj në fund të këtij debati, do të mund të miratoheshin. Dhe atë në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në debatin mbi Raportin e Progresit, në seancën plenare të mbajtur më 8 nëntor 2011, me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së, miratoi këto:

REKOMANDIME

Për plotësimin e kërkesave nga Raporti i Progresit 2011

Duke marrë në konsideratë të gjeturat e paraqitura në Raportin e Progresit për Kosovën 2011 të Komisioni Evropian,

Duke rikonfirmuar përkushtimin e qytetarit të Kosovës ndaj procesit të integritetit evropian,

Duke synuar përmbushjen e kriterëve politike, ekonomike dhe standardeve evropiane, si kusht kryesor për integritet evropian, Kuvendi i Republikës së Kosovës:

1. Vlerëson se duhet të intensifikohen reformat në të gjitha fushat e shoqërisë, sidomos në reformën zgjedhore, e cila do të mundësojë legjitimitetin e plotë të institucioneve të ardhshme të vendit, të sigurohet sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës në plotësi në tërë territorin e vendit.

Të zbatohen reformat ekonomike të cilat do të mundësojnë një zhvillim të diversifikueshëm, punësim dhe qëndrueshmëri buxhetore, të reformohet administrata publike dhe të rritet përgjegjësia dhe efikasiteti i saj.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ta angazhohet për përgatitjen dhe aprovimin e ligjeve të domosdoshme për të gjitha reformat politike, ekonomike dhe sociale, për monitorim të vazhdueshëm dhe intensiv të punës dhe veprimeve të Qeverisë.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës të përgatitë programin veprues në bazë të gjeturave, fakteve dhe analizave nga Raporti i Progresit.

Me këtë program, Qeveria duhet të heqë dorë nga retorika e përditshme dhe të marrë përgjegjësi të afatizuar për të siguruar sundimin e ligjit, eliminimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, politika nxitëse për zhvillimin e sektorit privat, për një rritje ekonomike dhe punësim, qeverisje të përgjegjshme korporative të kompanive publike, reformim të prokurimit, kontroll të shpenzimeve publike dhe qëndrueshmëri afatgjate buxhetore, duke respektuar detyrimet ndërkombëtare, heqje dorë nga ndikimi politik në institucionet e pavarura, në media dhe në administratë.

4. Të sigurohet një sinergji e Kuvendit dhe e komisioneve të tij, të Qeverisë dhe ministrive përkatëse, komunave dhe shoqërisë civile për bashkërenditje të veprimeve për plotësimin e të gjitha kriterëve dhe kërkesave në fushën politike, ekonomike dhe sociale, të cilat bashkësia ndërkombëtare i shtron para Kosovës për integrimin evropian dhe euro-atlantik.

Kuvendi i Republikës së Kosovës të trajtojë në çdo tremujor progresin në plotësimin e kërkesave nga Raporti i Progresit dhe duhet të adresojë përgjegjësinë ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kolegë të nderuar deputetë,

Pas një debati që sigurisht do të jetë i gjatë, përmbajtjesor, unë në emër të Grupit Parlamentar dhe sigurisht edhe në mbështetjen e kolegëve, do t'ju lusja që në fund t'i miratojmë këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, kërkesa ka qenë për debat dhe ne procedojmë sipas kërkesës së bërë nga grupi parlamentar.

Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, kryeministri ose dikush nga Qeveria që do ta marrë fjalën.

Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar Krasniqi,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë dëshiroj fillimisht t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare që ju kanë bashkangjitur idesë dhe iniciativës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për të zhvilluar debat në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për

Raportin e Progresit.

I falënderoj edhe ata që kanë proceduar dhe e kanë ndihmuar këtë proces që të ndodhë ky debat.

Pra, ky debat zhvillohet me vullnetin dhe ftesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, drejtuar juve për debat, që ditën e parë kur është nxjerrë Raporti i Progresit.

Natyrisht se formulimet, të nderuar deputetë, nuk mund t'ia ndryshojmë Komisionit Evropian, se raporte të progresit harton për çdo vend, prandaj edhe asnjë grup parlamentar apo individ, nuk mund të ndryshojë formulimin “progres” në diçka tjetër.

Në anën tjetër, mendoj se ky raport i progresit nuk duhet të jetë një debat elektoral, por duhet të jetë një debat përmbajtësor, substancial dhe i bashkëpërgjegjshëm për në të ardhmen.

Gjithashtu, e theksoj se Raporti i Progresit është për Kosovën, nuk është për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe pushtetet janë të ndara, edhe legjislativi, edhe gjyqësori, natyrisht edhe ekzekutivi.

Gjithçka që i takon ekzekutivit, e marrim përgjegjësinë e plotë, ndërsa nga diskutuesi i mëhershëm u harrua gjithçka që diskutohet për legjislativin dhe gjyqësorin dhe gjithçka nga këto u mundua t'i vihet në barrë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Prandaj, Qeveria e Kosovës distancohet nga ky trajtim i njëanshëm dhe pretendues elektoral.

Të nderuar deputetë,
Qeveria e Kosovës e ka mirëpritur plotësisht publikimin e raportit vjetor të Progresit 2011, dhe studimin e fizibilitetit.

Raporti i Progresit është një mënyrë e rregullt e komunikimit të Republikës së Kosovës me Komisionin Evropian, për progresin e arritur brenda periudhës njëvjeçare.

Raporti si i tillë është pasqyrim i progresit dhe sfidave në Kosovë, brenda periudhës një vjeçare, njëherësh udhërrëfyes për institucionet e Republikës së Kosovës në implementimi e agjendës evropiane. Sfidat e progresit të Raportit të Progresit janë në përputhje të plotë me prioritetet e Qeverisë së Kosovës, të cilat prioritete ne i trajtojmë përmes Planit të veprimtimit për partneritet evropian dhe dokumenteve tjera strategjike.

Gjetjet e Raportit të Progresit janë plotësisht në pajtim me pozicionin dhe qëllimet për zhvillimet politike dhe institucionale të Qeverisë në fushën e sundimi të ligjit, reformës së administratës publike, reformës së gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zhvillimin ekonomik të vendit dhe zgjerimit të dialogut dhe pajtimit të komuniteteve.

Strukturat për integrim evropian tanimë jo vetëm që janë themeluar, por janë funksionalizuar plotësisht, si Këshilli Ministror për Integrim Evropian, Komiteti Punues

për Integrim Evropian, ndërsa këtë vit Qeveria ka themeluar departamente për integrim evropian në çdo ministri.

Intensifikimin e procesit të integrimit, ne do ta adresojmë me forcimin e mëturjes së strukturave, të cilat janë bartëse të procesit të integrimit evropian dhe në këtë drejtim dëshiroj të potencoj edhe krijimin e Këshillit Nacional për Integrim Evropian.

Pra, ne jemi të vetëdijshëm se Kosova ka hyrë në një fazë të re në procesin e integrimit dhe ne po përgatitemi që këtë fazë ta trajtojmë me ngritjen e nivelit institucional, që merret me procesin e integrimit.

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Sfidat që dalin nga Raporti i Progresit janë prioritet i vazhdueshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e reformave, si përgatitje për integrim në strukturat evro-atlantike.

Prandaj, çdo mbështetje e juaja është e mirëseardhur dhe çdo sjellje natyrisht marrje e përgjegjësisë tuaja në kuadër të kompetencave të legjislativit, është jashtëzakonisht ndihmuese, por gjithmonë duke respektuar në përpikëri përgjegjësitë e ndarjes së pushteteve, legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv.

Vendosja e marrëdhënieve kontraktuale me Bashkimin Evropian është objektivë kryesore e Kosovës, dhe si të tillë mirëpresim udhëzimet e Komisionit Evropian rreth procesit të liberalizimit të vizave dhe avancimit të raporteve tregtare me Bashkimin Evropian.

Në fund të këtij viti, Kosova do të ketë edhe një udhërrëfyes zyrtar nga ana e Komisionit Evropian, i cili obligim përcakton standarde dhe veprime të caktuara.

Përmbushja e këtyre kriterëve do t'iu mundësojë qytetarëve të Republikës së Kosovës të udhëtojnë të lirë dhe pa viza në vendet e Bashkimit Evropian.

Përmbushja e këtyre kriterëve do të trajtohet me seriozitetin më të lartë institucional, duke marrë parasysh se tanimë Qeveria e Kosovës ka përgatitur udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave në mënyrë të njëanshme dhe ka arritur progres të konsiderueshëm në zbatimin e këtij udhërrëfyesi.

Ky progres është evidentuar edhe gjatë vizitës së komisionit vlerësues të Komisionit Evropian dhe si rezultat i këtij progresi evident, Komisioni ka vendosur të fillojë dialogun në fund të këtij viti.

Të nderuar deputetë,
Dëshiroj të potencoj që kjo fushë do të trajtohet me prioritet shumë të lartë dhe se Kosova nuk do të jetë prapa shteteve tjera të Ballkanit Perëndimor, megjithëse e fundit ka hyrë në këtë proces, pasi që është edhe e fundit që është pavarësuar, dhe është e fundit që ka fituar liri.

Si edhe më herët Raporti i Progresit do të shërbejë si dokument orientues për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në vazhdimin e reformave të gjithmbarshme sektoriale, me qëllim të përshpejtimit të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

E dimë se procesi i integrimit është një proces sfidues dhe kompleks jo vetëm për Kosovën, por edhe për shtetet e konsoliduar. Pra, jo vetëm se Kosova ka hyrë në këtë proces e fundit, por edhe përballlet me dy sfida paralelisht, atë të shtet ndërtimit dhe procesit të integrimit.

Për këtë arsye kemi marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar sa më shumë procesin në mënyrë që Kosova ta tejkalojë sfidën e integrimit suksesshëm.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Vendimtare në këtë proces është vullneti i Qeverisë së Kosovës që t'i marrë këto sfida dhe t'i inkorporojë në agjendën e saj, duke paraparë aktivitete konkrete drejt adresimit të tyre.

Kjo edhe është nënvizuar qartazi edhe në Këshillin Ndërministror për Integrim, ku të gjithë ministrat e Qeverisë së Kosovës dhe udhëheqësit e agjencive tjera, kanë raportuar rreth sfidave për sektorët përkatës dhe është me rëndësi të theksohet se Qeveria ka vendosur të bëjë prioritizimin e sfidave më urgjente të cilat duhet të arrihen gjatë vitit 2012.

Si rrjedhojë këto sfida për herë të parë janë identifikuar brenda 24 orëve nga koha e publikimit të Raportit të Progresit. Po ashtu, për herë të parë Plani i Veprimit për Partneritet Evropian për vitin 2012, do të finalizohet deri më 1 janar, që nënkupton se ky plan tash gati 6 muaj më herët po finalizohet nga vitet e mëparshme.

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj të theksoj para juve që në procesin e integrimit evropian do të ketë llogaridhënie dhe përgjegjësi nga çdo ministër, udhëheqës i dikasterit, prandaj ju bëj thirrje juve që edhe ju ta monitoroni këtë proces, në mënyrë që bashkërisht të kontribuojmë në arritjen e qëllimit final, pra të anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Integrimi Evropian është agjendë e cila na bashkon të gjithëve dhe duhet të jetë një agjendë që na motivon të punojmë edhe më tutje së bashku.

Pra, ju ftoj të gjithëve të punojmë pa dallime partiake apo etnike, bashkë për ndërtimin e Kosovës së re, Kosovës evropiane.

Të nderuar deputetë,

Agjenda Evropiane nuk nënkupton vetëm plotësimin e kriterëve dhe standardeve që parashtrihen nga Komisioni Evropian për anëtarësim, por këtë agjendë duhet ta kuptojmë edhe si përmirësim të gjithmbarshëm të standardit të jetesës së qytetarëve të Kosovës,

përmirësim të sistemit arsimor, infrastrukturës, administratës publike dhe në shumë fusha tjera.

Kosova gjatë kësaj periudhe ka vazhduar punën mjaft sfiduese drejt konsolidimit të institucioneve demokratike, reformave në fushën e administratës publike, gjyqësorit, etj.

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në vendosjen e ekonomisë së tregut që do të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve të saj, prandaj, ka marrë me prioritet rekomandimet e Komisionit Evropian në çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin financiar, menaxhimin e parasë publike.

Qeveria e Kosovës vlerëson kontributin e Komisionit Evropian në mbështetje të përpjekjeve integruese të Kosovës dhe konsideron se po krijohet një partneritet më i fuqishëm.

Në fund dëshiroj t'ju falënderoj juve, deputetë të Republikës së Kosovës, ju falënderoj për debatin tuaj, për sugjerimet tuaja që i takojnë ekzekutivit, ju falënderoj për përkrahjen e vazhdueshme dhe punën që deri më tani keni bërë lidhur me miratimin e ligjeve në kuadër të agjendës evropiane, por gjithmonë ju ftoj që përmbajtja dhe substanca evropiane e ligjeve të mos siç pretendohet edhe një herë me motive të caktuara politike, sepse kriteret evropiane mbi çdo interes partiak. Po ashtu, pres përkrahjen tuaj të vazhdueshme për sa i përket procesi të integritetit në përgjithësi.

Të nderuar deputetë,

Unë ju ftoj që ky debat t'i tejkalojë interesat e ngushta partiake, ju ftoj që të jetë një debat që i shërben vitit të ardhshëm, do të thotë deri në Raportin e Progresit të vitit të ardhshëm, që të punojmë bashkërisht në agjendën tonë evropiane dhe vizionin tonë për Kosovën evropiane.

Të gjitha përgjegjësitë që i ka ekzekutivi i Kosovës do t'i marrë dhe ato sfida do t'i implementojë në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve që i kemi në fuqi.

Ndërsa e ritheksoj edhe njëherë, Raporti i Progresit nuk është vetëm për ekzekutivin, por është Raport i Progresit për Kosovën, ndërsa çështjet e legjislativit të mos i barten ekzekutivit, se nuk qëndron dhe çështjet e gjyqësorit të mos pretendohet t'i barten ekzekutivit, se pushtetet janë të ndara.

Mund ta ndajmë edhe debatin edhe në tri pjesë, sa i përket ekzekutivit, sa i përket drejtpërdrejt legjislativit, se është një kapitull i gjerë për punën e legjislativit, gjithashtu në Raportin e Progresit e gjithashtu sa i përket reformave në drejtësi, por dhe të mos përzihen kompetencat dhe në asnjë rrethanë të mos pretendohet të ndikohen pushtetet nga njëra-tjetra, natyrisht që bashkëveprim po, por pushtetet janë të ndara.

Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Integritet Evropian, deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni fillimisht që para jush të paraqes angazhimet që në emër apo për Komision është punuar prej majit, fundit të prillit deri më tash. Ne kemi arritur që si deputetë të gjitha partive politike dhe grupeve etnike pjesëmarrëse, që ta harmonizojmë angazhimin tonë të përbashkët dhe është fakt merita e këtij Kuvendi që pas debatit të parë të ftuar lidhur me planin e veprimit të Kuvendit të Republikës për agjendën evropiane të miratohet Rezoluta e parë, e cila rikonfirmon përkushtimin e Kuvendit dhe i rekomandon Qeverisë që në këtë fazë të angazhimeve të trajtojë me prioritet të lartë agjendën evropiane.

Ne këtë konsensus të arritur e kemi shprehur dhe e kemi prezantuar në qendrën kryesore politike në Bruksel, duke qenë pjesë e punës dhe pjesë e angazhimeve të përbashkëta, pa dallime çfarë i kemi realisht në jetën politike në Kosovë, pozitiv -opozitiv.

Raporti pasqyron gjendjen apo faktin gjendjen në Kosovë dhe për herë të parë gjuha e përdorur e vitit 2010 dallon nga gjuha e përdorur nga BE-ja në raportin e vitit 2010. Kjo gjuhë është më e ashpër, është më e detajuar, është më eksplicite dhe raporti përmend shumëçka që për ne ndoshta duken detaje të parëndësishme po i referohet gjendjes në Kosovë, duke dashur që popullit të Kosovës t'i dëshmojë që kujdesi apo mbikëqyrja është jashtëzakonisht e madhe deri në detaje, në mënyrë që në gjithë sektorët e kërkuar të arrihet një progres më i madh.

Dëshiroj ta nis prej pjesës pozitive, sepse është dallim përkundër që procesi i liberalizimit të vizave ka qenë i ndarë, vetë fakti që komisionari për zgjerim nën moton: ” po rritemi së bashku “ ka paraqitur Raportin e Progresit dhe rekomandimin të njëjtin ditë, të njëjtën kohë dhe i ka bashkuar apo i ka futur në një ombrellë, dy kërkesat kryesore që lidhen me Kosovën duke dëshmuar në njërin anë që janë plotësuar kërkesat dhe mundësitë që Kosova të hyjë në proces të liberalizimit dhe e ka ndarë Kosovën prej grupit të shteteve si Afganistani dhe Ukraina, praktikisht e ka rikthyer në Ballkan në një rrugë të vështirë që procesi i liberalizimit e çmon, e aplaudon punën e Ministrisë për Integritet, ministres Çitaku, për herë të parë, sepse kemi pasur ministër për Integritet edhe më herët, e aplaudon rolin e Kuvendit përmes Komisionit për Integritet si përkushtim më i madh, por kritikon shumë sektorë tjerë edhe kritikon shumë mos angazhimin në arritjen e këtij progresi.

Tash, duhet të kalojmë në gjendjen faktike dhe më lejoni që ta them që integrimi për Kosovë nga Brukseli nuk shihet me ” i ” , por shihet me ” d, ” e kanë larguar integrimin si ” i ” e kanë vendosur ” d ” si dialog, sepse Kosovën e kanë rrasur në proces të dialogimit në të cilin ne duhet ecur dhe duhet kuptuar që është një proces jashtëzakonisht i rëndë, për fajin, apo për faktin që pesë shtete anëtare të BE-së nuk e kanë njohur Kosovën.

E para, dialogu për stabilizim- asocim, i cili është i rregullt, i ndërtuar, është i dallueshëm nga vendet tjera, dallon sepse Kosova e ka këtë problem, dialog i cili ka ecur mirë, është mbajtur në Prishtinë në afate të parapara, janë dëgjuar apo janë raportuar arritjet dhe gjithçka që lidhet me këtë proces dhe natyrisht është kritik edhe në kornizimin e Raportit të Progresit.

Dialogu i dytë është ai i njohur në Kosovë si dialog teknik apo dialogu me Serbinë, i cili e merr rrafshin teknik dhe dallimi është i madh, opozita nuk e mbështetur, po ky dialog po vazhdon të udhëhiqet nga e emëruara e veçantë e kryeministrit që ka portfelin e zëvendëskryeministres dhe e cila deri tash ka ecur në këtë proces me hapat edhe me të bëmat e veta. Krejt janë të lidhur me agjendë.

Dialogu i tretë është liberalizimi i vizave, i cili vjen si pasojë e konsensusit politik, vjen si pasojë e angazhimit të madh dhe premtim i realizuar prej vitit 2009, në vitin 2009 ka qenë deklarata e parë që Kosova do të hyjë në këtë proces dhe fatkeqësisht dy vjet vonesë ka bërë që tash të hymë në këtë proces dhe t'i marrim detyrat e realizimin teknik.

Dialogu i fundit, risia më e madhe është dialogu për sundimin e ligjit, është mekanizëm i ri, i pa definuar, as ne, besoj as Qeveria nuk e di. Duhet në mënyrë urgjente që ky dialog të qartësohet çka nënkupton për Kosovën dhe çka nënkupton për Brukselin, por është një fakt i madh që sundimi i ligjit merret sektori më i dështuar në Kosovë dhe për shkak të prezencës së EULEX-it këtu edhe për shkak të institucioneve tona, por do të gjendet një mënyrë, një mekanizëm i ri i cili do të fillojë të shtrojë detyra dhe do të fillojnë t'i quajnë teknike sikur në procesin e liberalizimit të vizave. Pra, keni për ta bërë kjo është punë teknike, mos e politizoni, sepse sundimi i ligjit duhet të vendoset në këtë rrafsh e unë e kuptoj si përshtetshmëri i detyrave dhe përshtetshmëri i rëndë i detyrave me të cilat duhet të merremi ne dhe me të cilën realisht duhet të ballafaqohemi sa më shpejtë më mirë, sepse nuk falen. Është konfirmuar që rrugë të shkurtër për integritet Kosovë nuk ka apo hap të madh për t'i zënë tri shtete tjera fqinje në këtë proces nuk mund të mbërrimë. Atëherë, kjo rrugë për ne është e gjatë dhe kësaj fushë dialogu për sundimin e ligjit duhet t'i jepet prioritet, në mënyrë që ta shkurtojmë rrugën nga ana jonë.

Kërkesë tjetër që vjen nga Raporti i Progresit është- Platformë me shoqërinë civile, që nënkupton hapje e dialogut të Qeverisë dhe Parlamentit me shoqërinë civile.

Ndërtimi i një platforme e cila definon rolin e shoqërisë civile në këtë proces dhe në jetën politike publike në Kosovë, do të duhej rifilluar. Unë e di që ekziston një marrëveshje e Qeverisë prej vitit 2007, e cila i jep drejtë, qasje dhe mundësi shoqërisë civile, po shihet që deri në këtë vit, në raport me shoqërinë civile, raporti vjen shumë i keq, jo afirmues dhe duhet rishikuar. Kuvendi ka filluar një dialog përmes Komisionit për Integritet Evropian me shoqërinë civile, por jemi larg asaj që mund ta quajmë mundësi apo gjetje rrugë. Mbi të gjitha dialogun e hap Qeveria, sepse ata kanë rol dhe mund të kenë më shumë në ekzekutiv, në kuptimin e prezencës, pjesëmarrjes dhe monitorimit, jo vendimmarrjes, po bëhen pjesë e vendimmarrjes në mënyrë indirekte.

Zoti kryeministër, ajo që po të vjen vitin e ardhshëm është problemi më i madh, kërkesa shumë e ashpër eksplicite për reformën në administratë publike e detyron Qeverinë ta hapë dialogun e fundit me partnerë social. Rishikimi i kontratës sociale, do të na detyroj të hapim një dialog të ri social në Kosovë, sepse ka për të afektuar, ka për të prekur shumë, administratën publike, reformat janë të dhimbshme, dhe humbja e vendeve të punës në këtë proces, i cili fillon me një përqindje të ulët, le të themi 10% e përfundon me 40%, duhet të bëhet e qartë në fillim, duhet harmonizuar në fillim dhe duhet të hyjë në këtë proces pa kthim.

Qeveria e Kosovës në vitin 2007 e ka nënshkruar një marrëveshje të zotimit për reduktimin e administratës për tri vjet atë kohë, që është dashur të mbyllet në këtë vit, me reduktim të stafit prej 10%, me rishikim krejt të administratës dhe strukturës në mënyrë që të fillojë edhe të ndërtojë administratë profesionale, jo politike dhe të pandikuar.

Ky proces e çon një dialog të ri social i cili është menaxhuar deri më tash, por paqja sociale nuk garantohet kur preken 80 mijë shërbyes, zyrtarë, edhe autoritete në administratën publike.

Do të doja në fund t'ia jap "d" e fundit, është dialogu me opozitën- kritik, i cili nuk duhet të injorohet, i cili duhet të qartësohet, i cili duhet të vendoset në agjendë dhe realizimi i kësaj bëhet më mirë nëse arrijmë diku t'i bashkojmë rrugët e aty ky jemi të ndarë, vazhdojmë secili ta luajmë rolin tonë, por sfida më e madhe mbetet të kalojmë prej dialogut në proces të plotë të integritetit e për të arritur këtë hap duhet punë e madhe, jashtëzakonisht e madhe edhe e durueshme e institucioneve, në mënyrë që ta kthejmë në standarde.

Mesazhi i fundit është që standardet në Kosovë po lexohen gabim dhe me vetë faktin që hapet dialogu dikush në anën tjetër të tavolinës do të na i lexoj më drejtë.

Ju lutem ta lexojë mesazhin drejtë, sepse mesazhi nuk mund të lexohet ndryshe pos ashtu siç është dhe kemi obligim që në këtë pjesë të procesit t' i shkurtojmë rrugët, sepse 92% e të rinjve që kapin moshën 16 – 23 vjeç kurrë nuk kanë shkuar më larg se në Tiranë edhe në Shkup. Dhe, kjo jetë në qark të vogël, në një shtet çfarë është Kosova, me më pak se 10 mijë kilometra katrorë, me të drejtë apo pa të drejtë, është jetë jashtëzakonisht e rëndë që e frustron gjithkënd, natyrisht që ata fëmijë janë të dikujt, sepse edhe prindërit s'kanë pasur mundësi të shkojnë shumë më larg.

Atëherë, e çmojmë arritjen në procesin e liberalizimit ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Para se t'ua jap fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare, po ju njoftoj se për debat janë lajmëruar 60 deputetë, ndoshta do të ishte mirë që ta ekonomizoni pak kohën.

Vazhdojmë me radhën e shefave të grupeve parlamentare.
Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën?
Deputeti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Sot kemi rastin të diskutojmë për dokumentin më të rëndësishëm të Komisionit të Parlamentit Evropian, i cili ka të bëjë me të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e vendit tonë.

Ky raport paraqet problemet e trashëguara në të kaluarën, problemet e evituara në të sotmen dhe problemet që priten të zgjidhen në të ardhmen.

Sot ndihemi mirë të gjithë ne dhe në veçanti qytetarët e Kosovës, familjet tona se ky raport shënon arritje të vazhdueshme të institucioneve të vendit.

Ky raport i hap rrugë perspektivës evropiane të Kosovës dhe shënon fillimin e një epoke të re për vendin tonë.

Sot kemi rastin, pozita dhe opozita, t'u themi qytetarëve të Kosovës se më në fund po vjen dita e qytetarit evropian dhe lirisë së tyre në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, t'u themi se po vjen dita që qytetarët e Kosovës të trajtohen njëjtë me qytetarët tjerë të Evropës, sipas të arriturave të vlerësuara në Raportin e Progresit.

Thuhet një thënie : ” Roma nuk është ndërtuar për një ditë”

Të nderuar qytetarë,
Po prezantojmë edhe një herë progresin e arritur nga dita në ditë për shtetin tonë të ri.

Njëkohësisht, më lejon që ta prezantoj fuqishëm punën e palodhshme të Qeverisë dhe të gjitha institucioneve të tjera të vendit për këtë proces.

Më lejon që shkurt të them atë që thotë Raporti i Progresit:

Kosova ka bërë progres për sa i përket kriterëve politike në një numër fushash të rëndësishme.

Pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe zgjedhjes së presidentit u formua Qeveria stabile, e cila filloi t'i adresojë sfidat e Kosovës.

Dialogu teknik mes Beogradit dhe Prishtinës u zhvillua në një frymë përgjithësisht konstruktive deri në shtator.

Koordinimi i agjendës evropiane në Kosovë është përmirësuar dukshëm.

Ministria e Integrimeve Evropiane ka forcuar rolin e saj dhe arriti me sukses një cikël të dialogut të stabilizim- asociimit.

Njerëzit në veri gjithashtu duhet të përfitojnë nga perspektiva evropiane. Dhe, është e rëndësishme që Kosova ta nisë një agjendë gjithëpërfshirëse për verin.

Të nderuar kolegë,

Më tutje thuhet: “Reforma gjyqësore ka vazhduar në mënyrë të kënaqshme si dhe reformat e institucioneve të rëndësishme të gjyqësorit në vend”. Është me rëndësi se ky raport si i tillë paraqet progresin e arritur edhe nga raportet e tjera me rëndësi që pasqyrojnë progresin e arritur.

Raporti i Progresit thekson edhe raporte të tjera të bëra nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së Ban Ki Mun.

Më lejoni që t’i referohem atij. “Autoritetet kosovare kanë rritur përpjekjet e tyre për krijimin e një angazhimi të ngushtë me Bashkimin Evropian, të cilët kanë gëzuar dukshmëri në nivel ndërkombëtar”.

Tutje, sa i përket kriterëve politike raporti thekson qartë se Kosova ka arritur përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagës.

Përmbushja e këtyre kriterëve sipas raportit, nënkupton se Kosova ka arritur progres të mirë në stabilitetin e institucioneve, që garantojnë demokraci, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.

Ky raport vazhdon tutje, duke theksuar bashkëpunimin rajonal, raportet e mira me vendet fqinje dhe respektimin e obligimeve ndërkombëtare. Në fushën e ekonomisë, raporti vlerëson qartë se ka rritje ekonomike, megjithatë kërkon përkushtim të vazhdueshëm, përkushtim ky i pareshtur i Qeverisë dhe institucioneve të Kosovës. Natyrisht se duhet të kemi përkushtim, por prapë Qeveria ka lëvdata se përkundër kësaj Kosova ka dalë me rritje ekonomike përmes menaxhimit të mirë të parasë publike.

Raporti i Progresit shënon zhvillime shumë pozitive sa i përket legjislacionit, progresi ka qenë në përafrim të legjislacionit të Kosovës me standardet evropiane. Kuadri ligjor është forcuar në mënyrë të veçantë në çështjet e tregtisë dhe sa i përket prokurimit publik.

Kosova ka organizuar një regjistrim në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Më tej raporti vazhdon, se duke pasur parasysh të arriturat dhe përparimin e Kosovës për rripranim dhe riintegrim të të kthyerve, Komisioni do të nisë një dialog të vizave me Kosovën, në fundit të vitit.

Ky dialog nuk do të fillonte pa plotësimin e kushteve dhe pa qeverisje të mirë. Raporti thekson shumë fusha të përparimit, në fusha të tilla si me lëvizjen e personave, të

mallrave, shërbimeve dhe thekson përparim të dukshëm në adresimin e krimit ekonomik-financiar dhe pastrimit të parave.

Po ashtu në mbrojtjen e të dhënave personale shihet se ka lëvizje dhe përparim të arritur.

Sa i përket gjyqësorit, Raporti shpreh qartë se Kosova ka bërë përparim në gjyqësor duke potencuar të gjitha të arriturat dhe zhvillimet pozitive në gjyqësi dhe vendimet e rëndësishme që janë marrë nga ana e gjyqësorit.

Raporti thekson se Kosova ka bërë përparim në luftimin e korrupsionit si dukuri apo fenomen rajonal, kjo nënkupton vullnetin e mirë të Qeverisë së Kosovës dhe gatishmërinë e saj për të luftuar pa kompromis çdo fenomen negativ që manifestohet në shoqërinë kosovare.

Raporti i Progresit flet edhe për ambientin më të përshtatshëm për lirinë e shprehjes, për shoqërinë civile dhe gazetarinë kosovare. Pavarësisht sfidave që shfaqen, jemi të vetëdijshëm se edhe në shtetet më të përparuara dhe që janë burim i demokracisë, mund të ketë pengesa e aq më tepër në Kosovën si shtet i ri.

Të jemi të bindur se pa këtë përparim s'do të kishim mbështetje të tillë evropiane dhe as shenja për liberalizim të vizave.

Raporti thekson se menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi, janë shtyllat kryesore që bëjnë të mundur liberalizimin e vizave dhe në këtë pikë Kosova ka arritur përparim, prandaj edhe ka raportuar për fillimin e dialogut për liberalizim të vizave.

Siguria e gjithmbarshme e qytetarëve të vendit është në nivel të mirë, përjashtim bënë veriu i vendit ku edhe aty institucionet e vendit kanë filluar shtrirjen e kushtetutshmërisë. Që nga 25 korriku kemi për herë të parë kufijtë e shtetit të Kosovës të menaxhuar nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Kjo nënkupton se kërkesa e bërë për strategji të mirëfilltë veç po zbatohet dhe shpejt siguria dhe rendi do të vendosen edhe në brendi të kësaj pjese të vendit. Natyrisht se strukturat kriminale dëshirojnë kthimin e para 25 korrikut dhe se situatën tani e konsiderojnë më të keqe se para 25 korrikut.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës falënderon iniciuesin e këtij debati lidhur me Raportin e progresit, sepse kemi vlerësuar dhe vlerësojmë se qytetarët nuk janë të njoftuar mirë deri më sot se sa pozitiv është ky raport për zhvillimet në Kosovë.

Grupi Parlamentar i PDK-së nuk është i prirë që të shoh vetëm zi, por jemi të prirë që t'iu gëzohemi të gjitha të arriturve në vendin tonë, pavarësisht se nga kush vijnë ato.

Këtë raport mund ta definojmë të gjithë së bashku, se emërtimi Raport i Progresit është i ndërtuar mbi progresin e arritur dhe punën e mirë që po bëhet në Kosovë, andaj me të drejtë quhet Raporti i Progresit.

Më lejoni krejt në fund që t'i përgëzoj qytetarët e Kosovës për të gjitha të arriturat e përbashkëta të cilat po i thotë ky raport...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Derisa e dëgjoja fjalën e kryeministrit Thaçi dhe veçanërisht fjalën e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së, zotit Adem Grabovci, e fitova një përshtypje për një moment se e kam lexuar raportin e gabuar, mu duk se unë kam lexuar një raport tjetër, e këta e paskan lexuar atë të mirin dhe fillova për t'u frikësuar. Ose, edhe një përshtypje tjetër, që po jetoj në një vend tjetër prej tyre.

Raporti i Progresit nuk është aspak befasi, natyrisht, për asnjërin prej neve, e veçanërisht jo për qytetarët e Kosovës. Ndoshta gjëja e vetme që të befason aty është titulli, që thuhet është raport i progresit, ndërkohë që në krejt tekstin e më pastajmë aty tregohet se në Kosovë në fakt nuk ka pasur kurrfarë progresi, ka pasur regres në disa fusha dhe ka pasur pak progres në disa fusha të cilat, kur analizohen drejt, nuk janë fare progres.

Pra, çka evidenton raporti? U përmendën këtu disa gjëra, por po e ndiej si obligim që prapë t'i përmendi ato, t'i listoj në mënyrë që ndoshta do të na dëgjojnë edhe këta që po mendojnë, që s'e kanë lexuar dhe aty po mendojnë se ka vetëm progres.

Pra, aty evidentohet që ka korrupsion në të gjitha sferat e jetës në Kosovë, pra në Polici, në Doganë, në Administratë publike, madje në arsim e në shëndetësi.

Evidentohet që te krimi i organizuar ka trafikim me narkotikë, trafikim me qenie njerëzore dhe krim tjetër të organizuar.

Pra, evidentohet që ka ndikim politik në gjyqësor, në punësimin në administratën publike dhe tjera. Pra, evidentohet që kjo ndarje e pushteteve, për të cilën po flet kryeministri, fare nuk ekziston.

Evidentohet, po ashtu, që ka ndikim të politikës edhe në media. Kjo nuk është e befasishme, ne gjithë e shikojmë RTK-në dhe e shohim këtë ndikim përditë.

Evidentohet keqmenaxhim i buxhetit. Evidentohet po ashtu mungesa e planit zhvillimor dhe të politikave të mirëfillta ekonomike.

Evidentohet edhe mungesa e një strategjie apo plani të veprimit për ta bërë Kosovën shtet sovran të mirëfilltë.

Evidentohet mos zbatimi i ligjeve dhe mungesa e vullnetit politik për zbatimin e ligjeve.

Të gjitha këto pika natyrisht se ne si lëvizje “Vetëvendosje”, por edhe subjektet tjera i kanë ngritur disa herë dhe i kanë theksuar disa herë më parë dhe në fakt për to edhe kemi kërkuar që të veprohet ngutshëm nga institucionet, në mënyrë që sadopak ta përmirësojmë jetën e qytetarëve të Kosovës.

Pra, çka thuhet tjetër në raport? Për sa i përket administratës publike, këtu thuhet që progresi është i kufizuar. Thuhet se kjo Qeveri nuk ka as plan të veprimit për reformën në administratë, e kjo kur dihet mirë se administrata është pra motori i punës së një qeverie, pra është një prej elementeve më të rëndësishme në punën institucionale.

Mbi të gjitha, konfirmon raportit, se ajo që po flitet tash e sa kohë në media dhe që ka qenë dhe është shqetësim i lëvizjes “Vetëvendosje” është se në administratën publike ka dhe vazhdon të ketë punësime politike dhe këtë e kemi ngritur edhe në Kuvend disa herë dhe madje edhe kemi dalë prej seancës së Kuvendit për shkak të kësaj.

Te gjyqësori, thuhet se progres i shënuar është vetëm vendimi i Gjykatës Kushtetuese për heqjen e imunitetit të deputetëve, që për mendimin tonë nuk ka qenë aspak progres.

Për më tepër, në pjesën e gjyqësorit gjithçka që shënohet më pas është regres dhe stagnim, si rastet e grumbulluara të pashqyrtuara e të pa ekzekutuara, ndikime politike, kërcënime e intimidime. Dhe, thuhet decidivisht në raport se gjyqësori është i dobët dhe jo efikas, ndikimi politik në gjyqësor është brengë të cilën e sjell raporti, e në fakt është brengë e secilit qytetar të Kosovës.

Për sa i përket korrupsionit, këtu u thanë, pra, edhe e përmenda më herët, që në këtë fushë vetëm sa ka pasur rritje të korrupsionit dhe këtë e evidenton Raporti, pra nuk ka progres po ka regres, ose ka progres të korrupsionit.

Preken edhe shëndetësia, edhe arsimi dhe thuhet sheshazi se deklaratimet e pasurisë së zyrtarëve të lartë nuk përkojnë me të hyrat e tyre reale.

Po ashtu është evidentuar edhe ngecja në punën e Agjencisë Antikorrupsion, e cila sipas Raportit po merret më shumë me aktivitete senzibilizuese, se sa me ndjekjen e rasteve të korrupsionit.

Për sa i përket të drejtave të njeriut, aty thuhet se përsëritja e parvjetshme, ndërhyrja politike edhe në lirinë e shprehjes, ku gazetarët përjetojnë presion politik dhe intimidime apo frikësime.

Raporti vë në pah po ashtu edhe kritika të shumta, të cilat lëvizja “Vetëvendosje” i ka ngritur tash e sa kohë, siç janë shpëlarja e parave, mungesa e kapacitetit për ta luftuar krimin ekonomik dhe financiar, por edhe mungesën e zbatueshmërisë së legjislacionit për të evituar këtë lloj krimi, mungesën e përvojës në prokurori dhe gjyqësi për këtë lloj krimi për të identifikuar, konfiskuar pasuri të paligjshme të krimeve të lidhura me grupet

kriminale. Dhe, natyrisht, një pjesë e konsiderueshme e raportit, gjë që është edhe shumë e rëndësishme, konsideroj unë për Kosovën, është ajo që merret me aspektin ekonomik.

Pra, pjesa ekonomike e Raportit të Progresit i nxjerr në pah të gjitha ato që lëvizja “Vetëvendosje” që në kohë të gjatë mundohet t’ia sqarojë kësaj qeverie, natyrisht pa sukses, dhe këto do t’i përmendi apo do t’i përmbledh, në fakt, në tri pika.

Pra, pjesa e politikave bazike ekonomike, siç i referohet Raporti i Progresit, sjell në pah faktin që kjo qeveri nuk ka aftësi të dizajnojë dhe implementojë një strategji të mirëfilltë ekonomike, e cila e bën lidhjen mes prioritetëve në politikbërje, reformave strukturore dhe shpenzimeve publike. Për më tepër, raporti potencon që Qeveria ka ndërmarrë hapa që në masë të madhe e kanë dëmtuar ekonominë e vendit. Pra, kjo është në faqen 26 dhe në faqe 27 të raportit.

Çështja tjetër është që në pjesën ku flitet për stabilitetin makro-ekonomik, thuhet qartazi që rritja ekonomike është e dobët dhe e thyeshme. Për më shumë, ato që lëvizja “Vetëvendosje” i flet që një kohë lidhur me mënyrën e rimëkëmbjes ekonomike, potencohet qartazi edhe në raport, ku thuhet se disbalancet tregtare janë të mëdha dhe që investimet që i ngrisin kapacitetet prodhuese në vend janë minimale, ose nuk kanë lëvizur fare prej vitit në vit. Pra, faqe 26 e 27.

Rrjedhimisht, edhe aftësia e kësaj ekonomie për të zvogëluar papunësinë është inekzistente. Pra, raporti potencon qartazi mosaftësinë e kësaj Qeverie për të zvogëluar papunësinë dhe kjo në vete është një notë e pamjaftueshme për Qeverinë.

Për sa i përket menaxhimit të buxhetit të qytetarëve, Raporti potencon faktin që planifikimi fiskal dhe kualiteti i kësaj kulete është dëmtuar edhe më tej. Për më shumë, Raporti potencon që pritshmëria, konsistenca dhe transparenca në lidhje me menaxhimin e kësaj kulete të këtij qytetari janë sfida të mëdha. Pra, buxheti është dëmtuar dhe këtë po ashtu e keni në faqen 27 të raportit.

Përfundimisht, Raporti është i qartë për sa i përket pjesës ekonomike. Pra, ai thotë që nuk kemi strategji, nuk kemi stabilitet të kënaqshëm makro-ekonomik, kemi disbalanc edhe më të madh tregtar, nuk kemi aftësi të zvogëlojmë papunësinë dhe, në fund fare, e menaxhojmë kuletën e qytetarit të kësaj Republike edhe më keq se në të kaluarën. Dhe, në vend që këto të përmirësohen, neve para pak kohe, para një javë ose dy na është dorëzuar buxheti i vitit 2012, i cili jo vetëm që nuk i përmirëson këto çështje dhe është një buxhet i cili s’do të përdoret për zhvillimin e Kosovës dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve, por e vazhdon avazin e njëjtë, avazin e rrezikimit fiskal të Kosovës dhe avazin e shpenzimeve të cilat më shumë përkojnë me interesat e qeveritarëve – kryeministrit dhe ministrave, se sa që përkojnë me interesin e qytetarit.

Pra, unë po e përfundoj me kaq, meqenëse natyrisht që edhe deputetët e lëvizjes “Vetëvendosje” do t’i kontribuojnë këtij debati dhe do ta shtjellojmë raportin ashtu siç e kemi lexuar ne, apo më mirë thënë në këtë rast, raportin që e kemi lexuar ne, për dallim prej juve. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Sqarim, jo replikë, në asnjë rrethanë.

Unë përsëri ju ftoj të gjithëve, deputetë të nderuar, që të mendojmë si të implementojmë kriteret e domosdoshme demokratike, edhe të politikës, edhe të ekonomisë, edhe të legjislacionit për vitin e ardhshëm e të punojmë bashkërisht dhe unë falënderoj të gjithë ata deputetë që kanë kontribuar, në veçanti Komisionin për Integritet, por edhe në sfera tjera, por në të njëjtën kohë dëshiroj t'ju ftoj të gjithëve që mendimet personale apo qëndrimet partiake të mos paraqiten si substancë e Raportit të Progresit apo si qëndrim apo si përmbajtje e Raportit të Progresit.

Këtu dëgjohen qëndrimet partiake, që nuk janë të përfshira në Raportin e Progresit, por tani mundohen qëndrimet partiake të paraqiten si qëndrime të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian. Këtu përfshihet prej liberalizimit, që do të thotë procesit të liberalizimit të vizave, të sigurisë së dokumenteve, riatdhesimit, riintegritit, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, menaxhimit të integritetit të kufijve, edhe sa i përket zgjedhjeve, ju e dini se kriza politike, në fakt, për këtë raport të progresit, ekzekutivi, sa i përket pjesës së ekzekutivit ka pasur mundësi të punojë 5 muaj, jo më shumë, sepse kishim krizën politike që u shkaktua nga ata që bojkotonin zgjedhjen e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe jo nga ata që participonin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës e dinë shumë mirë dhe është i njohur shumë mirë fakti se kush ka braktisur sallën e Parlamentit në atë kohë dhe kush ka qëndruar në Parlament. Pra, na është dashur 5 muaj për të menaxhuar atë krizë të shkaktuar nga bojkoti i panevojshëm, ndërsa gjithashtu rreth asaj çështjeje mendoj se rreth krizës Gjykata Kushtetuese ka dhënë përgjigjen më të drejtë të mundshme rreth asaj problematike.

Gjithashtu, theksoj se edhe sa i përket raporteve Qeveri – Kuvend – integritet evropiane, gjyqësor, raporti është shumë i qartë. Lexojeni mirë, ata që s'e kanë lexuar mirë dhe mundohen qëndrimet partiake apo individuale t'i paraqesin si përmbajtje të Komisionit Evropian. Qeveria e Kosovës vetëm deri në shtator ka sjellë rreth 78 projektligje, ndërsa të gjithë e dinë Kuvendi sa ka aprovuar. Unë falënderoj për aprovimin e të gjitha atyre projektligjeve, gjithashtu.

Ndërsa edhe sa i përket sistemit gjyqësor, administratës publike, regjistrimit të popullsisë, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoritarëve, edhe sa i përket kriterëve ekonomike, gjithashtu bilanci tregtar, inflacioni, investimet e huaja direkte, buxheti, të hyrat, shpenzimet, procesit të privatizimit, shqetësueset që kanë refuzimi i procesit të privatizimit dhe të gjithë qytetarët e Kosovës dhe bota demokratike e di se kush ka qenë për reformën ekonomike, pra për procesin e privatizimit dhe kush ka qenë kundër kësaj reforme, që ka qenë shqetësim për të gjithë miqtë dhe partnerët tanë ndërkombëtar, kështu që ju ftoj për një debat që ndërlihet drejtpërdrejt me përmbajtjen e Raportit të Progresit dhe jo debat për programet partiake apo agjendat partiake. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sot definitivisht se debati është për Raportin e Progresit dhe jo për paraqitjen e kryeministrit, mirëpo është e pa shmangshme të mos thuhet disa fjalë lidhur me atë paraqitje, edhe pse definitivisht nuk kanë kurrgjë të përbashkët, do të thotë Raporti i Progresit dhe fjala e kryeministrit nuk përputhen ama bash në asnjë pikë, përpos një fjale “progres”, që po keqinterpretohet nga ana e kryeministrit disa herë. Po thuhet që për shkak se e ka titullin “Raporti i Progresit”, kemi të bëjmë me progres. Kjo është realisht për t’i fyer njerëzit që s’e kanë lexuar raportin, për t’i fyer të gjithë njerëzit që nuk kanë pas shans për ta pasur në dorë. Nuk bën kështu. Raport i progresit quhet edhe kur nuk ka të bëjë fare me progres, veç titullin e ka raporti i progresit, sa për publik.

Një fjalë e kryeministrit ishte tepër interesant. Tha se sa i përket liberalizmit të vizave, Kosova nuk do të mbetet mbrapa vendeve tjera të rajonit. Zonja e zotërinj, që tash është dy vjet mbrapa. Qysh nuk do të mbetet mbrapa vendeve të rajonit? Sa duhet mbetur mbrapa, një shekull, a sa? E dëgjova duke thënë, e nuk po di qarta. Tha që nuk duhet pasur debat për interesa të ngushta partiake. Krejt në rregull. Mirëpo, çka të bëjmë ne. Ky merr vendime, vendimet i merr krejt të gabueshme dhe ne tash duhet të mos kemi interesa partiake. Po na nuk kemi hiq interesa partiake. Ne kemi interesa të Kosovës, e këto interesa të Kosovës seriozisht po cenohen prej vendimeve jashtëzakonisht të gabueshme të kryeministrit dhe të kabinetit të tij.

Sipas kryeministrit, atë që e dëgjuam, Qeveria është totalisht e pafajshme për gjendjen në të cilën është Kosova. Është Kuvendi që i ka fajet, komunat, bashkësitë lokale, shoqëria civile, shoqatat e peshkatarëve, gjyqësori, krejt përpos Qeverisë! Do të thotë, krejt tjerët kanë faj, krejt tjerët janë të gabueshëm, krejt tjerët s’po dinë çka po bëjnë dhe krejt tjerët e kanë marrë në qafë Kosovën, përveç Qeverisë.

Po thotë që për sundim të ligjit nuk ka Qeveria faj. Po dua t’ju tregoj, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, se ne në Aleancë mendojmë që sundimi i ligjit është edhe të mos kenë nevojë studentët për t’u regjistruar në fakultet, të thirrën në telefon një ministër, edhe ai është sundim i ligjit. Ne mendojmë që sundimi i ligjit është mos të ketë nevojë për ta njohur një ministër për ta marrë një kontratë të punës, ne mendojmë që sundim i ligjit është të mos ketë nevojë për ta njohur dikë në Qeveri për t’u punësuar diku, në çfarëdo ndërmarrje publike, ne mendojmë që sundimi i ligjit është mos të punësojmë krejt farefisën, edhe ata që e kanë sharë gjithkënd që po e punëson farefisën, edhe ky është sundim i ligjit. Nuk është sundim i ligjit veç një gjyqtar i gjorë, që nuk ka kurrfarë mbrojtje prej shtetit për ta kryer punën e vet.

Edhe në atë pjesë po ju flas. Shokët e kryeministrit janë të dënuar për vepra penale. Nuk po flas për ata që janë nën hetime, se gjysma janë. Po janë të dënuar dhe nuk shkojnë për ta vuajtur dënimin, nuk guxon kush t’i prekë. Vazhdojnë të qeverisin. Edhe ky është sundim i ligjit dhe ku i paskan fajet tash gjyqet? Qysh i kanë fajet gjyqet? Qeveria i ka fajet!

Unë kësaj radhe, për Raportin e Progresit shumë pak dua të flas për shkak se kam fol një herë para jush këtu dhe kanë folur të gjithë tjerët, edhe realisht u bë edhe bajat, më falni për këtë shprehje “bajat”, të tregohet çka po shkruan në raport, se me të vërtetë njerëzit po bien në konfuzion. Ne nuk po dimë kush çka po lexon, u tha më përpara.

Mirëpo, për të mos pasur dilema se a po shkruan a jo, dua të citoj dhe t’i tregoj faqet ku e çka shkruan, po jo vetëm për këtë raport të progresit – prej vitit 2007. Se ne duhet të bëjmë analizë prej vitit 2007, ku po shkon Kosova, cili është trendi. Domethënë, a ka përmirësim, apo mos ka ndoshta edhe shkuarje prapa prej vitit 2007.

Rritja ekonomike, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, prej vitit 2007, në cilin vit ka qenë 7.8%, ka mbërri në 3%. Rezervat e shtetit prej 500.000.000 eurove, pa e marrë dividendën, kanë mbërri në zero dhe me dividendë të shpenzuar: zero, zero. Tash jemi edhe minus!

Investimet e huaja, virtualisht kanë mbërri në zero sivjet, në këtë vit, në vitin 2011. Për ekonominë po flas.

Në një prej fjalimeve të mia, fjalëve të mia të më hershme, ju kam thënë – lexoni Raportin e Progresit qysh e lexon dikush në Bruksel, nëse doni liberalizim të vizave. E në raportin e vitit të kaluar, e njëjta Qeveri ka qenë, thotë kështu: Rritja e ekonomisë është jashtëzakonisht e ulët. Rritja e popullsisë jashtëzakonisht e lartë. Papunësia në rritje. Varfëria në rritje, sistemi i arsimit prodhon njerëz të paaftë dhe ekonomia nuk gjeneron vende të punës.

Kush e lexon këtë, kush e lexon këtë që ka shkruar vjet copa, copa, as shans nuk ka për t’i dhënë Kosovës liberalizim të vizave. Ju kam thënë vjet, po ua përsëris edhe sivjet, të njëjtën gjë e keni të shkruar në këtë raport. Po ju, nuk di qysh po e lexoni?

Qeveria ka thënë për të gjitha raportet se janë reale, reale, reale. Dhe tash, po ju lexoj vetëm disa pika të shkurtra të raporteve në vazhdimësi dhe po ju citoj, dhe ju mundeni, i keni do lap-topa, do IPada, mund t’i gjeni menjëherë. Në vitin 2007, te sistemi i ndërtimit të shtetit, thotë Raporti i Progresit – “tanimë elementet themelore për qeverisje efikase janë vë në vend, por gjithsesi duhet të përmirësohen më tutje dhe të aplikohen tërësisht”. Faqe 10, paragrafi 4. Lexojeni!

Të gjithë, përpos një sekretari permanent, janë lajmëruar sipas rregullave, ky është Raport i vitit 2007, lexojeni prapë, faqe 10 e keni: “Kuvendi e ka përmirësuar administratën dhe metodat e punës”, faqe 7, lexojeni! Në përmbledhje, kollaj është.

Në vitin 2008, po nis të ndërrojë situata. Po thotë: “ndërhyrja politike në emërimet në bordet e pavarura po e rrënon kredibilitetin e Qeverisë”, faqe 12. Raporti i vitit 2008, menjëherë.

Në vitin 2009, për të njëjtën temë po flasim, “ka ndërhyrje politike në emërimin e zyrtarëve publikë. Kjo çështje tanimë është bërë brengë serioze”, faqe 9, viti 2009.

Në vitin 2010, thotë: “reforma e administratës publike mbetet sfida kryesore për Kosovën”. E keni faqe 10, prapë. Dhe “ndërhyrjet politike në gjyqësor, shpeshohen”, faqe 12.

Prej vitit 2007 deri në vitin 2010, ky ka qenë trendi çka ka ndodhur me Kosovën ose qysh shihet Kosova prej Komisionit Evropian, ndërsa në vitin 2011, këtë që e keni tash, thotë kështu: “Ka ndërhyrje politike dhe politizim të administratës. Strategjia legislative nuk implementohet”.

Më përpara, në vitin 2010, në fillim, kanë thënë që në vitin e kaluar, të gjithë përpos një sekretari permanent, janë pushuar prej punës, përderisa më përpara ka qenë - të gjithë përpos një – janë emëruar sipas rregullave. Kjo është ajo çka ndodhë me Kosovën në këtë sistem të qeverisjes.

Te sundimi i ligjit, shembull të marrim, e keni një fjali që përsëritet vazhdimisht, në të gjitha raportet mund ta gjeni, thotë: “nuk ka përmirësim fare në raportet për shpëlarje parash, trafikim të drogës, luftim të krimit të organizuar dhe korrupsionit”. Tash vazhdon, më vonë thotë: “Njëfarë progresi mund të raportohet në punën e Policisë, por krimi i nivelit të lartë nuk luftohet”.

Tash po ju kallëzoj çka po ndodh me policinë! Në fillim, në vitin 2008, kur kjo Qeveri e para, para kësaj që është e njëjta, e ka marrë pushtetin dhe thotë: “ka njëfarë progresi në punën e policisë”.

E, në vitin 2009, ndodh vjedhja në polici dhe Raporti i Progresit thotë se ka nisë të prishet policia, ka probleme në polici, një vit më tej, dhe thotë “pa progres në luftimin e krimit të organizuar, të korrupsionit” e tjerë... I keni krejt të shkruara.

Në vitin 2010, thotë: “nuk ka vullnet politik për ta luftuar krimin e organizuar”, e keni faqe 56, te krimi i organizuar. Përfundon me këtë citat.

Në vitin 2011, e mbulon krejt këtë temë dhe thotë: “Ndërhyrje politike në polici dhe në emërime dhe në aksione të policisë, korrupsioni nuk luftohet, shërbimet sekrete partiake vazhdojnë ta kryejnë punën”. Kjo është e vitit 2001, tash. Po shkon, po vazhdon. Domethënë, nuk po shkon duke u ndrequr ky Raporti i Progresit, që po e quan kryeministri progres, po prej vitit në vit po shkon duke u prishur. Ky është trendi në të cilin ka hyrë Kosova.

Te liria e medias, përderisa gati sa nuk ka qenë temë prej kur çka, kemi mbërri deri te kërcënimi i gazetarëve dhe mos pasja e pavarësisë editoriale të RTK-së, Raporti i vitit të kaluar dhe i këtij viti, e dini të gjithë, se e keni lexuar të gjithë.

Të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Disa herë kemi biseduar për raporte të progresit. Kjo Qeveri nuk mundet ta ndryshojë trendin në cilin ka hyrë Kosova, nuk mundet për shkak se e kanë sjellë këtë kulturë të punës dhe nuk mund të dalin.

Këta i kanë futur krejt njerëzit e vet në ndërmarrje publike, në administratë publike, në polici, në gjyqësor, e mos të flasim për Qeveri, E kanë ngulfatur sistemin e ndërtimit të shtetit dhe nuk munden ta ndreqin vet, se iu kanë borxh njerëzve, se këta njerëz, të njëjtit njerëz të cilët i kanë futur nëpër shkolla, nëpër administratë e kudo tjetër - iu kanë ndihmuar për t'i manipuluar zgjedhjet e fundit, e për këto zgjedhje të fundit flet Raporti i Progresit, thotë: "zgjedhjet e fundit janë të manipuluar". Qysh manipulohen? Definitivisht që këta vet nuk i kanë njehur votat, as nuk kanë shkuar për t'i mbushur kutitë. Po, i kanë ata njerëz që i kanë shti në sistem, të cilët nuk mund t'i heqin, dhe Kosova, vendi ynë i dashur, me këtë qeveri, me këtë kulturë pune qeverisëse - as që ka shans për të ecur më tutje.

Krejt çka duhet të bëjmë ne, është të provojmë t'ua mbushim mendjen të shkojnë vet, të japin dorëheqje, të bëhen gati, të mos mbërrijnë në pikë të pa kthim, ku kanë për t'i mallkuar edhe njerëzit e vet, shumë shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
I nderuari kryetar,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Pasi që jeni fokusuar vetëm në ekzekutiv, atëherë kam obligime edhe kushtetuese, edhe ligjore, por edhe qytetare të prezantoj ballafaqimet dhe sfidat të cilat Qeveria e Kosovës i ka tejkaluar gjatë kësaj periudhe 5 – 6 mujore, të shkaktuar nga bojkotuesit e Parlamentit të Kosovës dhe bllokuesit e ndërtimit të institucioneve të Kosovës në fillim të këtij viti për interesa krejt personale, grupe dhe partiake.

Unë do t'ju kursej, në veçanti parafolësin, se e di parafolësi se nëse nuk e kursej, pastaj do të jetë një debat i rëndë për të, personalisht, në kuptimin legal dhe politik, edhe moral.

Sa i përket Raportit të Progresit, ne nuk mund t'i themi raporti i zi, apo i keq, apo i regresit, siç do të dëshironte dikush, por është Raport i Progresit i Komisionit Evropian.

Qeveria e Kosovës, sa i përket fillimisht sigurisë së dokumenteve, dëshiroj të theksoj, tash është edhe aspekt teknik pak, por e thashë, kam obligim para qytetarëve, para se gjithash, për të sqaruar dhe prezantuar këto të arritura.

Në bashkëpunim me EULEX-in është bërë vlerësimi i sigurisë së dokumenteve personale në nivel lokal, janë ngritur kapacitetet fizike dhe njerëzore në nivel komunal, është miratuar Ligji për gjendjen civile dhe Ligji për pasaportat biometrikë, ditë më parë veç kemi filluar për t'i shpërndarë edhe pasaportat biometrikë, ka përfunduar skanimi i gjithë regjistrave themelore, me ç'rast janë skanuar më shumë se 11.000 regjistra themelorë,

libra amë, është bërë verifikimi i të dhënave dhe është zhvilluar softueri i nevojshëm për rritjen e sigurisë së të dhënave, janë kyçur në rrjetin qendror rreth 99% të qendrave komunale për regjistrim civil dhe zyrave lokale për gjendjen civile, ka filluar procesi i prodhimit të pasaportave biometrikë, pra ditë më parë dhe unë ju uroj dhe përgëzoj juve të gjithëve, po në të njëjtën kohë, para se gjithash, qytetarët e Republikës së Kosovës.

Riatdhesimi dhe riintegrimi. Procesi i riatdhesimit është vlerësuar nga ekspertët e Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si shumë i suksesshëm, posaçërisht Ligji për ripranim, si dhe marrëveshjet për ripranim. Është miratuar plani i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, është themeluar programi për integrimin e personave të riatdhesuar me një shumë vjetore prej 3.4 milionë euro, është funksionalizuar plotësisht Bordi ekzekutiv për zbatimin e strategjisë dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar. Deri më tani, Bordi ka proceduar më shumë se 400 kërkesa nga niveli komunal për ndihmë të drejtpërdrejtë për personat e riatdhesuar.

Në të njëjtën kohë është themeluar dhe funksionalizuar Zyra për Integrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Zyrës pritëse për të riatdhesuarit e vendosur në Aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës, si dhe janë themeluar dhe funksionalizuar zyrat komunale për kthim dhe komunitete, me një staf prej afër 200 zyrtarë, janë trajnuar më shumë se 500 zyrtarë në nivel qendror dhe komunalë rreth procesit të riintegrimit. Unë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë kryetarët e komunave dhe autoritetet komunale për mbështetjen që ia kanë dhënë këtij procesi dhe e çmoj shumë kontributin e tyre.

Është themeluar mekanizimi për monitorimin e zbatimit të procesit të riatdhesimit, ndërsa sa i përket zbatimit të Udhërrëfyesit të njëanshëm për liberalizimin e vizave të aprovuar nga Qeveria, vlen të theksohet progresi i arritur në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit ka qenë, është dhe do të mbetet sfida e madhe për të gjithë ne, për Kosovën, për rajonin. Qeveria ka zhvilluar një qasje sistematike duke avancuar kornizën ligjore me miratimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë, Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, Ligjit për dhuratat e zyrtareve të lartë publike, Ligjit për përgjegjësinë e personave juridikë, Ligjit për mbrojtjen e informatorëve, Ligjit për prokurimin publik, Ligjit për bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Sa përket funksionalizimit institucional për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, janë zhvilluar këto aktivitete: funksionalizimi i prokurorisë speciale, caktimi i prokurorëve kundër korrupsionit në të gjitha prokuroritë e qarkut, funksionalizimi i Drejtorisë për hetimin e krimit ekonomik financiar dhe korrupsionit, themelimi i Njesisë për mbrojtjen e dëshmitarëve në kuadër të Policisë së Kosovës, miratimi i Strategjisë për Policinë e bazuar në inteligjencë, themelimi i Njesisë për mbrojtjen e dëshmitarëve në kuadër të Policisë së Kosovës, funksionalizimi i Agjencisë për menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, shtator 2010, themelimi i Njesisë së Inteligjencës Financiare në kuadër të Ministrisë së Financave.

Të nderuar të pranishëm,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Si rezultat i këtyre angazhimeve gjatë vitit 2011, në fushën e luftës kundër trafikimit me narkotikë janë realizuar 134 operacione policore, që kanë rezultuar në 244 raste të hapura dhe me arrestimin e 379 personave.

Gjatë këtyre operacioneve janë konfiskuar rreth 171 kilogramë narkotikë, edhe 3.611 fije kanabis, kurse janë shkatërruar 5 grupe kriminale.

E përmendët edhe vitin 2007. Unë ju ftoj të dëshmoni vetëm një rast të luftës kundër korrupsionit para vitit 2007 apo krimit të organizuar, apo trafikimit.

Në fushën e trafikimit të qenies njerëzore gjatë vitit 2011 janë bastisur 320 lokale, që kanë rezultuar me 40 raste të hapura, arrestimin e 99 personave dhe mbylljen e 23 lokaleve, kurse janë shkatërruar 11 grupe kriminale.

Në fushën e luftës kundër korrupsionit gjatë vitit 2011 gjykatat kanë trashëguar 216 raste nga vitet e kaluara, ndërsa janë pranuar 92 raste. Nga këto janë zgjidhur 75.

Po ashtu, Agjencia kundër Korrupsionit ka menaxhuar me sukses procesin e deklarimit dhe publikimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë shtetërorë. Në këtë drejtim, Agjencia kundër Korrupsionit ka iniciuar procedurat ligjore ndaj zyrtarëve që nuk kanë deklaruar pasurinë dhe ka filluar procesin e verifikimit të vërtetësisë së deklaratave të pasurisë.

Në luftimin e këtyre dukurive, Qeveria ka bashkëpunuar ngushtë me autoritetet e EULEX-it përmes funksionimit të Bordit të përbashkët për sundimin e ligjit dhe implementimin e programit të monitorimit dhe këshillimit, sikurse prokuroritë dhe gjykatat në procedimin e rasteve relevante.

Menaxhimi i integruar i kufijve, të nderuar deputetë: Kompletimi dhe avancimi i kornizës ligjore, vënia në funksion e sistemit – bordit menaxhment sistem, në të gjitha pikat e kalimit të kufirit, funksionalizimi i plotë i strukturave institucionale koordinuese për zbatimin e legjislacionit dhe politikave, fillimi i kryesimit me rrotacion të Bordit ekzekutiv, me qëllim të zhvillimit të pronësisë vendore të barabartë nga tri agjencitë përkatëse, përmirësimi i infrastrukturës teknike, transferimi i përgjegjësive për mbikëqyrjen e kufirit me Shqipërinë, transferimi i përgjegjësive për mbikëqyrjen e kufirit me Maqedoninë, finalizimi i përpjekjeve për transferimin e përgjegjësive për mbikëqyrjen e kufirit të Zi nga KFOR-i dhe Policia e Kosovës, nënshkrimin e marrëveshjeve për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë në fushën e doganave – 5 nga 19 sa janë planifikuar me Shqipërinë, Turqinë, Francën, deklaratë e përbashkët Malin e Zi, Finlandën. Gjithashtu, është themeluar Agjencia shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa i përket zgjedhjeve, përsëri nuk do t'i shtoja më tepër asaj çka e potencova. Kemi pasur kohë 5 muaj që të punojmë si ekzekutiv sa i përket pjesës së ekzekutivit për shkak

të bojkotit dhe bllokadës që u krijua në fillim të vitit sa i përket ndërtimit të institucioneve dhe qytetarët i dinë edhe bojkotuesit dhe bllokuesit.

Sa i përket Kuvendit, është mirë që secili ta lexojë edhe pjesën që i takon Kuvendit, edhe gjyqësorit.

E theksoj edhe një herë, ne marrim përgjegjësitë që na takojnë si ekzekutiv. Edhe sa i përket sistemit gjyqësor, edhe sa i përket administratës publike, natyrisht se ne kur e kemi marrë pushtetin në vitin 2007, jemi ballafaquar me një administratë komplet politike, të grumbulluar aty në 6 – 7 vitet e kaluara, por mund t’ju them se nuk ka largim as edhe të një shërbyesi civil nga puna në kuptimin e motiveve politike.

Sa i përket regjistrimit të popullsisë, kemi vlerësimin ndërkombëtar, prandaj nuk mund ta mohojë askush, edhe sa i përket të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoritarëve, në kuptimin më afirmativ, duke respektuar gjithmonë dokumentin e presidentit Ahtisari, por edhe Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Sa u përket mediave të lira, unë ndihem tepër mirë që kemi një partneritet të qëndrueshëm dhe efektiv, në të njëjtën kohë duke respektuar gjithmonë mediat e lira, por dëshiroj gjithashtu të potencoj se u theksua këtu kërcënimi ndaj mediave nga politika. Politika jemi të gjithë ne, është Parlamenti, është Qeveria, autoritetet komunale, të gjithë ne që merremi me politikë. Unë i falënderoj mediat e lira për qasjen ndaj institucioneve për kritikën e tyre, në të njëjtën kohë edhe për prezantimin e tyre objektiv.

Në të njëjtën kohë falënderoj organizatat jo qeveritare, shoqërinë civile për debatet e tyre korrekte, për idetë dhe sugjerimet dhe në të njëjtën kohë për mbështetjen e përpjekjeve tona të përbashkëta për integritet evropian, në veçanti.

Ndërsa, sa iu përket kriterëve ekonomike apo zhvillimit ekonomik, ne do të kemi këtu mundësi që të diskutojmë tani edhe me shifra dhe fakte dhe ministrat përkatës janë këtu, unë ju falënderoj të gjithëve që të merrni pjesë në debat, por në asnjë rrethanë do të kisha dëshiruar që të mos keqpërdoren shifrat dhe faktet, se nuk mund të keqpërdoren se janë të prezantuara edhe në raportet ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë me vizionin e saj ekonomik dhe planin e veprimit të zhvillimit ekonomik me ç’rast ka definuar, siç e dini edhe të gjithë ju, në 5 fusha kyçe:

- ruajtja e qëndrueshmërisë makro-fiskale,
- investimet, mjedisi investues dhe përkrahja e sektorit privat,
- zhvillimi i infrastrukturës publike,
- revitalizimi i sektorit të bujqësisë,
- zhvillimi i kapitalit njerëzor.

U përmend edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Unë sot kam pasur takim me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Buxhetin e kemi proceduar në Qeveri. Tani do t’ju dorëzohet edhe juve me siguri në Kuvend, pres aprovimin nga ju. Është buxheti më i lartë në

historinë e Kosovës ndonjëherë. Është buxhet i rritjes së pagave për të gjithë punëtorët kosovarë. Është buxhet i zhvillimit ekonomik, i reformave ekonomike, i rritjes së mirëqenies sociale të qytetarëve.

Pra, edhe një herë sa i përket Fondit Monetar Ndërkombëtar, raportet janë të shkëlqyeshme. Jemi në Programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Atë shqetësim, kush e përmendi, ia heq sot, se nuk është shqetësim dhe nuk është çështje.

E di se ka pasur thjeshtë lot krokodili sa i përket raporteve Qeveri me Fondin Ndërkombëtar, por ju e dini se me rritjen e pagave për mësimdhënësit, shërbyesit civilë, punëtorët e shëndetësisë, gjithë pjesëtarët e FSK-së, Policët e Kosovës, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, zjarrfikësit, të gjitha këto përbënin rreth 85 milionë euro kur ne i rritëm pagat po këtë vit. Një herë nuk u besua se do të rriteshin pagat. Ato paga janë rritur. Të gjithë mësimdhënësit i marrin, të gjithë punëtorët i marrin pagat e rritura. Raportet me Fondin Monetar Ndërkombëtar janë shumë të mira. Kur i rritëm pagat, u kritikua, kishim një debat jo të lehtë dhe është e vërtetë se nuk ka qenë debat i lehtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, por e kemi tejkaluar dhe jemi në program.

E theksoj se kur u rritën pagat, thanë tash nuk ka para për autostradë, por unë ju ftoj që të shtunën në ora 12:00 të merrni pjesë të gjithë në inaugurimin e 38 kilometërshit të parë të autostradës “Ibrahim Rugova” në kufirin Kosovë-Shqipëri. Është një festë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Është projekti më modern në historinë e Kosovës. Ndërsa, gjithashtu, edhe për vitin tjetër ju e dini se kemi ndarë 296 milionë euro për vazhdimin e autostradës prej Therandës në drejtim të Orllatit, për ta ofruar sa më shpejt me Prishtinën, në drejtim të Merdares.

Ndërsa, edhe sa iu përket projekteve tjera, mund të diskutojmë, por përsëri ju ftoj që të kemi një debat me përmbajtjen e Raportit të Progresit dhe jo të qasjeve ditore politike. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Replikë, Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dy tema, shumë shkurt!

Kjo është legjislatura e katërt e Kuvendit të Kosovës, prej pas luftës. Tri prej këtyre legjislaturave i ka kontrolluar zoti Thaçi, njërin si para politikë, e dy tjera këto të fundit si kryeministër. Që ku e ka, ish kryeministrin të ulur aty, për administratë të politizuar.

Deri në këtë legjislaturë të katërt, nuk ka ndodhur kryeministri i Kosovës t’i kërcënojë deputetët, t’ju thotë që e sheh legalisht, domethënë ky po i ngreh penjtë e legalitetit. Mundet të thotë që a e shoh unë, bëna e fola, çka më gjen legalisht, çka më gjen politikisht, çka më gjen moralisht, pse s’the edhe fizikisht, kryeministër? Ishim mësuar, krejt kallaj ka qenë, ke mund të thuash - mos, këqyr se ke thënë. Le të mbetet e shënuar që kryeministri i Kosovës, sot, mua, kryetar i Grupit Parlamentar, më ka thënë - ke për të pasur pasoja politike, legale dhe morale nëse vazhdon të flasësh!

Dhe, po ju them unë juve, kur thotë publikisht kështu, paramendoni ju çka iu bën njerëzve tjerë me telefon e me SMS? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Do të dëshiroja fillimisht...

(Ndërhyrje)

Ardian, paske marrë të trembur diçka, por askush nuk kishte të bëjë asgjë me ju, por e theksoj edhe një herë se në debatin që ju e ngritët, unë ju kurseva dhe vazhdoj të theksoj se përsëri po ju kursej nga të këqijat tuaja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lexojeni rregulloren! Unë po vazhdoj sipas Rregullores. Në emër të Koalicionit Kosova e Re...

(ndërhyrje)

Ju lutem, ne e kemi një Rregullore në fuqi dhe sipas Rregullores në fuqi, Kabineti qeveritar e merr fjalën sa herë kërkon dhe në çdo kohë, kështu që e kemi në Rregullore dhe realisht po shkoj sipas Rregullores. Fjalën e ka në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Muzejene Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin dhe kabinetin qeveritar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët të cilët janë sot në seancë!

Duke marrë parasysh se temë debati sot në këtë seancë është Raporti i Progresit të Kosovës, atëherë i gjithë debati duhet të shkojë në të mirë të Raportit të Progresit të Kosovës.

Në një Evropë me një krizë të thellë ekonomike, ku as vendet të cilat konsiderohen me traditë, si Greqia dhe tjerat, nuk pëlqejnë më të jenë pjesë e saj, e bën edhe më të vështirë integrimin e vendeve me demokraci dhe të ardhme të lëkundur, si vendi ynë.

Kjo paratezë nuk mund të kalojë pa u bind se çfarë ne po diskutojmë sot dhe sa do të ketë kuptim pas shumë, më se 5 vitesh kur e ardhmja e eurozonës, pjesa më e madhe e BE-së po vazhdojnë të jenë në pikëpyetje.

Andej, gjithë kritikën në Raportin e Progresit janë vetëm një parashikim teknik i çështjeve, ndërkohë që neve na takon të pyesim për çështje ditologjike dhe të ardhmen që duhet të ndjekin të gjithë politikanët, të zgjedhurit dhe drejtuesit e institucioneve dhe se çfarë të ardhme po u krijojmë brezave të ardhshme dhe të sotme.

E para që do të ndodhë vërtet, bashkimi i pretenduar me shtetet e integruara të BE-së, aq shumë të synuara apo të ndodhë thjeshtë asimilim i të voglit nga të mëdhenjtë, shqetësimi

i ngritur shumë hapur së fundi edhe nga vetë vendet e fuqishme dhe me demokraci ndër më të vjetrat e Evropës, si Britania, dhe nëse vazhdon, eurozona po shkon drejt mbisundimit nga më të fuqishmit, a ka vend edhe për të.

Pra, edhe kur kritikojmë apo lavdërojmë dokumentin si Raporti i Progresit, duhet të shohim se ku na çojnë pikëvështrimet tona në këtë kontekst, pra të ardhme sonë, gjë që nuk po e bën askush këtu, që vlerësimin ta japë përtej një dokumenti të tillë, pa e larguar shikimin nga ai. Nuk mjafton vetëm të thërrasim dhe të bërtasim, nuk ka rrugë tjetër përveç integritit në BE, ndërkohë që ne nuk bëjmë asgjë për vetveten tonë dhe për atë kohë sa nuk bëjmë asgjë për veten tonë, ne do të jemi edhe më të pafuqishëm dhe më inferior në raport me të tjerët dhe, si të tillë, të padëshirueshëm për të na integruar.

Pra, ne duhet të bëjmë atë që tani e kanë bërë të tjerët, që kushtet për integrim t'i plotësojmë jo më si gjëra formale për të marrë kandidaturën në BE, por duke e bërë çdo pjesë të Kosovës Evropë, duke filluar me vënien e rendit, të ligjit për të gjithë dhe në çdo pjesë të vendit dhe çështjen e veriut ta kemi spastruar një herë e mirë nga tryeza jonë dhe kur kemi të kuptojmë se qytetarët e asaj pjese duhet të zbatojnë ligjet, që është mbi të gjitha.

Po kështu, kur ta kuptojmë qartë se politika dhe askush nuk mund të qëndrojë mbi ligjin, kur sistemi i drejtësisë nuk bëhet qejf i politikës dhe politikanët nuk mund të jenë të paprekshëm për organet e ndjekjes, kur ekonomia vendos standarde të fuqishme evropiane mbi bazën e mirëfilltë të tregut të lirë, konkurrencës jo lojale dhe jo të monopolit, kur zgjedhjet janë të lira e të ndershme dhe askush nuk mund të zgjojë dyshime për to dhe manipulimin e tyre që mund të jetë pjesë e planeve për fitore, kur administrata publike është funksionale dhe rastet e korrupsionit janë vërtet të izoluara dhe plotësisht të ndëshkueshme, kur gjyqësori është vërtet i pavarur, gjykatësit dhe prokurori nuk e shikon të akuzuarin për të dyshuar nëpërmjet interesave të tij, kur politika antikorruption nuk janë të izoluara, por gjithëpërfshirëse dhe agjencia përkatëse nuk injorohet nga organet ndjekëse, ligjet e miratuara në kohë të mjaftueshme për shqyrtim, kur Kuvendi përkatësisht komisionet parlamentare duhet të hulumtojnë për barrierat funksionale dhe zbatimin e ligjeve. Pra, duke mos anashkaluar vërejtjet edhe pozitive të Raportit të Progresit, përparimi i mirëfilltë dhe i suksesshëm do të ndodhë kur të kemi kuptuar detyrat tona si Kuvend dhe si Qeveri, pa marrë parasysh vërejtjet dhe këshillat e të tjerëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka Petar Miletiq.

PETAR MILETIĆ: Želim na početku, poštovane kolegice i kolege, da vama i vašim porodicama, kao i svim građanima Kosova muslimanske veroispovesti, u ime Poslaničke grupe Samostalne liberalne stranke čestitam Bajram!

Poštovani predsedniče,
Poštovani predsedniče Vlade, članovi vlade,
Poštovane kolegice i kolege poslanici,

Debatu iniciranu od strane opozicije o Izveštaju o napretku Kosova u evropskim integracijama podržali smo jer smatramo da se radi o izuzetno važnom pitanju i dokumentu koji na jedan objektivan način pokazuje na kom se stepenu razvoja nalazi kosovsko društvo. Takođe, Skupština Kosova, kao najviši politički organ na Kosovu treba ozbiljno da razmotri sve zaključke koje je Evropska komisija pripremila i preporučila na usvajanje.

Čitajući ovaj izveštaj, vidimo da postoje mnoge sfere života u kojima je Kosovo postiglo značajan napredak, ali postoje delovi koji treba ozbiljno da zabrinu i o tim problemima treba ozbiljno da razgovaramo i da se sa njima suočimo, kako bi što brže usvojili evropske vrednosti i postali društvo koje zaslužuje ravnopravan tretman Evrope. Obzirom da je o ovom izveštaju već dosta toga rečeno, a očekujem i da će druge kolege učestvovati u ovoj debati o svim delovima izveštaja, želeo bih posebno da se zadržim na onim delovima koji se tiču ljudskih prava i zaštite manjina

U prvim rečenicama ovog izveštaja naglašava se da je srpska zajednica južno od Ibra, povećala saradnju i učešće u kosovskim institucijama. Bez lažne skromnosti, želim ovde da istaknem ulogu Samostalne liberalne stranke i naglasim angažman političke partije kojoj pripadam, u ključnim procesima kao što su učešće u centralnoj vlasti, formiranju novih opština i aktivna uloga u celokupnom društvenom životu.

Deo izveštaja koji govori o učešću Srba na izborima i popisu je dokaz da je naša politika participacije u kosovskim institucijama bila ispravna i ohrabruje nas da ne menjamo naš pravac političkog delovanja.

Kada se radi o učešću Srba sa severa Kosova u kosovskim institucijama, to i dalje ostaje izazov sa kojim treba svi da se suočimo. Neprestano nudimo svoju pomoć svim relevantnim političkim faktorima, kako bi se ovaj problem prevazišao. Izveštaj se bavi pitanjem decentralizacije koje ima direktan uticaj na živote kosovskih Srba i treba istaći da se proces decentralizacija opština razlikuje od procesa formiranja novih opština.

Naglašavam rečenicu iz izveštaja Evropske komisije koja kaže da “Vlada treba da nađe rešenje za dugoročnu održivost novo formiranih opština sa srpskom većinom i da se sve opštine na Kosovu i dalje suočavaju sa izazovima u smislu kapaciteta i resursa”.

Siguran sam da na Kosovu postoji ozbiljan kapacitet i želja institucija da pitanje ljudskih prava i zaštita manjina bude na nivou evropskih standarda. Verujem da su u cilju dostizanja ovih standarda formirana tela koja se bave ljudskim pravima, međutim ona su sada previše raširena i često se preklapaju, što potvrđuje i ovaj izveštaj. Tako, na primer, postoje Ministarstvo za zajednice, Kancelarija premijera za zajednice, Konsultativna veća za zajednice, opštinske kancelarije za zajednice, skupštinski odbor za zajednice.

Poštovane kolegice i kolege,

Da ne bi bio pogrešno shvaćen i da neko ne pomisli da je moj stav da ova tela ne treba da postoje, želim da kažem da su ona neophodna, ali da njihova komunikacija i

koordinacija treba da bude efikasnija, da njihovi mandati treba da se razjasne i da njihovi resursi treba da budu bolje iskorišćeni.

Možda je suvišno ponoviti preporuku iz izveštaja, koja kaže da je obezbeđivanje punog poštovanja ljudskih prava ključni prioritet evropskog partnerstva i mi moramo biti potpuno posvećeni tom cilju.

U više navrata smo u ovom visokom domu ali u javnosti naglašavali da sloboda izražavanja nije na zadovoljavajućem nivou. I ako je Ustavom i zakonima Kosova zagarantovano pravo manjina na informisanje na svojim jezicima, to nije do kraja ispoštovano. Da bi povećanje svesti o evropskim standardima bilo dostignuto, neophodno je da zakoni o Nezavisnoj komisiji za medije, javnom emitovanju budu usklađeni sa evropskim pravilima i da kanal na srpskom jeziku bude formiran na način koji će garantovati uređivačku i finansijsku autonomiju, kao i zaštitu imovine bivše Radio-televizije Priština i prava radnika te kuće.

Ono što smo konstatovali ocenjujući izveštaj RTK u Skupštini Kosova, da iako zakonodavstvo garantuje dovoljno vremena za programe na manjinskim jezicima, u praksi toga nema. To je potvrdio i ovaj izveštaj. Finansiranje fonda namenjenog za podršku manjinskih, multi etničkih i medija drugih specijalnih grupa, izdvajanjem 5% od pretplate, nije operativno i taj problem treba rešiti putem uvođenja televizijske pretplate.

Prema izveštaju Evropske komisije u sferi slobode misli, uverenja i vere, postignut je ograničen napredak. Da bismo izbrisali ovaj pridev "ograničen" i kako bi postigli da u narednom izveštaju ne piše da je nekoliko verskih lokaliteta vandalizovano, neophodno je da u što kraćem roku usvojimo Zakon o Velikoj Hoći i istorijskom centru Prizrena i tako ispunimo međunarodne obaveze preuzete iz Aneksa 5. Sveobuhvatnog predloga za rešenje statusa Kosova.

Izveštaj nas podseća da na Kosovu nisu ograničena samo prava etničkim manjinama i da Ustav i zakon o borbi protiv diskriminacije zabranjuju diskriminaciju i na osnovu seksualne orijentacije. Obzirom da se članovi LGBT populacije suočavaju sa pretnjama i rizikom od nasilja, neophodno je da se o pitanjima koji se tiču LGBT zajednice diskutuje otvoreno i da se ulože veći naponi kako bi se postigla opšta svest za borbu protiv diskriminacije.

Svojinska prava su akutni problem kosovskog društva. Činjenica da oko 11.000 zahteva evidentiranih u Kosovskoj agenciji za imovinu nije rešeno, govori o slaboj primeni zakona u vezi sa imovinom, što naglašava i izveštaj i napominje da Zakon o prodaji stanova sa stanarskim pravom još uvek nije usvojen.

Da primena Zakona o jezicima u službenoj upotrebi, nije adekvatna, vidi se na svakom koraku i bez čitanja ovog izveštaja. On međutim jasno naglašava da pravni okvir u ovoj oblasti ispunjava međunarodne standarde, ali da se on još uvek ne poštuje. Kao jedno

od najvažnijih tela za implementaciju Zakona o jezicima, naglašava se Komisija za jezike, ali da je njen uticaj veoma ograničen i da joj nedostaju ljudski resursi.

Protokom vremena od sukoba 99. godine, problemi interno raseljenih lica i njihovog povratka su zapostavljeni. Posebno zabrinjava činjenica, o kojoj i izveštaj gojori, da je budžet namenjen povratku značajno smanjen od strane Vlade. U dokumentu se navode problemi sa kojima se susreću interno raseljena lica i povratnici, od kojih bi istakao socijalno-ekonomske probleme, imovinsko - vlasnička pitanja, međuetničke tenzije u pojedinim sredinama. Mnoga raseljena lica žive u teškim uslovima, a probleme nepriznavanja dokumenata, restitucije zemljišta i drugih navedenih problema treba rešiti u sklopu započetog dijaloga Prištine i Beograda. Proces povratka je ostao izazov za Kosovo. Institucije Kosova ne treba da dozvole da nas Evropa podseća da svima onima koji žele da se vrate u svoje domove, to mora da bude omogućeno.

I na kraju, dame i gospodo, želeo bih da kažem nekoliko reči i o delu Izveštaja koji se odnosi na ekonomiju Kosova, a koja se osim na celokupno kosovsko društvo, tiče i života manjinskih zajednica. Nije neophodan izveštaj da bi se videlo da se na Kosovu živi teško, ali jasni i sistematično prikazani podaci od 45% nezaposlenih, padu naplate poreza čak i u apsolutnom smislu, podatak od 50% neaktivnih pravnih subjekata ili dugim i skupim sudskim postupcima, deluju pesimistično. Nemamo međutim pravo da se predamo pred ovim problemima, već treba da budemo iskreni jedni prema drugima i podsetimo da privreda Kosova i kosovsko društvo u proces ispunjavanja evropskih standarda nisu krenuli od solidne osnove, kao na primer Češka, Poljska ili Slovenija.

Naši evropski partneri ne očekuju od nas da izveštaj doživimo kao...

(Nërpjetje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ju lutem, edhe një minutë!

PETAR MILETI: Naši evropski partneri ne očekuju od nas da izveštaj doživimo kao ukor strogog učitelja, niti da gubimo vreme i energiju na objašnjenja o istoriji sistemskih problema na Kosovu, već očekuju da se ozbiljno suočimo sa izazovima razvoja ekonomije. Izveštaj kaže da 90% javnih preduzeća ostvaruje dobitak, s druge strane nekoliko energetskih i rudarskih giganta drastično opterećuju budžet, što jasno pokazuje šta treba da budu naši prioriteti. To su hrabri i odlučni potezi u privatizaciji, restrukturiranju ili pronalaženju strateških partnera kako bi ti giganti postali motor ekonomskog razvoja. Međutim, zabrinjava činjenica da Zakon o energetici ili rudarstvu izazove daleko manje interesovanje i strasti nego Zakon o Velikoj Hoći, u kome univerzalnoj i kulturnoj baštini se pokušava dati osnovna institucionalna zaštita koje ne ugrožava ni kosovsko društvo, ni kosovski budžet. To je onda dublji...

(Ndërrprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Nga grupi “6+”, fjalën e ka deputeti Fikrim Damka.

FIKRİM DAMKA: Sayın Meclis Başkanı, saygıdeğer bakanlar, Avrupa Birliği ilerleme raporunu dikkatlice incelediğimizi ve 9 ay içerisinde Kosovada gerçekten bir ilerlemenin kaydedildiği çok memnun edici olmamasına rağmen bazı hasas konularda ciddi adımların atıldığını gördük.

Kosova da raporda da belirtildiği gibi en büyük sorunumuz toprak bütünlüğünün ve ekonomik kalkınmanın gerçekleşmemesi, bunun yanında yasaların gecikmesi ve çıkan yasaların uygulanmaması.

Kuzey Mitrovicada KFOR gerekli düzeni sağlamasına rağmen uzun vadede Statükocu bir politika izlemesi, Kosovanın Avrupa Birliği ile entegrasyonu sağlaması zaman açısından engel teşkil edecektir.

Kosovanın Avrupa birliği entegrasyona ilkin yasal süreç ve prosedürleri gecikmeli olsa da ağustos ayına kadar yoğun çalışma göstererek hata meclis tatil yapmayarak yerine getirmeyi tümüyle başarılı olmamasına rağmen Meclis bu konuda ilerleme katetigine işaret etmek istiyorum.

IMF ve Dünya Bankası ile yapılan Stand By anlaşma gereği bazı kanunların hükümet tarafından uyumlu hale getirilmemesi, meclis komisyonların çalışma temposunu düşürmüştür ve ayrıca ifade etmek gerekirse sağlık sektöründe gerekli yasal süreci başlatılamadı. Kosova sağlık sigorta sisteminine geçisi her geçen gün geciktirilmektedir.

Kosova ilk defa uzun vadeli Avrupa Birliği fonlarından 67 milyon avro değerinde IPA programı çerçevesinde destek almış ve bu Kosovanın özellikle ekonomi, ticaret, sanayi ve kamu reformlarında kullanılması öngörülmüştür, hükümet 2011 yılında bu desteği almasına rağmen ciddi adımları atmadığını görmüş değiliz ama bu kaynakların kullanımında dikkatli davranılması gerektiği ortadadır.

Kosova blindiği gibi 2011 yılında seçim gecirmiş ve sancılı bir cumhurbaşkanı seçim sonucu anayasa mahkemesi kararına uyarak yeni cumhurbaşkanı seçimleri gerçekleştirdi. Seçim sürecinde meydana gelen usulsüzlükler halkımızda ciddi güvensizlikler oluşturduğu raporda belirtilirken seçim sisteminde bazı değişikliklerine ve düzeltmelerin yapılması gerekliliği ortaya çıkmıştır.

Seçim sisteminde ki açık liste uygulaması bugüne kadar demokratik ülkelerde gıpta ile bakılan ve Kosovada uygulanan sistem var iken bu günlerde yine Avrupa Birliğinin tavsiyelerini hiçe sayarak kapalı liste sistemine geçiş için merkez seçim komisyonun tavsiyelerin anlamak mümkün değil. Butun partilerde demokrasiyi yok edecek olan bu tür bir sistem küçük partilerin içerilerinde huzursuzluklar yaratacağı açıktır. Merkez seçim komisyounu seçimde çalışan kişilerin parti yetkililerinden değil de devlet memurlarından oluşturulması, seçim bölgelere oluşturulması, usulsuluk yapan kişiler üzerinde ciddi cezaların takibi ve listelerin temizlenmesi üzerinde durmaları belki daha isabetli olacaktır.

Bu tur olayalar hukümetin iki konuda daha ciddi yaklasmasını itigini gormekteyiz.Ozelikle yasamada boslukların doldurulması için yasal düzenleme ve mahkemelerin işlevseligine hız kazandırmakti ki bu konuda ilerleme katedildigini ama yinede mahkemede bir görev dağılım sorumsuzluğu yasandigi ve kanunlardaki boşluklar sebebiyle hakimlerin keyfi ve ya zoraki kararların alabildigini gorebilmekteyiz veya mahkeme tarafından alınan kararların ilgili kurum ve kişiler tarafından uygulanmadigin gorebilmekteyiz.

Yolsusuzlukta da ciddi sorunlarımızın var olduğu ve iç denetim ve dış denetimlerin artırılması gerektiği ortadadır.Gunumuzde ihallelerde usulsuzlukların varlığı ve devlet butcelerinin zarara uğratıldığını da gormekteyiz.

Kosovada Topluluk hakları konusunda, ilerleme raporunda objektiv olarak yaklasıldığını gormek mümkün ama eksik olduğunu da soylemek istiyorum.

Bizlerin sıkça dile getirdigimiz fakat dikkate alınmadigimiz Avrupa bilgisi ilerleme raporunda çok net bir şekilde dile getirilmiş.Ben noktalar şeklinde birkaçını yine saymaya çalışacam.

-Kosova Radyo televizyonunda yeteri kadar zaman ayrılamamsi ve ayrılan zamanın doldurulması için programların yapımına gerekli özen ve teknik donanımın RTK idaresi tarafından sağlanılamaması.

-Kultur derneklerimizin yeteri kadar belediye ve kultur bakanligından destek alamamaları
-Türkçe eğitimde Türkçe yazılan ve tercüme edilen su anda hazır bakanlıkta bulunan basılmaayı bekleyen kitapların halen basılmaması, kosova haritalarının ve atlaslarının Türk dilinde olmaması,Türk çocuklarına okutulan arnavutça dilinin kitaplarının olmaması,

-Türkçe eğitimin okutulduğu okullarda Türkçe dilinin kullanılmamsi

-Kosovada resmi kulanımda ve Prizrende Türkçe resmî dil olmasına rağmen, bugün belediyede asılan yeni tabelaların tek dilde arnavutça olması,resmî dillerin ihlali anlamını tasırmaktadır.

-Belediyeye bağlı kurumlarda Türkçe bildirilerin,aile sağlık merkezlerinde,belediye hizmetlerinde,polis merkezlerinde,belediye mahkemelerinde Türklerin yokluğu halkımızın Kendi ana dilinde hizmetlerinden yoksun olmalarına sebebiyet vermektedir.

-Prizrende kimliklerin Türkçe verilmemesi

-Prizren Kamu üniversitesinde Türkçe dilinin kullanılmaması

-Beldeye de doğum belgelerin ve diğer evrakların Türkçe olmaması, gibi sayabileceğimiz ihlallerin de raporda yer alması gerektiğine inanmaktayım

-Polis, kosova güvenlik güçlerinde yeteri kadar Türklerin yer almaması,yapılan giriş sinavlarında kendi anadillerinde yapılamamsi bizim çocukların başarısız olmasına sebebiyet vermektedir buda gunumuzde brakin topluluk haki olarak ama bireysel hakların da ihlali olarak görülmektedir ayrıca kamu iş yerlerinde de PTK ve KEK gibi kurumlarda savaş sonrası Türklerin işe alındıkları görülmemistir Kosova ilerleme raporunda zor durumda olan ve acilen desteklemesi bekleyen emeklilerimiz hakkında bilgiler vermesine karşın bizim kanantımız acilen emekliler yasaının hukümet tarafından meclise gönderilemsi gerkemetedir Kosovanın ilerleme raporunda ekonomi kalkınmanın

gerçekleşmesi için hükümetin daha fazla çalışması gerektiği dikkat çekilirken bence en önemli konu kayıtlı şirket sayısının yaklaşık yüzde elisinin pasif olmasıdır. Kosovada iş yapmanın zor olduğun bir göstergesidir. Ekonomi kalkınmayı sağlamak için ekonomide çok farklı bir siyaset izlenmesi gerektiğinin altını çizmek istiyorum.

Sadece gümrük vergileri ile bütçe ve Kosova ekonomisi ayakta kalamaz acil bir şekilde sağlanan fonlar ile üretime dönük yatırım yapan şirketlere destek olunmalıdır, aksi takdirde Kosova hedeflediği bütçeye ulaşamayacağını ve ciddi bütçe açıkları ile karşılaşacaktır.

Enerji sektöründe ki kara delik Kosovanın kalkınmasında ciddi sorunları teşkil etmektedir.. Bütçeden ciddi rakamlarda destek alan enerji sektörü bugüne kadar gerekli ilerlemeyi yapamadığı ve ekonominin kalkınmasında ciddi sorun olarak görülmeye devam etmektedir.

Kosovanın bölgede tek ülke olarak izole edilmiş olması Kosovada sosyal dengeleri bozduğunu da dikkat çekmek istiyorum sadece Kosova vatandaşlarına Avrupa ülkelerin kapılarının kapalı olması akıllarda çift standart uygulamasının olduğunu düşündürmektedir.

Kosovanın jeopolitik konumu, bu bölgede Heroin, kirli paranın aklanması, terörizm gibi konular da bas göstermektedir bu konuda Kosova polisi bölge ülkeler ile iyi bir işbirliği içinde olmasının gerekliliği açıktır bu konuda uluslararası toplumunu polis akademisine daha fazla destek ve polis güçlerinin çalışma şartlarının daha da iyileştirilmesine yönelik adımların atılması Kosova vatandaşların güvenliğinin istenilen düzeyde olması gerekmektedir.

Sonuç olarak Kosova Avrupa Birliğine adım adım yaklaşıırken yukarıda bahsi geçen konularda daha ciddi yaklaşmalı ve çözüm getirmelidir, biz Türk toplumu olarak elimizden gelen desteği vermeye de hazırız çünkü bu Kosova da bizim varız...

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Por, mendoj që duhet ta keni parasysh, që kur të flisni në emër të Grupit parlamentar dhe të Komisionit, gjuhë zyrtare, janë dy gjuhë zyrtare. Është mirë ta respektoni Kushtetutën!

Do të thotë, përfunduar me grupet parlamentare. Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, në tekstin e tij kryesisht përqendrohet në termat si “nivel i ulët i kapaciteteve njerëzore” dhe “nivel i ulët financiar” tek një numër dominant organizatash buxhetore. Rrjedhimisht, nga niveli i ulët i këtyre dy elementeve kyçe, për çdo administratë publike dalin një mori defektesh zinxhimore, siç është baza e dobët legjislative, e cila për pasojë ka institucione të dobëta, e si rezultat i këtyre institucioneve të dobëta, hasim në ngecje në procesin e integritetit evropian.

Gjithashtu, terminologjia e vlerësimit me të arriturat institucionale, si “të arriturat e kënaqshme”, “progres i vogël”, “progres i limituar” e tjerë, edhe pse politikisht korrekte, sugjerojmë për një nivel brengosës të zhvillimit institucional në Kosovës. Në emër të Lëvizjes për Bashkim, në pika të shkurta do të elaboroj historinë dhe disa pjesë të këtij dokumenti.

Raporti i Progresit tani rreth 7 vite paraqet njërin nga docentet kyçe të Komisionit Evropian për vlerësimin e punës të institucioneve tona. Ky dokument ka për detyrë që në fund të çdo viti të përshkruaj gjendjen reale të përkushtimit të institucioneve tona drejt transformimit demokratik, drejt shndërimit të këtyre institucioneve në prodhues të mirëfilltë të bazës së shëndoshë legislative dhe institucionale, e cila më pas do të ishte e gatshme për të ofruar kushte më të volitshme për zhvillimin e të gjitha sferave të jetës në Kosovë. Kjo paraqet edhe një lloj presioni për institucionet tona që të ndërmerren ndryshime pozitive në sferat politike, sociale dhe ekonomike dhe duke vazhduar me sigurimin e qëndrueshmërisë së tyre.

Në fillim, ky dokument ka qenë i panjohur për publikun kosovar, e madje edhe për një numër të konsiderueshëm të zyrtarëve në institucionet tona. Këtë e them bazuar në hapësirën mediave, e cila i është ndarë këtij dokumenti përgjatë këtyre viteve, për çka jemi dëshmitarë të gjithë.

Nga një dokument pak i dëgjuar, pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, është shndërruar në një udhërrëfyes, por ja që ky udhërrëfyes për tri vite rresht vazhdon që të përsërisë kritikën e njëjta, si kritika për Ligjin për mbi prokurimin publik, i cili për dy vite me radhë ka qenë i kritikuar për kualitetin e tij, ndërsa në vitin e tretë ka arritur që të marrë një formë të mjaftueshme.

Të mos harrohet lufta e mangët kundër korrupsionit, çështje e cila edhe më tej vazhdon të përsëritet. Gjithashtu, kur është fjala për zgjedhjet institucionale, të cilat në çdo vend demokratik paraqesin bazën e ndërtimit demokratik, Komisioni Evropian në Raportin e Progresit të fundit i karakterizon ato si jo kredibile.

Vëmendje të veçantë të niveli buxhetor, i cili konsiderohet jo i mjaftueshëm për jetësimin e një numri të madh të strategjive, nëpërmes të planeve të tyre të veprimit, e gjithë kjo nga investimet publike enorme, gjë që sugjeron në paaftësinë e Qeverisë për hartimin e politikave efektive fiskale. E nëse këtë e transformojmë në terme reale, ajo sugjeron se të gjitha kërkesat që dalin nga ky raport i progresit, nuk do të mund të realizohen jo vetëm për shkak të kapaciteteve të ulëta njerëzore, por edhe për shkak të mjeteve jo të mjaftueshme për t'i jetësuar këto kërkesa.

Është me rëndësi të përmendet që aty ku ka fillim të ndonjë progresi, çuditërisht punët mbesin të përgjysmuara. Këtë karakter të zhvillimit e hasim, për shembull, tek reformat në Administratën publike, ku ka pasur investime të theksuara nga Komisioni Evropian në draftimin e një numri të theksuar të strategjive, të cilat në fund të ditës nuk implementohet sa duhet në mungesë të disa ligjeve dhe rregulloreve, si dhe për arsye të

interferimit të politikës në ndërtimin e një administrate profesionale dhe të institucioneve të pavarura.

Në gjysmë të rrugës ka ngelur edhe lufta antikorruption, e cila ka shënuar një përparim të vogël, duke shqyrtuar disa raste të korrupsionit dhe në të njëjtën kohë duke përmirësuar strukturën njerëzore dhe ligjore, mirëpo lufta kundër korrupsionit mbetet ende larg nivelit të dëshiruar. Kjo fushë ka nevojë për rol më proaktiv, sidomos në implementimin ligjor dhe të gjyqësorit.

Sa i përket sistemit gjyqësor, ka pasur përparime si në kuptimin e organizimit, ashtu edhe në kuptimin e përmirësimit të kushteve për gjyqtarët dhe prokurorët. Janë themeluar Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, të cilët kanë filluar që t'i adresojnë çështjet e ngecura në kuadër të sistemit gjyqësor, edhe pse ato si organizma ende mbeten të pakompletuara. Në përgjithësi, sistemi gjyqësor mbetet i dobët dhe jo efikas. Ajo çfarë paraqet kërcënim serioz, është ndikimi i politikës në sistemin gjyqësor.

Raporti i Progresit këtë vit i kushton më shumë hapësirë, krahasuar me vitet paraprake, sektorit të shëndetësisë, më saktësisht politikave të shëndetësisë publike, ku rezulton se është shënuar pak apo diçka progres dhe atë kryesisht për shkak të përvetësimit të strategjisë për sistemin informativ shëndetësor dhe planet e veprimit 2010-2020. Ndërkaq, kritikata shkojnë në drejtim të mangësisë së të dhënave statistikore në nivel të komunave, mungesa e Ligjit për shëndetësi dhe sigurime shëndetësore, përparim i vogël në drejtim të implementimit të legjislacionit për gjak, inde dhe qeliza, vdekshmëria e fëmijëve vazhdon të jetë e lartë, nuk luftohet abuzimi i substancave narkotike dhe nuk ka madje as politikë për parandalimin e sëmundjeve jo infektive. Është parë përparim shumë i vogël sa i përket implementimit të programeve të skringut për kancerin gjirit servikal dhe kolorektal.

Shërbimet shëndetësore nuk arrijnë sa duhet deri te komunitetet minoritare, posaçërisht te romët, ashkalitë dhe egjiptianët. Kritikata drejtohen edhe për shëndetin mental. Edhe Raporti i Progresit thekson atë që kemi theksuar edhe ne si përfaqësues të Lëvizjes për Bashkim disa herë këtu, se buxheti për sektorin e shëndetësisë është i ulët dhe si i tillë pamundëson zhvillimin e këtij sektori. Mbase, do të jetë Raporti i Progresit, i ashtuquajtur i udhërrëfyes, ai që do ta bind Qeverinë tonë që të investojë më shumë për shëndetësinë, nga se vdekshmëria e lartë e foshnjave dhe e fëmijëve, më e larta në Evropë, tri deri 10 herë më e lartë se e vendeve fqinje, duket se nuk është bindëse mjaftë. Për më tepër, Raporti i Progresit nuk e ka bërë një analizë të hollësishme të shëndetësisë në Kosovë, se përndryshe do të ishte edhe më dekurajues.

Në fushën e arsimit, gjithashtu Raporti i Progresit demonstroi për pak apo diçka progres dhe kryesisht për hir të legjislacionit, i cili ka shënuar një përmirësim. Ndër të tjera, kritikohen qasja e pamjaftueshme e femrës në edukimin profesional, si dhe nevoja për zhvillimin e statistikave lidhur me arsimimin, duke përfshirë këtu edhe numrin e studentëve dhe përqindjen e punësimit të të diplomuarave.

Ndërkaq, fusha e hulumtimeve shkencore në këtë raport paraqitet shumë brengosëse dhe larg standardeve evropiane.

Duke qenë se personalisht jam e involvuar në fushën e hulumtimeve shkencore, më vjen keq se më është dashur ta lexoj Raportin e Progresit për të kuptuar se janë ndarë 1 milion euro për të financuar projekte hulumtuese dhe se për stimulim të shkencëtarëve ndahet çmimi hulumtuesit më të mirë kosovar dhe hulumtuesit të ri më të mirë.

Atë që dua të theksoj, është se shpresoj që hulumtuesit e tjerë që orvaten të shkrepin një shkëndi në errësirën e shkencës kosovare, të kenë dëgjuar për këto fonde dhe që ato të shkojnë në vendet meritore, sepse mos harroni që Komisioni Evropian në fillim kërkon nga ju të bëni stimulimin, e pastaj pret rezultatet dhe këto rezultate janë shumë lehtë të matshme, pra me publikime ndërkombëtare të punës në të cilën është investuar. Dhe ndonëse investimi nuk ka shkuar në vend të duhur, ju siguroj që publikimi nuk do të ndodhë kurrë. Ndërkaq, përsëri në raportet e ardhshme të progresit do të figurojë se nuk ka progres në fushën e hulumtimit.

Si përfundim, arsyeja në rastet e këtilla sugjeron në krijimin e prioritetëve për zhvillimin e administratës publike, me këtë rast si më prioritet do të duhej vendosur mediotokracia në administratën publike dhe në shoqëri në përgjithësi, e cila në vazhdim do të forconte resurset humane, të cilat si prioritet do të kenë forcimin serioz të kapaciteteve për draftimin e legjislacionit.

Nëse zyrtarët tanë të lartë vazhdimisht shprehen se ky raport duhet të na shërbej si udhërrëfyes, atëherë ju sugjerojmë që ashtu edhe të veprojnë e mos të lejojnë që me vite të përsëriten kritika të njëjta. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e merr deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

Unë do të flas për një çështje konkrete, që është përmendur në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, jo Raportin e Komisionit të Parlamentit Evropian, sepse një organ i tillë nuk ekziston, siç u përmend më herët nga partia në pushtet. Do të flas për mungesën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave, çështje apo shqetësim që është përmendur në faqen 15 dhe 16 të Raportit të Progresit, për të gjithë ata që dëshirojnë t'i referohen, sepse nuk do të flas gjëra që nuk janë përmendur në atë raport apo që nuk janë përmendur nga vetë gazetarët.

“Progresi në fushën e lirisë së shprehjes është i kufizuar. Gazetarët vazhdojnë të përballen me presion politik dhe me frikësim, gjë që po kërcënon gazetarinë hetuese apo hulumtuese, e cila edhe ashtu është ende fragjile”. Këto që sapa i citova, nuk janë

fjalët e mia, por janë vlerësimet e Komisionit Evropian në Raportin e Progresit të vitit 2011. Ky raport për më tepër konfirmon edhe një shqetësim të kahmotshëm të LDK-së dhe të çdo qytetari të Kosovës lidhur me pavarësinë e Radio-televizionit të Kosovës.

Sipas Komisionit Evropian, pavarësia editoriale e RTK-së, si transmetues publik, nuk është e garantuar dhe RTK-së i mungon financimi i qëndrueshëm, që rezulton në minimin e pavarësisë së këtij televizioni publik. Fatkeqësisht, ditëve të fundit, edhe përpjekjet e këtij Kuvendi për miratimin e Ligjit të ri për RTK-në po përballen me ndërhyrjet të cilat kanë për qëllim ngulfatjen e pavarësisë në programet e caktuara të Radio-televizionit të Kosovës.

Edhe gjatë këtij viti, liria e shprehjes dhe liria e shtypit në Kosovë ka vazhduar të degradohet si rezultat i presioneve dhe ndërhyrjes politike në media. Shqetësimi për cungimin e lirisë së shprehjes po dëshmohet edhe në raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat Kosovën e renditin në fund të listave të tyre sa i përket mediave të lira dhe të drejtës në shprehje të lirë.

Sipas Freedom House, Kosova renditet në fund të listës së vendeve të Ballkanit, në vendin e 104, me një rezultat prej vetëm 51 pikë, nga 100 pikë të mundshme. Pra, Kosova e këtyre ditëve po shpallet kampione rajonale e mungesës së lirisë së shprehjes, duke dalur edhe mbrapa Shqipërisë, Malit të Zi, Kroacisë, Bosnjës, Maqedonisë e të gjitha vendeve të tjera të rajonit.

Edhe misioni i OSBE-së në Kosovë, përmes raportimit vjetor të lirisë së shtypit shpreh shqetësimet për ndërhyrjen e Qeverisë dhe financimin që iu bën Qeveria disa medimeve, duke konstatuar se liria e shtypit në Kosovë matet sipas shpërndarjes së reklamave nga pushteti. Ndërkaq, Unioni i Gazetarëve, pra gazetarët vetë, që duhet t'i marrim shumë seriozisht, shprehën se liria e shtypit do të duhej të ishte një shqetësim më i madh për institucionet e Kosovës dhe ata të cilët e cenojnë lirinë e shprehjes. Ndërkaq, AGKP, Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, në raportin e tyre titulluar: Raporti mbi lirinë e mediave në Kosovë, nga lista e 101 gazetarëve të intervistuar, 70 prej tyre kanë identifikuar Qeverinë si kërcënimi më i madh për lirinë e shprehjes. Paramendoni sa serioze është kjo, kur më shumë se gjysma apo shumica dërmuese e gazetarëve të intervistuar, publikisht thonë se Qeveria është kërcënimi i tyre kryesor.

Llogariteni që gjysma tjetër nuk ka guxuar ta thotë këtë për shkak të kërcënimeve të përditshme që i kanë në punën e tyre. Madje në një deklaratë të AGKP-së, të publikuar menjëherë pas publikimit të Raportit të Progresit, thuhet se, citoj: “Liria e medias në Kosovë është në gjendje edhe më të rëndë nga sa është raportuar në Raportin e Progresit”. Ata vënë theksin kryesisht në kërcënimet e gazetarëve, presionet politike dhe varësinë financiare të shumicës së medimeve.

Edhe pse një pjesë e madhe e mediave është në pronësi private dhe diversiteti i mediave në Kosovës vazhdon të rritet, fatmirësisht, të përditshmet në Kosovë ende mbesin të lidhura me partitë në pushtet, të cilat përmes marketingut dhe formave të tjera

të financimit mbështetin mediat e tyre që i favorizojnë. Shumë nga këto gazeta mbështeten nga reklamat e Qeverisë dhe Qeveria ka vazhduar të shpërndaj reklama dhe njoftimet e tyre në mënyrë të pa barabartë, natyrisht për t'i favorizuar mediat miqësore. Mediat vazhdojnë të vuajnë nga presioni politik dhe shpesh janë të detyruar të praktikojnë edhe vetëcensurën, në mënyrë që t'i shmangen mbulimit të temave politikisht të ndjeshme. Shembuj të tillë ka mjaftë në Kosovë. Kemi rastin e gazetarëve të programit “Jeta në Kosovë”, të cilët ishin të kërcënuar seriozisht nga zyrtarë të lartë qeveritarë, pastaj në shkurt të këtij viti, një gazetari të përditshmes “Koha Ditore”, raportoi se është kërcënuar në përgjigje të një artikulli dhe raportoi se policia e inkurajoi që të mos paraqes një ankesë.

Absurditeti rritet edhe më shumë kur gjykatat, për shkak të ndërhyrjeve politike, shpallin dënime të tilla për gazetarët që t'i shtynë ata të ndihen se nuk kanë mbështetje për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese, që janë liria e shprehjes dhe liria e mediave, respektivisht të mbrojtura në nenin 40 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Prandaj, i bëjmë thirrje Qeverisë që të ndalojë çdo lloj të formës së presionit ndaj mediave në Kosovë. Liria e të shprehurit dhe shtypit janë parakushtet themelore dhe gurë themele të demokracisë së një shteti, krahas respektimit të të drejtave të njeriut dhe mbajtjes së lirë të zgjedhjeve. Në të gjitha këto parakushte, Qeveria fatkeqësisht ka treguar mosgatishmëri dhe, ajo që është më e keqja, të gjitha raportet vendore dhe ndërkombëtare po tregojnë për përkeqësim të situatës.

Përfundimisht, vlerësimet kritike të Raportit të Progresit do të duhej të shfrytëzoheshin për të ndërtuar një udhërrëfyes apo plan konkret për të tejkaluar këtë mungesë së lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave. Natyrisht që do të ishte obligim i këtij Kuvendi që të monitorojë zbatimin e një plani të tillë. Mbi të gjitha, këtë e kemi obligim kushtetues. Siç e përmenda më herët, neni 40, 41 dhe 42 mbrojnë lirinë e shprehjes, të drejtën në qasje në dokumente zyrtare dhe lirinë e mediave. Në të tria këto raste, thuhet se këto liri garantohen me Kushtetutë dhe nuk mund të cenohen apo të censurohen. Prandaj, në mënyrë që Kosova vërtet të thuhet që po ecën drejtë Evropës, në mënyrë që mos të jemi në fund të listave Freedom House dhe të mos kritikohemi çdo ditë nga OSBE-ja dhe nga vetë gazetarët dhe të paraqesim një gjendje të kundërt, besoj që Qeveria duhet t'i marrë jashtëzakonisht serioze këto kritika që paraqiten në Raportin e Progresit, të cilat unë thjesht vetëm i citova, sepse derisa nuk ndryshon kjo gjendje dhe nuk ka liri të shprehjes dhe të mediave, nuk do të ketë demokraci, e mbi të gjitha nuk mund të ketë assesi integrim në Evropë. Ju faleminderit!

KRYESUSI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Një sqarim, pasi që çështja e mediave është jashtëzakonisht e ndjeshme. Përsëri dëshiroj të sqaroj para qytetarëve të vendit dhe para të gjithë juve, në Raportin e Progresit askund nuk përmendet roli i Qeverisë me mediat, por presioni i politikës, se politikë jeni të gjithë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka ministri Bedri Hamza.
Regjia, zonjës Osmani fjalën, për replikë!

VJOSA OSMANI: Vetëm desha ta saktësoj, sepse natyrisht që edhe RTK-ja, RTK-ja është media, edhe kërcënimet dhe intimidimet apo frikësimet ndaj gazetarëve, që po ashtu paraqesin media, përmenden në faqen 15, paragrafi i fundit dhe në faqen 16, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Raportit të progresit. Këto janë të gjitha mediat që po përmenden dhe jo diçka tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Vetëm tregohu e sinqertë, a përmendet Qeveria apo politika? Nëse përmendet politika, jemi të gjithë dhe të gjithë duhet të marrim përgjegjësinë, nëse përmendet Qeveria, e marr përgjegjësinë, por mos dezinformoni. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Jo, jo, mos ta çojmë në pa kufi, Vjosë!
Politikë, është e vërtetë që janë të gjithë. Qeveria e ka përgjegjësinë kryesore se është qeveri, është pozitë.

Fjalën e ka ministri Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari zoti nënkryetar i Kuvendit,
I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Deputete dhe deputetë të nderuar,
Të nderuar të pranishëm,
Për çudi, kur nganjëherë bëjmë krahasime dhe marrim për bazë vitin 2007, disa individë i ikin kësaj, nuk dëshirojnë të ballafaqohen me këtë, por sot këtu u përmend dhe kanë të drejtë ata pse i ikin kësaj, kur ne dëshirojmë të krahasojmë me vitin 2007, se në vitin 2007, nëse e krahasojmë nëntëmujorin e vitit 2007 me nëntëmujorin e vitit 2011, shohim se në vitin 2007 investimet kapitale kanë qenë veç 62 milionë. Kur e krahasojmë atë periudhë prej vitit 2004 - 2007, e dimë se nuk është rritje asnjëherë paga. Kur e shohim atë periudhë dhe e krahasojmë me tash, e dimë që buxheti i Kosovës ka qenë në masën vetëm diku rreth 700 milionë.

U përmend këtu që duhet ta shikojë Raportin e Progresit real dhe ta lexojmë real. Por, kut themi - ta lexojmë real, nuk duhet ta lexojmë as bardh as zi, por ta lexojmë ashtu siç është dhe me qëllim që jemi sa më objektiv.

Raporti i progresit, është e vërtetë që përmend rritjen e shpenzimeve, por ku ka ndodhur rritja e shpenzimeve? Ka ndodhur rritja e shpenzimeve në paga, janë rritur pagat në kategori të cilat janë përmendur. Ka ndodhur rritja e shpenzimeve në investimet kapitale dhe ka ndodhur rritja e pagave në subvencione dhe transfere. Por, gjithashtu, duhet të thuhet se ka ndodhur edhe rritja e të hyrave dhe rritja e shpenzimeve është përcjellë me rritjen e të hyrave.

Raporti i Progresit e përmend shumë qartë se ka pasur rritje të eksportit për 36% dhe këtë e thotë në faqen 24. Raporti i Progresit, gjithashtu thotë se ka pasur rritje të GDP për kokë të banorit. Raporti i Progresit, gjithashtu thotë se ka pasur edhe rritje të importeve, por përqindja e rritjes së importeve ka qenë më e vogël se sa e eksporteve, edhe pse deficitit tregtar vazhdon të jetë ende i lartë, sepse dihet që disa vështirësi dhe disa probleme ekonomike nuk mund të zgjidhen për periudha shumë afatshkurtëra. Raporti i Progresit e përmend, gjithashtu, se ka pasur edhe rritje të dërgesave nga diaspora, apo remitenca 6%. Raporti i Progresit, gjithashtu, e përmend se ka pasur rritje të huaja të investimeve deri te 7.5%, po them faqja 25, raporti në gjuhën shqipe në përgjithësi, raporti thotë se korniza monetare ka vazhduar të funksionojë, relativisht mirë, gjithmonë reforma në menaxhimin e financave publike ka mundësi që të ketë përmirësime dhe progresi gjithmonë nuk është kurrë i arritshëm, gjithmonë vazhdon që të ketë nevojë për më shumë progres.

Sa i përket rezervës buxhetore, në të kaluarën ne e dimë që Kosova ka pasur shumë nevoja dhe e dimë që ka pasur, thajse qind për qind, sa ka pasur buxhet, ka pasur suficit, përballë shumë atyre nevojave. Dhe, përmendet që rezerva buxhetore nga 342 milionë apo 8.7% e GDP-së, ka rënë në 244 milionë apo 5.9% e GDP-së. Domethënë, këtu ka qenë edhe kërkesa e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Gjithashtu, nuk e thanë e do të ishte mirë të thuhet se është e arritur për Kosovën që në 8 muajt e parë të vitit 2011, ekzekutimi i buxhetit ka shënuar performancë të fortë në të ardhurat tatimore, 17% rritje vjetore.

Kjo 17% rritje vjetore nuk është si rezultat i tatimeve të reja, nuk është rezultat i normave të reja tatimore, por si rezultat i ngritjes së punës dhe efikasitetit të institucioneve, të cilat merren me administrimin e të hyrave.

Gjithashtu, raporti e përmend që në shpenzimet kapitale kemi pasur një ngritje prej 61%. Sa i përket sektorit financiar, gjithashtu raporti thotë se është zgjeruar për 13.7% në 2010, duke quar vlerën totale të aseteve në 3.2 miliardë euro apo 78% e bruto produktit vendor. Gjithashtu, raporti e cek se ka mbetur i kënaqshëm niveli i përshtatshmërisë së kapitalit të sistemit bankar dhe ka mbetur solid që është mbi 17%.

Në përgjithësi, ndërmjetësimi financiar ka vazhduar të thellohet si dhe përkundër rritjes sektori bankar ka mbetur stabil dhe fitimprurës. Ka vazhduar të rritet maturimi i kredive, gjithashtu depozitat e amvisërisë janë rritur 70%, kjo si rezultat i besueshmërisë në sistemin bankar dhe kjo rritje ka ndodhur për 18%.

Në përgjithësi baza e depozitave dhe aktiviteti kreditor ka vazhduar të rritet, por kushtet e huadhënies kanë mbetur ende të shtrënguara.

Në faqen 31, raporti e përmend se është miratuar Ligji për ndihmën shtetërore në korrik të vitit 2011.

Në faqen 33, në përgjithësi sa përparim është shënuar në kornizën ligjore.

Në faqen 34, sa përparim mund të raportohet në fushën e shërbimeve financiare, Ligji mbi sigurimin e depozitave ka krijuar bazën ligjore për themelimin e Fondit të sigurimit të depozitave. Bordi i saj është emëruar në korrik duke përfshirë guvernatorin e Bankës Qendrore edhe përfaqësues të Ministrisë së Financave, përfaqësuesin e Shoqatës së Kontabilistëve të si dhe ekspert tjerë.

Ka pasur përparim në fushën e sigurimeve, Kuvendi ka miratuar Ligjin për sigurimin e detyrueshëm të palës së tretë. Në të njëjtën faqe- 34, ka pasur përparim në fushën e letrave me vlerë. Lëvizja e lirë e kapitalit ka pasur përparim të kufizuar në lidhje me lëvizjen e lirë të kapitalit në kontekstin e një regjimit tërësisht liberal. Në përgjithësi, sistemi për lëvizjen e kapitalit është tejte liberal.

Ka pasur përparim në fushën e doganave. Dhe kur jemi te fusha e doganave vërehet se kemi pasur një rritje të të hyrave, të cilat i administrojnë doganat për 18.72%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ka pasur përparim në kompletimin e infrastrukturës legale dhe në faqen 36, e cek se ka pasur marrëveshje të bashkëpunimit të cilat kanë shkuar mes Kosovës dhe vendeve tjera dhe në përgjithësi, legjislacioni në Doganat e Kosovës është gjerësisht në përputhje me Kodin doganor të BE-së.

Ka pasur ca përparim në fushën e tatimeve dhe nëse e krahasojmë vitin 2010 me vitin 2011, prapë raportin në faqen 36, kemi një rritje për 17.94%, ku theksohet se numrat fiskal tani jepen brenda ditës. Në përgjithësi, zbatimi i tarifave doganore është përmirësuar, sidomos në fushën e luftës kundër kontrabandimit dhe falsifikimit, është miratuar Ligji për ndihmën shtetërore dhe në përgjithësi ka pasur ca përparim në fushën e konkurrencës.

Prandaj, nëse dikush tenton që raportin ta prezantojë si diçka që nuk ka të arritura, ai realisht, domethënë, raportin e prezanton në një mënyrë të njëanshme. Me qëllim të sqarimit këtu e kam edhe tabelën se si ka qenë deficitin në vendet e regjionit.

Kroacia, 2010, 4.9% , 2011 - 6%.

Maqedonia në vitin 2010, 2.5% , në vitin 2011, 2.5%.

Mali i Zi 5%, në vitin 2010, 3.1% vlerësohen në vitin 2011.

Shqipëria, 3.1%, në vitin 2010, 3.5% në vitin 2011.

Serbia 4.9% në vitin 2010, 4.3% në 2011, ndërsa Kosova 2.4% në 2010 dhe 2.4% vlerësohet që do të jetë në 2011.

Sa i përket borxhit publik, Kroacia, 42% të GDP-së e ka borxhin publik,

Maqedonia, 25%, Mali i Zi, 49%, Shqipëria, 57%, Serbia, 41%, ndërsa Kosova, 5.4%.

Sa i përket rritjes ekonomike ne gjithë e dimë që rritja ekonomike duhet të jetë më e madhe, ka pasur rritje ekonomike, mirëpo po e bëjmë një krahasim me vendet e regjionit.

Shqipëria, 2.6% në 2010, Bosnja dhe Hercegovina, 0.5%, Kroacia, rritje negative, 1.5%, Kosova, 4%, Maqedonia, 1.2%, Mali i Zi -1.8% dhe Serbia 1.5%.

Prandaj, qytetarët e Kosovës e kanë të qartë, ata e kanë lexuar Raportin e Progresit dhe ata që dëshirojnë t'i minimizojnë të arriturat, të cilat janë të prezantuara dhe janë pjesë e Raportit të Progresit, konsideroj që realisht është humbje kohe se një gjë të tillë s'mund ta bëjnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

I kemi qytetarët lexues të fortë edhe i lexojnë të gjitha raportet, sigurisht.

Fjalën e merr deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Mua po më vjen keq që kryeministri nuk është këtu, sepse po dua t'i them që në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës edhe njëherë t'ia përkujtoj që viti 2000 ka marrë fund moti, që kurrkush më nuk i frikësohet kurrkujt e aq më pak kryeministrit Thaçi, prandaj s'ka nevojë të na qaset, po na kujton atë "tigrin prej letrës" këtu në Parlament.

Po i kthehem diskutimit mbi Raportin e Progresit. Raporti i Progresit evidencoi ngecje të shumta në funksionimin e shtetit dhe rrjedhimisht pasqyroj jetën shumë të rëndë të qytetarëve të Kosovës. Tonet tejet kritike, të cilat u evidencuan në këtë raport, në fakt nuk ishin befasi as për ne, nuk janë befasi as për qytetarët e Kosovës, sepse ata çdo ditë përjetojnë keq- qeverisjen e Qeverisë Thaçi.

Çdo ditë të gjithë ne që jemi deputetë e shohim se si na censurohen fjalimet e opozitës në media, si financohen mediat pro qeveritare, e dimë si jepen tenderët, si ngec funksionimi i zbatimit të ligjeve, si monopolizohet kontrolli i administratës, rritet krimi dhe zvogëlohet përgjegjësia mbi shtrirjen e sovranitetit në veri të vendit. Prandaj, ky raport nuk është aspak befasues, përkundrazi dhe pikërisht kjo do të jetë arsyeja që unë shumë pak do të ndalem në raport, sepse është një dokument i cili në vete ngërthen shumë nga ato që qytetarët e Kosovës i shohin dhe i përjetojnë çdo ditë nën sundimin e Qeverisë Thaçi, sepse është thënë edhe në raport, kjo qeveri ka humbur konceptin e qeverisjes me mono-tendencën për të monopolizuar gjithçka dhe në fakt ka filluar ta sundojë vendin.

Është diçka, nëse ju kujtohet që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka alarmuar shumë kohë më parë, edhe kur kjo Qeveri përgjegjëse na quajti "të frustruar"- besoj se të gjithëve ju kujtohet që pikërisht pikat një nga një, për të cilat sot fol raporti, janë nxjerrë kohë më parë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, si shqetësime se ka po shkon Kosova dhe kjo Qeveri këtu na tha që ne jemi disa njerëz të frustruar. Tash, unë nuk e di se si do t'i quani zyrtarët e Komisionit Evropian, a mos janë edhe ata të frustruar që po i ngritin këto tema?

Unë do të fokusohem në periudhën ndërmjet Raportit të Progresit dhe pas Raportit të Progresit. Na kujtohet të gjithëve një ditë kur, pas Raportit të Progresit, kryeministri Thaçi i mbledhi të gjithë ministrat dhe nuk harroi t'i ftojë edhe mediat dhe ta lë një përshtypje në opinion që nuk mungon përkushtimi, qoftë ai shumë simbolik, mirëpo në realitet vazhdoi avazin e vjetër dhe nuk bëri as më të voglën përpjeke për t'i përmbushur pikat kritike të këtij raporti. Dhe, këto pika duhet të përmbushen, të nderuar, jo vetëm për

shkak të Evropës, po në rend të parë për shkak të qytetarëve të Kosovës, sepse ata janë njerëzit të cilët po i vuajnë ngecjet e pikave të cekura në Raportin e Progresit.

Në vend që të organizohen që të përmirësojnë, pikë për pikë ngecjet, këta vazhduan që t'i përsëritin gabimet e njëjta. P.sh. raporti thotë: “shkallë e lartë e korrupsionit”- Qeveria ngutet t'u japë tenderë kushërinjve, siç ndodhi në Ministrinë e Shëndetësisë, vetëm disa ditë pas publikimit të Raportit. Raporti alarmon politizimin e bordeve dhe vetëm besoni 3-4 ditë pas këtij raporti, zyrtarë të lartë të Qeverisë, publikojnë marrëveshjet e partnerëve të koalicionit për futjen nën kontroll të bordeve të pavarura dhe këtu në Parlament, deklarojnë që është normale të shpërblehen militantët apo anëtarët e partisë.

Po i referohem përpjekjes së fundit për të emëruar zyrtarë partiakë në Komisionin për Miniera dhe Minerale. Raporti thotë, po citoj: “17 nga 20 vlerësimet ekonomike, shënojnë regres dhe ngecje, të gjitha janë shumë të rënda dhe lënë pak shpresë që do shohim përmirësim”. Vërejtja e parë që jepet është në politika makro- ekonomike dhe vë në pah mungesën e vizionit qeverisës, mungesën e një strategjie të mirëfilltë ekonomike, mungesën e prioritetëve, reformat strukturore dhe shpenzimet qeveritare. Dhe, ai plani famoz i Banjskos, si duket nuk është marrë seriozisht, as nga Komisioni Evropian, por nuk është marrë seriozisht as nga vetë hartuesi, përndryshe do të kishim të paktën pak progres.

Raporti thotë: “të meta në fushën e bilancit tregtar”-përveç se, për të mos i hyrë në hak, është një rritje e eksportit të hekurishteve dhe nëse këtë Qeveria e merr si progres, atëherë unë mund t'iu them -urime!

Kjo flet për disbalancin e madh aktual, por edhe nënvizon kufizimet në tërheqjen e investitorëve të huaj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Se sa shqetësuese është gjendja sa i përket investimeve të huaja në vend, tregon fakti që në rangimin e Bankës Botërore, jemi më keq se Irani dhe Somalia. Dhe, rrjedhimisht edhe vlerësimi mbi gjendjen e punësimit, raporti thotë: “ që ka qenë i padallueshëm”, domethënë nuk ka pasur vende pune. Dhe, kjo po vërehet për të gjithë ata, për të gjithë ne deputetët, pavarësisht a përfaqësojmë pozitën dhe opozitën që sot pas seancës dalim dhe ecim në këmbë prej Kuvendit e deri te Grandi, do takojmë dhjetëra të rinj, të cilët do të pyesin- a ka ndonjë vend pune? Dhe, edhe pa e thënë raporti ne shumë mirë e dimë. Raporti thotë: “varfëria vlerësohet si e thelluar nga inflacioni i lartë kosovar” ose thënë shqip rritja e çmimeve që po vazhdon të reflektojë në rënien e nivelit të standardit jetësor në Kosovë, për të gjithë qytetarët e zakonshëm.

Edhe pas këtij raporti, i cili është i treti me radhë dhe i njëjti, Qeveria Thaçi vazhdon të degradojë menaxhimin e financave publike, duke rrezikuar marrëdhëniet me FMN-n. Qeveria Thaçi instaloj praktika dispropocionale të shfrytëzimit të buxhetit, sepse paratë e buxhetit çdoherë u përdorën në fushata për të blerë vota, qoftë drejtpërdrejt, qoftë përmes projekteve fushatore. Qeveria Thaçi ka vrarë praktikatat e mira të konkurrencës duke i korruptuar bizneset për qëllime përfitimi dhe mbështetje për të siguruar pushtet dhe pas

gjithë kësaj mungese të përgjegjësisë dhe prapaktimit të Kosovës në rrugën e saj integruese, e cila me këtë stil qeverisës do të vazhdojë të prapakthehet edhe më tutje, e më keq. Do të ndalem për një moment te Ministria e Integrimeve, e cila ka për obligim koordinimin ndërministror e cilës nuk po dua t'i hyj në hak, ka bërë përpjekje, mirëpo ka qenë një hallkë e vetme që s'ka mund ta zbatojë apo ta arrijë zbatimin e dikastereve të tjerë dhe sado që të punojë nuk mund të ketë progres.

Qeveria Thaçi angazhon një zëvendëskryeministre, respektivisht ministren e Tregtisë dhe Industrisë, e cila po ashtu, nuk është këtu, sepse nuk është e interesuar të dëgjojë për raportin dhe për rekomandimet e deputetëve, të dalë dhe t'i zbukurojë të gjeturat e këtij raporti duke mos ndier asnjë fije keqardhje për të pavërtetat e plasuara në mediat, shumë prej tyre të kontrolluara nga Qeveria, një audience shumë të varfëruar, të cilës të drejtën për integritet dhe prosperitet po vazhdon t'ia mohojë çdo ditë Qeveria Thaçi. Dhe, krejt e fundit e që është sot, nuk mund të presim që të kemi raport pozitiv, as në të ardhmen kur Qeveria e Kosovës, del apo emëron ambasadorë të cilët në të kaluarën e tyre shumë pak i kanë shërbyer vendit, shumë më tepër i kanë shërbyer shërbimeve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, të cilët atë imazhin e sulmuar të Kosovës, ku kemi një kryeministër, më të izoluarin në rajon, do ta sulmojë edhe më tepër, sepse do të jenë përfaqësues të një imazhi i cili në asnjë moment nuk do t'i bëjë mirë Kosovës, kuptohet që edhe në këtë listë ka disa përjashtime, por në përgjithësi është për keqardhje dhe kjo flet që edhe në të ardhmen nën qeverisjen Thaçi, Kosova çdo vit do të marrë raporte të regresit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ministri Agani e do fjalën, po për replikë, u mor vesh.

FERID AGANI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
E nderuara deputete,

Paraqitja juaj sot dhe akuza që e bëre, flet më së miri për qasjen sipërfaqësore të cilën disa përfaqësues të opozitës në momente të caktuara e marrin ndaj zhvillimeve me rëndësi shtetërore në vend.

Të etiketosh një ministri për një aktivitet korruptues në bazë të një shkrimi të gazetës, pa kërkuar asnjë fakt real lidhur me një proces juridik, është me të vërtetë shkallë e lartë e papërgjegjësisë institucionale dhe drejtpërdrejt një përpjekje për manipulimin e opinionit dhe për fitimin e poenëve politik në një situatë mjaftë të ndjeshme për vendin, kur të gjithë jemi duke u munduar që proceset t'i drejtojmë në kahe pozitive.

Rasti konkret të cilit i referoheni, është rast i cili në mënyrë konkretet e dëshmon këtë që e thashë. Bëhet fjalë për një procedurë nëpërmjet të cilës Ministria e Shëndetësisë tenton që të lirohet nga një barrë e rëndë 12- vjeçare e grumbullimit të barnave dhe materialit hargjues me afat të skaduar, për të cilin unë kam pasur pyetjen e parë parlamentare në

këtë Kuvend, se kur kjo do të bëhet sa më shpejtë. Është ministria e parë e cila ka arritur të japë përgjigjen në këtë çështje, ka arritur të hap rrugën juridike-ligjore për zgjidhjen e këtij problemi, i ka hyrë një procesi juridik në bazë të ligjit, në bazë të legjislacionit aktual dhe ai proces është përfunduar në mënyrë plotësisht korrekte, pa asnjë ankesë nga palët e involvuara...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ministër, të kaloi koha për replikë. 2 minuta i ke. Kaq.
I kemi 60 veta që donë të flasin nga një minutë, bëjnë 60 minuta, 2 minuta i kalove. Kaq.

Zonja Donika Kadaj- Bujupi e ka një minutë, kundër replikë.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Papërgjegjësi është t'ia japësh tenderin djalit të axhës, është konflikt interesi, nën një. Në dy, kur ky djalë i axhës ka veç 2 punëtorë dhe ka kapital në firmën e tij 25 mijë euro dhe merr një tender prej 500 mijë euro, përsëri është shkelje, është për më tepër një vepër penale, është pistë për hulumtim. Unë nuk jam këtu gjyqsor, nuk jam prokuror, por i ftoj organet e rendit që të merren dhe të hulumtojnë këtë rast, e para dhe, e dyta, është gjynah edhe prej Zotit për të bërë këso shkeljesh dhe këso veprimesh dikush që e përfaqëson Ministrinë e Shëndetësisë, në kohën kur qytetarët e Kosovës kanë shumë probleme shëndetësore.

KRYESUESI: Ministër, po ta jap edhe një minutë, por shkurt, mos na merr shumë kohë!

FERID AGANI: Zonja deputete,

Papërgjegjësia kur të fillojë nuk ka skaj. Fillimisht nuk bëhet fjalë për djalin e axhës fare, bëhet fjalë për kushëri të largët të familjes, në qoftë se doni konkretisht të dini, për djalin e djalit të axhës të babait tim. Në qoftë se kaq është e rëndësishme kjo punë, nuk ka të bëjë fare me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit. Unë i kam shumë të qarta dispozitat ligjore përkitazi me këtë dhe meqenëse nuk bëhet fjalë për asnjë shkelje ligjore, atëherë ju duhet të bartni përgjegjësinë e fjalës suaj publike, por unë dua t'ju siguroj edhe juve dhe gjithë atyre, të cilët mendojnë se nëpërmjet manipulimeve të mediave do të arrijnë t'i ndalin proceset pozitive në sektorin e shëndetësisë, po ju siguroj që nuk do të kenë sukses dhe për këtë do të bindeni shumë shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, jo nuk shkojnë pak, ky e pranoi që kushërinj janë, ashtu diçka, lëre tash këtë punë, mos e ço mandej!

Skënder Hyseni e ka fjalën.

SKËNDER HYSENI: Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeverisës,
Të nderuar deputetë,

Komisioni Evropian ka publikuar Raportin për Kosovën për vitin 2011, duke marrë parasysh përkushtimin dhe seriozitetin tonë të thellë për të afruar qytetarin dhe shtetin e Kosovës me familjen e gjerë të kombeve të lira të Evropës, gjetjet e Raportit të Progresit 2010, do të duhej të ishin udhëzuesi qendror i punës së institucioneve të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2011.

Përkundrazi, institucionet e Kosovës e në veçanti Qeveria e Republikës së Kosovës, ka treguar shkallë të ulët, do të thosha të papranueshme serioziteti në të gjithë ata sektorë, ku përgjegjësia ekskluzive ose gati ekskluzive ka qenë në kompetencën e saj. Dhe, kështu edhe raporti 2011 ka gjetur dështime serioze në segment kyç të qeverisjes të rëndësishme parësore për cilësinë e jetës së qytetarit.

Në lidhje me kriterin e parë, atë politik të domosdoshëm për anëtarësim, Komisioni Evropian ka vërejtur se procesi i fundit zgjedhor, për zgjedhjet nacionale ka pasur mangësi serioze. Pastaj, raporti ka vërejtur se administrata publike mbetet e dobët dhe e pareformuar. Presioni në media vazhdon të jetë në shkallë të lartë dhe i papranueshëm. Raporti pastaj, vëren se përpjekjet për të luftuar korrupsionin, pastrimin e parasë dhe krimin e organizuar, janë gati kurrfarë. Kjo do të thotë se nevoja për ndryshim është e qartë dhe e dukshme.

Sa u përket kriterëve tjerë, siç është përparimi në krijimin e një ekonomie tregu funksionale edhe këtu progresi vlerësohet tejet i vogël dhe në këtë drejtim mangësitë në formulimin dhe zbatimin e politikave janë vendimtare. Ndaj këtij realiteti, të nderuar deputetë, nevoja për ndryshime pozitive është urgjente dhe ndryshimet duhet të tejkalojnë retorikën. Shumë të nderuar deputetë, parafolës, prekën segment të veçantë të raportit dhe shumë të tjerë, unë besoj me kompetencë do të flasin për fusha të caktuara, prandaj unë do të përqendrohem në një aspekt të veçantë të raportit dhe ky është marrëdhëniet e Kosovës me BE-n, dhe këtë raport unë do ta shoh në rrafshin e neutralitetit ndaj statusit, ose Rezolutës 1244 dhe, sa po e ndihmon këtë neutralitet me mosveprimin e vetë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe jo vetëm Qeveria, por edhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës? Nevoja për presion që të ketë një politikë të jashtme të BE-së ndaj Kosovës konsensuale, është më de e domosdoshme dhe urgjente. Politika e jashtme e BE-së ndaj Kosovës dhe ndonjëherë vartësia e kësaj politike nga qëndrimet nacionale ndaj pavarësisë së Kosovës, te vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, po e dëmton Kosovën në të gjitha rrafshet.

Prandaj, ka nevojë vendimtarët për konsensus të politikës së jashtme të BE-së karshi Kosovës dhe këtu Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet e Kosovës, kanë detyrë për të përmbushur dhe nuk duhet hezituari dhe nuk guxon të mungojë kurajoja që të insistohet në këtë. Më ka nxitur të flas për këtë kopertinë e Raportit të Progresit, që vazhdon të jetë sipas Rezolutës 1244 të OKB-së, pastaj më ka nxitur një konstatim shumë i habitshëm në raport rreth pjesëmarrjes së Republikës së Kosovës në nisma rajonale dhe takime ndërkombëtare. Si duket, Qeveria e Kosovës ka bërë një hap prapa në këtë plan duke pranuar esencialisht një kërkesë të Republikës së Serbisë që Kosova mund të marrë pjesë në këto nisma vetëm si pjesë e delegacionit të UNMIK-ut, përkatësisht nën siglën UNMIK/Kosovë.

Dhe, këtë e keni qartë në raport, ku thuhet se Kosova përfundimisht ka pranuar që në takimin vjetor të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në Mal të Zi, në qershor dhe në takimin e bordit të këtij këshilli, në shtator të këtij viti, Kosova ka pranuar të jetë pjesë e delegacionit të UNMIK-ut.

Të nderuar deputetë,

Ky është kthim prapa i papranueshëm, Kosova nuk guxon, me veprimet e veta, ta ushqejë neutralitetin ndaj statusit, i cili edhe ashtu po e dëmton Kosovën në disa fusha gati në mënyrë të pariparueshme. Unë jam i sigurt që për temat tjera do të flasim kolegët tjerë deputetë, më lejoni krejt shkurt edhe rreth vizave, përkatësisht paralajmërimit me pompozitet të fillimit të ashtuquajtur “të dialogut për vizat”.

Ne nuk guxojmë të vetëkënaqemi me këtë, sepse nga informacionet që, secili prej nesh besoj ka mundësinë t’i mbledh aty-këtu, ky zotim i Komisionit Evropian është shumë fluid dhe gati aspak konkret. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet dhe unë insistoј që të kërkohet data e saktë, kur qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza, jo kur mund të fillojë dialogu për vizat, sepse ai dialog mund të zgjasë deri në pafundësi? Kosova duhet të insistoј në orare strikte, në orare të sakta dhe pastaj, përgjegjësia kalon të institucionet e Kosovës që të gjitha kërkesat, përkatësisht kriteret duhet t’i përmbushë në afatin e duhur.

Unë do ta përfundoј këtu, i nderuar kryesues, që të kurseј kohën tuaj dhe deputetëve tjerë dhe do të paraqitem prapë nëse ka nevojë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka ministri Besim Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Para se të hy në temën, të cilën do të adresoj në lidhje me çështjet e zhvillimit ekonomik, dua të ndalem në konstatimet e fundit, sa i përket pajtimit se Kosova merr pjesë në nisma rajonale, nën siglën UNMIK/Kosovë.

Dhe, rasti më i freskët në këtë rikonfirmim të pozicionit shtetëror të Republikës së Kosovës është rasti i djeshëm, në takimin ministror të ministrave që përfaqësojnë telekomunikacionin në nivel rajonal, ku Kosova është përfaqësuar në nivel shtetëror dhe jo në nivel të siglës UNMIK-ut dhe për këtë arsye kemi dalje të delegacionit të Republikës së Serbisë nga takimi duke protestuar që Kosova mund të flasë vetëm në momentin kur i jepet fjala nga UNMIK-u.

Ky është një fakt, fakti tjetër, të nderuar deputetë, para disa javësh kemi marrë pjesë në takimin e ministrave të Energjisë të Bashkimit Evropian, në Poloni, ku gjithashtu prezenca është bërë në nivel të Republikës së Kosovës duke vendosur flamurin, duke

vendosur emrin e Republikës së Kosovës në nivel të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian edhe ato të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, por njëkohësisht edhe vendeve të cilat e kanë kundërshtuar dhe e kundërshtojnë edhe më tutje praninë e tillë.

Ne e dimë që dominimi i emrit është çështje e bashkëpunimit të ngushtë me Bashkimin Evropian dhe kjo është duke ndodhur. Sigurisht se dihet shumë qartë, sepse ministri ka qenë edhe pjesë e këtyre angazhimeve shtetërore dhe në këtë drejtim i din procedurat të cilat duhen të merren parasysh për të krijuar një ambient të tillë, por për hir të respektimit ndaj qytetarëve, dëshiroj të theksoj se asnjëherë, në asnjë moment, Qeveria e Kosovës nuk ka marrë qëndrim të participojë dhe janë këto dy raste, për të cilat po flas, pra raste shumë konkrete lidhur me këtë.

Nëse flasim për aspektin ekonomik të Raportit të Progresit, dua të bëj vetëm një vështrim, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, se çka është Raporti i Progresit. Raporti i Progresit si i tillë vlerëson të arriturat njëvjeçare në fusha të ndryshme dhe kur shkruhet se nëpër secilën fushë arrihet progres, atëherë ne i kemi plotësuar kushtet për të hyrë në Bashkimin Evropian, ky është një proces i cili mat avancimin nëpër secilën fushë të caktuar, nëse flasim për kriteret politike, ekonomike dhe ato sektoriale.

Dua t'ju përkujtoj që nëse e lexojmë me vëmendje Raportin e Progresit kemi thënë disa herë se ky raport është korrekt, është raport i cili vlerëson shumë sfida, por raport i cili vlerëson edhe të arriturat dhe duhet t'i ritheksoj edhe njëherë, të arriturat në fushën e ekonomisë.

U përmend eksporti, të nderuar, raporti thekson që ka rritje të eksportit për 36%, i cili përbën 7.5% të bruto produktit vendor dhe i cili krahasuar me vitin 2009 është ngritur nga 4.5% në 7.5%. Njëkohësisht, janë rritur të hyrat për kokë banori në mënyrë të ndjeshme, duke mos i marrë statistikën e reja të cilat do ta tregojnë një gjendje edhe më ndryshe sa i përket të hyrave për kokë banori.

Vlerëson se remitencat, përkundër krizës ekonomike që ka qenë edhe nëpër vendet e Unionit Evropian kanë rritje dhe ajo rritje nuk është më e vogël se sa 7.5% dhe që është element i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik.

Vlerëson se inflacionin në një periudhë ka qenë mjaftë i lartë, për shkak të krizës ekonomike botërore dhe ndikimeve që i ka këtu, por vlerëson gjithashtu që në gusht ky inflacion ka rënë në 5.3% dhe vlerëson që deri në fund të vitit nuk do ta kalojë, sigurisht 7% që është element jashtëzakonisht i mirë, nëse neve e krahasojmë me vendet e rajonit.

Vlerëson që ka rritje të investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe këto investime të huaja të drejtpërdrejta bëhen në kohën kur të gjitha vendet e rajonit, por edhe bota edhe Evropa është duke pasur shumë probleme në investime, sepse në kohët e krizave ekonomike financiare vendet janë shumë të kufizuara dhe janë shumë të orientuara që të mos e qesin kapitalin e tyre jashtë vendit.

Vlerëson ky raport se papunësia në Republikën e Kosovës, ulet për 1%, që nëse i shohim të dhënat nga Trusti i Kursimeve Pensionale, nënkupton që ka 2.3% të raportuar më shumë, vlerëson që shkalla e papunësisë është në rënie dhe flet për nivelin e drejtpërdrejtë që ka të bëjë me shkallën e paedukuar të punësisë, ndërsa vlerëson që niveli i atyre të cilët janë me shkollim superior është ndoshta në rritje, por gjithsesi duke marrë parasysh që është një përqindje shumë e vogël nga njerëzit të cilët janë të papunësuar.

Flet për subvencionet të cilat Qeveria në kuadër të reformave strukturale ka vendosur t'i ulë dhe flet veç për ulje të subvencioneve në total pa e përfshirë tërë vitin 2011 për 1.3% dhe vlerëson vizionin e zhvillimit ekonomik, të nderuar, vlerëson se Qeveria ka treguar që ka një orientim të qartë për ta forcuar dhe mirëpret forcimin e sektorit provat si gjenerator kryesor të zhvillimit ekonomik.

Ky raport vlerëson se 90% të ndërmarrjeve publike performojnë me profit krahasuar me vitet tjera paraprake.

Vlerëson progres në privatizimin e ndërmarrjeve publike. U përmend këtu privatizimi i Postës dhe Telekomit, të nderuar deputetë, Qeveria e Republikës së Kosovës përkundër obligimeve financiare dhe projeksioneve që i ka pasur ka marrë një vendim jashtëzakonisht të përgjegjshëm për të ruajtur interesin e qytetarëve të vendit dhe ajo është që të mos privatizohet Posta me çdo kusht, ajo është që të pritet performancë më e mirë e tregut konform mendimit të Kuvendit të rritja e konkurrencës të jetë element thelbësor për të vazhduar me procesin e privatizimit.

Thekson se kreditimi në biznesin privat është 13.2% më shumë duke arritur nivelin e 35% të GDP-së. Nëse, flasim për energjinë thekson se Ligji për energjinë elektrike, Ligji për Rregullatorin Energjetik, janë aprovuar dhe vlerëson avancimin në furnizim, ku thotë se prodhimi i qymyrit ka 1.52% rritje, prodhimi i energjisë ka 4% rritje, inkasimi ka 11% rritje, faturimi mbulon 87.9%, ndërsa humbje teknike ulen në mënyrë të ndjeshme.

Njëkohësisht, ky Raport i Progresit vlerëson edhe ligjet ekonomike të cilat Qeveria i ka marrë dhe po i merr në drejtim të funksionalizimit të reformës strukturale.

Prandaj, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, sigurisht që Raporti i Progresit është një udhërrëfyes, për të adresuar sfidat, të cilat na mbesin, për të adresuar në mënyrë të përbashkët institucionale për një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Skënder Hyseni, replikë.

SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuar ministër,
Ose nuk e keni lexuar Raportin e Progresit, ose keni bërë një përpjekje dëshpëruese për të lënë përshtypje tjetër fare.

Në Raportin e Progresit të kapitulli që flet për çështje rajonale dhe obligime ndërkombëtare, thuhet qartë dhe unë po citoj: “Kosova nuk ka marrë pjesë në Këshillin Rajonal për Bashkëpunim dhe në takimet e bordit të këtij këshilli deri në maj të vitit 2010. Kosova, megjithatë ka marrë pjesë si pjesë e delegacionit të UNMIK/Kosovë në takimin vjetor të Këshillit rajonal për bashkëpunim në Mal të Zi dhe në takimin e bordit në shtator 2011. E kam lexuar variantin anglisht që të mos lë asnjë dilemë të keqinterpretimit ose të përkthimit të gabueshëm. Kaq.

KRYESUESI: Do edhe njëherë ministri, ministër shkurt, të lutem shumë!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

Ne duhet t'i kuptojmë që atëherë kur Bashkimi Evropian është i gatshëm për të denominuar emrin e Republikës së Kosovës, jemi në fazë tjetër, ky angazhim institucional, ministri e din mirë se në çfarë forme shkon dhe ajo çka unë po them është se pjesëmarrja në shumë raste konkrete, të cilat unë i përmenda, pjesëmarrja e Kosovës nuk bëhet nën siglën e 1244. Faleminderit!

KRYESUESI: Skënder e ke gjysmë minute.

SKËNDER HYSENI: Pikërisht pse ish-ministri e di mirë, po flet në këtë temë, sepse nuk e ka zakon të flasë për gjërat që nuk i di. Asnjëherë, madje edhe në samitin famoz të Sarajevës, ministri i atëhershëm dhe Kosova kanë negociuar me muaj të tërë që të mos marrin pjesë nën siglën UNMIK/Kosovë, po është gjetur një modus i barabartë për të gjithë, gjithë kanë marrë pjesë me emra dhe mbiemra të tyre dhe unë po flas për konstatimet e raportit, zoti ministër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Florin Krasniqi.

FLORIN KRASNIQI: Faleminderës, kryesues!

E kam qejf ashtu qysh thotë kryesuesi “faleminerës”. U fol shumë për Progresin e Raportit këtu, e do të flitet me siguri edhe më shumë, po një gjë është shumë pozitive se jemi pajtuar se është real, real domethënë i vërtetë. Në këtë realitet, ka një akuzë shumë të rëndë, që me faktin se të akuzuarit e pranojnë që është e vërtetë, e pranojnë krimin. Çka thotë kjo? Thotë kështu: “për më tepër, partitë kryesore politike në Kosovë vazhdojnë të operojnë me rrjetet e veta të sigurisë”. Pra, partitë kryesore në Kosovë vazhdojnë të operojnë me rrjetet e veta të sigurisë, kanë organizata kriminale, grupe kriminale brendapërbrenda partive. Partitë kryesore thonë: “po, i kemi” se po thonë është i vërtetë, është kështu “po, i kemi”. Po mos të ekzistonte fjala “vazhdojnë”- fjala “vazhdojnë” e liron “Vetëvendosjen” prej kësaj akuze, pse “Vetëvendosja”- lëvizja jonë është për herë të parë këtu, kështu që ne nuk kemi vazhdueshmëri.

Meqenëse, kjo është një akuzë e rëndë për Kosovën edhe për partitë kryesore politike, unë mendoj se kryeministri, partitë politike, Këshilli i Lartë i Sigurisë, në qoftë se ekziston, është dashur urgjentisht të mblidhet edhe të diskutojë këtë akuzë që na bën

Evropa. A është e vërtetë? Ju po thoni “po i kemi”. Unë ju kam thënë se i keni, populli e di se i keni. Ku janë, çka janë, çka bëjnë? Unë e shoh shumë të vështirë luftimin e strukturave kriminale në veri, përderisa partitë politike i kanë strukturat paralele të sigurisë.

Bile, më vështirë është për t’i luftuar këto struktura paralele të sigurisë të partive politike, se sa strukturat kriminale në veri, se në veri mund t’i luftojmë strukturat kriminale se e kemi ndihmën e ndërkombëtarëve dhe e kemi unitetin kombëtar. Të gjithë pajtohemi që duhet t’i luftojmë.

Këto struktura kriminale të partive, do të jetë shumë zor për t’i luftuar, se nuk e kemi mbështetjen ndërkombëtare dhe nuk e kemi unitetin kombëtar. Andaj, unë iu ftoj dy partive më të mëdha, për hir të së vërtetës, për hir të ardhmes të këtij vendi, kallëzoni çka janë këto struktura, ku është SHIK-u, a vepron, çka bëjnë, ku është Ministria e Rendit, a jeni ju të infiltruar në Ministrinë e Rendit, apo mos krejt Ministria e Rendit është kjo, a mos fyerjet që na bën neve Bajram Rexhepi, opozitës, që na quan “me pi kafe”, “na shtinë në xhep”, kur ai u thotë qytetarëve të Mitrovicës, të veriut të vendit se kush tutet, le të shkruajë hajmali. Deputetë, ata jetojnë nën ankthin e kriminelëve më të mëdhenj në botë, ata që kanë vlarë e kanë prerë në këtë vend, ju sillen gjithë natën e ministri u thotë “shkruani hajmali”, pse ai është pjesë e këtyre strukturave, ai nuk është pjesë... Po të ish pjesë e strukturave të mirëfillta të Kosovës, ai do të thoshte “të nderuar deputetë, kemi problem, duhet të punojmë bashkë, duhet t’i çojmë forcat e policisë, na duhet një unitet gjithëkombëtar, na duhet të pajtohemi me dallimet që i kemi politike e të veprojmë në mënyrë unike.

Kështu që edhe forcat tona të sigurisë, edhe Ministria e Rendit, edhe FSK-ja do të ishin shumë më të përgatitura për t’i luftuar këto struktura kriminale. Andaj, unë edhe njëherë ju ftoj dy partive më të mëdha të vendit, që ta elaboroni këtë fjali. Edhe për ju LDK-në, çka keni bërë me ” Sigurinë e Atdheut”, a e keni ende, a e keni prishur, të paktën këta na kanë dërguar një letër. E prishën, s’e kanë prishur, por na dërguan. Ju as letër s’na keni dërguar, s’na keni kallëzuar bile të thoni “është, s’është, ka qenë, s’ ka qenë”. Nuk mund të veprojnë në këtë mënyrë.

Kjo nuk është shtetformim, kjo është tallje. Andaj, unë ju ftoj edhe njëherë seriozisht e sinqerisht, si qytetarë të këtij vendi, që mendoj se ia duan të mirën këtij vendi, ta përkrahim iniciativën e Burim Ramadanit. Në qoftë se nuk pajtohemi me tekstin e Burimit, ta krijojmë një tekst të ri, që do të na krijojë mundësi që t’i hetojmë këto shërbime informative. Të shohim kush janë, çka kanë bërë, qysh kanë vepruar, a veprojnë...? Kurrëgjë të keqe nuk ka kur diçka hetohet, por ka shume të keqe, tepër të keqe kur pranohet krimi, kur ju thoni se – po, akuza që na bën Evropa është e vërtetë. Andaj, ju ftoj edhe një herë, si qytetarë të këtij vendi, si përfaqësues të këtij populli, të punojmë, t’i zbulojmë kush janë këto, çka bëjnë, qysh veprojnë, kush ka bërë krime, të shkojë në burg, kush s’ka bërë krime, të lirohet prej përgjegjësisë.

Edhe njëherë, ju faleminderit, kryesues! Ju ftoj që ta debatojmë këtë akuzë shumë të rëndë që iu është bërë partive politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti deputet, faleminderit!
Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra, të nderuar deputetë,

Pak vështirë tash të flas në temë, për të cilën jam përgatitur, pas një fjalori të një deputeti, i cili nuk ka njohuri as elementare për atë që iu drejtohet partive politike dhe s'ka kredibilitet që me autoritetin e tij, që mendon që ka, t'iu drejtohet partive politike lidhur me temën që e ka ngritur.

Por, sidoqoftë, unë do të orientohej në atë që e kam përgatitur.

Raporti i Progresit evidenton të arriturat e Kosovës në tre kapitujt kryesorë:

1. Në kritere politike,
2. Kritere ekonomike, dhe
3. Standarde evropiane.

Raporti i Progresit në njëfarë mënyre e ka ndërgjegjësuar Qeverinë e Kosovës për përgjegjësitë e saj ndaj agjendës evropiane për shtetndërtim të qëndrueshëm, zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale, që duhet të jenë parimet udhëheqëse të institucioneve të Kosovës. Tek e fundit, këto parime nuk janë vetëm kusht për përparim në procesin e integritimit evropian, por janë proces i domosdoshëm për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

Unë do të ndalem vetëm në vlerësimin e kriterit ekonomik, ku Qeveria e Kosovës ka marrë vlerësim negativ për performancën financiare, si dhe treguesit e përgjithshëm ekonomikë. Prandaj, unë mendoj se duhet, ashtu siç është thënë në Raportin e Progresit, të hartohet një strategji e besueshme ekonomike, që lidh prioritetet ekonomike, reformën strukturore dhe shpenzimet publike. Kjo duhet të bëhet sepse ekonomia e Kosovës ka mbetur e dobët dhe e prapambetur, sepse investimet e huaja në ekonomi janë më të ulëta në regjion, sepse ekonomia nuk ka krijuar vende të reja të punës dhe më tutje mbajmë vendin rekord për të papunë me 45,5% dhe një presion i tillë për punësim ka ndikuar që sektori shoqëror të absorbojë të punësuar më tepër se që duhet dhe kjo e rëndon buxhetin e shtetit, i cili buxhet po përballlet edhe ashtu me rreziqe të konsiderueshme për shkak të deficitit të lartë, sepse inflacioni është ngritur në nivelin më të lartë të mundshëm, sepse debalanci në mes importit dhe eksportit është tejet i lartë, sepse politika ditore dhe politika e zgjedhjeve ka shkatërruar marrëveshjen stand-by me Fondin Monetar Ndërkombëtar, që ka dëmtuar qëndrueshmërinë fiskale dhe cilësinë e shpenzimeve, sepse planifikimi fiskal dhe cilësia e financave publike është përkeqësuar edhe më shumë, parashikueshmëria, konsistenca dhe transparenca janë më keq se kurrë, sepse politika makroekonomike po rrezikohet nga ndërhyrjet e paparashikueshme fiskale dhe rritjeve të paqëndrueshme të shpenzimeve qeveritare, sepse administrata e dobët, furnizimi me energji elektrike i paqëndrueshëm, mungesa e sundimit të ligjit, korrupsioni, veprimtaritë joformale, politika ad-hoc dhe probleme strukturore po pengojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Prandaj, është e domosdoshme një strategji e besueshme ekonomike, që do t'u jep përgjigje të gjitha këtyre në thonjëza, të cilat unë vetëm i kam cituar nga Raporti i Progresit. Dhe atë që unë mendoj, faktori politik kosovar i pushtetit ose jo i pushtetit, duhet ta hartojë bashkërisht një strategji gjithëpërfshirëse, ku do të caktohen objektivat e Kosovës për përmbushjen e agjendës evropiane. Pikat të cilat nuk do të jenë të diskutueshme për përmbushjen e tyre, por vetëm do të ketë garë politike në mes të subjekteve politike, se cila parti do t'i përmbushë më mirë, më shpejtë për të mirën e Kosovës. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

(Reagim)

Ti, ku je në replikë?... Urdhëro, replikë, urdhëro, po emër s'ka përmendur ky, prandaj...

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Një fjalë e urtë popullore thotë kështu: “Kush e ka mizën në kapuç”, kështu që nganjëherë nuk ke nevojë shumë për të pyetur se kush e ka mizën në kapuç. Raporti i Progresit po thotë kështu: “partitë kryesore politike vazhdojnë të operojnë me strukturat e tyre të sigurisë”. Në qoftë se LDK-ja është parti kryesore politike dhe ky raport është i vërtetë, atëherë diçka ka! Ky nuk kupton, Raporti po thotë, nuk po thom unë. Ai thotë - deputeti s'ka kredibilitet, se ai ka kredibilitet! Më ka prurë ai këtu mua, të më kallëzojë a kam kredibilitet a s'kam. Raporti po thotë - ju i keni shërbimet e sigurimit. A i keni, a s'i keni, a është kah rren Raporti? Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Po, merre bre zotëri, replikë, po s'ndreqni gjë, se s'jeni as ai as ti duke thënë gjë... E ka një minutë... Urdhëro, Naser...! Nuk zgjidhen këto kështu!

NASER OSMANI: ... Raporti i Progresit nuk përmend me emër e mbiemër partitë politike, por përmend vetëm subjektet. E drejtë e kujt është këtu që të përmend LDK-në, ta shtien në thes me të tjerë, që ka grupe kriminale... Domethënë, është i pandërgjegjshëm, i papjekur dhe destruktiv, që nxitë konflikt në Parlament.

KRYESUESI: Unë, këtu më duhet të reagoj dhe t'ju them: Unë sa po shoh kryeshtruet, popullorçe, ju s'keni kapuç asnjëri! Kështu që, njëherë mbarojeni kapuçin, qiteni e këqyrni a po hi miza aty? Ndërsa, unë nuk besoj që “Vetëvendosja” s'pranon që është parti e madhe, ju thoni që jeni e madhe, kështu që leni këto krahasime...

Kalojmë. Blerim Shala e ka fjalën!

BLERIM SHALA: I nderuari kryesues i Kuvendit,
Kabinet i Qeverisë,
Të nderuar deputetë,

Nëse provojmë të dyzojmë përmbajtjen e Raportit të Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian për këtë vit, me zhvillimet aktuale në Kosovë dhe me ato që objektivisht janë të parashikueshme për vitin 2012, do të mund të konkludojmë që Kosova përballlet me probleme të mëdha, që mëdyshin qëndrueshmërinë politike, ekonomike dhe sociale të vendit. Lista e këtyre problemeve është kjo:

1. Sovraniteti i kontestuar në veri të Kosovës.
2. Legjitimiteti i dëmtuar thelbësisht i autoriteteve qendrore për shkak të zgjedhjeve të manipuluarra parlamentare.
3. Dialogu i Prishtinës me Beogradin në Bruksel, i cili në mënyrën se si është bërë deri më sot, para së gjithash, po i shërben Serbisë.
4. Mungesa themelore e qëndrueshmërisë ekonomike dhe e stabilitetit buxhetor, që do të ndikojë në përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes ekonomike dhe sociale në vend, dhe
5. Mungesa e perspektivës për fuqizimin e sundimit të Ligjit në Kosovë.

Kemi të bëjmë, pra, me dobësimin e shtetit të Kosovës, me dëmtimin e demokracisë, me degradimin e ekonomisë, me devalvimin e mëtejshëm të gjendjes sociale dhe me drejtimin e huqur në rrafshin e sundimit të Ligjit në Kosovë.

Nuk ka shenja se në vitin 2012 do të kemi një ndryshim për të mirë të gjendjes në këto pesë probleme kyçe, me të cilat ballafaqohet Kosova. Përkundrazi, në bazë të të gjitha analizave politike dhe parametrave ekonomike dhe sociale, të cilat së fundit u bënë të ditura edhe nga Propozim-buxheti i Qeverisë së Kosovës për vitin 2012, na del që viti i ardhshëm do të jetë më i vështiri në të gjitha aspektet e mundshme, që prej se Kosova është bërë shtet i pavarur. Këtu do të merremi me 3 prej 5 çështjeve kyçe të Kosovës.

Në bazë të Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën dhe Serbinë, si dhe duke pasur parasysh gjendjen e tanishme në veri të Kosovës dhe rrjedhën e derisotme të dialogut të Brukselit midis delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë, mund të parashihet që Serbia nuk do të detyrohet t'i shpërbëjë strukturat e saj në veri të Kosovës, për të cilat tashmë flitet në mënyrë eksplicite nga ana e Brukselit. Kjo do të thotë që ne do të vazhdojmë të përballemi me sovranitetin e kontestuar të Kosovës në veri, që tensionet e të gjitha llojeve do të vazhdojnë të jenë të pranishme në këtë pjesë të Kosovës, që do të rritet presioni nga të gjitha anët për të pasur bisedime politike të Prishtinës dhe Beogradit për këtë çështje, së bashku me shtytjet që ne të ofrojmë për veriun e Kosovës më shumë se sa që është kodifikuar me Propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisaari. Me një veri kështoj nuk mund të kemi siguri themelore të shtetit të Kosovës. Pa këtë siguri, nuk ka përparim në sundimin e ligjit, e pa këtë përparim nuk mund të kemi ndryshim të gjendjes ekonomike, që mund të ndodhë vetëm me një shtim dramatik të investimeve nga jashtë dhe me ndryshim rrënjësor të politikave ekonomike të Qeverisë së Kosovës.

Shqyrtimi i çështjes së dyte, i qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare e buxhetore të Kosovës dhe i stabilitetit social, na bën që të jemi edhe më të zymtë në parashikimet për vitin e ardhshëm. Nuk kemi nevojë të shtojmë këtu që zhvillimet në segmentin ekonomik, financiar dhe social të shoqërisë kosovare janë njësisht kryesore matëse për perspektivën

evropiane të Kosovës. Vetëm pak muaj më parë, Qeveria e Kosovës doli me vizionin e saj për zhvillimin ekonomik të Kosovës, i cili u artikulua qartë edhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012 – 2014.

Qeveria e Kosovës kishte paraparë një rritje ekonomike mesatare prej 7-8% në vit, një ulje të papunësisë prej 8-10% në vit, rritjen e eksportit dhe uljen e ndjeshme të importit, vendimmarrjen e shpejtë për privatizimin e PTK-së dhe të Distribucionit të energjisë në këtë vit, për ndërtimin e kapaciteteve të reja të energjisë në vitin e ardhshëm, fillimin e ndërtimit të rrugës 6 Prishtinë – Shkup, në vitin 2012. Pastaj, krijimin e rrethanave ligjore dhe të atmosferës ekonomike, që do të mundësonte që Kosova të jetë në mesin e 40 shteteve më të preferuara për investime nga jashtë.

Shkurt, Qeveria paralajmëroi ditë shumë më të mira për qytetarët e Kosovës. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian u jep goditjen e parë të rëndë këtyre paralajmërimeve, të cilat pasohen me një goditje edhe më të rëndë të vetë Qeverisë së Kosovës, nëse marrim parasysh propozimin e buxhetit për vitin 2012, të parashikimeve për ecjen ekonomike dhe financiare të Kosovës në vitet 2012 – 2014, të cilat paraqiten në këtë buxhet. Rrita ekonomike në Kosovë nuk do të kalojë 5%-shin, në variantin më të mirë, do të ketë shtim e jo zvogëlim të papunësisë, e cila aktualisht është 45,4%. Rrogat e shërbyesve civilë për 3 vjetët e ardhshëm do të rriten tërësisht 7,7%, që do të thotë se në realitet, kur të merret parasysh inflacioni i paraparë prej 5% për çdo vjet, rrogat e tyre në vitin 2014 do të pësojnë një zhvlerësim thelbësor krahasuar me rrogat e sotme. Transferet sociale për tre vjetët e ardhshëm do të rriten tërësisht 7,9%, që do të thotë se edhe të gjithë ata që kanë të ardhura sociale do të përballen me zhvlerësimin e atyre pak mjeteve që i marrin prej shtetit.

Importi do të rritet në vitet e ardhshme duke bërë që buxheti i Kosovës, i cili në këtë vit ka 63,2% prej të hyrave doganore, në vitin 2014 do të varet madje 66,3% prej doganave. Kjo do të thotë që në ndërkohë nuk do të bëhet asgjë për të favorizuar prodhimtarinë në vend dhe që Kosova, sa më afër që do të jetë anëtarësimit në Bashkimin Evropian, do të jetë më e varur prej doganave, në vend se të jetë e kundërta.

Nga perspektiva e sotme e pozicionit të 117-të në listën e shteteve për investime nga jashtë, nuk shihet se si do të mund të mbërrijmë tek top 40-shi. Ndërtimi i rrugës 6 Prishtinë-Shkup nuk do të nis në vitin 2012. Privatizimi i PTK-së dhe i Distribucionit të energjisë nuk do të ndodhë në këtë vit dhe, sipas të gjitha gjasave, deri në vitin 2017, së paku, Kosova do të ketë probleme të mëdha me furnizimin me energji, ndërsa vlera e rezervave të linjitit në Kosovë i afrohet 80 miliardë eurove. Këto parametra na paralajmërojnë vite shumë të vështira për qytetarët e Kosovës dhe për shtetin e Kosovës.

Pra, nuk do të ketë rritje reale ekonomike në Kosovës, nuk do të ketë ngritje të rrogave, nuk do të ketë ulje të papunësisë, nuk do të ketë ulje të mjerimit social të varfërisë, nuk do të ketë perspektivë afatshkurtër dhe afatmesme për zhvillimin e biznesit në Kosovë.

Pra, do të jetë mrekulli e dorës së parë, nëse Raportet e Progresit për Kosovën në vitin 2012 dhe 2013 do të jenë më të mirë se ky i fundit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Arsim Bajrami!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,
Kolegë deputetë,

Do të mundohem të fokusohem në dy çështje, sepse Raporti i Progresit është shumë i gjerë dhe është shumë pretencioze që deputetët me një diskutim pesë minutash ose dhjetë minutash të prekin të gjitha segmentet.

E para, dëshiroj të theksoj atë që u theksua edhe më herët se ky raport nuk është Raport për Qeverinë, por është Raport për Kosovën dhe është një lloj studimi i progresit të arritur në të gjitha sferat e jetës, bile në tri degët kryesore të pushtetit. Pra, përfshinë Parlamentin, Qeverinë dhe gjyqësorin dhe segmentet tjera.

E dyta, Raporti i Progresit ekziston vetëm për shtetet që ende s'kanë statusin e anëtarit të Bashkimit Evropian dhe është iluzore të pritet që këto raporte të përfundojnë me një përshkrim të progresit, por gjithmonë janë raporte kritike dhe po që se shohim gjuhën rajonale të këtyre raporteve, shohim që edhe Kosova nuk bën përjashtim nga kjo qasje. Do të ndalem në dy momente. Një moment që s'e preku askush në diskutim, cilat janë gjetjet e Raportit të Progresit në raport me legjislativin, në raport me Kuvendin dhe momenti i dytë, do të ndalem aty ku e quaj edhe veten kompetent, të kriteret politike dhe në fund do të flas se çfarë strategjie duhet të ndërtojë Kosova që Raporti i Progresit të mos jetë temë në shtator, por të jetë temë në janar, të jetë më 1 janar temë dhe të punojmë që ky raport të shkruhet në Kosovë, jo të shkruhet në Bruksel, sepse unë mendoj se raporti duhet të shkruhet në Kosovë, me të arritura tona.

Po që se, të nderuar deputetë, anëtarët e Parlamentit e lexojnë pjesën për Parlamentin, do të shohim se Raporti nuk është gjithaq i mirë, sepse ai regjistron pesë shkelje, të cilat ne s'i diskutoam, ndoshta u morëm më tepër me Qeverinë e më pak me vetveten.

E para, në Raport në mënyrë të qartë ceken mungesat e kapaciteteve të konsulencës legislative, përkatësisht mungesat e qarta në Departamentin Ligjor dhe Departamentin e Standardizimit të Ligjeve, e në mënyrë të veçantë mungesa e konsulencës në sferën kushtetuese, ku edhe Kuvendi ka bërë shkelje kushtetuese, të cilat vendin tonë e kanë futur në një krizë institucionale, e cila krizë ka pasur një impakt në Raportin e Progresit, sepse Kosova nuk i ka pasur 9 muaj, por i ka pasur vetëm 5 muaj, për shkak se 4 muaj kemi qenë në një krizë institucionale.

Pra, këto pesë gjetjet e Raportit të Progresit duhet të gjithëve neve të na fokusojnë që të përmirësojmë kapacitetet e Kuvendit të Kosovës edhe në dy fusha, që nuk u përmendën, fusha e monitorimit të ligjeve, ku haptas Kuvendi nuk po ka kapacitete të mira për të mundësuar monitorimin e ligjeve, e në mënyrë të veçantë në fushën e një kontrolli efektiv parlamentar. Pra, që i referohet opozitës që të ndërtojë kontroll efektiv parlamentar, në mënyrë që Qeveria të vihet në kontroll.

Sa iu përket kriterëve politike, që është pjesa më e rëndësishme e Raportit, kryesisht bëhet fjalë për arritjen e standardeve të Kopenhagës, sa i përket stabilitetit dhe funksionalitetit të institucioneve të Kosovës, sa i përket sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave. Stabiliteti institucional në Kosovë duhet shikuar në kontekstin real, në kontekstin që ne kemi pasur një krizë të thellë politike, me faktin që kemi pasur tri momente. Momenti i parë, është fakti që kemi pasur largimin e dy presidentëve para kohe. Fakti i dytë, kemi pasur një sistem të zgjedhjeve, që nuk ka qenë plotësisht me standarde dhe nuk ka pasur një integritet zgjedhor, çfarë e ka. Dhe, fakti që aktiviteti legjislativ është vonuar për shkak të marrjes së Kosovës me këto tri segmente dhe mendoj që këtë duhet shikuar në kontekstin real. Megjithatë, institucionet në Kosovë janë funksionale, veprojnë brenda kuadrit kushtetues dhe funksionojnë brenda kompetencave të veta.

Sundimi i ligjit është një teori shumë e gjerë që mund të shikohet nga shumë segmente dhe unë mendoj që edhe shumë anëtarë të Bashkimit Evropian kanë probleme me konceptin e sundimit të ligjit. Megjithatë, Kosova ka pasur progres tek sundimi i ligjit. Ne kemi një legjislacion të mirë. Kemi ligje me standarde evropiane. Për dallim nga shtetet tjera, ne i harmonizojmë ligjet para se të dorëzohen në Kuvend me standardet e Bashkimit Evropian dhe në këtë drejtim ka pasur progres. Natyrisht, ka edhe shumë dobësi. Dobësia kryesore është mungesa e veprimit të ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht dy lloj standarde për sundimin e ligjit. Një lloj standardesh në pjesën që shtrihet nën juridiksionin e Qeverisë së Kosovës dhe standardet tjera, ku autoritetet ndërkombëtare nuk kanë arritur të mundësojnë kushtet për shtrirjen e plotë të ligjit. Mirëpo, kjo objektivë është afatgjatë. Kjo objektivë kërkohet edhe prej shteteve tjera. Po ta lexojmë raportin, po e zëmë për Maqedoni, për vende tjera, do të shohim që nuk jemi keq në këtë segment.

Gjithashtu, në pjesën për Qeverinë, tri institucione lavdërohen, dhe në tri segmente Raporti është jashtëzakonisht pozitiv. Ministria e Integrimeve është një storie pozitive e raporteve dhe definitivisht Kosova ka struktura funksionale sa i përket koordinimit të aktiviteteve të integrimeve evropiane, jo vetëm në funksionimin e Këshillit Ndërmintor, por me faktin që kohë më parë të gjitha ministritë kanë krijuar departamente të veçanta për integrime evropiane dhe kjo është një progres.

Gjithashtu, ka progres në sferën e policisë, ku janë shënuar progrese dhe në sferën e gjyqësisë, në sektorin që ka të bëjë me ingerencat e Qeverisë, ku kemi miratimin e legjislacionit, kemi fillimin e zbatimit të këtij legjislacioni dhe kemi hapat e parë dhe përmirësime të pozitës materiale të gjyqësorit, por mos të harrojmë se kjo nuk është përgjegjësi e Qeverisë. Përgjegjësi e Qeverisë është të bëjë ligjet e mira, të krijojë kushte. Gjyqësori funksionon sipas një mekanizmi të pavarur, ku Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Këshilli i Pavarur Prokurorial kanë kompetencat e veta.

Gjithashtu, Kosova, sa i përket të drejtave të njeriut, nuk është në nivelin e rajonit. Bile, në aspektin legjislativ dhe kushtetues mund të jemi edhe para rajonit, sepse kemi implementuar në ligje standarde të të drejtave të njeriut. Pa dyshim, një storie e

dhimbshme këtu është Administrata publike. Administrata publike që po reformohet ngadalë dhe që ngadalë po lirohet nga një bagazh, që e kemi trashëguar nga UNMIK-u, nga periudha e pasluftës, ku kemi krijuar një administratë që nuk është në proporcion me kapacitetin e shtetit tonë. Jemi një shtet me më pak se 2 milion banorë, me një bruto produkt të vogël dhe një administratë kaq e madhe është plotësisht në diskontinuitet me kapacitetet tona, por mendoj se Qeveria duhet të marrë hapa të dhimbshëm, Qeveria nuk duhet të marrë vetëm hapa, me të cilat aplaudohet, por edhe hapa të dhimbshëm, sepse integrimi evropian ka një çmim. Ai çmim është krijimi i një administrate proporcionale dhe funksionale. E di që shkurtimet nuk janë të popullarizuara. Është këtu edhe ministri dhe e di që nuk është bash temë e lehtë. Por ne, nëse duam të hyjmë në Bashkimin Evropian, herët a vonë duhet t'i marrim. Të krijojmë një administratë sa më të vogël, një administratë funksionale të depolitizuar, në mënyrë që të plotësojmë kriteret e Bashkimit Evropian.

I nderuari kryesues, më lejoni në fund dy tri fjali rreth strategjisë që duhet ta ndjekim, sepse këtu po flitet vetëm me episode, po merren momente të caktuara dhe ato po ekzagjerohen. Por, unë mendoj se krahas këtij debati dhe rekomandimeve, ne duhet të mendojmë në të gjitha institucionet, jo vetëm Qeveria. Nuk është, edhe një herë po e përsëris, ky raport për Qeverinë, është raport për Kosovën, ku të gjithë duhet ta shohim. Edhe ne deputetët duhet të jemi vetëkritik dhe të shohim lëshimet. Ne duhet shpesh, jo vetëm tash me kërkesën e Lidhjes Demokratike, por shpesh ta vendosim në agjendën e debatit për të parë në çdo tre muaj cili është progresi, ku është Kuvendi me arritjen e objektivave dhe unë mendoj që të gjitha institucionet, të cilave iu referohet Raporti i Progresit, filluar nga Parlamenti, duhet ta kenë planin e veprimit funksional nga 1 janari. Jo kjo temë të jetë një temë që ne e ngrisim në qershor, miratojmë ligje shpejt e shpejt, miratojmë ligje ndoshta edhe jo të mira, por le t'i marrim këto, t'i lexojmë mirë këto gjetje. T'i specifikojmë çka është detyrë e Qeverisë, çka është detyrë e Parlamentit dhe mos të bëjmë një garë kush është më keq në Raport, a është Parlamenti, a është Qeveria, a është Gjyqësori, a është Policia. Kjo është një pasqyrë e Kosovës dhe nga një raport i mirë përfitojmë të gjithë, nga një raport i keq humbim të gjithë. Kështu që neve na duhet vërtet që si Parlament të marrim rolin e koordinimit, të kërkojmë edhe prej Qeverisë, sepse Qeveria i përgjigjet Parlamentit, që në këtë Parlament t'i bie planet strategjike për përmirësimin e gjetjeve të Raportit të Progresit. Jo ta thërrasim Qeverinë kur del Raporti i Progresit, por ta thërrasim çdo tre muaj. E kemi edhe ministren e resorit përkatës, që çdo tre muaj ne ta përcjellim përparimin tonë dhe mos të jemi në stres në shtator, kur raportet bëhen publike.

Po e përfundoj me konstatimin se definitivisht kam edhe përvojë në këto segmente. Raporti i Progresit nuk shkruhet në Bruksel. Raporti i Brukselit shkruhet në Kosovë. Ai është real dhe ai pasqyron aktivitetet tona, qoftë në kuptimin pozitiv apo në kuptimin negativ. Dhe, assesi nuk duhet dikush të mendojë se ka një qasje diskriminuese sa i përket Kosovës në raport me Bashkimin Evropian. Ka ngecje, ka huti, nganjëherë ka edhe luftë politike, e cila e dëmton progresin tonë. Definitivisht, integrimi në Bashkimin Evropian nuk është një temë e mirë për debat opozitar, por është një çështje e cila duhet të na bashkojë dhe është një çështje që duhet të kërkojë angazhimin e të gjithëve, në mënyrë që Kosova ta shkurtojë këtë rrugën e integritit evropian dhe mos të jetë një

ishull i izoluar në Evropë, por të jetë pjesë e këtij treni evropian. Do të doja që mos të jetë në vagonin e fundit, por të jetë bashkë me këto shtetet e mbetura, të futet në një lloj konkurrence rajonale.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Është koha të konsultohemi, a doni të vazhdojmë ende, apo të marrim pushimin e drekës? Apo, doni të punojmë deri në 14:00 e prej 14:00 – 15:00 pushim?

Veç një moment! Edhe 50 vetë janë të paraqitur për të folur. Nga 10 minuta, shumëzoni, e dini sa bëjnë. Këtu nuk janë të regjistruar edhe ministrat, që të gjithë po lypin të flasin. E dyta, ka deputetë që mendojnë që ai është i pari në rend. Unë, për t'u bërë korrekt, dhe mbani mend mirë, po ju lexoj të regjistruar 20 emrat e pare, që thotë: Teuta Sahatçia, Afërdita Berisha Shaqiri, Kurtan Kajtazi, Kimete Bytyqi, Blerta Deliu Kodra, Hashim Deshishku, Haki Demolli, Xhevdet Neziraj, Time Kadrijaj, Sali Morina, Bahri Thaçi, Valbona Dibra, Glauk Konjufca, Duda Balje, Albert Kinolli, Rasim Demiri, Halit Krasniqi, Xhevahire Izmaqu, Berat Buzhala, Fadil Demaku etj.

Mbani mend, mos kujtoni që dikush po ndërron emra. Kështu jeni paraqitur. 50 janë, nëse juve ua merr mendja të vazhdojmë, vazhdojmë! Po e zëmë, në listën që e ka ofrua Partia “Vetëvendosje”, e ka bërë një rend të vetin, Visar Ymeri, Florin Krasniqi, e treta është Alma Lama. Ndërsa, në regjistër është Konjufca dhe, unë, po ta respektoj regjistrin, them: fjalën e ka Glauk Konjufca! Urdhno, Glauk!

(Ndërhyrje)

Po, ju jeni pajtuar, por lista është e tillë, hidhërohet Glauku ashtu. Do me thënë, ka një rend këtu.

Glauk, a po flet, a çka po thua?

GLAUK KONJUFCA: Kryeministri nuk qenka këtu, mirëpo megjithatë ndjehem i detyruar që të ndërhyj në dy pika të fjalës së tij, në paraqitjen e tij të parë.

Së pari, mendoj që e keqpërdori shumë krizën institucionale në Kosovë dhe nënteksti i tij sikur aludonte se kjo krizë institucionale ka ardhur për shkak të opozitës. Unë nuk mendoj ashtu. Mendoj që për dy arsye ka ardhur kriza institucionale në Kosovë. Ajo është që, Behxhet Pacollin u përpoqën që ta zgjedhin patjetër president dhe kaloi nëpër disa shkelje, të cilat i anuloi Gjykata Kushtetuese, meqenëse kishin bërë marrëveshje partitë, që ai të bëhet president. Dhe, e dyta, për shkak të vjedhjeve industriale të votave, që kanë ndodhur në Kosovë dhe të cilat i identifikon edhe Raporti i Progresit, të them të drejtën.

Kurse, e dyta ishte që, kur i përshëndeti mediat, tha - i përshëndes mediat kritike por, edhe ato objektive. Domethënë, ky është mentaliteti i qeverisjes tonë. Mediat i ndanë në

media kritike dhe në media objektive. Kjo do të thotë në media kritike, të cilat janë të pavërteta, ato që thuhën, dhe në media objektive, të cilat e lavdërojnë Qeverinë.

Tash t'i kthehemi Raportit të Progresit. Ndonëse vetë Qeveria, por edhe të tjerët e kanë vlerësuar si real Raportin e Progresit, unë mendoj që ai nuk është i tillë. Ai nuk është real, sepse nuk ka mundur ta paraqesë realisht gjithë atë korrupsion që i ka përfshirë institucionet tona në të gjitha nivelet. Nuk ka mundur të shpjegojë gjithë kontrollin politik të pushtetit mbi drejtësinë dhe mediat e të tjera, dhe nuk ka mundur ta portretizojë realisht politikën ekonomike të Qeverisë, që ka rezultuar të jetë kaq shkatërruese për kapacitetet zhvillimore të Kosovës. Sidoqoftë, nuk është çështja këtu vetëm ta lavdërojmë Raportin e Progresit për evidentimin e të metave të qeverisjes. Nuk është puna as vetëm të nisemi prej tij për ta legjitimuar kritikën tonë për Qeverinë, e Qeveria në anën tjetër të mbrohet duke u kapur te riinterpretimet. Ne, si deputetë, po ashtu duhet ta kritikojmë edhe vetë Raportin e Progresit, aty ku ka nevojë. Dhe, duhet ta kritikojmë atë, sidomos nga krahasimi i Raportit të Progresit për Kosovën e Shqipërinë, në raport me Raportin e Progresit për Serbinë. Nëse krahasojmë Raportin tonë të Progresit me atë të Serbisë, do të vërejmë standarde të dyfishta në kurrizin tonë.

Përderisa Kosova kritikohet në çdo aspekt, Serbia lavdërohet pa arsye në disa prej fushave, të cilat po të shikohen nga Kosova, paraqesin ambicie hegjemonike të shtetit serb përballë Kosovës. Ta zëmë, ka mirëkuptim për Kushtetutën e Serbisë, ndërkohë që dihet shumë mirë se një Kushtetutë e tillë paraqet cenim të sovranitetit të Republikës sonë. Në preambulë dhe në nenin 182 të kësaj Kushtetute, shteti ynë definohet si pjesë integrale e Serbisë, kurse nenin 114 të saj e obligon presidentin serb që të betohet mbi Kosovën. Kjo Kushtetutë e Serbisë, pra, vendos standarde dhe detyrime ligjore që i obligon zyrtarët serbë ta luftojnë Kosovën në mënyrë të domosdoshme. Toleranca e Komisionit Evropian dhe raporteve të progresit për Kushtetutën hegjemonike të Serbisë është inkurajim i Serbisë, që e qetë dhe pa kurrfarë trysnie ta vazhdojë minimin e sovranitetit të Kosovës dhe integritetin territorial të Kosovës përmes strukturave të veta kriminale dhe të paligjshme.

Meqë jemi këtu te strukturat kriminale të Beogradit, është vërtet e papranueshme që Komisioni Evropian, përkundër herëve të mëparshme, kësaj radhe i referohet strukturave vetëm si struktura të ndara të Serbisë. Vetë fakti që Komisioni nuk i kualifikon këto struktura si të paligjshme, tregon se ato për këtë institucion janë të pranueshme. Kjo politikë e gabuar e dëmton projektin e shtetndërtimit të Kosovës, meqë mund të shërbejë si sinjal për strukturat kriminale të Beogradit që ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre kundërligjore për ta mbajtur Kosovën të ndarë dhe për ta zhvilluar të pa sfiduara aktivitetin e tyre të krimit të organizuar dhe të kontrabandës në atë pjesë të Kosovës.

Po ashtu, te pjesa e menaxhimit të kufijve Raporti vlerëson se ka pasur përparime, ndërkohë që përmenden vetëm kufijtë e Kosovës me Shqipërinë, me Maqedoninë dhe me Malin e Zi. Këtu shtrohet pyetja: Kufijtë me Serbinë a janë krejtësisht të menaxhueshëm dhe Raporti nuk e ka përmend me qëllim, apo mos Raporti i Komisionit Evropian nuk i konsideron shtetëror, zyrtarisht shtetëror kufijtë e Kosovës me Serbinë. Ne e kuptojmë që kjo sjellje ledhatuese e BE-së karshi Serbisë bëhet nga pozicioni, sipas të cilit Serbia

duhet futur patjetër në BE, por ne do të jemi vendosmërisht kundër që ky integrim i Serbisë të bëhet në kurriz të Kosovës dhe të qytetarëve të vendit tonë.

Zyrtarë të lartë evropian ia kanë thënë Serbisë se duhet zgjedhë ne mes të Kosovës dhe BE-së. Në anën tjetër, motoja e Qeverisë serbe është edhe BE-ja, edhe Kosova. Por, deri tash, siç po duket, BE-ja nuk po e kushtëzon seriozisht Serbinë me Kosovën. Dhe, pikërisht ky hezitim dhe tolerim i BE-se ndaj politikës hegjemoniste të Serbisë po ia mundëson asaj që në njërin anë të shkojë drejt statusit të vendit kandidat e në anën tjetër të ngris barrikada në territorin e Republikës së Kosovës.

Politika e koordinuar e Kosovës me BE-në ndaj Serbisë duhet të jetë kjo: Hapërimi i Serbisë drejt BE-së duhet të jetë në përpjesëtim me tërheqjen e Serbisë nga Kosova. Ne nuk duhet të pajtohemi që Serbia me një këmbë të hyjë në BE, e me tjetrën t'i mirëmbajë strukturat e paligjshme në veri.

Raporti i Progresit e lavdëron dialogun Prishtinë-Beograd. Në të vërtetë duhet të thuhet se ky dialog nga Serbia vetëm po keqpërdoret para Brukselit, që Serbia ta maskojë praninë dhe aktivitetin e saj kriminal brenda Kosovës. Kryenegociatori zyrtar serb Borislav Stefanoviq, që nga Brukseli shihet aq i moderuar, në fakt u pa tek i udhëheq bandat serbe të financuara nga Beogradi, që i dogjën kufijtë e Republikës së Kosovës. Raporti i Progresit nuk e thotë këtë gjë. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës nuk e ka pajisur Brukselin me videoincizimet, ku shihet qartë prania e Borislav Stefanoviqit në djegien e pikave doganore dhe nëpër barrikada. Me siguri Qeveria nuk e ka bërë këtë gjë, për sa kohë e konsideron Stefanoviqin bashkënegociator. Përveç këtyre vërejtjeve për të pathënat e Raportit të Progresit, vlerësimi pozitiv i reformave ushtarake në Serbi nuk është aspak i drejtë. Në Serbi kemi ngritjen e atyre ushtarakëve të cilët janë shquar për udhëheqjen e njësiteve që kanë kryer masakra mbi popullin shqiptar. I tillë është për shembull Goran Radosavljeviq, në krye të masakrës së Reçakut. Dy muaj pas Reçakut, po nga Brukseli, NATO-ja filloi bombardimin e Serbisë. Qeveria e Kosovës me pasivitetin e saj nuk do të krijojë imazh të gënjeshtërt për Serbinë, por duhet ta mbajë Brukselin gjithnjë të informuar për një Serbi, e cila në raport me Kosovën këto vite nuk ka ndryshuar aspak.

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatçija!

TEUTA SAHATÇIJA: Faleminderit, nënkryetar!
Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,
Mendoj që Raporti i Progresit duhet të pritët me një interesim duhet të pritët nga çdo shtet, i cili aspiron që një ditë të merr kandidaturën për BE, sepse tregon fushat ku duhet të koncentrohemi për përmirësimin për progresin real, në këtë rast për Kosovën. Mendoj që këtu nuk ka pozitë apo opozitë. Nuk e do pozita më shumë Kosovën ose opozita. Mendoj që këtu duhet më tepër rëndësi t'i japim atyre pjesëve ku nuk ka progres, sepse dëshirojmë progres, sesa të vetëkënaqemi me një progres të munguar apo me një progres të pakët. Në fakt, fjala apo fjalët që më së shumti përdoren në çdo paragraf, janë

“përparim i kufizuar”, “ca përparim”, “progres i limituar”, “nevoja për reforma”, “nuk ka përparim”, por ka edhe vende ku thuhet që “ka përparim të mirë”. Mendoj që kryeministri, kur e përmendi fushatën dhe tha që kjo nuk duhet të jetë fushatë, mendoj që i kanë mbetur në kujtesë pikërisht premtimet gjatë fushatës. Premtimet, të cilat sot përbëjnë pjesën me kritika më të shumta në Raportin e Progresit. Në anën tjetër, ne nuk kemi nevojë për Raportin e Progresit që të shohim që një Qeveri megalomane, e cila e ka për detyrë që të ngopë kërkesat e koalicionit, partnerëve të koalicionit, ende nuk ishte në gjendje që të bëjë një strategji zhvillimore, e cila do të jetë në gjendje që ato përparime, ato premtime të fushatës edhe t’i realizojë. Në fakt, në qoftë se flasim për inflacion, në faqen 26 thuhet që në vitin 2010 inflacioni ka qenë 3,5, , më 2011 është 10,8.

Në Raportin e Progresit thuhet që gjendja ekonomike është sfiduese, që ekziston deficiti buxhetor, që financimi i buxhetit 2010 përballet me rreziqe të konsiderueshme, ku papunësia është 45,4% dhe në qoftë se është zvogëluar për 1% papunësia e njerëzve me kualifikim të ulët, është me të vërtetë për keqardhje që është rritur shumë numri i të papunëve me kualifikim të lartë. Dhe, kjo qartë tregon për mungesën e ndërlidhjes së arsimit dhe tregut të punës. Brengosëse është gjithashtu kur në Trustin Pensional shënohet që ka rritje të kontributdhënësve, por kjo rritje është aq sa është në sektorin qeveritar, aq edhe në sektorin joqeveritar. Dhe, kjo në qoftë se përkthehet në terma ekonomike, tregon se nuk ka pasur zhvillim ekonomik, nuk ka pasur ambient për biznes, i cili do t’i punësonte këta njerëz, po ata punësohen në sektorë qeveritar.

Në faqen 24, ku flitet për stabilitetin ekonomik, makroekonomik, thuhet: Në përgjithësi rritja ekonomike në Kosovë ka mbetur e dobët dhe e brishtë. FMN-ja, në raport me FMN-në kaluar apo ramë prej stand-by arangment në programin monitorues, dhe kjo nuk ka çka të konstatohet më tepër se sa jo një zhvillim i mirë.

Në Bankën Botërore patëm humbje të mjeteve. Mosshitja e PTK-së, e cila është me buxhet si mjet, tregon që menaxhimi i dobët i buxhetit dhe i parasë publike ekziston. Në këto ditë shohim edhe rreth Kosovës, shohim se mosmenaxhimi i duhur me paratë publike, me buxhetin e shtetit, me harxhime shumë të mëdha se sa kapacitetet gjeneruese ekonomike, Greqinë e sollën në trazira të shumta, në ndryshime në skemën politike, që s’kishte qenë keq, përndryshe, por ajo që është pasojë më afatgjatë dhe më e dobishme, më e dhimbshme, do të jenë vitet e vështira për qytetarët e Greqisë.

Me këtë politikë shpenzuese në Kosovë, dëmtimi afatgjatë i shtetit të Kosovës është evident. Por, kjo zotësia e kryeministrit për organizimin e zgjedhjeve të kontestuara dhe premtimeve pa bazë buxhetore, nuk rezultoi si zotësi në organizimin e kapaciteteve qeveritare për një program zhvillimor profesional. Jo programi i Power Pointit, made in Bullgaria, por programi i duhur, i cili do të plotësonte nevojën e arsyeshme për rritjen e pagave.

Kryeministri lavdërohet me rritjen e rrogave, që është mirë, por harron të tregojë që përderisa mjekët marrin rroga më të mëdha, pacientët nuk kanë barëra dhe trajtim të duhur. Përderisa arsimtarët marrin paga më të mira, librat në sasi të premtuar, apo ndërtimi i shkollave nuk është duke ndodhur. Harron të tregojë që bizneseve që e mbajnë

buxhetin e Kosovës, i ka borxh 32 milion euro në kontrata të papaguara. Dhe, pjesa më e madhe e investimeve kapitale, që është dedikuar autostradës, nuk prodhon efekte multiplikuese ekonomike. Shembulli i angazhimit të pak firmave vendore në punët e Bechtel-Enka, apo të nivelit të pagesave minimale, për shembull 90 centë për m³ të transportit të dheut, përderisa Bechtel-Enka paguhet me 3,82 vetëm se vërteton mungesën e një vizioni zhvillimor. Me dëmtimin e rëndë të biznesit, në afat të gjatë dëmtohet, zvogëlohet buxheti i shtetit, zvogëlohen tatimet nga të cilat paguhen mësimdhënësit, personeli mjekësor, policët etj. Zvogëlohen investimet kapitale për vitin vijues, tkurren dhe hyjnë në një cikël të varfërisë. Bizneset tjera, që nuk ndërtojnë rrugë, mbesin në prag të ekzistencës, pasi nuk ka buxhet për veprimtaritë e tyre.

Energjetika – sa i përket energjetikës, thuhet se sektori i energjisë vazhdon të vuaj nga problemet serioze. Në pikën 4.2.5, thuhet: Asnjë zhvillim lidhur me furnizimin me rrymë.

Korrupsioni dhe efikasiteti i ulët i gjykatave në zgjidhjen e kontesteve gjyqësore, akumulimi i lëndëve të pazgjidhura, ndikimi i politikës në punën e tyre, largoi investitorët seriozë nga tenderët e rëndësishëm për Kosovën. Vazhdimi i këtij lloji të qeverisjes, fatkeqësisht, nuk e çon Kosovën drejt përparimit. Ato pak përparime që janë, nuk janë të mjaftueshme. Me këtë trend Kosova shkon drejt një kohe të rëndë kah aspekti buxhetor. Raporti i Progresit kërkon një seriozitet, kërkon angazhim të madh, kërkon veprimtari të planifikuara afatgjatë të të gjitha shtyllave institucionale. Dhe, normalisht që pritet që barra më e madhe t'i takojë kryeministrit, t'i takojë Qeverisë. Këto kritika dhe rekomandime që dalin, duhet të pranohen si qëllimmira për të mirë të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete.
Atëherë, pushimi i drekës deri në orën 15:00!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Mbledhjen drejton: zoti Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Deputetë të nderuar, po fillojmë punën!
Fjalën e merr ministri Bajram Rexhepi!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues,
Zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,

Një ndër arritjet kryesore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në përgjithësi në agjendën evropiane është plotësimi i parakushteve për hapjen e dialogut për liberalizmin e vizave me Bashkimin Evropian, në dhjetor të këtij viti. Kjo arritje është rezultat i qasjes pro aktive dhe punës së palodhshme, institucionale dhe e përkushtimit të plotë në këtë drejtim, edhe pse për shkaqe tashmë të njohura Republika e Kosovës nuk ka qenë e përfshirë në këtë proces njëjtë si vendet tjera të rajonit.

Në vazhdim, do t'i përmend sfidat e Raportit të Progresit për kapitujt që janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe planet tona për adresimin e tyre.

Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi.

Në këtë kapitull ceket se Kosova ende nuk ka regjim të vizave, edhe pse një dokument i tillë është hartuar dhe është i gatshëm për diskutim e miratim në Qeveri.

Edhe pse pozita e Kosovës në fushën ndërkombëtare është shumë e ndjeshme, sa i përket njohjeve – 85 janë aktualisht, ne duhet sa më shpejt të aplikojmë regjimin e vizave për shkak se shtetasit e ndryshëm, në veçanti nga Lindja dhe Afrika veriore, shfrytëzojnë Kosovën si rrugë transite për të depërtuar në shtetet perëndimore evropiane. Kjo është edhe një nga standardet evropiane që duhet të plotësojmë dhe një nga kushtet për liberalizimin e vizave me Bashkimin Evropian.

Sa i përket gjendjes civile, kemi bërë progres në miratimin e Ligjit për gjendjen civile, që i adreson defektet që i kemi pasur sa i përket gjendjes civile dhe në këtë drejtim planet tona janë që të integrohen të gjitha bazat e të dhënave në regjistrin qendror civil të Kosovës, duke pasur parasysh se të gjitha librat janë skanuar dhe digjitalizuar dhe në këtë mënyrë rrisim kredibilitetin e sigurisë së dokumenteve.

Gjithashtu, do të rrisim bashkëpunimin ndërmjet ambasadave, zyrave lokale dhe Agjencionit të Regjistrimit Civil për nevojat e regjistrimit civil me qëllim të përmirësimit, të trajtimit të duhur tëtë raportuara që përfshijnë: certifikatat e gjendjes civile apo dokumentet e identitetit, si dhe funksionalizimin e plotë të Inspektoratit të Agjencionit të Regjistrimit Civil, me mandat për të kontrolluar integritetin e procesit lidhur me gjendjen civile, librat e regjistrit civil, regjistrimin e veturave dhe lëshimin e patent-shoferëve. Arritje në fushën e sigurisë së dokumenteve dhe regjistrit civil, është edhe fillimi i lëshimit të pasaportave biometrikë, me ç'rast edhe kemi përmbushur një nga kriteret për liberalizim të vizave.

Menaxhimi i integruar i kufirit.

Në këtë kapitull të Raportit të Progresit theksohet progresi që e ka bërë Kosova në funksionalizimin e sistemit për menaxhim të kufirit BMS kontabël me sistemin SIS të Shengenit në të gjitha vendkalimet kufitare, si dhe në qendrat e komandës policore, si qendrore ashtu edhe rajonale. Gjithashtu, përmendet themelimi i task-forcës së përbashkët të doganave dhe shërbimeve policore për të luftuar kriminalitetin tejkuftar dhe kontrabandën e cila ka filluar që të bëjë vlerësimet e përbashkëta të rrezikut dhe vlerësohet bashkëpunimi i agjencioneve për zbatim të ligjit në operacionet e përbashkëta patrulluese në vijat kufitare dhe pikat e kalimit kufitar.

Planet tona në këtë drejtim janë:

- zbatimi i legjislacionit të plotësuar për menaxhimin dhe kontrollimin e kufirit shtetëror;
- rishikimi dhe plotësimi i strategjisë për menaxhimin e integruar të kufirit;

- përfundimi i demarkacionit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi;
- përforsimi i bashkëpunimit me shtetet e rajonit në aktivitetet që kanë të bëjnë me patrullimet e përbashkëta në zonat kufitare dhe shkëmbim të informatave me qëllim të parandalimit të krimeve ndërkufitare;
- aplikimi i konceptit të menaxhimit të integruar të kufirit në të gjitha pikë-kalimet kufitare, duke përfshirë edhe Jarinjen dhe Bërnjakun.

Azili

Në fushën e azilit është arritur përparim. Kosova është ballafaquar me rritje të kërkesave për azil. 31 persona kanë kërkuar azil në vitin 2009. Në vitin 2010 ky numër ka arritur në 271 dhe ka pasur 147 kërkesa në gjysmën e parë të vitit 2011.

Në bazë të Ligjit për azilin, autoritetet e Kosovës e kanë sistematizuar lëshimin e dokumenteve të identifikimit për azil-kërkuesit, një udhëzues sqarues lidhur me obligimet dhe të drejtat e azil-kërkuesve është zhvilluar dhe shpërndarë.

Raporti thekson se Kosova ende nuk ka bazë të dhënash në fushën e azilit dhe se Qendra për azil-kërkues në Magurë ka kapacitete të limituara.

Planet tona në fushën e azilit janë:

- zbatimi i legjislacionit të plotësuar në fushën e azilit;
- funksionalizimi i plotë i Qendrës për azil-kërkues me kapacitete prej 50 persona në fshatin Magurë, donacion i Komisionit Evropian. Kjo do të bëhet gjatë muajit nëntor;
- përmirësimi i procedurave për shqyrtimin e kërkesave për azil nga azil-kërkuesit. Vlen të theksohet se si rezultat i ngritjes së efikasitetit të mekanizmave përgjegjës të Ministrisë së Punëve të Brendshme në adresimin e rasteve të azil-kërkuesve tani në vendin tonë kemi vetëm 4 azil-kërkues, pra ka rënë në mënyrë drastike.

Migrimi

Në fushën e migrimit Raporti i Progresit thekson progres në përmirësimin e procedurave për hyrjen e të huajve në Kosovë, me çka ka kontribuar në parandalimin e hyrjes së migruesve të pa rregullt, si dhe përmendet progres i konsiderueshëm sa i përket riintegrimin të personave të riatdhesuar si dhe politikave të riatdhesimit.

Planet tona në fushën e migrimit janë:

- vazhdimi i nënshkrimit të marrëveshjeve të riatdhesimit;

- përforcimi i kapaciteteve komunale për ri-integrimin e personave të riatdhesuar;
- lidhja e partneriteteve në fushën emigracionit me shtetet e Bashkimit Evropian;
- ndërmarrja e veprimeve preventive me qëllim të parandalimit të migracionit ilegal nga Kosova në shtetet e Bashkimit Evropian, përkatësisht rënia e numrit të azil-kërkuesve nga Kosova në vendet e Bashkimit Evropian;
- luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit me narkotikë dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Raporti i Progresit përmend Kosovën si vend transit për kalimin e narkotikëve nga Lindja. Përmendet progresi në luftimin e krimit të organizuar, bashkëpunimi me EULEX-in në raste të krimit të organizuar ka qenë i mirë në nivelin e policisë dhe prokurorisë.

Policia me sukses ka siguruar mbrojtje të afërt për prokurorët specialë të përfshirë në hetimin në rastet e krimit të organizuar.

Policia e Kosovës e ka filluar ndërtimin e kapaciteteve për trajtimin e dëshmitarëve të mbrojtur.

Strategjia dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore për vitin 2011 – 2014 është miratuar më 1 shtator dhe në vjeshtë të vitit 2010 është organizuar një fushatë për vetëdijësim në lidhje me trafikimin.

Grupi punues ndërministror kundër trafikimit i ka vazhduar takimet e rregullta. Është emëruar koordinatori kombëtar i cili është përgjegjës për të siguruar implementimin e strategjisë.

Planet për adresimin e sfidave janë:

- përforcimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit në identifikimin dhe shkëmbimin e informatave me qëllim të luftimit të të gjitha llojeve të krimit të organizuar;
- ngritja e mëtejme e kapaciteteve të Policisë së Kosovës në luftimin e krimit të organizuar;
- funksionalizimi i plotë i Njësitit të Policisë së Kosovës për zbatimin e Programit për mbrojtje të dëshmitarit;
- zbatimi i plotë i strategjisë së miratuar rishtazi për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore 2011 – 2014.

Policia

Raporti i progresit thekson arritje të Kosovës në fushën e policisë, përmes marrjes....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, faleminderit! Para se tua jap fjalën, në vazhdim, po ju njoftoj që janë 45 diskutues të paraqitur. A e aprovoni këtë propozim për 5 minuta a s'e pranoni? Si të keni qejf ju. A doni, apo jo? Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën!

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pata dëshirë që fjalën ta merrja në kohën kur ministri i Bujqësisë ishte prezent, sepse unë do të fokusohem tek pikat e Raportit të Progresit për sektorin e bujqësisë.

Në përgjithësi vërejtjet janë për çdo aktivitet të Ministrisë së Bujqësisë. Në variantin më të mirë thuhet se në fushën e bujqësisë, edhe në politikat e zhvillimit rural, është bërë progres shumë i limituar legjislativ. Ky është i vetmi konstatim pozitiv për tërë këtë sektor.

Vërejtjet janë të shumta. Vazhdon të ketë shumë dallime ndërmjet të dhënave të Eurostatit dhe Zyrës së Statistikave të Kosovës në lidhje me tregun e bujqësisë - Bashkësia Evropiane – Kosovë.

Shtrohet pyetja: Si mund të bëhet planifikimi i politikave zhvillimore në mungesë të të dhënave?

Shërbimet këshillimore në Ministrinë e Bujqësisë ende nuk kanë bërë ndonjë informim se si fermerët të aplikojnë për grante. Financimi komercial nga bankat e Kosovës mbetet i kushtueshëm, bile shpesh i pa arritshëm si në aspektin e nivelit të kamatës dhe në kolateralin e kërkuar.

Ligji i ushqimit nuk zbatohet, ose zbatohet fare pak, sidomos në lidhje me kompetencat e inspektorëve në nivel lokal dhe qendror.

Infrastruktura e teknologjisë informatike për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve nuk është ende operacionale. Regjistrimi i kafshëve vazhdon të pengohet nga mos raportimi i lindjeve të kafshëve, si dhe ka kontrabandë dhe therje të paligjshme.

Laboratori i AVUK-ut nuk ka staf të mjaftueshëm dhe infrastrukturë fito-sanitare dhe veterinarë. Gjithashtu, pikat e inspektimit kufitar janë shumë të dobëta.

Mendoj që Raporti i Progresit është një dokument ku ne me politikat e ardhshme të ndikojmë në rritjen e progresit, aty ku ka ngecje. Ndërsa, buxheti për sektorin e bujqësisë edhe për këtë vit është tejet i ulët.

Investimet kapitale 7.9 milion dhe subvencionet 8.4 milionë, që janë 1.1% e buxhetit të tërësishëm, limitojnë arritjen e synimeve në këtë sektor. Gjithashtu, implementimi i kornizës legislative është sfidë për institucionet.

Që nga pas lufta investimet në pyjet e Kosovës kanë qenë fare të ulëta. Ka ngecje të struktura e organizimit për menaxhimin e pyjeve. Agjencioni Kosovar i Pyjeve është vetë menaxhues, vetë kontrollues.

Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës ende mbetet në Zyrën e kryeministrit, që paraqet një anomali të veçantë në organizimin e institucioneve.

Kjo i bie që kryeministria, përveç tjerash, do të duhej të merret edhe me kontrollimin e mishit të importuar.

Për vitin 2012 nuk ka asnjë projekt të ri kapital në këtë agjencion. Janë krejtësisht 2.3 milionë që barten nga ky vit, të cilët nuk janë shpenzuar.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë përparim të kufizuar në fushën e bujqësisë dhe sigurimit të ushqimit. Regjistrimi i kafshëve, asgjësimi i nën-produkteve të tyre dhe vlerësimi i impianteve të agro-ushqimit, si hap i parë në avancimin e tyre, meritojnë vëmendje të veçantë.

Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë është më i ulëti në rajon. Vendet e rajonit ndajnë 5 deri 8% të buxhetit të përgjithshëm për bujqësi. Për t'u bazuar me vendet e rajonit dhe për të shënuar progres në sektorin e bujqësisë, buxheti për bujqësinë e Kosovës do të duhej të ishte rreth 100 apo më tepër milionë euro. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Kurtan Kajtazi e ka fjalën!

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Raporti i Progresit përfshin periudhën njëvjeçare dhe bazohet në tre parametra kryesorë.

Vetë qasja e Komisionit Evropian, në njërën anë, si dhe pozita specifike e Kosovës në raport me Komisionin, duke mos pasur ende statusin e vendit kandidat, pa përmendur sfidat e veçanta me të cilat ballafaqohet aktualisht Kosova, janë indikatorë të mjaftueshëm për të konkluduar se në diskutimet dhe analizat rreth raportit duhet të jemi real dhe të kujdesshëm. Kjo për faktin se gjithmonë duhet të kemi parasysh edhe kufizimet me të cilat ballafaqohemi si shtet i ri.

Nuk është në rregull që i tërë fokusi i diskutimit orientohet vetëm në sferat ku jepen vërejtje dhe sugjerime, por me qëllim të një qasjeje gjithëpërfshirëse do të duhej që vërejtjet t'i kuptojmë si sfida me qëllim që t'i përmirësojmë ato, kurse të mos i lëmë anash as komentet dhe vlerësimet pozitive, pasi që në këtë mënyrë ne si Kuvend do të njohim dhe çmujmë punën që bëhet nga të gjitha institucionet tona.

Ne duhet që t'i afirmojmë fuqishëm rezultatet pozitive të arritura, sepse në këtë mënyrë tregojmë se nuk i anashkalojmë ato, por edhe i nxisim dhe motivojmë të tjerët që të përdorin shembuj pozitivë.

Në këtë drejtim, unë sot do të përmendja disa aspekte shumë të rëndësishme që në raport vlerësohen pozitivisht.

Kështu, vlerësohet pozitivisht përparimi në punën e Gjykatës Kushtetuese, në nxjerrjen e mjaft aktgjykimeve kyçe, pastaj në punën e Këshillit Gjyqësor, si dhe në fillimin e funksionimit të Këshillit Prokurorial. Gjithashtu është vlerësuar edhe përfundimi i suksesshëm i riemërimit të gjykatësve.

Në raport theksohet se gjithashtu të drejtat e punës dhe ato sindikale janë të garantuara gjerësisht, si dhe përparimi në sferat e të drejtës pronësore. Këto aspekte janë shumë të rëndësishme dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik.

Potencohet edhe përmirësimi i pozitës së mediave në gjuhët e pakicave.

Në fushën e refugjatëve dhe personave të zhvendosur në vend, po ashtu raportohet për përparim, sikurse edhe për kthimin e pjesëtarëve të pakicave që janë kthyer vullnetarisht në Kosovë dhe që numri i tyre është më i madhi në 6 vitet e fundit.

Është vlerësuar pozitivisht edhe hartimi i Ligjit për personat e pagjetur, i cili garanton njohjen e të drejtës për të ditur, por edhe të drejtës së reparacionit për familjet e të pagjeturve bashkë me statusin juridik të personave të pagjetur.

Do të ndalem edhe në disa aspekte të pjesës së Raportit për kriteret ekonomike. Që në fillim të kësaj pjese potencohet se në përgjithësi vazhdon të fuqizohet përkushtimi ndaj politikave ekonomike me orientim kah ekonomia e tregut.

Kur të merret parasysh periudha e tranzicionit të shumëfishtë, që si shtet jemi duke kaluar, si dhe të gjitha vështirësitë që rrjedhin nga kjo, ky është një moment shumë i rëndësishëm që ndërlidhet me reformat e gjithmbarshme strukturore që si vend jemi duke i ndërmarrë në këtë drejtim.

Rritja e ekspertit prej 70%, e shënuar në vitin 2010, është quajtur me të drejtë impulsive, sepse kjo nga 4.5% sa ishte në vitin 2009, arriti në 7.4% të bruto-produktit vendor.

Në këtë drejtim është shumë i rëndësishëm edhe përmirësimi i shkallës së mbulimit të importit me eksport, e cila tashmë ka arritur në 14.1%.

Duhet përmendur se në raport kur bëhet fjalë për deficitin buxhetor, ai kualifikohet si i lartë. Nuk mund të pajtohem me këtë cilësim, pasi që ai edhe ka mundur të përmendet se ka qenë 2.6%, shifra ato që janë ndër më të mirat në rajon, si dhe ky nivel është madje edhe nën nivelin e kritereve për anëtarë të ri të Bashkimit Evropian.

Ka shumë indikatorë tjerë ekonomikë e financiarë të cilët janë përmirësuar dhe që përmenden në raport. Kështu, për shembull, neto investimet e huaja direkte janë rritur për 7.5% të bruto produktit vendor.

Është rritur edhe niveli i dërgesave neto nga diaspora me rreth 6%. Pastaj, ka rritje të aseteve në rezervën e Bankës Qendrore. Gjithashtu, thuhet që korniza monetare ka vazhduar të funksionojë relativisht mirë.

Po ashtu, përmendet edhe performanca e mirë në ekzekutimin buxhetor, e sidomos në grumbullimin e lartë të hyrave në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu, evidencohet edhe rritja e bruto produktit vendor për kokë banori.

Një indikator shumë i rëndësishëm që përmendet në raport është edhe niveli i borxhit të jashtëm qeveritar, i cili është në shkallë të ulët prej 6.2%. Në raport përmendet edhe angazhimi i Qeverisë për të përmirësuar angazhimin në koherencën e politikave dhe në këtë drejtim potencohet si hap shumë pozitiv përgatitja e vizionit ekonomik, si dhe hartimi i planit të veprimtë për reformën ekonomike.

Në këtë drejtim, vlerësohet shumë roli udhëheqës që i është dhënë sektorit privat në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Në kapitullin – Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut, përmenden kryesisht në kontekst pozitiv përpjekjet që janë duke u bërë jo vetëm nga institucionet shtetërore por edhe nga strukturat ekonomike dhe biznesore në zhvillimin ekonomik. Kështu përmenden veprimet që në vazhdimësi janë duke u bërë në përmirësimin e bazës ligjore për të vlerësuar punën e bizneseve, pastaj angazhimi i Administratës Tatimore të Kosovës në dhënien e numrave fiskalë, si dhe instalimin e arkave dhe pajisjeve elektronike fiskale. Natyrisht se këto veprime shihen si aktivitete të drejtpërdrejta në luftën kundër informalitetit në ekonomi.

Në Raport i është kushtuar kujdes edhe integritetit ekonomik në BE. Dhe në këtë drejtim përmendet që hapja e ekonomisë, e matur me vlerën e importit dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve, në raport me bruto-produktin vendor, në vitin 2010 është rritur për 81.2% në krahasim me 70.5% në vitin 2009.

Eksporti drejt shteteve anëtare të BE-së është rritur në 84.% dhe ato tash përfshijnë 45% të totalit të eksportit të mallrave. Po ashtu, edhe sa i përket importit të mallrave, vendet e BE-së kanë mbetur burimi kryesor 38.3% nga totali i importeve.

Është e rëndësishme të përmendet se në rreth 2/3 e rrjedhave të reja hyrëse të investimeve të huaja në vitin 2010, vendet e BE-së kanë qenë investitorët më të mëdhenj në Kosovë.

Është theksuar se në fushën e doganave ka pasur përparim dhe këtu përmendet konkretisht jo vetëm niveli i këmbimeve me botën, që realizohet në pikat doganore të vendit, por edhe ndryshimet ligjore, pastaj ato në rritjen e kapaciteteve të përgjithshme teknike e teknologjike në këtë institucion të rëndësishëm shtetëror.

Vlerësohet, sidomos puna e Njësitit anti-kontrabandë në dogana, si dhe veprimet e tij në luftën e kontrabandës dhe evazionit fiskal.

Mendoj se është e rëndësishme të përmendet edhe vlerësimi që i bëhet përparimit në kontrollin e brendshëm financiar publik, si njëri nga aspektet më të rëndësishme të punës në menaxhimin e sektorit të financave publike. Në këtë drejtim përmendet krijimi i kornizës si bazë ligjore për auditimin e brendshëm, si dhe hartimi i planeve vepruese për zbatimin e kontrollit të brendshëm nëpër organizatat buxhetore.

Konsideroj se këto trende të zhvillimit ekonomik, financiar dhe rrjedhave të tregtisë dhe investimeve me këta tregues janë indikatorë të qartë të orientimit të përgjithshëm që ka vendi ynë drejt perspektivës evropiane.

Edhe pse nuk mund të jemi plotësisht të kënaqur me intensitetin, ai që është satisfaksion i veçantë është orientimi dhe trendi i kahes së rrjedhave ekonomike dhe në këtë raport trend dhe indikatorë të tillë ka mjaft, dhe ato duhet t'i kemi edhe ne parasysh, natyrisht duke synuar gjithmonë një përmirësim të vazhdueshëm të tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Alma Lama!

ALMA LAMA: I nderuar kryesues,
Te nderuar deputetë

Raporti i Progresit edhe këtë vit diagnostifikoi funksionimin e institucioneve në Kosovë dhe na bëri me dije se i gjithë diskursi pro integriteteve i Qeverisë së Kosovës nuk ka qenë tjetër veçse retorikë boshe.

Ka qenë retorikë pasi veprimet e ndërmarra përgjatë vitit që shkoi janë aq të zbehta e të papërfillshme për të përmbushur standardet evropiane, sa që nuk lënë asnjë hapësirë për të besuar se ka pasur vullnet të qartë politik.

Konstatime, si shkalla e gjerë e korrupsionit, ndërhyrjet politike në drejtësi, dobësimi i institucioneve të pavarura, administratë politike, krim i organizuar, kontroll i mediave e tjerë - mjaftojnë për të dëshmuar se pro integriteteve evropiane nuk ka vullnet, por vetëm retorikë. Në rast se do të ishte e kundërta, do të kishim rezultate shumë më pozitive në këto fusha. Le t'i marrim me radhë.

Raporti i vitit 2011 i referohet një nga shtyllave kryesore të shtetit, sistemit të drejtësisë, duke konstatuar, citoj: “se ndërhyrja politike në punën e gjyqësorit është brengosëse.” Do të mjaftonte vetëm kjo fjali për të arritur në përfundimin se i tërë sistemi institucional në Kosovë është në rrezik. Ndërhyrjet politike në drejtësi dëmtojnë çdo garanci të funksionimit të shtetit. Njerëzit të cilët nuk respektojnë ligjin, zyrtarët të cilët keqpërdorin pozitën e tyre, mbeten të pandëshkuar.

Në një situatë të tillë, kur politika fut hundët në drejtësi, nuk ka rëndësi se sa i rrit rrogat e gjykatësve e të prokurorëve, nuk ka rëndësi as infrastruktura ligjore që mund ta kesh përgatitur, pasi ato zhvlerësohen përballë ndërhyrjeve.

Shtrohet pyetja se - kush e bën këtë ndërhyrje politike në drejtësi? E, kush tjetër përveçse partia në pushtet! Atëherë, a mund të flasim për vullnet dhe përkushtim pro integriteteve? Jo, vetëm për retorikë.

Vijmë te çështja tjetër, lufta ndaj korrupsionit. Raporti konstaton se vazhdojnë të mbeten brengosëse shkeljet e rregullave të prokurimit publik në kontekstin e korrupsionit. Kjo do të thotë se miliona eurot e tenderëve nuk menaxhohen ashtu si duhet, me drejtësi dhe transparencë, siç bëhet në vendet demokratike. Pra, si rrjedhojë, miliona euro keqpërdoren, përfundojnë në xhepa zyrtarësh.

Në rast se nuk e besoni, shihni shpërputhjet e mëdha të pasurisë së disa zyrtarëve të lartë, të cilët çuditërisht janë bërë milionerë me rroga shteti. Faktet flasin vetë. Korrupsioni është bërë parim institucional, por më e keqja është se ai po përhapet edhe në disa fusha, si arsimi e shëndetësia, konstaton raporti.

“Legjislacioni i prokurimit ende nuk është në përputhje me standardet evropiane. Kosova ka punë për të bërë në kompletimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore në fushën e prokurimit publik”, thuhet në Raport.

Mjafton të shihni raportet e Auditorit të Përgjithshëm se si shkelet me dy këmbët edhe ligji që e kemi aktualisht. Pra, ka parregullsi dhe keqpërdorime të parasë publike.

Po kështu, shikoni edhe raportet e mediave që përditë raportojnë për afëra korruptive. E cili është reagimi i prokurorisë në raste të tilla? Është zero! Sa çështje ex officio janë hapur, zero. Pra, jo vetëm që nuk ka luftë ndaj korrupsionit, por ka inkurajim nga ana e Qeverisë. E në këtë rast, a mund të flitet për vullnet pro integriteteve apo vetëm për retorikë boshe? Përgjigja është vetë retorike. Mungon transparenca në procedurat e tenderimit dhe në përgjithësi në jetën institucionale, për arsyen e thjeshtë se kanë çfarë të fshehin.

Ligji për qasje në dokumente publike është në fillimet e tij, zyrtarët rezistojnë për të bërë publike dokumentet, tamam siç bëri Qeveria me kontratën 700 milionëshe. Është e kuptueshme, fryma vjen nga lart.

E meqë jemi te transparenca, Raporti konstaton se një pjesë e madhe e mediave janë vënë nën kontroll dhe i bëjnë temena Qeverisë. Liria e tyre është e kufizuar dhe gazetaria investigative nuk gjen terren. Kosova rangohet në listën e lirisë së medias, krahas disa vendeve diktatoriale dhe kjo është më shumë se sa brengosëse. Kjo është alarmante. Filozofia e Qeverisë, pra, është kthimi i medias në një instrument për të mbajtur pushtetin. E këtu nuk mund të flasim përveçse për retorikë pro integriteteve evropiane.

Madje Qeveria nuk ka caktuar ende asnjë zëdhënës, i cili do të ishte hapi fillestar i transparencës. Edhe pse ka premtuar këtu në Parlament, s'e ka mbajtur fjalën deri tani.

Por, në instrument për të legjitimuar pushtetin duket se është shndërruar edhe institucioni i Avokatit të Popullit. Në vend që ky institucion të jetë dera ku qytetarët të trokasnin për të zgjidhur problemet që vijnë, si pasojë e arrogancës institucionale, ai është shndërruar në një institucion që nuk zgjidh dot as hallat e veta. I lënë pas dore, në fakt me qëllimin për ta dobësuar, ky institucion është tregues i qartë i performancës së demokracisë në këtë vend.

Vijmë te administrata publike, e fryrë dhe e stërfryrë me njerëz, por mungesë e theksuar ekspertize. E politizuar deri në pikën e fundit dhe e paafte për të përballuar sfidat qeverisëse. Kam dëgjuar këto ditë deklarata se ky është mëkat i përbashkët, domethënë i partive që kanë qenë në pushtet. Kjo ndarje e fajit është shfajësim për partinë që është në pushtet tani, e cila jo vetëm që nuk ka bërë asgjë për të korrigjuar gabimet e mëparshme, por ka punësuar dhjetëra apo qindra vetë pa kriterë dhe pa nevojë. Nga 60 mijë veta, sa ka qenë administrata para tre apo katër vitesh, tani ka shkuar në 80 mijë.

Administrata është shndërruar në vendin e përmbushjes së premtimeve elektorale për vende pune nga partia në pushtet, e pritshme kjo duke pasur parasysh se Qeveria nuk ka kurrfarë vizioni për zhvillim ekonomik dhe hapjen e vendeve të punës. Në rast se do të ishte e kundërta, do të mbronte tregun dhe produktet e veta. Pra, edhe çështja e administratës, e cila është kyçe për integritetin në BE, BE mbetet vetëm retorikë boshe.

Kosova është han pa porta në kuptimin e plotë të fjalës. Ajo është shndërruar në një lavatriçe të pastrimit të parave të pista. Krimi ekonomiko-financiar është i pranishëm kudo. Kompani të huaja gjoja vijnë për të investuar, por në fakt e bëjnë këtë vetëm për të shpërlarë paratë. OJQ të dyshimta herë nën petkun humanitar e herë fetar, bëjnë të njëjtën gjë, duke futur në Kosovë edhe para që financojnë terrorizmin, apo para që vijnë nga trafikimi i drogës dhe të gjitha këto zhvillohen në prani të një policie e cila vuan nga mungesa e kapaciteteve dhe e ndërhyrjeve politike, dhe e një prokurorie impotente.

Nuk kam ndonjë fjalë më të mirë as për misionin e EULEX-it në këtë rast. Dikujt mund t'i duken të parëndësishme këto, por në të vërtetë këto janë strukturat që kapin shtetin dhe nuk e lënë atë të funksionojë edhe në rrethanat kur politika do të kishte vullnet politik për t'i luftuar këto struktura.

Prokurorëve dhe gjyqtarëve iu mungon përvoja në këto fusha, thuhet në raport. Por, çfarë ka bërë Qeveria që të inkurajojë rritjen e nivelit të ekspertizës në institucionet e

drejtësisë? Asgjë! Aktiviteti i saj është përqendruar në rritjen e numrit të ministrave në 19, dhe zëvendës kryeministrave në 6, thua se jemi në Indi apo Kinë, sa edhe pjesëmarrjen në seancë duket se e bëjnë me turne ministrat pasi nuk ka karrige për të gjithë. Dhe, kuptohet se secili prej tyre e ka shpurën e vet administrative, pra miliona euro shpenzime pa nevojë, ne vend që të investohet në ekspertizë. Të gjitha institucionet kanë nevojë për ekspertizë, dhe jo për punësim njerëzish pa kritere.

Edhe Kuvendi i Kosovës ka marrë mjaft kritika nga Raporti i Progresit, pikërisht për mungesë ekspertize. E, meqë jemi te Kuvendi, unë personalisht e kam theksuar disa here se as po bëjmë ligje të mira, sepse po i miratojmë me nguti, e as po bëjmë mbikëqyrje të mirë të punës së Qeverisë.

Dua të ndalem edhe tek dy çështje të tjera, që kanë të bëjnë me retorikën e qeverisë pro integriteteve. Siç e keni dëgjuar, kur doli Raporti i Progresit, Qeveria në vend që të marrë përgjegjësinë për ngecjet e konstatuara në këtë raport dhe për problemet e mëdha, u përpoq që ta linte këtë nën hijen e një sinjali pozitiv që erdhi nga Brukseli për hapjen e dialogut për liberalizim vizash.

Deri para pak kohësh Qeveria thoshte se këto janë dy procese të ndara, pra liberalizimi nuk ka lidhje me Raportin e Progresit, kurse tani na doli se ky qenka rezultat i punës së mirë, i konstatuar në këtë raport. Thjesht, dua tua sqaroj juve dhe qytetarëve se kjo nuk është aspak e vërtetë. BE ua ka mundësuar këtë proces, pra lëvizjen pa viza edhe plotë shteteve të tjera që nuk janë në Evropë.

Ndërsa, po të shikoni hartën, Kosova mbetet e vetmja pikë e kuqe në Evropë e cila nuk ka përfituar nga ky proces dhe shpresojmë që në dy vitet e ardhshme kjo gjë të përmirësohet. Pra, liberalizimi i vizave, gjithashtu është pjesë e retorikës, që kërkon të fshehë të vërtetën për Raportin negativ të Progresit

Ta sqaroj pak këtë çështje në raport negativ apo real, Raporti është real, realiteti është negativ, rregulla e treshit – raporti është negativ.

Së dyti, ka propozime e iniciativa për krijimin e një këshilli kombëtar pro integriteteve, i cili do të përfshinte krerët më të lartë të institucioneve, partive politike e tjerë.

Mua më duket se krijimi i mekanizmave mbi-institucionalë është shndërruar në një mahni këtu në Kosovë, ka institucione mbi institucione, zhvillon konferencë pas konferencash, ka lloj-lloj idesh që hidhen, por kryesisht kanë të bëjnë me fjalë boshe, pasi kur vijmë tek puna, ajo është shumë e pakët.

Në Kosovë nuk kemi nevojë për një këshill të tillë, i cili mund të ketë qenë i nevojshëm dhe produktiv në vende ku ekzistojnë parti politike dhe masa të tëra të njerëzve të cilët janë kundër integriteteve në BE...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mirë, pasi pozita po kërkon edhe një minutë, merre edhe një minutë!

ALMA LAMA: Thashë, ky këshill mund të ketë qenë i rëndësishëm dhe produktiv në vende të cilat kanë parti politike që i kundërshtojnë integrimet në BE, apo masa të tëra njerëzish, kurse në Kosovë të gjithë janë pro integrimi në BE. Pra, nuk ka nevojë për mekanizma të tillë dhe thjeshtë do të ishte humbje kohe, energjie dhe financash. Prandaj, këshilla ime është më pak retorikë pro-evropiane dhe më shumë punë për të plotësuar standardet evropiane. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Nëse jeni dakord me propozimin e Armendit për të kaluar në 5 minuta në diskutim, e bëjmë këtë. Pra, a jeni dakord që diskutimet të jenë nga 5 minuta?

Fjalën e ka deputetja Kimete Bytyqi!

KIMETE BYTYQI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Sot po diskutojmë për një raport që quhet Raporti i Progresit, ama që në esencë dhe në përmbajtje është raport i progresit për vendin tonë dhe si të tillë Qeveria e ka cilësuar raport real.

Mirë që e ka pranuar që është i tillë. Të tillë e ka bërë vetë kjo qeveri, e cila me marifetllëqet e saj, në vend që të ofrojë, ajo me keqqeverisjen e saj po e largon vendin tonë nga afrimi në anëtarësimin në strukturat e Bashkimit Evropian.

Meqenëse kolegët e mi nga Lidhja Demokratike e Kosovës diskutuan për disa pjesë të Raportit, unë jam fokusuar në kapitullin e respektimit të të drejtave të njeriut, qasjen në media, si dhe dy dukurive që janë kancer për shoqërinë dhe shtetin tonë - korrupsioni, luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit.

E para, në raport theksohet se promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut mbetet sfida madhore për autoritetet e vendit, ndërsa liria e shprehjes mbetet e kufizuar, sepse gazetarët vazhdojnë të përballen me procesin politik dhe frikësimin, gjë që ... gazetarinë hulumtuese, e cila edhe ashtu është ende e brishtë.

Ky fakt tregon se kjo qeveri me presione politike dhe me frikësim mundohet t'ua mbyllë gojën gazetarëve për të mbuluar veprimet e tyre të kundërligjshme dhe aferat e tyre korruptive me grupe që udhëheqin krimin e organizuar në vend.

Duke financuar RTK-në vetëm nga buxheti i Kosovës, kjo Qeveri ka demontuar dhe po demonton seriozisht pavarësinë editoriale të RTK-së, ndërhyrjet në politikat redaktoriale të transmetuesit publik, por edhe në të gjitha mediat tjera të shkruara dhe elektronike, bile, bile edhe me presione dhe frikësime ndaj gazetarisë dhe gazetarëve, që është

praktikë e regjimeve diktatoriale, të cilat tentojnë që secilin segment të shoqërisë dhe në këtë rast edhe të mediave ta fusin nën kontrollin e Qeverisë dhe të diktatorit.

E dyta, sa i përket krimit të organizuar, në Raport theksohet se Kosova mbetet vend i origjinës, transitit dhe destinimit për viktimat e trafikimit. Me këtë theksohet se ka vazhduar trendi i trafikimit të femrave brenda Kosovës, por edhe në shtetet tjera kudo në Evropë për qëllime të shfrytëzimit seksual.

Ka pasur shtim të numrit të viktimave të trafikimit të të miturëve, të trafikimit të fëmijëve dhe shfrytëzimit për qëllime të lëmshës, mbetet në nivele të larta. Numri i viktimave të identifikuar ka shënuar rritje. Ky raport po na tregon se në çfarë gjendje e ka sjellë kjo Qeveri vendin tonë dhe çfarë ardhmërie është duke e siguruar për djemtë dhe vajzat tona.

Është për t'u çuditur nga fakti se për çdo ditë e më tepër thuhet se policia kosovare ngritet profesionalisht. Krahas kësaj ngritjeje, çuditërisht kemi edhe një rritje të numrit të viktimave të identifikuar të trafikimit të qenieve njerëzore.

Shtroj pyetjen: Ku është Policia e Kosovës dhe ku janë organet e drejtësisë? A mund të krijohet terreni i ushtrimit të kësaj forme të krimit të organizuar pa pasur mbështetje nga dora e personave zyrtarë në Qeveri, konkretisht nga ministrinë përkatëse.

E treta, sa iu përket politikave kundër korrupsionit, në Raport është theksuar se ka përparim në hartimin e kornizës legjislative. Mirëpo, shkeljet e rregullave të prokurimit vazhdon të jetë brengosëse. Në kontekstin e korrupsionit, qytetarët rregullisht përballen me korrupsion në polici, doganë dhe në kryerjen e shërbimeve gjyqësore.

Gjithashtu, korrupsioni është përhapur gjerësisht në fushat e arsimit dhe të shëndetësisë. Duke qenë kështu, korrupsioni mbetet i pranishëm në shumë fusha dhe atë në masë të madhe pikërisht në institucione shtetërore që kanë mandat luftën kundër korrupsionit. Kjo tregon se premtimet dhe zotimet e Qeverisë zero tolerancë ndaj luftës kundër korrupsionit i përgjigjet më së miri motoja - zero luftë ndaj korrupsionit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Vendi ynë sot ka miq të mëdhenj në botën demokratike. Vendi ynë përfaqëson vlerat e larta dhe të lashta evropiane dhe si të tilla ne duhet t'i mbrojmë me fanatizëm, sepse këto vlera na garantojnë të ardhmen tonë në Bashkimin Evropian dhe miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Raporti i Progresit edhe pse ka paraqitur disa të arritura në luftë kundër terrorizmit, financimit dhe shpëlarjes së parave, ajo prapë se prapë ka kërkuar vigjilencën tonë ndaj atyre dukurive.

Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet e Republikës duhet të jenë në luftë kundër krimit të organizuar, grupet kriminale të çfarëdo konteksti, qofshin ato që janë kundër lirisë së vendit tonë dhe kundër paqes në rajon e në botë. Këto grupe nuk përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, nuk përfaqësojnë vlerat tona si shtet dhe si të tilla rrezikojnë qenien e vendit tonë dhe të ardhmes sonë. Këtë duhet ta ketë parasysh

Qeveria e vendit, e cila duhet të angazhohet maksimalisht për të korrë fitoren ndaj kësaj të keqe, që po mundohet të gjejë strehë në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra, le të përgatitet Suzan Novobërdaliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që fillimisht të përshëndes lajmin e shumëpritur rreth lancimit të dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për procesin e liberalizimit të vizave deri në fund të vitit, gjë që është konfirmuar edhe zyrtarisht nga Komisioni Evropian.

Kjo dhe progresi që do të arrihet në kuadër të këtij procesi, paraqet vetëm njërin nga arritjet më të vlefshme të vendit, që nga shpallja e pavarësisë.

Po ashtu, mirëpresim publikimin e Raportit të Progresit 2011 nga ana e Komisionit Evropian. Raporti paraqet gjendjen reale të zhvillimeve njëvjeçare në vendin tonë, duke evidentuar kështu të arriturat, por edhe sfidat e të gjitha institucioneve të vendit.

Ky raport vlerëson periudhën kohore tetor 2010 – shtator 2011 dhe paraqet një vlerësim të tri shtyllave të ndara të pushtetit, respektivisht të legjislativit, ekzekutivit dhe të gjyqësorit.

Raporti shënon një moment të ri të intensifikimit të reformave strukturore në rrugëtimin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke shndërruar kështu në një udhërrëfyes kyç në orientimin e politikave drejt fuqizimit të rendit, por edhe të ligjit, rritjes ekonomike dhe rritjes së mirëqenies qytetare.

Do të ndalem pak tek liria e mediave. Gjatë kësaj seance, nga kolegët deputetë u diskutua për mungesën e lirisë së shprehjes, zhurma por edhe perceptimet e ndryshme që u dëgjuan gjatë këtij debati për mungesë të shprehjes së lirë, mendoj se nuk është alarmante në atë masë në të cilën u proklamua këtu. Madje edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian thuhet se ka një përparim të kufizuar në lirinë e shprehjes.

Transparenca e pronësisë së mediave garantohet me ligj, ndërkaq ligji zbatohet në mënyrën e duhur, thuhet në këtë raport.

Vlen të theksohet se për herë të parë Komisioni i Pavarur i Mediave ka ndërmarrë monitorimin nga mediat të fushatës zgjedhore. Edhe këtë vit janë bërë përpjekje për hartimin e ligjeve të reja për KPM-në dhe për mediumin publik RTK-në.

A nuk është kjo vetëm një kontribut sado i vogël drejt rritjes së standardeve evropiane? Ne jemi të vetëdijshëm se detyrë e opozitës është që të kritikohet pushteti, por nuk është mirë të thuhet të pavërteta.

Raporti i progresit askund nuk thotë se nuk ka liri të mediave në Kosovë. Në Raportin e Progresit përmendet si ngecje vetëm dështimi që të gjendet një zgjidhje për financim të qëndrueshëm të mediumit publik, por askund nuk thuhet se Qeveria po e ngulfatë lirinë e mediave.

Sa i përket financimit të mediumit publik, në hartimin e Ligjit të RTK-së janë të përfshira të gjitha partitë politike. Raporti i Progresit nuk e fajëson Qeverinë për këtë çështje, por na fajëson ne, të nderuar deputetë.

Ka apo nuk ka liri të medias në Kosovë? Përgjigjen më të mirë për këtë pyetje do ta gjeni në rast se shfletoni shtypin tonë të përditshëm. Cila prej këtyre mediave është ankuar se është kërcënuar nga partia në pushtet, apo ndoshta një media e lirë mund të cilësohet vetëm media që kritikon institucionet deri në shpifje.

Konsideroj se media është një pjesë shumë e rëndësishme e demokracisë dhe shkrimet kritike, sikurse institucionet, ashtu edhe Qeveria i marrin si bazë për përmirësim të performancës.

Ndërkaq, pothuaj se në secilën temë apo debat televiziv janë çdo herë për të mos thënë përherë pjesëmarrës edhe deputetë të partive opozitare.

Tash, së fundi, është marrë edhe vendimi që Qeveria të mos publikojë më njoftimet në gazetatat e përditshme për shkak se është konsideruar si një formë e presionit. Por, kjo ka bërë që këto media të reduktojnë numrin e gazetarëve dhe në këtë rast do të kemi një numër të madh gazetarësh që do të mbesin pa punë.

Konsideroj se në Kosovë liri të mediave ka, por grupe të caktuara të interesit që vijnë nga mediat janë të interesuara për qëllime të ngushta të dëmtojnë imazhin e Kosovës duke raportuar të pa vërteta rreth realitetit në Kosovë.

Mediat në Kosovë nuk kanë presion nga pushteti dhe askund në Raport të Progresit nuk thuhet kjo, por është e vërtetë që janë financiarisht të paqëndrueshme për shkak të tregut të vogël dhe numrit të madh të tyre. Por, për këtë nuk është faji i pushtetit, prandaj kur flasim për Raportin e Progresit, është mirë të themi të vërtetën dhe jo t'i hedhim hi syve të qytetarëve.

Shqetësimi që nxjerr në pah Raporti i Progresit për financimin e mediumit publik e besoj që këtë vit do të rregullohet me miratimin e Ligjit për RTK-në, që pritet të silltet së shpejti në Kuvend, në të cilin kanë punuar të gjitha partitë politike dhe të gjitha grupet punuese si nga shoqëria civile, nga mediat, por edhe nga grupet e tjera. Ndërsa, mediat në Kosovë janë të lira që ta bëjnë punën e tyre.

Dhe, konstatimi im përfundimtar është se i kemi mediat më të mira në rajon.

KRYETARI: Faleminderit, për kohën! Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të gjithë jemi të bindur se Raporti është i mbushur me sfida të cilat duhet të tejkalohen në institucionet tona. Vërtet ka pasur arritje në disa fusha, por kemi edhe shumë ngecje të cilat kërkojmë përgjigje aktive në këtë viti.

Janë disa probleme të cilat po na përsëriten vit pas viti dhe të cilat me një përkushtim më të madh edhe mund të zgjidhen. Pothuaj se në të gjitha raportet e Komisionit Evropian kritikohet politizimi i administratës publike. Unë e kuptoj që ndërtimi i një administrate publike profesionale dhe efikase kërkon kohë dhe mjete financiare, por politizimi është çështje e cila me vullnet pozitiv të të gjitha qeverive që e kanë drejtuar Kosovën, nuk do të shënohej në raport.

Problem tjetër akoma vazhdon të jetë korrupsioni, sidomos te prokurimi publik. Është fat që ende në Kosovë nuk ka kulturë korruptive, ku çdo gjë kryhet me ryshfet, por është e pa tolerueshme që ende zyrtarët e prokurimit janë burim korrupsioni. Edhe pse kemi bërë përparime në modernizimin e Ligjit për prokurim, ka hapësirë që ende të punohet në këtë ligj, sidomos në rritjen e sanksioneve ndaj zyrtarëve të prokurimit, të cilëve u kthehen lëndët nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe gjykatat.

Këta zyrtarë në mënyrë automatike do të duhej ta humbnin licencën për të punuar në prokurim. Problem tjetër akoma i theksuar mbetet funksionimi i sistemit të drejtësisë, edhe pse Raporti thekson përparime konkrete në këtë drejtim, sidomos në rritjen e pagave dhe plotësimin e bazës ligjore, duhet të punohet që të rritet numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve, sepse Kosova ka trashëguar një numër të madh të lëndëve të pazgjedhura këto 12 vite pas lufte.

Po ashtu, është me rëndësi të madhe që të gjitha vendimet e gjykatave tona të jenë të publikuara në faqet e tyre elektronike, me qëllim që të rritet transparenca, si dhe të njoftohen kolegët në mes veti se si po zgjidhen lëndët e karakterit të njëjtë.

Jo në pak raste kemi gjykime të ndryshme për rastet e karakterit të njëjtë. Këtu e kam fjalën për laramaninë e vendimeve të gjykatave për keqpërdorimet që ndodhën gjatë zgjedhjeve. Sfidë tjetër është plotësimi i kuadrit ligjor për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve. Ky parlament ka formuar Komisionin për reformën zgjedhore, me çka besoj se edhe në këtë drejtim duhet të kemi përparime. Jemi dëshmitarë që zgjedhjet po organizohen dhe menaxhohen nga strukturat politike, të cilat nuk kanë siguruar ndonjëherë proces fer dhe demokratik. Prandaj, duhet të përcaktohem për digjitalizimin e procesit zgjedhor në depolitizimin e organizimit.

Problem i fundit që do ta përmend, është e çuditshme që ende nuk respektohen vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të shërbimit civil. Këto vendime janë obligative për çdo institucion, por ato ende nuk zbatohen në praktikë. Mos zbatimi i vendimeve të

institucioneve të pavarura, le një shije të keqe, sidomos tregon se duhet më shumë punë në rritjen e kulturës institucionale.

Uroj që në raportet e ardhshme të shënojmë më shumë progres, më pak sfida dhe ndoshta hiq vërejtje. Këtë e meriton vendi ynë, sidomos në rrugën drejt integritit evropian. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Mahir Jagcilar, le të përgatitet deputetja Time Kradrijaj.

MINISTRI MAHIR JAGCILAR: Ju faleminderit!

I nderuari kryetar i Parlamentit,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Sigurisht që Raporti i Progresit evropian është një çështje për të cilin të gjithë duhet të punojmë ose çdo institucion duhet të veprojë si një udhëzues për rrugën drejt Bashkimit Evropian, ashtu që të gjithë duhet të përkushtojmë energjinë, të bëjmë përmbushjen e sfidave nga Raporti i Progresit evropian.

Unë me këtë rast do të përqendrohem vetëm në pjesën e cila i dedikohet Ministrisë të Administratës Publike dhe do të veçoj të gjeturat dhe të arriturat e paraqitura në Raportin e Progresit për vitin 2011. Administrata Publike në Raportin e Progresit përmendet në faqen 8 dhe 9, por edhe në disa faqe të tjera në raport, ku thuhet se në kuptimin e reformës së Administratës publike ka progres të kufizuar. Në këtë aspekt, unë dëshiroj që t'i përmend vetëm ato sfida të cilat i kemi si Qeveri dhe si Ministri e Administratës Publike. Së pari, është zbatimi i strategjisë të reformës së Administratës publike në përmbushjen e hapave të parapara me strategji. Mund të themi që është bërë progres, por ende ekzistojnë mangësi. Janë dy komponentë: rishikimi i planit funksional ose planet strategjike, por gjithashtu është edhe plani i veprimit të strategjisë të reformës së Administratës publike.

Mund t'ju informoj se deri tash 9 institucione kanë përfunduar rishikimet funksionale në Komisionin ndërministror dhe janë aprovuar në Qeveri, ndërsa për katër ministri tjera janë në fazën para aprovimit në Qeveri, ndërsa gjashtë institucionet tjera duhet të kalojnë përmes procesit të rishikimit funksional, duke kaluar përmes Komisionit ndërministror, mandej në Qeveri. Ndërsa sa i përket strategjisë ose zbatimit të strategjisë të reformës të Administratës publike, sipas planit nevojiten mjete buxhetore të cilat janë të konsiderueshme dhe ekziston mungesë e mjeteve buxhetore. Planin e veprimit është tash në Qeveri, ka kaluar përmes vlerësimit dhe besojmë që në Qeveri do të aprovohet dhe do të krijojë prioritete në veprim që të fillojmë edhe në mungesë të mjeteve të zbatojmë strategjinë hap pas hapi.

Sa i përket Ligjit të shërbimit civil, rregulloret të cilat kanë dal nga Ligji i shërbimit civil shumica janë aprovuar, por sigurisht ende ekzistojnë disa rregullore të cilat duhet të aprovohen ose nga Ministria e Administratës Publike, ose nga Zyra e kryeministrit.

Gjithashtu, te Ligji për pagat janë dy rregullore themelore ose bazike sa i përket ligjit, e ato janë: Projekt-rregullorja për shtesat mbi pagën bazë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civilë. Tash ka kaluar fazën nga Komisioni qeveritar dhe gjendet në Ministrinë e Financave për vlerësimin e ndikimit financiar, ndërsa Projekt-rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin civil tash është në Qeveri, por prapë ekziston një mungesë e mjeteve financiare nga aspekti buxhetor.

Nga aspekti i Entit të Statistikave të Kosovës, ka shënuar progres të kënaqshëm në regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, me ç'rast është vlerësuar kënaqshëm nga Komisioni Evropian, plor mbeten sfidë çështjet e infrastrukturës kadrovike dhe ligjore, por gjithashtu edhe nga aspekti i mbështetjes financiare. Sa i përket qeverisjes, ekziston një bindje se në të ardhmen bashkimi i të gjithë institucioneve në nivelin qendror edhe nga aspekti i koordinimit të qeverisjes do të realizohen ose do të përmbushen sfidat nga raporti i progresit evropian.

Me këtë rast, si Ministri e Administratës Publike shpresojmë se me një përkushtim më të madh të të gjithë akterëve, do t'ia dalim në përmbushjen e këtyre obligimeve që rrjedhin nga progresi për vitin 2011, si dhe dokumentet e tjera strategjike të Qeverisë të Republikës së Kosovës.

Administrata publike është një term shumë i gjerë, për reformën përgjegjësi kanë të gjitha institucionet shtetërore. Sigurisht që roli kryesor është te Ministria e Administratës Publike, Zyra e kryeministrit dhe Ministria e Financave.

Unë, duke ftuar të gjitha institucionet t'i zbatojnë ligjet nga fusha e administrimit publik, ju përshëndes edhe besoj që bashkë do t'i përmbushim këto sfida dhe do të jemi më të suksesshëm në raportin e ardhshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Rexhep Selimi.

TIME KADRIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të gjithë jemi të shqetësuar me gjetje të raportit, duke vënë theksin tek shqetësimet në fushën e sundimit të ligjit të cilat, siç thuhet, po e dëmtojnë Kosovën dhe po e ngadalësojnë rrugën e integritetit të saj ë Bashkimin Evropian.

Duke analizuar raportin, mund të konkludojmë se e vetmja e arritur e Kosovës në vitin që kaloi, është se ka ndihmuar që nëpërmjet bisedimeve, Serbia të propozohet si vend kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Të nderuar kolegë,

Raporti i Progresit 2011, tregon edhe një herë sa shqetësuese është situata në Kosovë. Kritikën e ashpër që kanë të bëjnë me korrupsionin, luftë e pamjaftueshme kundër krimit të organizuar, jo transparencë në tenderët publikë, politizim të panevojshëm të sistemit

të drejtësisë, marrjen nën kontroll politik dhe partiak të ndërmarrjeve publike dhe presioni ndaj mediave janë vetëm disa simbole të Kosovës të vitit 2011.

Pjesët e raportit që Kosovën e paraqesin përsëri si vend të krimit të organizuar, vend ku korrupsioni është shumë i përhapur, ku nuk respektohet sa duhet liria e mediave, Qeveria e Kosovës po i nënvlerëson me arsyetimin se nuk është më mirë as në vendet e tjera të rajonit. Ky arsyetim duket si arsyetim i njohur, pasi që krejt bota po vjedh, edhe ne nga pak.

Sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe Administrata Publike, janë vërejtjet kryesore të paraqitura në Raportin e Progresit për Kosovën. Skandal i radhës është kur ministrja e Integriteteve Evropiane pranon se Administrata publike qenka e politizuar dhe fajin e kanë të gjitha partitë që kanë qenë në pushtet. Jo, zonjusha ministre, nepotizmi dhe politizimi i Administratës publike fillon dhe mbaron me këtë Qeveri. Por, problem serioz mbetet gjendja e vështirë e mediave dhe problemi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Edhe sa i përket politikave sociale dhe punësimit, nuk është bërë asgjë. Mbetet shqetësuese shkalla e punësimit e ulët, papunësia e rinisë, si dhe papunësia afatgjate janë të larta në masë alarmuese.

Ndërsa, në politikat e shëndetit publik, e përshëndes atë pak përparim që është raportuar në implementimin e legjislacionit për gjakun, indet dhe qelizat. Megjithatë, Ministria e Shëndetësisë është e njohur dhe pjesë e skandaleve të njëpasnjëshme që ndodhin në Kosovë që nga ardhja e kësaj qeverie.

Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve vazhdon të mbetet e lartë. Lufta kundër abuzimit të drogës, kancerit të gjirit, kancerit cervical, kolorektal janë disa shqetësimet e BE-së që janë adresuar në raport, por shqetësimet e qytetarëve të Kosovës janë shumë më të mëdha se sa vet raporti.

Të nderuar deputetë,

Kjo nuk është Kosova evropiane që ne e dëshirojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Rexhep Selim, le të përgatitet deputeti Hashim Deshishku.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, janë tri palë që rrjedhimisht do të duhej të mos ishin të kënaqur me raportin e komisionit. Vetë Komisioni Evropian, qytetarët e Kosovës dhe opozita dhe Qeveria e Kosovës.

E para, duke u mbështetur në këtë raport, Komisioni Evropian i ka bërë të ditura pakënaqësitë e veta.

E dyta, edhe qytetarët e Kosovës dhe opozita nuk kanë si të jenë të kënaqur, prandaj edhe po i shprehin pakënaqësitë e tyre ndaj punës së Qeverisë, nga e cila dalin kësi lloj raportesh, dhe

E treta, e vetmja palë e kënaqur në këtë trekëndësh, mbetet Qeveria. Pikërisht këtu qëndron anomalia, kur Qeveria e Kosovës është e kënaqur me paaftësitë dhe dështimet e veta dhe ato i konverton në arritje. Madje, këtë nuk mund t'ia marrim si tentim për të fshehur, ashtu siç hasim shpesh në qëndrimet e Qeverisë.

Duke qenë se raporti nuk është i Qeverisë dhe rrjedhimisht nuk është një gjë që mund ta fshehë Qeveria përmes zëvendëskryeministrit nëpër konferenca shtypi, atëherë këtu kemi të bëjmë me një zëdhënës të kryeministrit, atëherë kemi të bëjmë këtu me një mburrje në dështimin që i bie, që dështimi paska qenë i qëllimshëm.

Në pozicionet mbrojtëse ndaj këtij raporti, Qeveria sikur thotë se ky raport ka mund të jetë edhe më keq. Ne e dimë se ka edhe më keq, por krahasueshmëria nuk do të duhej të bëhej me të keqen, por me të mirën. Do të duhej që ta kishim një raport të mirë të Komisionit dhe sot këtu të themi se ka edhe më mirë.

Qeveria ndihet e kënaqur dhe e vlerëson si raport real, kur Komisioni konstaton mangësi, sidomos në fushën që ka të bëjë me siguri në vend, sidomos në mangësitë dhe luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizëm e të tjera.

Për shembull, në pikën 4.3.4 në lidhje me Policinë, thuhet: “Ka pasur ndërhyrje të pavend nga politika në emërtimet e larta të Policisë dhe në kryerjen e operacioneve të ndjeshme të policisë”. Sa e sa herë u tha dhe u përsëritë kjo, gjë që e konfirmon që vërtet kjo është një ndër pikat që ne duhet të fokusohemi. Pastaj thotë: “Shtylla operative e policisë nuk ka kapacitete sa i përket planifikimit strategjik dhe aftësive analitike”. Këto thënie i hasim në Raportin e Progresit. Kjo realisht është reale, por jo për t'u mburrur. Në të njëjtën kapitull, “komandanti i Policisë rajonale të Prizrenit”, thuhet më poshtë, “është arrestuar dhe akuzuar si pjesë e hetimeve për krime lufte”. Së paku këtë fakt nuk besoj se e vlerësoni si të arritur.

Në pikën 4.3.2, rreth pastrimit të parave, thuhet: “Kosova ka pasur përparime të kufizuara në adresimin e krimit ekonomik, financiar dhe pastrimit të parave”. Kjo është e kuptueshme. Dihet se Qeveria nuk e lufton këtë dukuri që ka të bëjë me krimin ekonomik e financiar dhe të pastrimit të parave. Ato, pra paratë e pa pastërtia, i duhen për zgjedhjet e ardhshme.

Në pikën 4.3.3, rreth drogës, thuhet: “Kosova ka bërë përparime të kufizuara në luftën kundër trafikimit të drogës”. Këtu përshkruhet një rrjet dhe vendi i Kosovës në këtë rrjet është shumë shqetësues.

Në pikën 4.3.5, rreth luftimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit, thuhet: “Është arritur përparim i kufizuar në luftimin e krimit të organizuar, por bashkëpunimi me EULEX-in, në rastin e krimit të organizuar ka qenë i mirë në nivelin e Policisë dhe të Prokurorisë”. Disa operacione, pra që ka të bëjë me bastisje dhe hetime, kanë ... zyrtarë dhe ndërtesa qeveritare. Prandaj, në sajë të këtij bashkëpunimi të Qeverisë me EULEX-in, ka edhe deputetë që sot mungojnë pa dëshirën e tyre në këtë seancë.

Në pikën 2.1, rreth demokracisë dhe sundimit të ligjit, kur bëhet fjalë për mbikëqyrjen e forcave të sigurisë, thuhet: “ Partitë kryesore politike në Kosovë vazhdojnë të operojnë me rrjetet e veta të sigurisë”, thuhet vazhdojnë të operojnë me rrjetet e veta të sigurisë.

Qeveria vlerëson raportin si real, kurse ne e vlerësojmë si realisht i keq, i përshtatshëm për një qeveri të keqe, siç është kjo e jona. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku, pastaj zëvendëskryeministri dhe ministri Hajredin Kuçi.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryetar i Parlamentit,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Sado që pak me vonesë po e shqyrtojmë Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, megjithatë është mirë që e kemi këtë dokument dhe ku si në pasqyrë e shohim vetveten punën tonë që e kemi bërë gjatë një viti. Do të ishte një mashtrim i madh nëse kënaqemi pse në këtë raport ka një vlerësim më optimist, krahasuar me ato të viteve të mëhershme, por nëse ai lexohet me kujdes dhe vërehet se ende ka shumë mangësi e defekte në organizimin dhe funksionimin e jetës institucionale në Kosovë. Madje edhe aty ku flitet për progres, ai kryesisht është i kufizuar apo i përzier, në raste tejet të rralla, ai është i plotë apo i kënaqshëm. Prandaj, kjo tregon se ende jemi larg të qenit shoqëri e organizuar dhe shtet funksional. Fatkeqësisht, ngecjet apo përparimet e kufizuara janë të pranishme te institucionet kryesore, përkatësisht në fushat më të rëndësishme të jetës institucionale në vend.

Procesi zgjedhor shënon një mangësi serioze. Mbesin sfida në kuptimin dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare dhe thjeshtësisë së sistemit aktual, si dhe mungesa e dënimit kur janë në pyetje keqpërdorimet gjatë procesit zgjedhor.

Ky problem serioz me kohë ka qenë i theksuar nga opozita, por kjo nuk ishte marrë në mënyrë serioze, ndërkajshëm në Raportin e Progresit kjo e ka vulën e seriozitetit. Njëkohësisht imponohet ndryshimi i ligjeve që rregullojnë tërë procesin e zgjedhjeve, forcimin e integritetit dhe ruajtjen e pavarësisë të Këshillit Qendror Zgjedhor, si dhe ndëshkimin e vjedhësit të votave.

Në vazhdim, Kuvendi nuk ka mund të sigurojë mbikëqyrjen ndaj ekzekutivit. Qeveria në të shumtën e rasteve nuk i plotëson kërkesat që i shkojnë nga Kuvendi. Pastaj, Rregullorja e Administratës së Kuvendit nuk është në përputhje me ligjin. Nuk duhet të krijojmë ndjenjën e vetëkënaqësisë për progresin e kufizuar në sistemin e gjyqësisë. Se situata është alarmante, tregon numri i lëndëve të pazgjedhura, ku janë 211.588 lëndë. Nga kjo del se rritja e pagave nuk është e arsyetuar me ngritjen e efikasitetit. Po ashtu, kjo neglizhencë e gjyqësisë siguron strehim, përkatësisht i lë të pa ndëshkuar ata që kanë shkelur ligjin apo kanë bërë vepra kriminale. Ne duhet vërtet të shqetësohemi edhe për

një të vërtetë tjetër, që e vëren edhe raporti: prokurorët dhe gjyqtarët veprojnë nën kërcënimin dhe nën ndjenjën e frikës. Kjo lë për të dëshiruar paanësinë e gjyqësorit.

E katërta, që sërish lidhet me efikasitetin, gjyqësinë dhe institucionet përgjegjëse për hetime dhe ndëshkim, është lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndonëse sipas raportit, ka ca përparime, por korniza ligjore ende nuk është e plotë, ndërsa në Agjencinë për zbatimin e ligjit dhe gjyqësori, duhet të jenë shumë aktiv.

Në kuadër të kësaj, Qeveria duhet të brengoset se këtu konstatohet prania e korrupsionit, madje ai cilësohet si brengë serioze dhe që ndikon në qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve publike. Prandaj, nëse zgjedhjet kanë lënë përplot dyshime, nëse gjyqësia është joefikase, nëse nuk ka konsistencë dhe disponim për ta luftuar krimin e organizuar dhe nëse korrupsioni mbetet brengë serioze, atëherë nuk mund të flasim për përparime e as nuk duhet të kënaqemi edhe në ato pak vlerësime pozitive që gjen Raporti i Progresit.

Fushë tjetër për brengosje mbetet ekonomia, ndonëse aty ka konstatime se është ruajtur orientimi kah tregu i lirë, pastaj që janë rritur kapacitetet dhe performanca e Administratës Tatimore dhe e doganave, se ka një organizim më të mirë të disa agjencive, por që të gjitha ende janë në fazën e hershme.

Financimi i buxhetit 2011, po përballlet me rreziqe të konsiderueshme, është i madh rreziku që këtë vit ta përfundojmë me një deficit të lartë dhe me rënien e konsiderueshme të rezervave buxhetore. Ato do të bien me qenë se Qeveria nuk ka asnjë burim tjetër alternativ për financimin e shpenzimeve enorme. Këtu vlerësimet mund të jenë edhe më të mira seç është realiteti.

Me qenë se Raporti i Progresit është përpiluar para se të shpallet i dështuar tenderi për privatizimin e Postës dhe të Telekomit të Kosovës, në rrafshin ekonomik vendi ka çrregullime të theksuara në krijimin e politikave fiskale, më saktësisht, nuk ka analiza të kujdesshme për ndikimin fiskal të shumicës të masave që ka ndërmarrë Qeveria.

Se planifikimet janë jo serioze, po e përmendi faktin që qëndron edhe në Raportin e Progresit se synimi i planit për deficit buxhetor afatmesëm, prej 2% të bruto produktit të brendshëm, nuk është në përputhje me deficitin prej 0,5% të parashikuara me Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Kjo mënyrë e punës është normale dhe e pritshme që stabiliteti makro ekonomik ... përditë e më shumë nga politikat e paparashikueshme fiskale dhe rritje e paqëndrueshme e shpenzimeve qeveritare.

Rrjedha sado pak stabile, është goditur nga vendimet qeveritare. Rritja e pagave ka çrregulluar bilancin e buxhetit, por në të njëjtën kohë ka rrezikuar raportin e Kosovës me shumë institucione ndërkombëtare financiare, e në rend qëparë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ky vendim e ka lënë buxhetin e Kosovës pa një 109 milionë euro të kontraktuar vjet me këtë institucion.

Sfidat serioze mbetin inflacioni i lartë dhe tregu jofunksional i punës. Ndërkaq, pasiguria ekonomike ka mbetur pengesa kryesore për zhvillimin e sektorit privat dhe për

rritjen e punësimit. Se mund t'ketë ndryshme, është vështirë të besohet, pa marrë parasysh se Qeveria ka hartuar një vizion ekonomik dhe plan të veprimit për reformë ekonomike, por këtij plani i mungon caktimi i prioriteteve dhe renditja e masave të propozuara. Në mungesë të tij, ai është pak i besueshëm pa marrë parasysh optimizmin që bartë ai.

Ambienti për biznes nuk ka përparime të dukshme. Këtë e thotë edhe Raporti i Progresit, por edhe ai i Bankës Botërore, por për më keq, bizneset ende kanë probleme me energji elektrike, ndërsa pengesë serioze po mbetet korrupsioni dhe burokracia. Pra, në këtë fushë nuk mund të flitet për zhvillime serioze, meqenëse që të tri problemet e theksuara nuk potencohen vetëm në raportin e sivjetmë, por edhe në të gjitha raportet e mëhershme. Njëkohësisht, nuk mund të presim derdhjet e kapitalit nga jashtë dhe siguri në biznes, kur zbatimi i dobët i kontratave ka mbetur një prej brengave kryesore të kompanive dhe të investitorëve në Kosovë.

Për më keq, kjo merret edhe si njëra prej arsyeve pse mbesin kamatat e larta që aplikojnë bankat komerciale me rastin e huazimit të parasë për biznesin privat. Kur merren parasysh të gjitha këto që u përmendën, del se përcaktimi i Qeverisë së Kosovës për reforma për krijimin e ambientit më të favorshëm për biznes, krijimin e lehtësirave, luftimin e korrupsionit dhe eliminimin e burokracisë, mbetën në fazën deklarative.

Më saktësisht, për tejkalimin e këtyre problemeve mungon vullneti politik dhe disponimi për veprime konkrete. Dhe, në fund, e kam një pyetje: Sa lloj dialogime ka Kosova me BE-në? Se po më dalin mua shumë dhe këtë e përmendi pak më herët zoti Lutfi Haziri. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Zoti zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Do të mundohem që të jap disa vrojtime të mia, por edhe në emër të Qeverisë lidhur me Raportin e Progresit, por edhe në tërësi me qasjen që e kemi, jo vetëm sot, por me atë që do ta bëjmë edhe në të ardhmen.

Qeveria e Kosovës e pret seriozitetin e trajtimit dhe këtë seriozitet e çmon jo vetëm në kuptimin e asaj që mund të kemi debat në Kuvend pozitivë e opozitivë, por është për një vlerësim që vjen nga Komisioni Evropian, por ajo çka është më me rëndësi, është një vlerësim që edhe qytetarët e Kosovës e kanë ... përmes këtij raportit të progresit, kur merret vlerësimi më real i mundur. Për ata të cilët deri tash edhe thanë fjalë të mira për punën e raport-progresit dhe për ata që bënë kritika, i kuptojmë edhe nga prizmi i pozitës dhe i opozitës dhe unë do të thosha kështu për Qeverinë e Kosovës: Na pëlqen kur dikush na lavdëron, por nuk na ngazëllen, sikurse nuk na pëlqen që na kritikon, por na bënë që të jemi shumë serioz në punët dhe në aktivitetet tona dhe në këtë drejtim jemi të bindur që do të punojmë bashkërisht.

Ajo çka duhet të bëjmë tash e tutje, më lejoni që t'i definojmë disa gjëra, që besoj në këtë drejtim ka edhe obligime parësore dhe qendrore Qeveria e Kosovës, por pa dilemë secili prej nesh, në mënyrë komplementare. Puna e parë mbetet identifikimi i sfidave që ju themi ne, ju mund t'i quani dobësi dhe këtë identifikim duhet të bëjmë shkrirjen e prioriteteve tona si institucione me këto prioritete që i ka vënë Komisioni Evropian dhe kjo shkrirje nuk është e lehtë. E para, se ne kemi prioritete që lidhen me projekte paraprake, pastaj kemi diku mungesë të donacioneve apo të buxheteve dhe diku kemi edhe mungesë të kapaciteteve njerëzore. Pra, ne duhet të tentojmë që këto prioritete t'i shkrijmë, që buxhetin ta orientojmë nga këto prioritete dhe donacionet eventuale po ashtu t'i kërkojmë në përputhje me integritet të Unionit Evropian.

Raporti, besoj të gjithë jemi ne të vetëdijshëm, ne veçanti po e them për Qeverinë, raporti parasheh për punën që është deshtë t'i bëjmë në vitin 2010, deri tash, por raporti nuk i tangon dhe nuk duhet t'i tangojë politikat zhvillimore që i ka vendi. Çka nënkupton kjo? Ne duhet t'i orientojmë politikat tona zhvillimore kah i kemi pasur, por gjithsesi mos t'i harrojmë këto detyra. Pra, detyrat e vitit të kaluar të mos jenë ato detyra që na pengojnë që ta realizojmë një të ardhme më të lartë.

Natyrisht, orientimet tona, besoj edhe Kuvendi që mund të na ndihmojë, buxhetore dhe të donacioneve, janë me rëndësi vitale. Ne mund të kemi vullnete të mira, mund të nxjerrim ligje të mira, po ashtu mund të nxjerrim edhe vendime të mira në Kuvendin e Kosovës apo në Qeveri, por nëse nuk mbulohen me buxhet, prapë do të ketë sfida. Unë që tani mund të them që ka sfida në Raport të Progresit që nuk do të realizohen në vitin e ardhshëm. Pse? Sepse nuk kemi buxhet adekuat për atë, por që tani besoj se ka gjëra të cilat mund t'i bëjmë me pak buxhet apo edhe pa buxhet fare.

Një çështje tjetër është çështja e integriteteve evropiane kërkon konsensus. Unë nuk do të ndalem vetëm në konsensusin nacional, ku përgjegjësinë kryesore e ka pozita. Pozita duhet të jetë ajo që krijon oferta, angazhime, të gjitha për konsensus, por problemi kryesor për ne është konsensusi në kuadër të BE-së, dhe kjo është sfida kryesore dhe ky konsensus në kuadër të BE-së, nëse 22 shtete kërkojnë prej neve plotësimin e kushteve, të kriterëve politike, juridike dhe ato ekonomike, ka shtete që kërkojnë diçka më shumë dhe këtu jemi të vetëdijshëm. Ka shtete që Raportin e Progresit, në veçanti rrugën tonë të integritetit në Union Evropian e lidhin me rezultatin në dialog më shumë se sa me rezultate që mund t'i kemi ne veç e veç në këtë drejtim dhe këtu kërkohet një balancim, këtu kërkohet një mirëkuptim, jo për ta dëmtuar statusin tonë, jo për ta dëmtuar pozitën tonë juridike si shtet, por gjithsesi një mirëkuptim edhe për veprimet tona politike. Dhe ky raport i progresit jo për justifikim, por ky raport i progresit, këto 22 shtete kur e hartojnë, kanë parasysh a e miratojnë në Këshillin e Ministrave edhe ata 5 ministra që vijnë nga shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën.

Unë e di që për procesin e integriteteve evropiane kemi konsensus me BE-në, por po ashtu që e di që konsensusi është i domosdoshëm për hapa në këtë drejtim. Vetëm një shtet anëtar pastaj mund të na krijojë telashe, të cilat me siguri, me ose pa vullnetin tonë mund të pengohen. Por, kjo nuk na bën komod që ne të mos i kryejmë detyrat tona. Në

këtë drejtim e kam parasysh dialogun për liberalizimin e vizave. Është një e arritur e madhe dhe ne pak lavdërohem në këtë, unë besoj lavdërohem të gjithë. Por, ky dialog i përcakton përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të secilit. Nëse deri me këtë vit e kemi kritikuar Komisionin Evropian pse nuk po na e jep dialogun, në vitin tjetër, nëse nuk punojmë, ne do të marrim kritika pse nuk po i kryejmë detyrat e shtëpisë dhe kjo na rritë përgjegjësinë dhe duhet ta pranojmë një fakt, sa më shumë që shkojmë drejt integritetit të Unionit Evropian, më shumë do të rritet apo do të rritet më shumë llupa e BE-së përballë Kosovës dhe këtu nuk guxojmë që të jemi shumë komod.

Një çështje që duhet të na ndihmojë Kuvendi, besoj edhe gjyqësori edhe të gjithë të tjerët, një vijë ndarëse në mes të asaj që quhet pavarësi të sistemeve, dhe komplementaritetet. Ne e dimë që sistemi gjyqësor është i pavarur plotësisht, e dimë që Kuvendi mbikëqyrë Qeverinë dhe është i pavarur, e dimë edhe Qeveria. Unë personalisht, besoj e keni marrë Raportin e Progresit, nuk di çka të bëj më shumë për sistemin gjyqësor. Po e them si ministër i Drejtësisë. Nëse kemi siguruar pagat me ndihmën tuaj, nëse siguruar ligje të mira me ndihmën tuaj, nëse ata përzgjedhin gjyqtarët dhe prokurorë në mënyrë të tërësisht të pavarur, vitin që po shkon tash, ka pasur buxhet për 130 gjyqtarë plus, ka pasur buxhet për 45 prokurorë plus, nuk është punë e imja t'i përzgjedhë. Dhe çka bëhet? Nëse unë kërkoj pak më shumë, në raportin e ardhshëm do ta shihni ndikimin e politikës në gjyqësor. Hajde të ulemi të gjithë bashkë, ta shohim ku e kemi ne ndërhyrjen, ku e kanë të tjerët, por ku e kanë edhe llogaridhënien. Edhe ideatorët e parë të ndarjes së pushteteve, mos të filozofojnë shumë prej Gjon Llokut edhe kështu me radhë, kanë menduar në pavarësinë e sistemeve, por edhe në komplementaritetin e njëri – tjetrit. Ne jemi të pavarur secili në kuptimin si sisteme, por secili kemi një sistem të përbashkët që duhet t'i përgjigjemi.

Unë, nëse më lejohej ta them që për rendin dhe ligjin kemi arritur këtë vit dhe do ta bëjmë një bord të përbashkët edhe me EULEX-in dhe Komisionin Evropian që adreson jo vetëm sfidat për rendin dhe ligjin, por dhe sfidat që dalin nga Raporti i Progresit për rendin dhe ligjin.

Unë besoj bashkë me ju, e dimë se kemi shumë punë për të bërë dhe e dimë kështu, puna e secilit do ta ndikojë Raportin e Progresit, por ngecja e vetëm njërit, mjafton për ngecjen në integritet evropiane. Ne mund të punojmë veç e veç secili, mund të lavdërohet në mandati tjetër ose kurdo vitin tjetër, Kuvendi ose Qeveria ose dikush se e ka kryer punën e vet, por vetëm një segment nëse ngecë, pastaj do të kemi ngecje në tërësi.

Unë, krejt në fund, më lejoni të them që do të jemi të gatshëm ta pranojmë vlerësimin e Kuvendit që e bënë për këtë çështje dhe do të jemi të gatshëm në rrugën e integriteteve evropiane, të jemi në kuptimin fleksibil, tolerant dhe harmonizues të politikave tona dhe integritet evropiane është diçka që na bashkon të gjithëve, natyrisht duke ruajtur identitetin secili o si parti dhe si filozofi politike, por në programet tona secili e ka shënuar dhe shënon rrugëtimin në Union Evropian. Unë i kuptoj edhe debatet dhe ndoshta nganjëherë vlerësimet që mund të jenë, që e tha zoti Selimi, po dua t'ia jap përgjigjen. Ma qiti veshi pak si zëvendës, e nuk e dija për cilin, por ai ka menduar pak

më ndryshe, por cilat do që mund të jetë, janë pjesë e debateve që ndihmojnë, por unë pres prej Kuvendit një mbikëqyrje më të madhe për ne, por jemi të gatshëm të punojmë edhe më shumë.

Tanimë, logjika jonë, zhvillimet tona do të maten me rrugën për integrim në Union Evropian, garat e brendshme mbesin brenda kufijve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Valbona Dibra e ka fjalën, le të përgatitet Duda Balje.

VALBONA DIBRA: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për dallim nga opozita, unë e shoh në mënyrë më optimiste Raportin e Progresit për Kosovën dhe këtë dua ta lidhë me filozofinë e gotës gjysmë të mbushur dhe gotës gjysmë të zbrazët, që në esencë është e njëjtë, por ndryshon nga pikëpamja e këndvështrimit dhe në realitet, kur Raporti i Progresit është ideal, atëherë Kosova bëhet pjesë e Bashkimit Evropian dhe nuk ka nevojë të debatohet më për raport të progresit. Ne duhet ta dimë se Kosova është në vlugun e punëve në të gjitha drejtimitet dhe duke marrë parasysh pengesat që i kemi nga kundërshtarët tanë, po ashtu edhe nga disa vende të Bashkimit Evropian që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, është për të përshëndetur progresi që ka arritur Kosova.

Është për t'u përgëzuar Ministria e Integritimeve Evropiane, e sidomos shërbyesit civilë që merren me çështjen e integritimit evropian, që kanë avancuar në masë të konsiderueshme menaxhimin e ciklit të dytë të dialogut të procesit të stabilizim asocimit. Kosova ka bërë përparim në sektorin gjyqësor. Gjykata Kushtetuese ka marrë një numër vendimesh të cilat kanë pasur ndikimi të konsiderueshëm. Institucionet kanë siguruar që këto aktgjykime të zbatohen.

Kosova, po ashtu, ka bërë përparim në luftimin e korrupsionit. Ngritja e pagave të gjyqtarëve dhe përfundimi i procesit të riemërimit, janë hapa pozitiv në parandalimin e korrupsionit në gjyqësor. Kosova ka shënuar përparim në lidhje me sistemin e burgjeve. Kushtet e jetesës dhe qendrat e paraburgimit në Kosovë janë përmirësuar, si dhe ka pasur përparim në lidhje me shërbimet korrektuese.

Në fushat e të drejtave të gruas dhe barazisë gjinore raportohet përparim, si dhe pozita e gruas në politikë është përmirësuar. Mbrojtja e të drejtave e fëmijës është përmirësuar në zbatimin e kodit të drejtësisë për të mitur, si dhe procesin e monitorimit të tij.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë përparim në fushën e bujqësisë dhe sigurisë së ushqimit. Regjistrimi i kafshëve, asgjësimi i nënprodukteve të kafshëve dhe vlerësimi i impianteve të agro-prodhimit meritojnë vëmendje të veçantë. Në raport thuhet se buxheti i përgjithshëm i vitit 2011 i Ministrisë së Bujqësisë është më i ulët rreth 7%, në krahasim me buxhetin e vitit 2011. Këtu mendoj se është bërë një gabim teknik, se të gjithë ne

këtu e dimë se buxheti i Ministrisë së Bujqësisë është rreth 12% më i lartë në krahasim me vitin 2010.

Në fushën e të drejtave të punës dhe atyre sindikale është arritur përparim. Ligji i punës është miratuar në nëntor të vitit 2010, kjo përmirëson kushtet e punës sidomos në kuptimin e kontratave të punës. Ka pasur përparim në respektimin dhe mbrojtjen e pakicave. Në përgjithësi ka pasur përparim në integrimin e komuniteteve pakicë, por ka pasur përparim në lidhje me infrastrukturën e të drejtave pronësore. Të gjitha zyrat kadastrale komunale tanimë janë lidhur me Agjencinë Qendrore kadastrale në Kosovë, derisa dokumentet janë në dispozicion në të dyja vendet. Përkundër faktit që ndërmjetësimi financiar ka vazhduar të thellohet si dhe përkundër listës së kredive të këqija, sektori bankar ka mbetur stabil dhe profitabil.

Ka pasur përparim në akreditim, mbikëqyrje të tregut, lëvizje të lirë të personave, lirinë e ofrimit të shërbimeve, shërbimeve postare, shërbimeve financiare, fushën e sigurimeve, fushën e letrave me vlerë, fushën e të drejtës komerciale. Po ashtu, ka pasur përparim në fushën e doganave, si dhe në fushën e tatimit.

Ka pasur përparim të mirë në lidhje me legjislacionin në fushën e të drejtave të pronës industriale, si dhe në fushën e arsimit, kryesisht sa i përket legjislacionit. Të gjitha këto janë fakte që tregojnë që ka përparime në Kosovë, por natyrisht që ne duhet të punojmë edhe më shumë që raportet në vijim për Kosovën të jenë sa më pozitive dhe në përputhshmëri me kriteret e Bashkimit Evropian, si familje e përbashkët e të gjithë neve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Duda Bale, le të përgatitet deputeti Haki Demolli.

DDUDA BALJE: Zahvaljujem!

Izveštaj o napretku Kosova za 2011, predstavlja rekapitulaciju aktivnosti koje su preduzimane, nedovoljno poduzimane ili zaostavljene u državi. Pored evidentiranih nedostataka i defekta, delimičnih poboljšanja i napretka, ograničenih napretka, mešovitih napretka, imamo stanje u kojem se nalazimo.

Na samom početku izveštaja koji se odnosi na Vladu i rad Vlade, napominje se da su naponi na decentralizaciji nastavljani i da je značajan napredak u tom pogledu načinjen. Ali je zanimljivo to da se čitav taj proces isključivo vezuje samo za Srpsku zajednicu i da su svi naponi fokusirani samo na njih, i naravno nemiri na severu Kosova koji su zakočili dalji proces decentralizacije. U izveštaju se ne spominje, jer nisu ni preduzimani zahtevi i potrebe drugih manjinskih zajednica i njihovom potrebom za decentralizacijom. Deo izveštaja koji govori o poštovanju Zakona o ljudskim pravima i čitava ova oblast ostaje kao veliki izazov za buduće vreme.

Za period od godinu dana, postignut i određen napredak u poštovanju i zaštiti manjina. Evidentirani su problemi u obrazovanju, upotrebi jezika, medija i zaključeno je da su sva ta pitanja i za njihovo blagovremeno rešavanje potrebna je veća pažnja i veća

politička volja. Manjak te volje i pažnje rezultirao je time da je i pored toga što je obrazovanje jedan od najvećih vladinih programa, koji čini oko 13% ukupne potrošnje, odnosno 3,9% bruto društvenog proizvoda, a mi u Bošnjačkoj zajednici i dalje imamo problema u sferi obrazovanja.

Podržavamo sve postignute uspehe i optimisti smo u pogledu da će u narednoj godini ti uspesi biti postignuti u svim drugim oblastima, da će postojati veća volja i višak ... za rešavanje problema. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Haki Demolli, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë, deputete,

Pak kohë pas publikimit të Raportit të Progresit për Kosovën, pasuan reagime dhe komente ndër më të ndryshmet lidhur me këtë dokument. Po që se analizohen vetëm komentet dhe reagimet lidhur me raportin, pa e lexuar përmbajtjen e tij, atëherë do të krijohej përshtypja se bëhet fjalë për disa raporte e jo për një raport të vetëm. Kështu, derisa zoti Mireli ka vlerësuar se Kosova ka arritur progres të kufizuar, po e theksoj, progres të kufizuar, opozita kosovare konsideron se Raporti i Progresit evidenton paaftësitë e Qeverisë për të menaxhuar me Kosovën, kurse vetë Qeveria, duke e vlerësuar si dokument tejet pozitiv, thekson se raporti shënon një moment të ri për intensifikim të reformave strukturore drejt BE-së.

Vlerësimet e këtilla kontradiktore mbi raportin, vërtet shkaktojnë një konfuzion dhe huti te qytetari i rëndomtë i Kosovës. A thua kujt t'i besojë qytetari? Bazuar në përmbajtjen e raportit dhe fakteve të prezantuar në të, do ta kisha porositur qytetarin tonë që mos të bëhet viktimë e demagogjisë së qeveritarëve kosovarë dhe mos të krijojë përshtypje se Raporti i fundit i progresit është një raport afirmativ për Kosovën. Ç'është e vërteta, në raport përshkruhet gjendja dhe proceset ekonomike - politike dhe sociale në mënyrë tejet reale, e ky realitet për tri çështje që do të flas unë sot konkretisht - pastrimin e parave, droga dhe krimi i organizuar, është i këfillë.

Sa i përket pastrimit të parave, në Raportin e Progresit vlerësohet se ka pasur përparim të kufizuar në adresimin e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Ndërsa, konkluzioni i përgjithshëm për këtë çështje është se pastrimi i parave mbetet një çështje serioze brengosëse dhe Kosova është në një fazë fillestare të trajtimit të këtij problemi.

Një konkluzion të këfillë, hartuesi i raportit e ka bazuar në këto fakte: Nën një, gjatë vitit 2010, Drejtoria kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit ka hetuar mbi 700 raste nga të cilat afro 500 me kryerës të njohur. Dëmi i vlerësuar për shtetin e Kosovës është afro 27 milion euro apo 2% e buxhetit kosovar. Fakt tjetër janë shuma të mëdha të parave që vazhdojnë të investohen në pasuritë e patundshme, ndërtimtari, restorante dhe kazino pa mbikëqyrje adekuatë dhe pa verifikuar origjinën e parave që investohen, sasi të konsiderueshme të të cilave dyshohet se burim e kanë aktivitetin kriminal në formë të

trafikimit të drogave, prostitucionit, trafikimit me qenie njerëzore, korrupsionit, keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe abuzimit të parasë shtetërore me procedurat e tenderimit.

Fakt tjetër janë transaksionet financiare të ndërlidhura me bizneset në xhiro-llogari private dhe ekzistimi i numrit të madh të subjekteve që bëjnë biznese pa qenë të regjistruara. Pastaj, një fakt tjetër është mos identifikimi i aktivitetit kundër ligjor në formë të importi dhe eksportit të sasive të mëdha të parave në Aeroportin e Prishtinës.

Lidhur me këtë mosveprim të organeve shtetërore kosovare, që e ka identifikuar Raporti i Progresit, në Kosovë është folur me të madhe se janë zbuluar valixhe me para të cilat ju takonin personaliteteve publiko-politike, por të cilat janë heshtur apo si raste janë mbyllur nën ndikimin e politikës, e kjo tregon se pushteti politik kosovar mund t'i heshtë problemet dhe t'i fshehë nga popullata kosovare, por vëzhguesit ndërkombëtar të njëjtat i regjistrojnë dhe vlerësojnë si dobësi në punën e organeve tona shtetërore.

Si çështje e dytë është trafikimi me droga dhe përdorimi i tyre. Vlerësimi fillestar në raport është se Kosova ka bërë përparim të kufizuar në luftën kundër trafikimit të drogave, kurse konstatimi përfundimtar është se përpjekjet e Kosovës në luftën kundër trafikimit të drogës, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar sfidën me të cilën është duke u ballafaquar në këtë rrafsh.

A thua pse janë vlerësuar këto përpjekje si të pamjaftueshme të organeve kosovare në luftë kundër trafikimit të drogave? Përgjigjen e hasim në vet raportin, sepse në te thuhet: “vazhdojnë të funksionojnë flukset e futjes së heroinës dhe drogave sintetike në Kosovë nga Lindja e Mesme për tregjet evropiane, po ashtu edhe futja e kokainës përmes Shqipërisë dhe Malit të Zi është edhe më tutje e pranishme në Kosovë”.

Ripaketimi i drogës dhe dërgimi i saj në tregjet evropiane në paketime të vogla është fakt tjetër që e përforcon konstatimin se përpjekjet e organeve tona në luftë kundër trafikimit të drogave ishin të pamjaftueshme. Gjithsesi, fakti më i hidhur për shtetin dhe popullin tonë në rrafshin e drogave është shtimi i përdorimit të drogave nga rinia kosovare. Ky fakt në raport është konstatuar me shprehjen “tregu i brendshëm është rritur gjithashtu, sidomos për kokainë”.

Vlerësohet se nivelet e përdorimit të drogave mes adoleshentëve dhe të rinjëve që janë përdoruesit kryesor, kanë arritur afër niveleve të shumicës së vendeve të Evropës Perëndimore. Ndonëse nuk ka përlllogaritje të sakta, sipas UNICEF-it mund të jenë afro 20.000 përdorues të drogave apo mbi 1% e popullatës dhe kryesisht përdorues të heroinës, megjithëse edhe kokaina është mjaftë e përdorur. Por, jo vetëm kaq. Në vlerësimin jo të mirë të punës së organeve kosovare në këtë rrafsh, ka ndikuar edhe fakti se organet tona gjatë periudhës së analizuar kanë sekuestruar asete në sasi të vogla në raport me ato që qarkullojnë nëpër vendin tonë. Pastaj, fakti se rastet të trafikimi të drogave nuk përcillen në mënyrë adekuate nga gjyqësori, pastaj fakti se burimet për zbatimin e politikave për ndjekjen e trafikantëve janë të pamjaftueshme, kanë mungesë

personeli, si dhe mungesë të hapësirës, përfshirë këtu edhe kapacitetet e pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për trajtimin spitalor të përdoruesve të drogave.

Çështja e tretë, vlerësimi është edhe më i pafavorshëm në raport lidhur me krimin e organizuar, për të cilin qeveritarët tonë kanë plotë gojën zero tolerancë, e në realitet kjo dukuri negative jo që nuk luftohet me seriozitet nga kjo Qeveri, por është e ndërlidhur dhe e pranishme edhe në disa prej resorëve tejet të rëndësishme të saj, siç është Ministria e Punëve të Brendshme.

Simbiozën e krimit të organizuar me Qeverinë e Kosovës raporti e thekson me këtë fjali që gjendet në faqen 59, citoj: “një numër i hetimeve, aktakuzave dhe dënimeve janë arritur në rastet e krimit të organizuar. Disa operacione kanë shënjestruar zyrtarë dhe ndërtesa të Qeverisë”, që do të thotë, në vend se organet tona shtetërore të veprojnë me të gjitha kapacitetet e tyre në luftë kundër krimit të organizuar, për fat të keq të Kosovës dhe popullatës së saj, vetë zyrtarët dhe ndërtesat e kësaj Qeverie janë shënjestruar për shkak të kryerjes së krimit të organizuar.

Sipas raportit në përgjithësi, kapacitetet e Kosovës për të luftuar krimin e organizuar janë ende në një fazë të hershme. Me fjalë të tjera, kjo shprehja “fazë të hershme” nënkupton se organet e Kosovës për të luftuar krimin e organizuar nuk kanë kapacitete të mjaftueshme, nuk janë mirë të përgatitura dhe thjesht aktualisht janë shumë më të dobëta në raport me kryesit e krimit të organizuar, të cilët ose vijnë nga radhët e zyrtarëve të caktuar qeveritarë, ose kanë përkrahjen e tyre apo së paku janë në mbrojtje permanente të tyre.

Mirëpo, në raport kur flitet për të metat dhe dobësitë e luftës kundër krimit të organizuar në Kosovë, përveç lidhshmërisë së krimit të organizuar me institucione shtetërore kosovare, përmenden edhe kapacitetet e pamjaftueshme për zbulimin e krimit tej kufitar, pastaj komunikimin jo të kënaqshëm ndërmjet Departamentit kundër krimit të organizuar dhe qendrave rajonale të policisë, pastaj mungesën e hapësirave dhe personelit për aktivitete sekrete në luftë kundër krimit të organizuar dhe sidomos theksohet programi i dobët aktual i mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë, gjë që nuk jep besim dhe garancion të mjaftueshëm qytetarëve qëllimpirë për të bashkëpunuar si dëshmitarë me autoritetet kosovare.

Po ashtu, vërejtje serioze ju bëhet organeve qeveritare edhe në aspektin e vëllimit të rasteve të gjykuara në rrafshin e formave të caktuara të krimit të organizuar. Kështu, decidivisht në raport theksohet dhe atë thuajse në mënyrë habitore se gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, vetëm një, po e përsëris, një rast i krimit të organizuar në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore është sjellë në gjykim edhe përkundër faktit se në raport vlerësohet se në periudhën raportuese ka vazhduar trendi i trafikimit të femrave përbrenda Kosovës për qëllime të shfrytëzimit seksual, ka pasur shtim në numër të viktimave të mitura të trafikuar për shfrytëzim seksual, trafikimi i fëmijëve dhe shfrytëzimi për qëllime të lëmshës mbetet në nivele të larta.

Andaj, vetvetiu shtrohet pyetja, pse kemi vetëm një rast të tillë para gjykatave, kush po i pengon apo kujt po i frikësohen organet e judikaturës që të ndjekin dhe gjykojnë kriminelët e tillë. Dhe, krejtësisht në fund, mendoj se Qeveria, të cilës i adresohen disa prej këtyre kritikave dhe vërejtjeve në një raport kaq serioz, assesi nuk mund të vlerësojë raportin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Duam ta ndalojmë leximin e diskutimeve! Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra dhe kolegë deputetë,

Do të jem shumë i shkurtër dhe do t'i prek dy çështje që shpresoj që janë me rëndësi, është çështja e mbrojtjes së komuniteteve në këtë raport dhe zhvillimit ekonomik.

Tek çështja e komuniteteve, çka është pozitive, është plani i decentralizimit, i cili është arritur dhe ai është arrit në saxe të përpjekjeve që i ka bërë edhe Qeveria, por më tepër që i ka bërë përfaqësuesi special ose përfaqësuesi i ICO-s, i cili më tepër kujdeset për këtë punë se sa për punë tjera. Sa i përket mekanizmave të tjerë që i ka krijuar Qeveria për komunitete, unë mund të them që 90% prej tyre janë shumë joproduktive dhe janë sterile. Ta marrim shembull Këshillin Konsultativ për Komunitete, Zyrën pranë kryeministrit për komunitete, Komisionin për Komunitete. Unë nuk di që për këto 10 vjet kanë dhënë ndonjë rezultat dhe lirisht mund të them që vetëm janë duke harxhuar buxhet kot dhe shumë më mirë është që ato para të kalojnë në buxhet të Ministrisë për Komunitete dhe të merren konkretisht e mos të bëjnë politikë.

Unë nuk di një rezultat të Zyrës pranë kryeministrit për minoritete. Nëse është në gjendje dikush të ma thotë këtui, është kjo e arritur, unë nuk e di që është e arritur. Gjithashtu, Këshilli Konsultativ u kënaq duke mbajtur mbledhje në Zyrën e Presidentit, duke mos marrë asnjë vendim dhe harxhohen alamet para.

Gjithashtu, Ministria për Integritet e ka bërë një punë të mirë rreth riatdhesimit, edhe pse ka ndarë një buxhet 3.000.000, që në shikim të parë thuhet se 3.000,000 janë shumë, mirëpo ne i kemi mbi 30 komuna dhe po t'i ndajmë këto, ju del se për çdo komunë ka mbi 100 000 euro, as ato nuk i ka dhe kur themi se qindra të kthyer, atëherë shumë vështirë është që të merresh me riatdhesimin dhe prandaj në raport është se është një brengë e madhe për Qeverinë, sidomos për komunitetet se kanë nevojë mbrojtje, sidomos për komunitetin egjiptian, ashkalinj dhe romë, për arsye se ata kanë probleme edhe me banime jo formale, në të cilën Qeveria nuk e ka marrë asnjë hap, as të vetmin, prandaj të gjitha janë këto vërejtje që shpresoj dhe dua të besoj që edhe zëvendëskryeministri tha "do t'i marr shumë seriozisht" dhe unë besoj që do t'i merr seriozisht me qëllim që raporti në vitin tjetër mos të jetë negativ për Kosovën dhe më pak për atë se po shkelen të drejtat e komuniteteve.

Sa i përket zhvillimit ekonomik, unë shpresoj që Kosova vite me radhë është duke hyrë pa një strategji të zhvillimit ekonomik dhe për çdo vit ka të paraparë ad-hoc prioritete, të cilat nuk janë kah sjellin rezultate. Unë dua të them se ministri i Zhvillimit Ekonomik ceki shumë rezultate, rritja e GDP-së, rritje ekonomike, mirëpo në anën tjetër del se shkalla është shumë e lartë e papunësisë, del që Kosova është vendi më i varfër, del që pjesa e madhe e popullsisë është në varfëri të skajshme, atëherë këto dy elemente nuk po përputhen njëra me tjetrën.

Unë shpresoj që duhet të ulemi, të bëjmë një strategji dhe prioritet të zhvillimit ekonomik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli, le të përgatitet deputeti Salih Morina.

(Reagime)

Unë e bëj rendin këtu!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Tema që po shqyrtojmë sot, padyshim që është e një rëndësie të veçantë për rrjedhat politike dhe shoqërore në përgjithësi. Është e ditur se Raporti i Progresit është një raport i hartuar nga Komisioni Evropian me anë të cilit pasqyrohet gjendja e shoqërisë sonë në shumë sfera të jetës në përgjithësi. Dhe, fatkeqësisht, ky përshkrim është tejet alarmant në disa prej temave që mbulon, si në atë të luftës kundër korrupsionit, të çështjeve sociale dhe punësimit, si dhe atë të arsimit. Në këtë mënyrë, ky raport paralajmëron një të ardhme të pashpresë për vitet në vijim për qytetarët e shtetit të Kosovës të udhëhequr nga kjo politikë. Për më tepër, ky raport me faktet shpotitëse që prezanton, arrin që të demaskojë njërin nga paravanët ideologjike mbi të cilin ky pushtet ka synuar që ta justifikojë ekzistencën e tij politike.

Siç dihet, një nga sloganet kryesore të kësaj Qeverie ka qenë premtimi i saj për integrim të Kosovës në struktura të BE-së, por paradoksalisht janë veprimet e saj ato të cilat më së shumti na largojnë nga këto synime të proklamuar për shkak të rrezikimit që i ka bërë kjo Qeveri premisave normative të shtetit ligjor e demokracisë përmbajtësore, duke përfaqësuar kështu modelin e plotësimit vetëm formal të kriterëve politike demokratike.

Paradoksalisht, karakteristika qenësore ideologjike e këtij pushteti është ndërtuar mbi atë formulën e njohur, sipas të cilës, të flasësh gënjeshtër të vetëdijshme gjatë gjithë kohës e të njëjtën kohë t'u besosh atyre, ta harrosh çdo të dhënë kur bëhet e palakueshme, e pastaj kur bëhet e nevojshme, të nxjerrësh nga harresa për aq kohë sa lypset të mohosh ekzistimin e fakteve objektive, e gjatë tërë asaj kohe të kesh parasysh realitetin që mohon.

Përgjithësisht, a nuk ishte përpjekur vazhdimisht Qeveria e Hashim Thaçit që me të gjitha instrumentet dhe relacionet e fuqisë, të cilat i qëndrojnë prapa, që realitetin e zymtë e pa perspektivë të kësaj shoqërie ta mohojë me dokrra të vazhdueshme. Mirëpo, kur ky raport ua përplasi të vërtetën në fytyrë, atëherë ata thanë se “raporti është real”, duke bërë kështu që të dështojnë të gjitha përpjekjet për të maskuar dhe pajtuar gjendjen antagonistë e të papajtuueshme ndërmjet të vërtetave zyrtare, në njërin anë, dhe proceseve reale objektive, shoqërore, politike dhe ekonomike, në anën tjetër.

Atëherë, shtrohet pyetja - si i kemi punët sot me korrupsionin dhe luftën ndaj tij, sipas këtij raporti? Kështu, ndonëse raporti nuk lë pa përmendur plotësimin e disa kriterëve formale, si rolin e Agjencisë Antikorrupsion, shtimin e disa prokurorëve dhe oficerëve policorë, kryesisht në rrafshin burokratik, apo edhe shqiptimin e ndonjë dënimi të mundshëm, megjithatë raporti konstaton se fenomeni i krijimit dhe mos dënimit që ka të bëjë me korrupsionin, vazhdon të lulëzojë pikërisht në majat kulmore të jetës institucionale dhe politike, duke e bërë atë të pahetueshëm dhe të pandëshkueshëm.

Me këtë rast vlen të përmendet sidomos një fakt impresionues në këtë drejtim, diskrepanca e tmerrshme ndërmjet pasurive të deklaruara dhe të ardhurave aktuale të zyrtarëve publikë. Gjykuar mbi këto parametra, ky fakt i sipër cekur përpos që tregon dështimin e strukturave juridike dhe gjyqësore në luftimin e korrupsionit ndaj zyrtarëve të lartë publikë e politikë, po ashtu tregon se fenomeni i korrupsionit nuk është ndonjë dukuri aksidentale e kësaj politike, por pikërisht përbën esencën strukturore dhe endemike të kësaj Qeverie. Për më tepër, sipas kësaj logjike, kjo Qeveri ekziston për hir të korrupsionit dhe mbijeton nga ekzistenca e tij. Rrjedhimisht, ajo është shndërruar në ideal djallëzor të saj, duke e tjetërsuar kështu funksionin e politikës demokratike nga një instrument që ka për qëllim t’ju shërbej interesave të shumicës shoqërore, në mekanizëm për të mbrojtur interesat kleptokratike të kësaj politike.

Në këtë kontekst, edhe krijimi i kësaj shtrese oligarkike politike të zyrtarëve publikë e ka bazën pikërisht te institucionalizimi i korrupsionit, i cili përdor instrumentet e shtetit, zyrat publike, aparatet e tij për të monopolizuar jetën ekonomike dhe për të konservuar edhe më tej në sajë të abuzimit këtë strukturë qeverisëse turbo kapitaliste. Pra, si pasojë e pleksjes së këtij pushteti politik me pushtetin ekonomik, me një instancë të vetme, kjo kastë politike e pasuruar brenda natës, edhe përkundër kontradiktave që i shoqëron nëpërmjet të ardhurave të saj dhe pasurisë astronomike që e posedon, ka arritur që edhe sistemin e drejtësisë ta shndërrojë në mekanizëm që mbron klientelizmin e saj dhe, fatkeqësisht, seria e këtyre akteve degraduese nuk ndalet me kaq, por ajo vazhdon edhe më tej me shkelje të rregullave të prokurimit apo me konstatimin se qytetarët e Kosovës përballen me korrupsion edhe në polici, dogana e deri në shërbime gjyqësore.

Mirëpo, kulmi i metastazimit të kësaj gangrene institucionale arrin me konstatimin mbi përhapjen e korrupsionit gjerësisht edhe në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë. Në këtë sens, kjo Qeveri përpos dështimit total sa i përket investimit në hulumtim, siç thotë raporti, politizimet e sistemit shkollor i cili përfshin momentet që nga emërimi i drejtorëve e deri te rekrutimi i mësimdhënësve mbi bazat partiake politike të partisë në pushtet dhe jo mbi kriteret meritokratike, si dhe dështimit të shumë njësive akademike

për të plotësuar standardet e mirëfillta të akreditimit, me aktin e korrupsionit të sistemit arsimor, më në fund, Qeveria po e përmbys në mënyrë vetë transparente edhe njërin nga sloganet kryesore, mbi të cilin kishte operuar deri më tani.

Kështu nëse propozicioni i saj i njohur ideologjik propagandues ishte se “dija është fuqi” apo ajo sentenca tjetër famoze e shkruar nga kryeministri se “institucionet e dijes janë shpëtim për kombin e njerëzimin”, në realitet kjo Qeveri ka promovuar një model krejt tjetër të organizimit shoqëror në sferën e edukimit se korrupsioni na qenka fuqi dhe se ai përbën të vetmin instrument shpëtimi dhe kjo frymë në mënyrë virulente nuk lë pa molepsur as shëndetësinë, siç konstaton raporti. Përfundimisht, me këso politikash çfarë e kanë udhëhequr vendin, ne me këso raporte padyshim që do të përballemi edhe gjatë viteve në vijim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Salih Morina, le të përgatitet deputeti Fadil Demaku.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë personalisht do të fokusohem në fushën e mjedisit, e cila është paraqitur në Raportin e Progresit.

Mjedisi si resurs i pa kompenzueshëm është duke u atakuar nga të gjitha anët dhe format e mundshme, duke u shndërruar në të shumtën e rasteve në mjedis pa vlerë dhe pa të ardhme të qëndrueshme. Mjedisi konsiderohet njëri prej standardeve kyçe në BE, por tek ne ende nuk është në prioritetet e Qeverisë. Në Raportin e Progresit, sa i përket mjedisit janë dhënë shumë vërejtje dhe është cilësuar si shumë negativ. Implementimi i Ligjit për vlerësim dhe ndikim në mjedis ka filluar ka implementohet, por cilësia e raporteve është i dobët dhe kërkon përmirësim.

Cilësia e ajrit në vendin tonë tregon zbrazëtira domethënëse, ku bëjnë pjesë krahasimi me standardet e BE-së. Sektori i energjisë vazhdon të jetë brengë kryesore e imitimit të pluhurit, dyoksidit të sulfurit dhe dyoksidit të azotit, janë në mënyrë substanciale përmbi kufijtë e BE-së. Andaj, si burim kryesor të ndotjes së ajrit të cilët paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut janë: Termocentrali “Kosova A” dhe “Kosova B”, mihjet sipërfaqësore në Obiliq, kompleksi industrial në Mitrovicë, “Ferronikeli” në Drenas, Fabrika e çimentos “Sharçem” në Han të Elezit, si dhe në një masë të konsiderueshme edhe trafiku për shkak të veturave të vjetruara, e cila është në kundërshtim me standardet e BE-së.

Në raport thuhet se ka pasur pak përparime në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Kjo do të thotë se sistemi për administrimin e mbeturinave nuk është efikas dhe ka ngecje të shumta në shumë çështje, si: mungesa e mekanizmave efikas për ndarjen dhe seleksionimin e mbeturinave, mungesa e projekteve për riciklimin e mbeturinave, inkasimi i ultë për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, si dhe ende vazhdojnë të jenë një numër i madh i deponive të egra.

Cilësia e ujit. Gjendja e përgjithshme e urave në Republikën e Kosovës në të gjitha aspektet është e pakënaqshme. Në raport thuhet se ende nuk kemi të miratuar Ligjin për ujëra, ende nuk kemi program për monitorimin e cilësisë së ujit, sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm është i dobët dhe një pjesë e mirë e popullatës ende nuk është e lidhur me sistemin e ujit të pijshëm.

Qeveria e Republikës së Kosovës ende nuk ka plan strategjik për ujërat, nuk ka plan për administrimin e ujërave, nuk ka plan për administrimin e pellgjeve dhe nuk ka plan për administrimin e përmbytjeve. Sa i përket mbrojtjes së natyrës, kapacitetet institucionale dhe administrative në këtë fushë mbesin të dobëta. Në fushën e kemikaleve në raport thuhet se nuk ka pasur asnjë zhvillim në mbrojtjen nga zhurma dhe mbrojtja civile.

Kapacitetet administrative mbesin shumë të dobëta në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Në raport kërkohet të bëhet përpjekje për t'i ndarë funksionet politike nga ato operacionale në Ministrinë për Mjedis, Planifikim Hapësinor.

Buxheti i Ministrisë së Mjedisit në Raport të Progresit është vlerësuar i pamjaftueshëm për vitin 2011 dhe është i zvogëluar në krahasim me vitet 2010 dhe 2009, gjë që ka pasur ndikim të madh negativ në aftësimin e institucioneve të ndryshme për kryerjen e funksionit të tyre në mënyrë efikase. Buxheti i zotuar në Ministrinë e Mjedisit është i vogël për t'u ballafaquar me sfidat e mëdha mjedisore që i ka Republika e Kosovës, në veçanti, nevojat e konsiderueshme për investime në infrastrukturën e mjedisit. Në raport thuhet se implementimi dhe zbatimi i legjislacionit sa i përket mjedisit është shumë i dobët, cilësia e ujit dhe ajrit kërkojnë vëmendje thelbësore për të plotësuar kërkesat minimale për shëndetin e njeriut. Andaj, në këtë raport kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmerren hapa drejt themelimit të politikave të klimës, në veçanti me Bashkësinë Evropiane.

Duke parë vërejtjet e shumta që janë dhënë në Raportin e Progresit për fushën e mjedisit, sugjerojmë Ministrinë e Mjedisit dhe Qeverinë e Kosovës që të marrë hapa konkretë në rritjen e buxhetit, hartimin e politikave standarde me BE-në, sa i përket fushës së mjedisit, hartimin e ligjeve standarde me BE-në dhe implementimin e tyre, ngritjen e kapaciteteve administrative, përfshirjen në programet e zhvillimit rajonal, tërheqja e investimeve dhe donacioneve të huaja dhe kyçje në korridoret e infrastrukturës pan-evropa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku, le të përgatitet deputeti Albert Kinolli.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Progresit nuk do të duhej të shfrytëzohej as nga njëra palë as nga ana tjetër si kartë për t'ju kundërvënë oponentit politik, sepse asnjë palë nuk mund të qëndrojë komod

sa i përket çështjeve që ballafaqohemi si vend, e të cilat i prezanton raporti, por kjo natyrisht po ndodh edhe në seancën e sotme.

Raportin e Progresit ta marrim si udhërrëfyes për hapat që duhet të ndërmarrim tutje, në mënyrë që të bëjmë sa më shumë në rritjen e standardeve në të gjitha fushat e jetës për qytetarët tanë dhe që vendi ynë të shkojë sa më shpejt drejt integritimeve evropiane. Ky është synimi i institucioneve tona. Pavarësisht të gjithave, në Raportin e Progresit një gjë është shumë e qartë e që askush nuk mund ta nënvlerësojë. Aty janë përparimet e dukshme në shumë segmente të caktuara të shoqërisë sonë dhe atë në krahasim me një vit më parë. Dhe, kjo vjen si rezultat i angazhimeve të shumta i të gjitha institucioneve tona, edhe pse të sfiduar nga shumë barrierë nga më të ndryshmet. Por, kjo nuk na jep aspak të drejtë për vetëkënaqje, por si shtytje për të vazhduar tutje në të gjitha drejtimet e nevojshme dhe të detyrueshme. Në disa çështje në të cilat ka më pak përparim, përveç institucioneve vendore do të duhej vullnet dhe gatishmëri e të gjithë mekanizmave ndërkombëtarë që i kemi në vendin tonë.

Siç e dimë, në disa çështje të rëndësishë së veçantë ata do të ruajnë të drejtën dhe kompetencën për vendimmarrje. Kjo seancë më së miri do t'u shërbente qytetarëve dhe interesave të tyre, nëse institucionet, natyrisht edhe ne këtu në Parlament, si pozitë, ashtu edhe opozitë të kemi një mirëkuptim me angazhim të përbashkët dhe të sinqertë dhe të gjitha idetë dhe alternativat që janë të qëndrueshme dhe të aplikueshme të na shërbejnë për të vepruar të vendosur në segmentet që ende janë sfida për institucionet tona.

Nuk do të ishte mirë që kjo seancë t'i shërbejë dikujt për të na treguar që Kosova është vend i varfër, se ka papunësi të madhe, ekonomi të pazhvilluar, sepse të gjithë e dimë këtë, por edhe arsyet natyrisht që i dimë të gjithë. Për ta ndryshuar sa më shpejt, duhet kohë dhe mund i të gjithëve dhe i atyre që mendojnë se po bëjnë punë vetëm kur konstatojnë gjendje dhe asgjë më tepër.

Nuk është puna për të arsyetuar, por as ne, as vendi nuk mund të tjetërsohemi brenda natës. Shumë çështje janë trashëguar në nivelin më të ulët dhe natyrisht kërkohet kohë dhe angazhim i madh për standarde. Në anën tjetër, nuk na shërben për të mirë kur shumë herë në shumë seanca është thënë se kjo po bëhet vetëm për Raportin e Progresit, që ai të dal sa më i mirë për Kosovën, e po të njëjtit tani e thonë pse Raporti i Progresit është i keq?

Ajo që e dominon pothuajse të gjithë raportin, është se në të gjitha çështjet që janë evidencuar, kemi fillimin e njëjtë, ka pasur përparim. Dhe, detyrë e jona dhe e të gjitha institucioneve në vendin tonë është që ky përparim të vazhdojë me hapa edhe më të mëdhenj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albert Kinolli, le të përgatitet deputeti Burim Ramadani.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë edhe kolege deputetë,
Kam pasur rastin që më herët në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Integritet Evropian të debatojmë gjerë e gjerë për Raportin e Progresit, duke filluar nga zoti Kllaudin Sfino, zonja Lunacek dhe ministrja për Integritet Evropian, zonja Vlora Çitaku dhe jemi munduar që të japim kontributin tonë lidhur me këtë raport, por do të mundohem që edhe sot të jap opinionin tim lidhur me këtë Raport të Progresit.

Ky raport në vete përmban vërejtje të caktuara dhe në fushat e caktuara, por përmend edhe progres, siç përmendet puna e gjyqësisë, gjegjësisht Gjykatës Kushtetuese dhe Ministrisë për Integritet Evropian. Mendoj se sipas këtij raporti kemi shumë sfida me të cilat do të ballafaqohemi në përgjithësi si shoqëri, por me të cilat mendoj se institucionet tona me angazhim maksimal kanë mundësi të tejkalojnë me sukses dhe së shpejti shpresoj se gjatë muajit dhjetor Kosova do të marrë udhërrëfyesin e shumëpritur dhe se në të ardhmen e afërt qytetarët e Republikës së Kosovës do të përfitojnë nga liberalizimi i vizave dhe do të trajtohen të barabartë me qytetarët e shteteve tjera dhe do të kenë mundësi të udhëtojnë lirshëm në eurozonë.

Ndërsa, sa i përket paragrafit 2.2, që flet për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e komuniteteve pakicë, gjegjësisht komunitetit rom, ashkalinj, egjiptas, ku thotë se është arritur përparim i përzier, unë kisha për të thënë - përparim i konsiderueshëm, duke pasur parasysh progresin i cili përmban në vete ky raport.

Unë shfrytëzoj rastin të falënderoj Bashkimin Evropian dhe në tërësi faktorin ndërkombëtar për kontributin e tyre sa i përket mbrojtjes të drejtave të komuniteteve në pakicë dhe brengën e tyre, sidomos në procesin e ri integritetit të personave të riatdhesuar. Dëshiroj t'ju informoj se tashmë ky proces mjaftë i ndjeshëm ka filluar të implementohet dhe të zbatohet me një përkushtim të veçantë, duke pasur parasysh se tashmë janë funksionalizuar të gjitha zyrat komunale për integritetin e personave të riatdhesuar dhe se vetëm në komunën e Prizrenit, qytet nga vij unë, janë trajtuar 176 raste dhe ky proces është duke ecur me sukses.

Ky ishte vetëm një shembull konkret dhe mjafton lidhur me shqetësimin dhe brengën e përmendur në këtë raport, e që tashmë po trajtohet me seriozitet nga institucionet e Republikës së Kosovës që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, e në veçanti për personat e riatdhesuar. Unë fuqimisht besoj dhe shpresoj se të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe subjektet politike do të japin kontributin e tyre të çmuar duke pasur parasysh sfidat me të cilat do të ballafaqohemi si shoqëri, e që së bashku do të mund t'i tejkalojmë me sukses dhe se përfitues do të ishin të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe se ky është interes nacional.

Unë mendoj se kjo është e realizueshme, duke pasur parasysh vetë faktin se institucionet tona, subjektet politike dhe të gjithë faktorët tjerë kanë dëshmuar dhe treguar një shkallë të lartë të pjekurisë institucionale dhe politike dhe në unitet mes veti, duke ditur t'i tejkalojnë të gjitha sfidat me të cilat jemi ballafaquar deri më tani si shoqëri. Unë mendoj se vetëm unik e të bashkuar do tejkalojmë edhe këto sfida dhe se në një të ardhme të afërt

qytetarët tanë do të përfitojnë nga liberalizimi i vizave dhe se në vitet e ardhshme shpresoj do të jemi pjesë e familjes së madhe evropiane dhe sa i përket obligimeve që na presin, ia vlen të jemi pak sa optimist. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Burim, a je përgatitur? E ke fjalën!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Shumë elemente u thanë deri tash, po ajo që ne qytetarët e Kosovës e dimë a është mungesa e industrisë në Kosovës, apo ky Raport i Progresit për këtë vit na ka dhënë një element të ri, për të cilin shumë qytetarë nuk e kanë ditur, e kjo është ajo që mund të quhet “industria e ripaketimit”.

Industria e ripaketimit normalisht me efekt negativ dhe shumë të keq, e kam fjalën për ripaketimin e drogës që vjen prej Lindjes së Mesme, përmes Turqisë, ish-Republikës Jugosllave Maqedonisë ose Maqedoni, si i themi ne, dhe në Kosovë ripaketohet për t’u dërguar në Evropë me përmasa ose me sasi më të vogla. Kjo është një shenjë jashtëzakonisht e keqe dhe tepër e rëndë për Kosovën dhe e hedhë poshtë çfarëdo lloj pretendimi që të thuhet se Kosova është vetëm vend transit. Vend transit nuk do të thotë edhe ripaketim dhe ky ripaketim kërkon kapacitete goxha shumë të shtuara të rrjetit të trafikut të drogës për të arritur që Kosova të bëhet në këtë rrjet total, prej Lindjes së Mesme këtu të bëhet ripaketimi.

Edhe shqetësim tepër i madh është rritja e konsumit të brendshëm edhe i kërkesës së brendshme, sidomos për kokainën dhe shihni mirë raportin që thotë se “ drogat hyjnë në Kosovë në të gjithë kufijtë ku përfshinë kamionë, autobusë edhe automjete private”. Është tashmë tepër e qartë se droga në Kosovë hyn me kamionë, hyn me autobus, hyn edhe me automjete private, ndërsa rezultatet për të cilat po na folët, merrini me mend një vend si në Kosovë, ku droga hyn me kamion, rezultatet janë 2 kg e gjysmë kokainë për këtë vit 2011, 30 kg. heroinë dhe 90 kg marihuanë.

Po këto janë shumë më pak se sa që janë vjedhur në dhomën e dëshmime në polici. Janë shumë pak kur e krahason me atë se droga hyn me kamionë në gjithë kufijtë e Kosovës. Komisioni Evropian e thotë qartë se ka mangësi serioze në adresimin e sfidave të kërkesës së drogës dhe kjo është një prej shqetësimeve tepër të mëdha që po dua ta ngrit sot.

Shqetësim tjetër është se, ndoshta pak si rastësi, po pikërisht prej atje kah po vjen droga, vijnë edhe do elemente tjera ekstreme negative fundamentaliste në Kosovë edhe kjo tashmë është bërë brengë për Komisionin Evropian. Komisioni Evropian thotë se terrorizmi edhe elementet tjera, lidhja me grupet ekstremiste fetare është brengë për Komisionin Evropian në Kosovë. Ne e kemi kthyer Kosovën me një vend në 2011 që Komisioni Evropian të ketë brengë çka po ndodhë në Kosovë edhe në këtë fushë. Dhe, kjo fushë, mos harroni se nuk shkon vetë, shkon edhe me drogën, shkon edhe me trafikun

e elementeve tjera. Kjo është fushë tepër e madhe, tepër komplekse për të cilën duhet tepër shumë angazhim. E ky angazhim po shihet qartë se po mungon.

Një element, edhe me këtë po e përmbylli atë që e përmendi deputeti Florin Krasniqi paradite, por edhe deputeti Rexhep Selimi, sa iu përket strukturave ose rrjeteve të sigurisë, të cilat vazhdojnë të partitë politike kryesore. Çka domethënë kjo? Domethënë se ato dy lloj shërbimeve të mëdha që kanë ekzistuar, po vazhdojnë edhe më tutje të ekzistojnë, edhe SHIK-u edhe Sigurimi i Atdheut. Çka është kjo? Kjo është pengesë për punën e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, sepse momentin kur këto vazhdojnë të funksionojnë, domethënë ka strukturë paralele ndaj një institucioni shtetëror.

Njerëz, duhet të kuptoni se servis ose shërbim i Kosovës është AKI-ja, nuk jeni ju. Çka po bëni? Ndaj kujt po punoni, për kënd po punoni edhe kundër kujt po punoni? Apo janë kthyer, sikurse tash thonë këta miqtë ndërkombëtarë, janë kthyer këto në shërbime të tenderëve tash. Këto elemente janë tepër të rënda dhe unë po ju them se është tepër vonë tashmë. Duhet sa më shpejt të ndalen këto. Duhet vetëdijesuar, në mënyrë që të vihet një situatë, nëse nuk vetëdijesohen, ligji vetë ka për t'u marrë me këta njerëz, të cilësdo palë, për mua janë komplet njëjtë, si ata, si këta. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Rasim Demiri e ka fjalën. Nuk është! Deputetja Xhevahire Izmaqi, nuk është. Deputeti Imri Ahmeti, nuk është. Deputeti Halit Krasniqi, a është këtu deputeti?

HALIT KRASNIQI: Përshëndetje, kryetar i Kuvendit!

Faleminderit që më futët në radhë, se para 20 vetave më është përmendur emri që isha në radhë edhe në isha në udhëtim për në Tiranë, përgatitesha të shkoj unë, sepse vetëm unë kam mbetur nga ata që kanë për të shkuar andej.

E kam reduktuar fjalimin tani edhe do të mundohem ta përmbledh në mënyrë figurative esencën e asaj që kam dashur ta them më herët.

Këtë seancë e ka ftuar, e ka thirr Lidhja Demokratike dhe për këtë jam xheloz, pse se ka thirrur grupi ynë parlamentar, por i faleminderit Lidhjes Demokratike! Ka qenë shumë me interes për ta trajtuar këtë temë.

Janë afër 250 gjetje që i ka bërë Raporti i Progresit, rreth 160 fusha lavdërohen institucionet tona, rreth 60 fusha, afërsisht, sfidohen lehtë dhe rekomandohen. Është një rezonancë magnetike e funksionimit dhe të pragmatizmit institucional, një instrument i fizibilitetit politik të Kosovës si entitet juridik, kështu e kuptoj unë këtë raport. Përmbajtja e tij është sfidë edhe ledhatim për institucionet, njëherazi. Nuk e kam pritur të jetë kaq dashamirës, i cili është një puhizë me vërejtjet që janë me sugjestion miqësor dhe me tendencë për forcimin e performancës në aspektin ndërtues të institucioneve. Edhe aty ku ka vërejtje të lehta, nuk mund të interpretohet ndonjë tendencë rrënuese dhe askush nuk duhet ta interpretojë kështu. As vetë ministrat ku adresohen vërejtjet. Janë goditur 3 ministri, ku e udhëheqin 3 ministra me performancën publike. Ministrinë përkatëse ku sfidohen fushat e caktuara, duhet të mobilizohen, sepse ka edhe dobësi të tjera që janë evidente, por në raport nuk janë flaskuar, nuk e di pse. Këtu në këtë raport kemi një tekst

përshfaqen dy dioptri në fokusimin e tekstit këtu në Parlament. Opozita nuk ka kurajë të nënvizojë progresin e theksuar dhe të konstatuar në këtë raport, por as ne nga pozita nuk ndalemi në vërejtjet relevante.

Në shumicën e paraqitjeve u manifestua një perceptim subjektiv me ngarkesa elektorale, në mungesë të fakteve, zhvillimi i teorive spekulative ishte pak a shumë i theksuar, trajtimi i çështjeve politike pa qenë objekt i Raporti të Progresit, ekspozim i tendencave dhe i trajtimit të temave dhe trajtim i çështjeve si në fushata elektorale, të gjeturat e raportit trajtohen përciptazi.

Nuk kishte qasje të pritur dhe profesionale, me përjashtim të nja 3 deputetëve që ishin mjaftë konstruktiv dhe nja 2 deputeteve që të lenin përshtypjen e kanarinave, por që ishte kënaqësi t'i dëgjoje. Kishte patetikë të tepruar dhe retorikë për eksport, të cilat nuk i duheshin kësaj teme në këtë seancë dhe nuk i ndihmojnë procesit të zhvillimit të vendit.

Zhargoni i përdorur aty-këtu ishte nën nivelin e formimeve që shfaqen në publik, e lëre më këtu në këtë Parlament, që do të duhej të ishte ndryshe, profetizimet për arritjen e standardeve të domosdoshme të BE-së ishin pa sens, të njëanshme dhe me konotacione të programeve partiake. Më shumë ëndje do të dëgjoja qëndrimet e tjera konstruktive, sepse do t'i ndihmonin institucionet tona dhe do ta ngritnin performancën tonë këtu në këtë Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Krasniqi! Unë po ju njoftoj, për debat, diskutime, janë të lajmëruar edhe 17 deputetë.

(Ndërhyrje)

Jo, debatin do ta përfundojmë sonte. Po shihet që shumica i kanë fjalët e shkruara, mund t'i lënë me shkrim, nëse donë. Unë mendoj që ata që i kanë me shkrim, është mirë t'i lënë me shkrim e i lexojmë ne kur ta marrim stenogramin. Përndryshe, vazhdojmë! Fjalën e ka deputeti Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Duke pritur Raportin e Progresit, Qeveria e Republikës së Kosovës sillet sikur nxënësit kur presin shqiptimin e suksesit për vitin shkollor. Edhe pse e dimë që nuk kanë punuar mjaftë, gjatë tërë vitit shpresojnë në zemërgjerësinë e profesorëve se do ta falin ndonjë notë, në mënyrë që ata të kenë rezultate të kënaqshme.

Kjo edhe mund të ndodhë në shkollat tona, por këtë herë nuk ndodhi edhe me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, i cili vuri në pah ngecjet e mëdha dhe serioze në të gjitha fushat, ku preku edhe fushën e punësimit, politikave sociale dhe politikat e shëndetit publik. Konkretisht, i jep vërejtje për mungesën e kapaciteteve për t'u avancuar me kërkesat e qytetarëve që janë jashtë tregut të punës dhe për mos përfshirjen e partnerëve social në hartimin e strategjisë së punësimit.

Ministria e Punës mendon se ka pasur baza legale për një gjë të tillë. Kujtojmë këtu se Kuvendi ka miratuar Ligjin për këshillin ekonomiko-social, nuk ka vepruar në adresimin e kësaj çështjeje. Përfshirja e partnerëve social në hartimin e strategjive të punësimit është qenësore, për qëndrueshmërinë e atyre strategjive, qëndrueshmëri kjo e cila është parakusht për zbutjen e këtij problemi shumë të madh për gjithë shoqërinë tonë. Pra, punësimi nuk mund të përmirësohet pa një strategji të mirëfilltë, e kjo strategji nuk mund të jetë e mirëfilltë dhe e qëndrueshme nëse në hartimin e saj nuk përfshihen të gjithë partnerët social, për të cilën përfshirje ekziston baza e mjaftueshme ligjore.

Në fillim të mandatit të kësaj Qeverie një numër i madh i qytetarëve, nga ata 380.000 që ishin të lajmëruar në zyrat e punësimit, shpresuan se do të punësohen, sepse partitë që tani janë në pushtet, gjatë fushatës elektorale premtuan shumë vende punës, bile edhe pas marrjes së pushtetit, pas një shëtitje pune në Bullgari, premtuan rritje ekonomike 7 deri në 8%, si dhe zvogëlimin e papunësisë 8-10%, që kjo do të thotë krijimin e disa dhjetëra mijëra vende të punës. Po t'i realizonim këto, sigurisht vendi ynë do të merrte notë kaluese, por në Raportin e Progresit shkruan se shkalla e punësimit është shumë e ultë, e sidomos papunësia e rinisë dhe papunësia afatgjatë është në shkallë alarmante. Këtu vihet në dukje mungesa në qasje serioze nga Qeveria në adresimin e këtij problemi.

Kërkohet nga Qeveria që të ndërmarrë veprime vendimtare. Këto veprime nënkuptojnë angazhimin për gjetjen e zgjedhjeve sistemore. Kujtojmë këtu rastin e punëtorëve në ndërtimin e autostradës "Ibrahim Rugova", shumica e të cilëve edhe ashtu në kushte të rënda të punës, janë larguar nga puna, në këtë sezon. E mos të flasim për mijëra punëtorë që gjatë procesit të privatizimit janë nxjerrë në rrugë.

Qeveria duhet të angazhohet për krijimin e politikave të tilla të punësimit, të cilat garantojnë punësim të qëndrueshëm, dinjitoz dhe afatgjatë. Pra, duhet të mësohemi që premtimet e dhëna në fushatë gjatë qeverisjes të bëhen realitet, është e ndershme dhe është e njerëzishme.

Sipas ligjit, punëdhënësi është i obliguar të kujdeset për sigurinë e punëtorëve, mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe ambientin e punës. Shumë ndërmarrje në Kosovë, jo vetëm që nuk kujdesen mjaft për to, por nuk kujdesen as për ambientin përreth, duke shkaktuar dëme të rënda e nganjëherë edhe të pariparueshme, që rezultojnë me rrezikim të shëndetit të qytetarëve. Inspektorati i Punës nuk është mjaft efikas në kryerjen e detyrave të veta, Ligji për Inspektoratin e Punës nuk zbatohet. Mungesa e mbikëqyrjes e inspektorëve të punës edhe nga niveli komunal ndikon në efikasitetin më të madh në punën e tyre. Regjistrimi i aksidenteve në punë nuk bëhet në mënyrë të kënaqshme. Duhet të shtohet numri i inspektorëve të punës. Edhe pse është miratuar Ligji për organizimin sindikal, në Kuvendin e Kosovës, vërehet moszbatimi i tij, sidomos në regjistrimin e anëtarëve në sindikata, regjistrim ky që do të mundësonte evidentimin në sindikata përfaqësuese, pra, do të sqaronte legjitimitetin e organizatës sindikale. Pra, është neglizhencë e Ministrisë në zbatimin e Ligjit për organizimin sindikal, gjë të cilën e ka për obligim.

Ndikimi politik në emërimin e drejtorëve në qendrat për punë sociale, përbën një tjetër problem të adresuar nga raporti. Ndërhyrje politike, fatkeqësisht vërehen edhe nivele të

tjera të vendimmarrjes. Ministria, ndonëse është zotuar shumë herë, nuk e ka sjellë në Kuvend për miratim Ligjin për skemën e asistencës sociale dhe Ligjin për shërbime sociale dhe familjare. Pra, kemi të bëjmë me një mos përmbushje të obligimeve të Ministrisë. Po ashtu Ligji i shëndetësisë dhe Ligji i sigurimeve shëndetësore nuk janë sjellë në Kuvend, ndonëse sipas strategjisë legjislative për vitin 2011, ka qenë e paraparë të vijë qysh në qershor të 2011-ës. Ne kërkojmë nga Qeveria të angazhohet që këto ligje të vijnë sa më parë në Kuvend, të rishikojë buxhetin për shëndetësi për vitin 2012, nëse vërtet për këtë qeveri, shëndetësia paraqet interes nacional. Gjithashtu kërkojmë që ligjet e aprovuara në Kuvend të implementohen.

Në raport adresohet mungesa e stafit adekuat të punës në Ministrinë e Shëndetësisë. Ministri duhet të angazhohet në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale. Ne kemi kuadro shumë të mira profesionale dhe menaxheriale, por ato dëbohen nga institucionet dhe në vend të tyre vendosen militantë partiakë. Kush mund të besojë arsyetimin se në këtë ministri disa barnave u ka skaduar afati për shkak të mungesës së transportit. Unë mendoj se çdo qytetar po të ishte ftuar që t'i transportojë këto barna deri në vendin ku kanë qenë të destinuara, besoj që me kënaqësi do ta pranonte.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

E nderuara ministre,

Kolegë deputetë,

Unë do të flas për pjesën e Raportit të Progresit, që ka të bëjë me arsimin dhe shkencën në Republikën e Kosovës.

Marrë në përgjithësi, ky raport është pozitiv dhe përmend për të mirë disa hapa të zhvillimit të arsimit në vendin tonë, siç janë: hartimi i strategjisë për arsim 2011 – 2016, rregullimi i legjislacionit për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë, hartimi i kornizës së kurrikulumit, hartimi i disa strategjive, siç janë për ndaljen e braktisjes së shkollës, kundër dhunës nëpër shkolla, gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta.

Janë inkurajuese edhe përpjekjet për integrimin e minoriteteve: romë, ashkalinj dhe egjiptian në arsimin parauniversitar, për të cilët është hartuar dhe një strategji. Po ashtu është rritur dukshëm pjesëmarrja e institucioneve të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës në projektet “Tempus”, prej të cilave përfitojnë, si institucionet publike, ashtu edhe ato private, me të cilat projekte punon dhe koordinon punën zyra e “Tempus”-it në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Vërejtje me vend është ndërhyrja e politikës në përzgjedhjen e drejtorëve në shkolla, por këtë vërejtje duhet ta marrin kryetarët e komunave, të cilët vendosin për këto emërimë dhe gjithashtu edhe për përzgjedhjen e arsimtarëve. Këtë mundësi ua ka dhënë Ligji për

pushtetin lokal dhe Ligji mbi arsimin në komunat e Republikës së Kosovës. Zgjedhja e personave jo kompetentë dhe të paaftë për këto pozita ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe mbarëvajtjen e mësimin në të gjithë arsimin parauniversitar. Prandaj, kjo praktikë duhet të ndalet, sepse më së paku duhet të politizohet arsimi. Sa i përket arsimit dhe aftësisht profesional dhe arsimit të rritur, në raport rekomandohet që të rishikohen ligjet dhe të përputhen me kornizën kombëtare të kualifikimeve. Me sa di unë MASHT-i është në proces të harmonizimit të këtyre ligjeve me kornizën kombëtare të kualifikimeve. Është për t'u lavdëruar hartimi i programit kombëtar të shkencës si më i avancuari në rajon, mirëpo, mungesa e një buxheti për shkencë është ende pikë e dobët e shtetit të ri të Kosovës, prandaj, duhet bërë përpjekje që të ndahen aq mjete sa është përcaktuar me ligjin aktual për veprimtari kërkimore shkencore dhe që të themelohet fondi për shkencë, ashtu siç e kanë të gjitha vendet e zhvilluara. Mendoj se tash është koha e themelimit të një fondi të tillë dhe të hiqet praktika e tanishme e shfrytëzimit të mjeteve për shkencë nga mallrat dhe shërbimet në kuadër të MASHT-it.

Të nderuar kolegë deputetë dhe anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

Është evidente që në arsim dhe shkencë duhet të investohet më shumë dhe të bëhet një koordinim më i mirë i punëve, gjegjësisht bashkëpunim më i ngushtë në mes Qeverisë dhe pushtetit lokal. Mendoj që ne duhet të bëjmë punët tona ashtu si duhet, jo për hir të tjerëve apo pse ashtu duan ndërkombëtarët, apo që Raporti i Progresit apo ndonjë raport tjetër çfarëdo, të jetë pozitiv, por se duhet të bëhen punë më mirë për hir të Kosovës dhe popullit të saj, për perspektivë më të mirë. Vetëm me vlera reale dhe me ndershmëri dhe profesionalizëm në kryerjen e obligimeve tona, mund të synojmë të jemi pjesë e vendeve të zhvilluara. Besoj që kjo është edhe filozofia e punës së Qeverisë.

Prandaj, duhet të inkurajojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës në përmbushjen e obligimeve që kanë marrë për agjendën evropiane të integritetit të Kosovës. Kjo është dhe duhet të jetë synimi i të gjithë neve, pa dallime partiake. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Lirije Kajtazi

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit!

Na u tha edhe më herët se nuk është veç raport i Qeverisë, s'është e vërtetë se raporti flet për progresin në Kosovë, ku janë edhe Kuvendi edhe Qeveria edhe gjyqësori edhe media, sundimi i ligjit, politika sektoriale, e tjera, por është më se e vërtetë që në gjithë këtë progresi çalon për një gjë. Po i përmend disa fjali. Ndërrhyrja e politikës në gjyqësi është brengosëse, ndërrhyrja në polici e dogana është shumë evidente, krimi i organizuar i pa denoncuar, presioni politik dhe frikësimi ndaj gazetarëve, të cilin e prezantoi shumë mirë deputetja Vjosa Osmani dhe nuk besoj se ka nevojë të ndalëm më tepër, kërcënimi në shoqërinë civile, ndërrhyrja politike dhe si rrjedhojë ngecjet në reformën e administratës.

Vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk ekzekutohen nga institucionet përkatëse politike dhe lëndët shkojnë në gjykatë duke dëmtuar në këtë mënyrë edhe buxhetin. Dhe, më esencialja në demokraci është keqpërdorimi i votës së lirë, ani pse kryeministri

shumë herë na e përmend me krekosje fitoren e grabitur, me gjasë këtë ka nevojë t'ia thotë më shumë ndërgjegjes së vet.

Si ndërhyrje e politikës notë të dobët merr edhe policia e Kosovës, citoj:” Në polici mungon personeli për ta transformuar informacionin e inteligjencës vepruese dhe kapacitete të pamjaftueshme për planifikime strategjike dhe analitike.”

Në lidhje me këtë mendoj se mbi 7.000 pjesëtarë që ka Policia e Kosovës, domosdo do të gjendeshin oficerë të zot që do t'i përmbushnin këto detyra esenciale, po t'i linte rehat partia në pushtet. Citoj:” Ka pasur ndërhyrje të pavend nga politika në emërime të larta dhe në kryerjen e operacioneve të ndjeshme”. Inspektorati policor nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Punëve të Brendshme ende nuk e ka kryeshefin. Operacioni i filluar në vitin 2011, në lidhje me importin dhe eksportin e sasive të mëdha të parave në Aeroportin e Kosovës, ka mbetur aty ku ishte.

Tani një tablo tjetër, ne pranojmë edhe rezultatet e arritura. Ne e pranojmë se ka pasur përparim në respektimin dhe mbrojtjen e pakicave, ani se e dimë se edhe këtu kishte yshtje nga pushteti. Ne kemi parë letra falënderuese nga komuniteti serb drejtuar kryeministrit Thaçi, për pazarin vota-para. Progresi është edhe më i madh kur të njëjtit kanë akuzuar për tradhti presidentin Rugova, që guxonte të fliste dhe të respektonte pakicat. Po ashtu mund të përmendim se ka edhe përparim në hartimin apo të themi huazimin e disa strategjive, pa u kujdesur asnjëherë për zbatimin e tyre.

Për fund Lidhja Demokratike e Kosovës do të vazhdojë të angazhohet për shtet ligjor të zhvilluar, mirëqenie qytetare dhe demokraci të mirëfilltë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Më lejoni t'ju përsëndes të gjithëve, e përsëndes, natyrisht, edhe këtë debat, ndonëse për mendimin tim, çështjet si kjo që po debatojmë sot, nuk duhen shtruar kështu siç janë shtruar. Jo mbledhje e veçantë, jo mbledhje, në njëfarë mënyre e jashtëzakonshme. Ne edhe me Rregulloren të Kuvendit jemi të obliguar që në mënyrë të rregullt periodike të shqyrtojmë agjendën evropiane. Edhe me Planin e veprimit jemi të obliguar që çdo tre muaj t'i shtrojmë këto çështje. Nuk është çështje që shtrohet në mënyrë parciale dhe pastaj edhe të trajtohet si pre, në të cilën kush mund të grabisë më shumë poenë politikë.

Megjithatë, vetë fakti se ka një numër aq të madh diskutuesish, flet se është një çështje me peshë, është shprehje edhe e interesimit të jashtëzakonshëm. Megjithatë, nuk besoj se do të duhej të ishte shndërruar, siç u shndërrua, në diskutim për gjithçka dhe për gjithkënd. Ka nevojë të debatohet edhe për ato çështje, por e mira është që Raportin e

Progresit ta analizojmë si të tillë. Dhe, për mendimin tim, do të ishte mirë që më në fund t'u ikim dy qasjeve që po na ndjekin vazhdimisht. Një qasje, një dioptri, si të them, me syza. Nuk na duhet asnjë qasje me syza të errësuar, një mohim nihilist i të arriturave dhe një seleksionim negativ i konstatimeve. Në një farë mënyre, për inat të skuadrës rivale, një dëshirë që të humbë edhe kombëtarja. Nuk fiton askush në atë mënyrë.

Dhe, e dyta – syze lustruese, një injorim i vërejtjeve edhe kur janë të qëlluara dhe dashamirëse dhe një seleksionim vetëm i konstatimeve pozitive. Edhe kjo është logjika e makushit, që e fut kokën në zall dhe mendon se në atë mënyrë i shpëton rrezikut. Nuk është prandaj eklektizëm, nëse thuhet se të dy qasjet janë të njëanshme, po kanë argumentet e tyre, siç u tha, ajo gota gjysmë e mbushur dhe gjysmë e zbrazët, por të dyja e teprojnë dhe mbeten të njëanshme. Krijohet dilema a është lexuar i njëjti raport, apo kanë lexuar raporte të ndryshme? Ka madje edhe një prirje për t'ia lënë ngile, për t'ia lënë si të thuash “vetë e qyqes” një institucioni tjetër. Dhe, në këtë rast “cungu i kovaçit” mbetet gjithmonë Kuvendi i Kosovës, ai fajësohet për gjithçka. Ai fajësohet madje, edhe për parregullsitë në zgjedhje edhe në raport, për fat të keq edhe këtu në debat. Megjithatë, një konstatim mendoj që mbizotëroi edhe në këtë debat dhe unë e përsëris, që del evidente edhe nga Raporti i Progresit.

Në Kosovë ka progres dhe kjo do konstatuar me kënaqësi nga të gjithë edhe nga opozita, edhe nga pozita, askush nuk humb nëse Kosova bën progres. Ka siç është thënë në anglisht some progress, që e përkthyer shqip më shumë se sa “ca progres”, qysh e kanë përkthyer, do të ishte një progres, njëfarë progresi. Dhe, mendoj se kjo nuk është një vlerësim aq i pamjaftueshëm, krahasuar me vendet tjera në stadin e ngjashëm me Kosovën. Do të thosha, me një mënyrë është më mirë se vjet, e besoj më keq se në mot. Uroj që edhe të jetë kështu.

Por megjithatë, besoj, pajtohem edhe me një konstatim tjetër se të arriturat tona, me të cilat krenohemi dhe duhet të krenohemi, megjithatë mbeten në shpërpushje jo të vogël, jo vetëm me kërkesat dhe nevojat, por edhe me mundësitë objektive e subjektive që ka Kosova. Kosova mund të bëjë dhe duhet të bëjë më shumë.

Por s'mund të mohohet edhe fakti se ka edhe dështime, dobësi e mangësi që janë konstatuar me të drejtë. Unë do të përmendja vetëm disa prej tyre, që janë në pjesën e fundit të Raportit, i cili kam përshtypjen se është lexuar më pak.

Keqpërdorimet gjatë zgjedhjeve dhe sidomos mosndëshkimi i bartësve. Vërtet vështirë justifikohet, sidomos kjo e fundit. Masat qeveritare që kanë shkaktuar çrregullime të rënda ekonomike, rritje e madhe e deficitit buxhetor, zgjerimi i deficitit tregtar, rritje e shkallës së papunësisë, nuk ka përparim legjislativ në mbrojtjen e konsumatorit, legjislacioni për prokurimin nuk është në përputhje me standardet evropiane, nuk ka pasur kurrfarë përparimi investiv në hulumtim e inovacione, nuk ka pasur asnjë zhvillim lidhur me furnizimin me rrymë, nuk ka pasur zhvillime në fushën e shoqërisë informative. Kuvendi i Kosovës ka dështuar të zgjedhë anëtarët e Këshillit të Pavarur të Mediave dhe të rregullojë financimin e RTK-së, Kosova nuk ka asnjë politikë të vizave, pasqyrimi, pastrimi i parave dhe mbetet problem serioz, kurse përpjekjet

kundër korrupsionit, trafikimit mbeten angazhime të pamjaftueshme. Ka, për fat të keq, edhe shumë konstatime të këtilla. Unë u përqendrova te këto, sepse sukseset sado që janë më shumë, nuk na prishin punë. Na prishin punë mangësitë, prandaj edhe mendoj duhet vënë theksin këtu, pikërisht. Nuk na ka fajin gjithmonë pasqyra, por na ka fajin fytyra. Dhe, fytyra jonë mund të jetë më mirë dhe duhet të jetë më mirë, por duhet të jemi edhe të vetëdijshëm edhe për një fakt, nuk kemi arritur gjithmonë t'i afirmojmë sukseset tona. Për më tepër, kanë punuar shumë të tjerët për të mohuar të arriturat dhe për t'i imputuar Kosovës edhe dështimet, që objektivisht nuk janë. Qarqe të njohura të propagandës antikosovare, avokatët e tyre, për fat të keq edhe qarqe kuazicivile e kuaziopozitare, ndonjëherë sikur kanë bërë garë kush ka arritur më shumë të ndikojë në nxirjen e realitetit në Kosovë dhe, mendoj se është diçka që do të duhej rishikuar prej secilit.

Mirëpo, unë përshëndes edhe një liri që e pash te një diskutues për të shikuar a është i bazuar edhe vetë raporti? A i ka fajet edhe pasqyra pjesërisht? A ka aty konstatime që janë të pabazuara?

Dhe, në këtë kuadër, pajtohem me vërejtjen që ishte që në ballinën e Raportit, theksimi në këtë mënyrë: “Kosova sipas Rezolutës 1244 është një hendikep i madh” dhe është në shpërputhje të madhe me gjithë brendinë. Si mund të kufizohesh me Rezolutën 1244 dhe të kërkosh pastaj prej Kosovës standarde, që i kanë shtetet që nuk janë brenda kësaj kornize? Për më tepër kjo mos konsekuencë në trajtimin e realitetit të ri në Kosovë, stimulon dhe inkurajon obstrukcionin dhe diversionin në Kosovë. Tashmë ka fakte të mjaftueshme dhe është koha që kjo të shtrohet seriozisht, ose edhe konstatime konkrete si këto.

Flitet për dokumentet kadastrale si një problem në Kosovë, por nuk theksohet shkaku që dokumentet kadastrale janë uzurpuar, janë plaçkitur nga Serbia. Injorohet kjo dhe keqkuptimet janë evidente.

Ose, thuhet: “Kuvendi i Kosovës, shoqëria kosovare, nuk ka kontratë me shoqërinë civile. Shoqëria civile nuk është përfshirë në asnjë debat në Kuvend.” A është e vërtetë? Dhe, kujt i konvenon ky sforcim i shoqërisë civile edhe atëherë kur ajo motivohet me do motive, që nuk janë tamam civile dhe nuk janë në interes të Kosovës?

Flitet shumë për komunitetet pakicë dhe ne mburremi që kemi arritur standarde të larta, por a mund të mos konstatohet fakti që injorohen ta zëmë komunitetet tjera, që janë po ashtu pakicë. A ka disproporcion në vlerësimin e tyre? A vlerësohen njerëzit- ta zëmë njëjtë, ta zëmë shqiptarët e Preshevës në Kosovë dhe shqiptarët e veriut që janë të zhvendosur në Kosovë?

Flitet, ta zëmë, për mungesë përparimi në gjuhët dhe si arsye përmendet pse nuk po u mësuka gjuha serbe si gjuhë e dytë. Do të ishte mirë të mësohet, jam dakord, por nuk përmendet, ta zëmë, pse nuk mësohet gjuha shqipe si gjuhë zyrtare? Pse?

Ose, e njëjta gjë thuhet për librat, për mediat, për valët. Të zhvendosurit e një kombësie të konsiderohen persona përkohësisht të zhvendosur, por të zhvendosurit e një kombësie tjetër nuk e kanë të njëjtin tretman. Pse?

Ose, thuhet: “Nuk është miratuar lista e monumenteve të mbrojtura.” Nuk është e vërtetë, është miratuar dhe ne kemi ligj për të.

Ose, që është edhe më frapante dhe më bën përshtypje si nuk është theksuar nga askush, kur flitet për të pagjeturit, kjo futet te çështjet regjionale dhe flitet si pasojë e konfliktit ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Hajde, një minutë!

HYDAJET HYSENI: ... Flitet për 14.000 të pagjetur, por vëni re! 10.000 thuhet nga konflikti në Bosnje, 2.000 nga Kroacia dhe në Kosovë mbeten 1.800, kurse është fjala vetëm për Kosovë. Dhe, nuk i përmend askush të vrarët e të masakruarit.

Prandaj, do të duhej shtruar- a ka vend për t'i shikuar edhe sfidat që bëhen me hartimin e raporteve, a ka vend për të parë edhe standardizimin e standardeve, me të cilin shkruhen raportet, nëse krahasohen me vendet tjera? Dhe, a ka vend edhe për një mbikëqyrje parlamentare edhe në këtë çështjen e raporteve, që po determinojnë proceset, jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë?

Si do që të jetë, rekomandimet e propozuara, mendoj janë pozitive dhe kryesisht janë të mbështetura, por për mendimin tim, nuk do të duhej të miratonim rekomandime parciale. Ne jemi të obliguar të bëjmë planin e veprimit. Prandaj, komisioni përkatës dhe komisionet tjera, mendoj që duhet të angazhohen që në bashkëpunim me institucionet tjera të bëjnë... (Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk është asnjëherë e tepërt të kërkohet liri më e madhe për mediat në Kosovë. Sikurse edhe në të kaluarën, qoftë Raporti i fundit i Komisioni Evropian, qofshin edhe raporte tjera vendore e ndërkombëtare, për fat të keq nuk po flasim për atë që ne, shoqëria jonë, në fakt e dëshirojmë. Si rrjedhë e tërë kësaj Kosova vazhdon të radhitet ndër vendet ku shkelet liria e shprehjes dhe pavarësia editoriale e mediumeve tona. Veprimet e Qeverisë së Kosovës në këtë drejtim po vazhdojnë të jenë të vonuara, sepse ende po mungon ndërmarrja e masave konkrete në drejtim të sanimit të kësaj gjendjeje.

Pra, edhe sipas raportit të fundit të progresit është specifikuar se nuk ka pasur zhvillime në fushën e shoqërisë informative. Ligji për organet qeveritare të shoqërisë informative nuk është miratuar. Ky ligj është i rëndësishëm për të krijuar bazën ligjore për agjencinë e E-qeverisjes dhe një forum të qeverisjes për shoqërinë informative.

Gjithnjë sipas këtij raporti, Kosova ka ngecur prapa me implementimin e garancive të konkurrencës dhe ende nuk ka kod telefonik ndërkombëtar. Kompanitë e pa licencuara të Serbisë vazhdojnë të operojnë në Kosovë. Ndonëse, Komisioni i Pavarur për Media ka lëshuar disa rregullore, Kuvendi i Kosovës ka vazhduar procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim. Ende nuk është bërë emërtimi i pesë anëtarëve të Këshillit të KPM-së. Arsyeja e mos zgjedhjes apo mos emërimit të këtyre anëtarëve pikërisht është se vetë Qeveria e Kosovës është e interesuar të dërgojë njerëz jo profesionistë, pra njerëz mbi të cilët do të ketë ndikim në vazhdimësi.

Si çështje me urgjencë në Raportin e Progresit edhe kësaj radhe është ngritur problemi i financimit të qëndrueshëm të RTK-së. Këtë çështje ne si Aleancë e kemi ngritur vazhdimisht në seancat e Kuvendit, por edhe gjatë punës sonë në komisionin përkatës, sepse konsiderojmë se pa zgjidhjen e çështjes së financimit, absolutisht nuk do të bëhej fjalë për një pavarësi të plotë editoriale, ku liria e shprehjes dhe kodi i etikës në gazetari, si bazë e informimit të paanshëm dhe objektiv do të ishin realitet. Përkundër përpjekjeve të mëdha, Kuvendi i Kosovës edhe përmes punës së vazhdueshme që është bërë në kuadër të komisionit përkatës për media, nuk ka arritur ende të nxjerrë Ligjin për RTK-në, i cili do t'i përshpejtonte veprimet lidhur me financimin e qëndrueshëm të këtij mediumi publik. Mungesa e financimit të qëndrueshëm e dëmton, normal gjithsesi, pavarësinë e vet këtij mediumi.

Ndërkaq, për sa i përket arsimit, edhe pse siç potencohet, ka pasur disa përparime në fushën e arsimit, kryesisht sa i përket legjislacionit, edhe pse konsideroj me disa të meta edhe këtu nuk duhet të ndihemi komod, për faktin se shumë çështje të tjera, jo vetëm se nuk janë zgjidhur, por as që kanë filluar të trajtohen siç në të vërtetë do të duhej të ishin. Ne mendojmë se në raport me të drejtë është kërkuar përkushtim dhe vëmendje edhe më e madhe në matjen e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në arsim. Në veçanti është kërkuar cilësi në fushën e trajnimit të mësimdhënësve dhe në sistemin e vlerësimit të studentëve dhe mësimdhënësve.

Është nevojë urgjente, që para së gjithash procedurat për vërtetimin e kualifikimeve, akreditimin e ofertuesve të trajnimit në arsimin profesional, të testohen, vërtetohen në terren, në të gjitha komunat dhe të njëjtat të implementohen në mënyrë efektive. Në këtë kuadër Këshilli për arsim dhe trajnim profesional, duhet patjetër të jetë plotësisht funksional. Natyrisht, se ne kërkojmë që qasja e femrave në trajnimin profesional duhet akoma edhe më shumë të përforcohet. Ministria e Arsimit duhet të zhvillojë statistika dhe të dhëna të sakta për arsimin, përfshirë këtu edhe numrin e studentëve dhe shkallën e punësimit, gjithsesi edhe numrin e të diplomuarve. Arsimi përfshirës kërkon vëmendje të ngritur, vëmendje dhe veprime konkrete. Edhe pse në fushën e hulumtimit dhe inovacionit është raportuar përparim i kufizuar drejt përafrimit të standardeve evropiane, pjesëmarrja në programin e 7 të Kornizës Evropiane të Hulumtimit, ka qenë shumë e

kufizuar dhe nuk kemi përparim për sa i përket investimit në hulumtim, sepse prekje e rezultateve konkrete në fushën e hulumtimeve shkencore, kërkon përpjekje dhe në vazhdimësi duhet bërë më shumë për të arritur dhe për të pasur një arsim çfarë ne e dëshirojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Sala- Berisha Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Interesimi kaq i madh për të debatuar në këtë çështje më shtyn të mendoj se kjo është një prej shprehjes së vetëdijes së Kuvendit, për t'ia përcjellë ndërdijes se duhet me urgjencë t'i përvishemi punës për kryerjen e obligimeve tona, jo pak detyrime dalin edhe për Kuvendin nga ky raport.

Tani po i kthehem raportit në fjalë, aq sa mundem shkurtimisht, ta kursej edhe kohën.

Në faqen 2, për shembull thuhet, veç tjerash, "Raporti bazohet në informata të grumbulluara dhe ta analizuara nga Komisioni." Janë përdorur shumë burime, përfshirë informata nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Unë shtroj pyetjen: Sa janë kredibile këto informata dhe çfarë është perceptimi i tyre, i cili po ndikon dukshëm në imazhin e Kosovës? Pse e them këtë? Do t'i marr disa shembuj shumë simbolik, që përfshihen këtu në raport, për shembull faqe 16 te liria e shprehjes në raport, thuhet se në Kosovë toleranca ndërfetare është e brishtë. Unë mendoj se është e kundërta. Mandej, faqe 37, ku flitet për Komisionin e Konkurrencës si një raport pozitiv që del për atë komision, ne si Kuvend ia kemi kthyer një raport Komisionit të Konkurrencës për moskryerjen e punëve të tij si duhet e tjera të dhëna, që i përmendi edhe më herët kolegu im Hydajet Hyseni, me të drejtë, se ne duhet të kemi edhe një qasje tjetër ndaj këtij raporti dhe të mendoj që nuk duhet të na përfshij ajo psikologjia e robit, se të tjerët dinë të na vlerësojnë, ne duhet t'i pranojmë, faktikisht edhe realitetet, por mos të nënshtrohemi në njëfarë forme dhe realitetin në Kosovë ta shohim vetëm në segmentin zi.

Shumë çështje tjera që çojnë në mendimin se raporti duhet të bëhet në Kosovë, siç tha profesor Bajrami, e jo në Bruksel, sepse ndryshe është kur çështjet preken me dorë e shihen me sy, e ndryshe është kur i merr perceptimet prej të tjerëve. E kam fjalën për disa segmente, jo për të gjitha.

Më lejoni t'i përmend vlerësimet në raport siç janë të tipit "nuk ka përparim", "ka ngecje", "ka pengesa", e tjera. Unë i kam bërë një analizë në një qasje tjetër këtij raporti. Për shembull, në faqe 3 thuhet: "Në Kosovën veriore integrimi nuk ka përparuar. Komunat e mbështetura nga Serbia nuk kanë bashkëpunuar me UNOPS-in dhe Komisioni për t'i mundësuar vazhdimin e regjistrimit në këtë pjesë të Kosovës, serbët në veri kanë sfiduar edhe EULEX-in." Mandej po në këtë faqe, "në fund të korrikut, situata

në veri eskaloj, kur Kosova mori vendim të vendosë embargo ndaj mallrave serbe në përgjigje ndaj bllokadës serbe të mallrave qysh më 2008, e tjera..”, që të mos i citoj në tërësi se çka thuhet në atë segment, në këtë raport, “ndodhën edhe incidente të dhunshme.” Nga ky konstatim del një rekomandim- tensionet në veriun e Kosovës duhet qetësuar, ndërsa lëvizja e njerëzve dhe mallrave duhet rivendosur. Të gjitha palët duhet ta kenë rolin e tyre në proces. Kujt po i rekomandohet kjo? Hajde edhe ne ta kontrollojmë se cilat janë detyrat tona, cilat janë të tjerëve dhe bashkërisht t’i kryejmë të gjithë detyrat për një Kosovë më të mirë, si institucione vendore ashtu edhe ndërkombëtare.

Qasja konstruktive e Kosovës në dialog shënon përparim në përkushtimin e saj në BE. Në faqe 4, thuhet: “EULEX ka vazhduar të veprojë në gjithë Kosovën dhe ta përmbushë misionin e tij.”. Mendoj që ne më së miri e dimë këtë konstatim të këtij raporti.

Në faqe 9, thuhet: “Kosova ka nevojë të ndërtojë administratë profesionale publike të lirë nga ndërhyrjet politike.” Ky vlerësim duhet të jetë prioritet kyç i partneritetit evropian. Ky prioritet, mendoj që kërkon kohë që të përmbushet, ngase bordet e pavarura vërtet janë të stërmbushura me ndërhyrje politike, por edhe të trashëguara nga qeveritë e kaluara dhe duhet pritur kohë sa t’u skadojnë mandatet. Për këtë fenomen ne kemi pasur një analizë të KIPRED-it si deputetë nëpër kutitë tona postare dhe aty mund ta shihni fort mirë se cilat subjekte politike kanë më shumë përfaqësues në ato borde.

Mandej, në faqe 11 - ”Sundimi i ligjit vazhdon të jetë çështje brengosëse në veriun e Kosovës. Gjykata në Mitrovicë vazhdon të përbëhet vetëm nga gjyqtarë e prokurorë të EULEX-it, si dhe funksionon me kapacitet të zvogëluar. Kjo kufizon qasjen në drejtësi si dhe dëmton sundimin e ligjit.”. A duhet të na shkojë mendja neve dikujt, që ta analizojmë edhe këtë aspekt, këtë vlerësim negativ që e marrim si Kosovë?

Mandej, në faqen 29, te sistemi juridik, thuhet që ka pasur ca përparime në lidhje me infrastrukturën e të drejtave pronësore, disa regjistra kadastrale mbeten në Serbi. Këtë fenomen e përmendi edhe kolegu Hydajet Hyseni, që nuk do më shumë koment.

Në faqen 33, “ lëvizja e lirë e mallrave e kufizuar – duhet koordinim.” Nuk thuhet si të arrihet ky koordinim, përderisa palët kanë qasje të ndryshme.

Faqe 43, te politikat sektoriale, përkatësisht vëni re, në raport thuhet titulli “Bujqësia dhe peshkataria”. Dhe unë, pa dyshim prita nga disa kolegë të mi deputetë që do të na akuzojnë edhe për mos turizëm detar, sepse thuhet në Raport të Progresit dhe aty çka thuhet ne duhet ta marrim apriori se ashtu është. Sa do që është edhe një lëshim teknik nga Komisioni, por dikujt nuk i intereson, ka thënë Komisioni Evropian edhe u krye.

Faqe 47, politikat e transportit. Askujt nuk iu kujtua ta ngre si çështje- pse vlerësohemi negativisht për gjërat që janë jashtë kompetencave dhe mundësive tona? Bie fjala, në paragrafin e fundit, faqe 47, thuhet: “Autoriteti i Kosovës për Aviacion Civil nuk është pjesë e standardizimit dhe vlerësimit të sigurisë për aeroplanët të huaj, si pasojë e mosmarrëveshjes për statusin. Sektori i aviacionit në Kosovë vazhdon të vuaj si rezultat i

kufizimeve të fluturimit mbi Serbinë, për fluturime që vijnë e shkojnë nga Prishtina, gjë që ka edhe ndikim financiar për operatorët ajrorë dhe ndikim mjedisor për rajonin.”.

Mandej po e njëjta frymë, në faqe 48 te energjia: “Sektori i energjisë vazhdon të vuajë nga probleme serioze.” Kështu thuhet në raport. “Operatori i sistemit të transmisionit të energjisë elektrike me Kosovën ende nuk merr pjesë, Kosova nuk merr pjesë në mekanizmat rajonal për të planifikuar dhe shpërblyer transitin e energjisë elektrike, për shkak të dallimeve lidhur me statusin e saj. Mungesa e kontrollit që rezulton nga kjo e vë në rrezik stabilitetin e sistemit të energjisë elektrike në Kosovë, ndërkohë që Kosova humb të hyrat nga transiti.” Domethënë, ndikim direkt në buxhetin e Kosovës. Më tej thuhet: “Kompania e Serbisë për energji elektrike ende mbanë një degë të pa licencuar në veri të Kosovës. Si rezultat nuk ka kontroll në rrjetin e vet, gjë që e privon KEK-un nga të hyrat”. Me fjalë të tjera Kosova vazhdon të ndikohet, përkatësisht dëmtohet negativisht nga ndërhyrja e Serbisë në sistemin e saj energjetik.

Faqe 50, te shoqëritë informative: “Kosova ka ngecur mbrapa me implementimin e garancive të konkurrencës dhe ende nuk ka kod telefonik ndërkombëtar. Kompanitë e palicencuara të Serbisë vazhdojnë të operojnë në Kosovë. Kjo ndërhynë në menaxhimin e spektrit nga Kosova.”

Mandej, në po të njëjtën faqe te statistikën, thotë: “Mungesa e bashkëpunimit nga komunat që mbështet Serbia i ka pamundësuar UNOPS-it kryerjen e numërimit e kështu me radhë. Janë të gjitha këto sfida që paraqiten në këtë raport dhe vërtetë ne duhet, së paku për vete, ta bëjmë një analizë dhe të shohim se a duhet edhe ne të vlerësojmë diçka në këtë drejtim, apo t’i marrim ashtu siç na servohen.

Dhe, dua t’ju përkujtoj, të nderuar deputetë, faktin se ne jemi duke ndërtuar shtet dhe neve na ka rënë hise që në emër të qytetarëve të kontribuojmë në ndërtimin e tij. Të ndërtosh shtet nuk është e lehtë, dikush mund të thotë se është privilegj, nga njëra anë dhe, më shumë se kaq, është përgjegjësi e jashtëzakonshme për të gjithë ne.

Ajo për të cilën ne duhet të zotohemi së bashku pozitë dhe opozitë, është se nuk duhet të na mungojë vullneti për t’iu përkushtuar me përgjegjësi me përgjegjësi të pa kompromis në kryerjen e obligimeve tona për ta çuar Kosovën përpara edhe në përmbushjen e këtyre obligimeve të dala nga raportet. Kemi shumë sfida, shumë detyrime, që na presin. Në raste të tilla lihen anash ndasitë partiake, opozita duhet të vijë dhe të adresojë probleme në Kuvend, e jo vetëm të kritikojë pa dhënë alternativa. Së paku të gjithë fitojmë, nëse Kosova ka progres. Dhe, nëse analizojmë me një qasje tjetër këtë raport të progresit për BE-në në Kosovë, do të dilte krejt ndryshe. Ju ftoj që së paku për vete ta bëni një analizë të tillë. Mendoj që ne duhet të dalim edhe me një konkluzion- të ftohet prania e BE-së në Kosovë, që përkushtimin e deklaruar politik, publikisht ta shoqërojë me angazhim konkret me punën në terren. Është tepër e rëndësishme puna e tyre e jo vetëm deklaratat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja, Rita Hajzeraj- Beqaj, le të përgatitet deputeti Gëzim Kelmendi!

RITA HAJZERAJ BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe vetë prezenca e Kabinetit, apo mos prezenca e Kabinetit qeveritar tregon për seriozitetin e temës dhe se sa me përgjegjësi sillen ndaj Parlamentit të Kosovës, shumica e deputetëve, po disa hyjnë e dalin, herë mbetet një ministër, herë dy, herë tre, prej 23 a 24 sa i kanë zëvendësministra e ministra.

Sa i përket deputetëve të pozitës, deputetja në fjalë, e fundit që foli, na dha sugjerime dhe e lexoi Raportin e Progresit. Ne secili prej nesh e kemi lexuar Raportin e Progresit, s'kemi nevojë të na lexojnë këtu deputetët Raportin e Progresit për të kuptuar ne se çka ka thënë.

E treta nuk mund ta vlerësojmë ne vetveten, sepse evropianët i ke në çdo segment të politikës tonë dhe çdo proces politik të Kosovës e përcjellin evropianët dhe të tjerët na vlerësojnë më mirë se sa ne vetveten.

Sa i përket Raportit të Progresit, unë konsideroj që ky raport do të duhej të jetë për progres, por fatkeqësisht, në këtë raport më shumë theksohet për ngecje, apo mangësi të implementimit edhe të ligjeve edhe të gjitha projekteve se sa për përparimin e tyre.

Unë dua t'i prekë dy fusha, e para prej të cilave ka të bëjë me shëndetësinë, ndërsa tjetra me mirëqenien sociale. Duke u nisur nga të gjeturat e këtij raporti për punën e Ministrisë së Shëndetësisë, në theks të zhvillimit të politikave të shëndetit publik, mund të them se pavarësisht se raporti për këtë segment nuk është voluminoz, në thelb jep për të kuptuar se nuk ka pasur aktivitete të shumta pozitive për të raportuar dhe për shkurtazi raporton jo efikasitetin e Ministrisë së Shëndetësisë. Pse e them këtë? Kjo për shkak se raporti përfshinë brengën, se shumë ligje, përfshirë ligjin për shëndetësi dhe ligjin për sigurime shëndetësore, kanë mbetur pa u miratuar. Andaj, konsideroj se një punë e ngathtë në përpilimin e ligjeve nga Ministria e Shëndetësisë, do ta gjejë këtë të fundit edhe në Raportin e Progresit të vitit të ardhshëm, me të njëjtin raportim, pra, kanë mbetur pa u miratuar këto dy ligje kryesore.

Më duhet të theksoj në këtë rast dhe t'ia përkujtoj Qeverisë se ka kaluar 100-ditshi i parë i Qeverisjes së tyre dhe tani duhet t'i shohim rezultatet e kësaj qeverisjeje.

Po ashtu raporti paraqet ngecjen paraqet ngecje në luftimin e sëmundjeve ngjitëse, përkatësisht politikat për parandalimin e tyre. Padyshim se është e dhimbshme, por përveç që nuk është përparuar në këtë segment, ne kemi pasur edhe raste flagrante të humbjes së fondeve, siç është rasti i fondit global, ku për shkak të tendencës së nepotizmit dhe orientimit të fondeve sipas interesave personale, fondi global e ka konsideruar si përzierje në punët e tyre dhe ka ngrirë fondet që merren pikërisht për këtë çështje.

Sipas raportit, po ashtu, ka pasur shumë pak përparim në parandalimin e kancerit të gjirit, sepse fondet që posedon Ministria e Shëndetësisë, nuk orientohen asnjëherë në

fushata prevenuese, por edhe ato fonde të pakta që janë për produkte onkologjike, keqpërdoren e këtë e tregon së fundi edhe ndëshkimi prej 30.000 eurosh i Ministrisë së Shëndetësisë, nga ana e OSHP-së. Për të mos humbur kohë, nuk po hyj në detaje të serialit të quajtur “Instituti i Onkologjisë”, sepse të gjithë e dimë se si funksionon dhe si ka funksionar, sepse opinioni tashmë e din dështimin e këtij instituti.

Raporti përshkruan se Ministria e Shëndetësisë ballafaqohet me mungesë fondesh, për të cilën pajtohem plotësisht, sepse Ministria e Shëndetësisë asnjëherë nuk ka pasur një fond adekuat e kur e shohim që ballafaqohemi me shumë probleme në këtë segment, mirëpo nuk mund të pretendohet rritja e fondeve në një situatë kur edhe fondet që janë, keqpërdoren nga kjo ministri, nga kemi edhe raste të gjobitjeve të Ministrisë, padi ndaj shumë kompanive. Më herët zëvendëskryeministri tha se Parlamenti duhet të bashkëpunojë me Qeverinë, po zoti zëvendëskryeministër ne i miratojmë ligjet, ndërsa ju duhet t’i zbatoni, ndërsa, kur një ministri apo pothuajse të gjitha ministrinë i keqpërdorin edhe tenderët edhe fondin edhe buxhetin e Republikës së Kosovës, kjo tregon që nuk ka një seriozitet të duhur në respektimin e ligjeve në Kosovë. Andaj, këtu fillon edhe keqpërdorimi i të gjitha këtyre apo ngecjeve që janë përfshirë në Raportin e Progresit.

Nëse shkon dhe shikon në QKUK se sa është furnizimi me barëra esenciale, atëherë do ta shihni se si është gjendja në shëndetësi. Kjo lidhet me raportimin për mungesë të kapaciteteve në Ministrinë e Shëndetësisë e cila pa dyshim se është në masë shqetësuese, sepse kemi shumë drejtorë që ende funksionojnë si ushtrues detyre.

Kem njerëz të cilët akuzohen dhe janë nën hetime për shumë akuza të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, njerëz të cilët në mënyrë kronike i dëmtojnë politikën e shëndetit publik duke keqpërdorur fondet, duke nepotizuar institucionet dhe duke humbur fonde nga organizatat e ndryshme që promovojnë përmirësimin e shëndetit.

Të nderuar deputetë,

Kjo që është raportuar në Raportin e Progresit, është edhe një shenjë se shëndetësia përkundër premtimeve pompoze vazhdon të jetë një dështim i vazhdueshëm, i rrethuar nga mungesa e vizionit, mungesa e ligjeve, mungesa në përmirësimin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe formave më të shpeshta të kancerit te femrat, mungesa e kapaciteteve njerëzore për arsye që u cekën më lart.

Unë, zoti kryetar e kam edhe një pjesë për mirëqenien sociale, mirëpo me qenë se edhe deputetët janë lodhur, konsideroj që këtë pjesë për mirëqenien sociale do ta dorëzoj me shkrim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Replikë, një minutë Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, kryetar!

Desha t’i them koleges time deputete, Komisioni Evropian, përkatësisht Evropa s’ka nevojë për avokat si ti, me psikologji robi. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër replikë, Rita Hajzeraj, një minutë.

RITA HAJZERAJ: Mua po më vjen keq që kemi ardhur në gjendje që duhet ta mësojmë ne Evropën se si të na vlerësojë, andaj unë e lë në përgjegjësi të deputetes. Përndryshe, herëve tjera nuk ke nevojë të na lexosh Raportin e Progresit, se ne pa e lexuar hiq dimë ta transmetojmë më mirë se ti.

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!
Keni të drejtë plotësisht edhe unë do të ndalem vetëm në dy pika për hir të kohës që të mos iu marrë më shumë.

Te ligji, do të thotë, në parim të drejtat ekonomike dhe sociale ku kemi një vërejtje nga Raporti i Progresit, ku thuhet se është zgatur periudha e lindjes në 9 muaj te lehonat, do të thotë, pas shtatzënisë e ne jemi dëshmitarë të asaj se në praktikë ndodhë e kundërta, nuk respektohet në plotësi ky ligj. Faktor tjetër që e rëndon më shumë edhe Ligjin aktual të punës është edhe mosrespektimi i orarit të punës nga ana e punëdhënësve dhe diskriminimi i të punësuarve. Kjo arsyetohet me faktin se ekziston mungesë të kapaciteteve të Inspektoratit të Punës.

Faktor tjetër të cilën e ka paraqitur edhe Raporti i Progresit është edhe gjendja aktuale sa i përket zbatimit të Ligjit të duhanit në Kosovës. Sipas Raportit thuhet se zbatohet në tërësi Ligji i duhanit, ndërsa ne jemi dëshmitarë se vetë duke qenë pjesë e grupit punues për Ligjin e duhanit, kemi hasur në shumë mangësi në mosrespektimin e Ligjit të duhanit dhe mangësitë që i paraqet ky ligj në praktikë. Prandaj, unë them se këtu ka një korrespondencë në mungesë të informatave sa i përket këtij raporti për Ligjin e duhanit.

Dhe, krejt në fund për të kursyer kohën, do të ndalem edhe një fjalë të luftimi i krimit të organizuar ku në Raportin e fundit të Komisionit Evropian, Kosova vazhdon të jetë vend kyç i trafikimit me qeniet njerëzore, çka për një shtet me 2 milionë banorë dhe me një sipërfaqe rreth 10 mijë kilometra është tragjedi dhe s'kemi si t'i themi se e kemi kaluar çdo kufi të keqes sa i përket krimit të organizuar. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti, Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!
Unë mendova që fare s'do të më vijë radha pasi që fillimisht isha i renditur i 45-ti, dhe pasi u hodhën vështrime të ndryshme nga aspekti politik, profesional, besa edhe artistik mbi këtë raport, mua nuk më mbetet shumë të them lidhur me raportin, por po e shfrytëzoj edhe unë rastin që publikisht të gjithë besimtarëve myslimanë t'ua uroj festën e Kurban Bajramit. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian është një nga dokumentet më të rëndësishme që mat progresin ekonomik, politik dhe shoqëror të vendit tonë, i cili aspirojnë integrimin në Bashkimin Evropian. Rëndësia e këtij raporti, në krahasim me shumë raporte tjera vlerësuese ndërkombëtare, qëndron edhe në atë se vlerësimi vjen nga një organizëm ndërkombëtar, në të cilin synon të anëtarësohet Kosova.

Si zakonisht, pas publikimit të Raportit të Progresit, në Kosovë debatet po zhvillohen në atë drejtim se sa me të vërtetë ka pasur progres, që në një farë forme edhe është normale një qasje e tillë, por shpeshherë përmbajtja e këtyre raporteve po personalizohet, keqinterpretohet dhe keqkuptohet dhe po përdoret për politikë ditore.

Mendoj se analizat duhet të bëhen me qëllim të qartësimit sa më të madh të përmbajtjes së Raportit të Progresit dhe eliminimin e dobësive të evidentuara në raport, për marrjen e masave për përmbushjen e kërkesave që dalin nga raporti dhe sfidat që mbeten të përmbushen në interes të qytetarëve të vendit.

Si zakonisht, edhe në këtë raport dallime të mëdha mes opozitës dhe pozitës mbesin sa i përket kuptimisë së progresit në Kosovë, por këto dallime duhet tejkaluar, në interes të qytetarëve dhe në interes të Kosovës për të krijuar një të ardhme evropiane për fëmijët tanë, këtë ua kemi obligim, jo vetëm pozita, por dhe opozita, roli i cili shpeshherë edhe po keqkuptohet si diçka e cila duhet të kritikojë, por jo edhe për të dhënë alternativa.

S'do mend se ky është raporti i progresit më pozitiv që Kosova ka pasur ndonjëherë prej se Komisioni Evropian, nga viti 2002, përpilon raporte të këtilla për Ballkanin Perëndimor.

Kosova është shtet i ri dhe në këtë raport vërehen progres në të gjitha fushat. Askush nuk ka pas iluzion se raporti do të jetë perfekt, por është fakt që Kosova është në zhvillim e sipër dhe po ecën me hapa të sigurt drejt Bashkimit Evropian. Për herë të parë Kosova merr diçka direkt nga Raporti i Progresit, dialogun për liberalizimin e vizave, me çka po hapet rruga drejt Bashkimit Evropian.

Në këtë raport, në përgjithësi, në të gjitha fushat ka përparime. Kosova ka bërë përparim në sektorin gjyqësor, në përgjithësi, Kosova ka shënuar përparim në këtë fushë.

Pastaj raportohet për përparim në lidhje me shërbimet korrektuese. Kosova po vazhdon t'i ndjekë synimet e saj në këtë fushë, në rastin e qasjes në drejtësi, ka pasur përparim.

Është shënuar progres i kufizuar në përforcimin e mbikëqyrjes së Qeverisë nga Kuvendi, që është çështje që na takon ne, në përmirësimin e shqyrtimit të propozim- ligjeve në përputhje me prioritetet e integritetit evropian, apo në punën e përbashkët mes Qeverisë dhe Kuvendit, në një program të përbashkët të reformës.

Ministria e Integritetit Evropian ka avancuar në masë të konsiderueshme në menaxhimin e ciklit të dytë të dialogut të procesit të stabilizim-asocimit, pastaj në përgjithësi ka pasur përparim të kufizuar në reformën e administratës publike, disa ligje dhe rregullore janë miratuar.

Në përgjithësi, të drejtat e punës dhe ato sindikale janë garantuara gjerësisht. Në përgjithësi ka ca përparime që mund të raportohen në lidhje me të drejtat e gruan, Ligji i punës ka zgjatur të drejtën e pushimit të lindjes.

Raportohet përparim në fushën e të drejtave të gruas dhe barazisë gjinore. Pozita e gruas në politikë është përmirësuar, është përmirësuar edhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve me zbatimin e Kodit të drejtësisë për të mitur, si dhe procesin e monitorimit të tij.

Sa i përket personave të zhdukur, Kosova ka miratuar Ligjin për personat e pagjetur. Edhe në këtë fushë raportohet një përparim, fusha për persona të pagjetuar kërkon një përkushtim të madh politik të të gjithëve.

Në përgjithësi, ka pasur përparim në integrimin e komuniteteve pakicë. Ka pasur përparim në fushën e doganave, tatimit, konkurrencës. Përparim raportohet edhe në fushën e prokurimit publik, në fushën e politikave të punësimit, në fushën e arsimit, në fushën e industrisë dhe në bujqësinë, sigurisht se ka edhe sfida.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është sfidë jo vetëm për Kosovën, por edhe për shumë shtete të Bashkimit Evropian, ku pretendon të hyjë Kosova.

Kosova ka bërë ca përparime në luftimin e korrupsionit, ngritjen e pagave të gjyqtarëve dhe përfundimi i procesit të riemërimit janë hapa pozitivë në parandalimin e korrupsionit.

Mendoj se edhe shoqëria civile dhe qytetarët nuk janë pa përgjegjësi në këtë proces të plotësimit të standardeve evropiane, në veçanti në mbështetjen për luftim e dukurive negative, krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Luftimi i këtyre dukurive do të ndodhë kur të kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm të shoqërisë civile, qytetarëve me organet e hetuesisë dhe drejtësisë.

Zyrtarë të korruptuar ka kur shoqëria është e korruptuar dhe kjo e keqe zhvillohet kur qytetarët nuk e raportojnë atë, por e zhvillojnë atë.

Korrupsioni në Kosovë është një farë e keqe e mbjell në sistemin e kaluar okupues të paraluftës, ku korrupsioni ka qenë mjet për të mbijetuar nën atë okupim, por kur sot po jetojmë në liri, korrupsion dhe dukuritë negative duhet raportuar nga qytetarët dhe duhet luftuar me mekanizma shtetëror.

Sjellja evropiane nuk i takon vetëm Qeverisë dhe politikanëve, por të gjithëve: shoqërisë civile, mediave, qytetarëve, bizneseve, dhe pa arritur një standard evropian nga të gjithë, vështirë se mund të arrihet nga institucionet, ngase ato burojnë nga populli. Është bërë praktikë në Kosovë të flitet për interesa shtetërore, të gjithë kërkojnë të mbrohen ato, por sa herë që interesat individuale u ndeshen me interesat shtetërore, shumica përcaktohen për interesat individuale, përpara tyre shtetërore.

Shihni pengesat që bëhen nga qytetarët gjatë investimit në infrastrukturë, ku secili kërkon të përfitojë pak më shumë në kurriz të interesave shtetërore. Kjo nuk është praktikë evropiane.

Të gjithë kërkojnë të luftohet nepotizmi dhe korrupsioni, gjë që duhet vlerësuar, mirëpo pas deklarimeve çdonjëri kërkon të afërm për të intervenuar për të kryer ndonjë punë për vete, as kjo nuk është praktikë Evropiane.

Sipas organizatave të ndryshme, që merren me analizë të Raportit të Progresit, Raporti i Progresit i vitit 2010, ishte raporti më pozitiv që Komisioni Evropian e ka shkruar për Kosovën, pas shpalljes së pavarësisë, ky i vitit 2011 e tejkalon në progresin e arritur.

Dhe, në fund nga fillimi i debatit më mbet një çështje për ta thënë kur deputeti Gjini foli për mos sundimin e ligjit, punësimet me të njohshëm në ministri, kërcënimet, mu duk që tamam po bënte një përshkrim autobiografik të tij dhe të subjektit që përfaqëson kur ka qenë vetë në Qeveri. Ju faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Replika ime veç është kështu, s'vlen as të replikosh! Faleminderit!

KRYETARI: Edhe Bekimi, kështu po mendon, më duket.

Deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për ju,

Kabinetin qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Vetë fakti që Kosova ka mbetur e vetmja në regjion pa liberalizim të vizave, na sjell në pozicion që duhet ta marrim me një seriozitet të veçantë çdo raport që shkruhet për Kosovën. Nuk jam ithtar i asaj që të përshkruhet zi ose bardhë prej pozitës apo opozitës dhe këtu patëm rastin që të dëgjojmë qilim me lule dhe të shohim gjithçka që është e

errët. Unë mendoj se progresi është tepër i ulët dhe Kosova ka nevojë për një progres krejt tjetër.

Në raport thuhet se shkalla e zhvillimit ekonomik është e ulët, shkalla e papunësisë është shumë e lartë. Dhe, unë pyes, po si mund të jetë ndryshe kur kemi një sistem monetar që 80% shërbimet bankare i udhëheqin bankat e huaja? Po si mund të kemi një shërbim të tillë, kur nuk ke bursë, kur nuk ke treg të kapitalit? Po si mund të kemi në një progres, kur dihet që sistemi monetar gjeneron vende pune, në një ambient ku bankat e gjejnë një oazë tepër të shkëlqyeshme, dividendat e tyre brenda vitit kalon shumë milionë, ato vilen në Kosovë? Si mund të kemi një gjë të tillë, kur merrni kamatën në depozita apo plasmanë?

Në raport ceket mirë se plasmanet kryesisht janë orientuar në tregti shumicë me pakicë, shumicë apo pakicë, në shërbime, por jo edhe në prodhim, prodhimi është ai që gjeneron vende pune.

Sa ka progres, do ta ilustroj me një element tjetër. Ne në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike gjithëherë para se të startojmë për raportin e vitit të cilin e kemi para vetes, shikojmë rekomandimet që janë dhënë një vit më parë dhe ato të cilat është reflektuar në to.

Po ju them se ministria e fundit që ne e patëm, kishte pasur 10 rekomandime për vitin 2009. Gjatë vitit 2010 kishte adresuar vetëm 1, kurse 9 i kishte të pa adresuara. Apo një element tjetër, proceset e prokurimit nga 22 raste që i kishte audituar auditori gjatë kontrollit, i dalin se i ka 11 jashtë dispozitave ligjore, jashtë ligjit, jashtë rregullave. Po kjo është alarmante!

Apo t'i marrim shifrat të cilat na referohen dhe ne do të kemi rast ta shohim në materialin që do të vijë për Raportin e Zyrës së Auditorit, do të shohim se nga të gjitha raportet që janë audituar gjatë vitit, del se 14 janë me pasqyra financiare të treguara në bazë të standardeve të kërkuara, 35 janë, po kanë çalime, 17 janë të kundërta, 9 janë mohim. Për mua, është ky është një rezultat tepër brengosës dhe është tepër alarmues, është një diçka që po reflekton edhe këtu, se të gjitha ato të gjetura në raporte, auditori nuk largohet derisa nuk e merr pëlqimin se janë konstatime të sakta. Dhe, ne në fillim i pyesim- janë të sakta, po, por më vonë kur i fillon dhe ia shpalosim një për një, fillon të shpurdh dhe t' i mohojë ato, më jep të kuptoj se nuk lexohen raportet fare. Këto janë gjëra brengosëse dhe unë mendoj se korrupsioni, si kategori, në shoqërinë tonë ka shkuar shumë larg dhe është shumë shqetësues.

Unë e di se në të gjitha fazat e zhvillimit njerëzor ka pasur, por ka pasur një frikë, ka pasur një përcjellje, një ndjekje, një gjykim, sot s'ka as marre, as frikë dhe kjo është shumë shqetësuese.

Ne mund ta vlerësojmë raportin si të duam, apo më mirë t'ua tregoj një proverb. Dy të uritur dhe po kërkojnë bukë, dikush po jep atje bukë në radhë, radha shumë e gjatë. Njëri shkon, kur të kthehet, thotë - a po jepnin- po. A ish kulaçi i madh, thotë - valla jo. Po, sa,

vizatoma në hi. Ia vizaton. Thotë, lëshoj bre më të madh, se unë jam i uritur. Unë po ta lëshoj çfarë të duash, po atje po ta jepnin kaq. Jemi larg standardeve dhe unë jam shumë i brengosur, nëse në raport nuk mund ta lëmë pa e cekur edhe këtë.

Ne të gjithë themi, edhe opozita, edhe pozita se raporti paraqet realitetin. E, unë po ju pyeti, si mund ta pranojmë realitet që paska struktura paralele, struktura të sigurisë, dhe unë pyes, çka bën kryeministri, çka bënë ministri i Rendit? Del edhe më flet pallavra këtu, pse nuk flet ai, ka ose nuk ka, cilat janë ato? Kush i financon ato, çfarë objektivi kanë, kundër kujt janë? Këto janë detyrat e tij, jo të më flet për gjëra të tjera, ose në zyrën ku duhet të ruhen, vidhen faktet, çka mund të flasim? Flasim për progresin e doganës. Po, ju lutem, në raport shkruan se Kosova është shndërruar në vend të ripaketimit të drogës. Ky vlerësim është shumë i rëndë, ne mund ta marrim qysh të duam.

Apo merreni Administratën Tatimore, ka progres, po a është ai që do të duhej të ishte? Jo, ju them! Në vitin 2002 deri 2004, unë kam qenë ministër, ky prag i TVSH-së ka qenë në 50 mijë euro. Kemi trajnuar mbi 56 veta për ta ulur pragun në 30 mijë euro, sot e atë ditë e ke në 50. Atëherë janë bërë të gjitha përgatitjet që të kemi arka fiskale në të gjitha bizneset, 105 mijë biznese i ke, sa arka fiskale i ke të montuara? 9.000. Po këtu i ke të gjitha problemet, sepse është vepruar keq.

Në vend që arkat fiskale t'i blejë shteti t'ua jep bizneseve falas dhe përmes tyre t'i kontrollojë, ai ka shkuar dhe iu ka vënë një taksë shumë të rëndë që për shkak të asaj takse disa ikin krejt. Do të thotë, unë sinqerisht nuk i marrë këto shqetësime si opozitë, në këtë rast, unë i marr si kosovar që mendoj ta ndaj fatin në këtë vend, dhe unë shpresoj që shumicën dërmuese këtu e prek kjo, sepse jam i bindur që janë në këto valë. Prandaj, bashkërisht duhet t'i luftojmë, jo nga pozita zi, apo nga pozita kuq, por ashtu siç janë, nuk kemi nevojë t'i fshehim, këto gjëra janë shqetësuese.

Apo ta marrë një rast tjetër, Agjencioni i Ushqimit. Komplet, në raport thotë, janë ndërruar pajimet e ushqimit. Po, ju lutem, çka do të thotë ajo? Po mua nuk më dhemb atje ai keqpërdorim aq shumë, sa ato mjete që janë ndërruar. Sa është vlera e tyre, standardet e tyre, nuk e dimë çka po hamë, çka po pimë, kanceret po lindin, kanë vluar, leukemia ka vluar, këto janë rezultatet e tyre.

Në televizion e dëgjuam, tha nuk mund ta kthejmë mallin në Serbi, se është vi e veçantë e prodhimit! Këtë e ke edhe në ushqim, këtë e ke edhe në gjëra tjera.

Prandaj, mendoj se është koha e fundit kur të gjithë duhet t'i hapim sytë dhe në këtë drejtim ta marrim si një problem të përbashkët, sepse ky raport është për Kosovën, edhe më në fund të fundit këtyre të huajve duhet t'ua themi.

Soja e Kosovës, për të mirë dhe për të keq, nuk është veç e Kosovës, është edhe faktori ndërkombëtar, se ka qenë edhe është, në veçanti te kompanitë publike. Unë po i këqyri këto ditë, po më del Ligji mbi kompanitë publike, procedura e angazhimit të auditorit të jashtëm, thotë e bën përzgjedhjen vetë kompania, po a s'është konflikt i interesit ajo? A

s'mund t'i them kolegut- ty po ta jap, po ti ke për të më vlerësuar pozitivisht. Këtë s'e kanë bërë kosovarët, këto janë praktika të këqija që na i kanë lënë do tjerë, por meqë kjo është shtëpia jonë, ne duhet të angazhohemi dhe t'i përmirësojmë këto. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci, le të përgatitet Jeton Svirca.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Progresit është një instrument i rëndësishëm për demokratizimin e shoqërisë dhe rrugëtimin evropian të Kosovës.

Respekt dhe falënderime për shërbimet e Komisionit Evropian për analizën e kthjelltë në këtë raport, që është një vazhdimësi e detyrave të lëna për vendin tonë nga opinioni i vitit të kaluar dhënë në Raportin e Progresit të vitit 2010.

Nga Raporti i Progresit 2011 shihet se Kosova në periudhën nga tetori i vitit 2010 deri në shtator të vitit 2011, ka shënuar progres diku më shumë, ndërsa diku si progres i kufizuar, por gjithsesi progres në plotësimin e kriterëve dhe rekomandimeve të raporteve të mëparshme të Komisionit Evropian.

Progresi është edhe më i rëndësishëm duke marrë parash fondin e ngjarjeve që e përshkruan Kosovën, pas vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në vjeshtën e vitit 2010, ngjarje këto që Kosova i kaloi duke dëshmuar institucionalizim dhe respektim të kushtetutshmërisë dhe nën kërcënimin e një ngërçi politik 6- mujor, nga tetori i vitit 2010 deri në zgjedhjen e presidentes Jahjaga, më 7 prill 2011.

Në fushën e politikës ekonomike, raporti adreson sfidat kryesore të cilat e preokupojnë Kosovën që nga pas lufta. Gjendja ekonomike në Kosovë është sfiduese që nga paslufta dhe nuk është sfiduese vetëm në periudhën që i adresohet raporti.

Përkundër shumë vështirësive dhe sfidave me të cilat po përballet Kosova në fushën e financimit publik, Qeveria mbetet shumë e përkushtuar për krijimin e një ekonomie funksionale të tregut dhe një ekonomie që do të jetë në gjendje që t'i rezistojë presioneve konkurse dhe kompatible në aspektin ligjor me *asquis communitaire*, të drejtën e komitetit evropian, në këtë rast, fushën ekonomike.

Marrëveshja stand- by, e negociuar me FMN-n në mesin e vitit 2010, doli përkohësisht nga rruga për shkak të rritjes konsiderueshme të shpenzimeve rrjedhëse.

Rritja e shpenzimeve rrjedhëse ishte refleksion i rritjes së pagave të shërbyesve civilë, ngritje kjo e cila ka dal si domosdoshmëri viza-vi standardit dhe sigurimit të dinjitetshëm të mirëqenies sociale të domosdoshme të shërbyesve civilë të Kosovës.

Dallimi konsistonte vetëm në mënyrën dhe kohën e realizimit, përderisa FMN-ja ishte për ngritje graduale për gjatë 3 vjetëve, opsioni i Qeverisë ishte për ngritje të menjëhershme.

Megjithatë, përkundër shumë prognozave të zymta që janë dhënë, Kosova nuk do të ketë krizë të financimit publik dhe marrëdhënie me FMN-n kanë avancuar pozitivisht si rezultat i përkushtimit të sinqertë të Qeverisë dhe institucione relevante financiare të Kosovës. Në këtë drejtim, rol vendimtar ka luajtur rritja e performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave siç janë: Doganat dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Rritjes së performancës, në mbledhjen e të hyrave publike i referohet edhe Raporti i Progresit, citoj: Në 8 muajt e parë të vitit 2011, ekzekutimi buxhetor ka shënuar performancë të fortë në të ardhurat tatimore 17% rritje vjetore.

Shpenzimet publike në Kosovë nga viti në vit janë rritur, sepse janë rritur funksionet shtetërore të Kosovës, përkatësisht nevojat publike të saj.

Sikurse në të gjitha shtetet tjera edhe në rastin e Kosovës rritja e shpenzimeve publike ka qenë dhe është indikator, presioni mbi institucionet përgjegjëse që të gjejnë burime për financimin e shpenzimeve.

Në dimensionin e shpenzimeve kapitale buxheti i vitit 2011, në pjesën më të madhe të tij, është produkt i projeksioneve dhe politikave të filluara në vitet e mëparshme, një ngritje prej 25.6% në krahasim me realizimin e shpenzimeve për vitin 2010.

Ngritja e shpenzimeve kapitale reflekton kryesisht implementimin e projektit të autostradës, projekt ky i cili do të shkaktonte presione fiskale për Kosovën edhe për dy vjetët e ardhshëm, por që pa dyshim do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe integrujes të Kosovës.

Në mesin e korrikut 2011, Qeveria hyri në një marrëveshje të re me FMN-n, një program me monitorim nga stafi SMP dhe besojmë se Kosova do të kalojë me sukses këtë tekst dhe do të forcojë kredibilitetin e politikave ekonomike dhe fiskale karshi FMN-së.

Përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit, duke rritur në të gjitha ato fusha ku kërkohet në raport, veçanërisht kam parasysh intensifikimin e aktiviteteve për dizajnimin e një strategjie afatgjate të zhvillimit ekonomik mbi bazën e të cilit do të konsideroheshin politikat ekonomike dhe do të ishin në funksion të plotësimit të kërkesës së Raportit të Progresit i cili thotë, citoj: ” hartimin dhe zbatimin e një strategjie koherente dhe kredibile ekonomike që ndërlidhen prioritetet e politikave, reformat strukturore dhe shpenzimet publike.

Konsideroj se Raporti është dashur të ketë parasysh edhe mini-strategjinë e Qeverisë në Bullgari.

Në shumë fusha tjera që i referohet Raporti i Progresit thekson përparime si në plotësimin e kriterëve politikë dhe po ashtu në standardet evropiane që kanë të bëjnë me tregun e brendshëm politik, sektorial si dhe drejtësinë dhe sigurinë.

Në këtë kuadër do të veçoja progresin e shënuar në fushën e sistemit gjyqësor dhe këtu kam parasysh zbatimin e kushtetutshmërisë përmes zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe punën e Këshillit Gjyqësor dhe fillimin e punës së Këshillit Prokurorial.

Mendoj se rekomandimet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i LDK-së për votim janë të arsyeshme dhe do të votohen edhe nga Grupi Parlamentar i PDK-së por pasi që të hiqet fjala nga pika e tretë, reshti i tretë ku thuhet: “të heqë dorë nga retorika e përditshme dhe në rekomandimin e pestë për Qeverinë sepse Raporti i progresit nuk i kritikon vetëm Qeverinë në këtë pikë por edhe partitë politike dhe institucione tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti, Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që të flas edhe unë disa fjalë në lidhje me debatin e sotëm për Raportin e Progresit.

Agjendën e popullit të Kosovës dhe institucionet e saj për integrim në Evropë askush nuk mund ta vë në pikëpyetje.

Si shoqëri e re dhe shtet i ri është e ditur se Kosovën e përcjellin dhe do ta përcjellin probleme të ndryshme, asgjë nuk mund të rregullohet brenda natës apo një kohe të shkurtër. Jemi të vetëdijshëm që Raporti ka evidentuar probleme në sfera të ndryshme, por edhe përparime në sfera të tjera.

Në konstatimet e Komisionit Evropian në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2011 lidhur me procesin zgjedhor, menaxhimin e buxhetit, zhvillimin ekonomik, funksionimin e rendit dhe ligjit, zbatimin e legjisllacionit, administratën publike, për korrupsionin dhe krimin e organizuar, duhet angazhuar më shumë që gjendja e njëjtë të mos nga gjej në raportin e ardhshëm.

Raporti ka edhe konstatime se ka përparime të kufizuara. Kosova e ka gjithë potencialin njerëzor dhe material për të ndërtuar të ardhmen e sigurt, por duhet vullnet më i madh politik dhe qytetar për t'i adresuar dhe luftuar fonemenet negative.

Jemi duke dëshiruar BE-n, atëherë të ngrihet niveli i punës, të implementohen të gjitha standardet e Bashkimit Evropian në të gjitha fushat si : në arsim, ekonomi, administratë, gjyqësor, proces zgjedhor e të tjera.

Megjithatë, korrupsioni mbetet brenga jonë më e madhe në lidhje me këtë. Më kujtohet një fjalë e para luftës, të cilën e shprehnim shpesh në ndeja të ndryshme se a vjen dita të çlirohemi se 10 vjet do të punojmë për Kosovën, pa para, veç ta qojmë shtetin tonë përpara. Pyes veten dhe juve dhe të gjithë qytetarët, ku mbeti ky premtim apo ideal i joni?

Për fund, për plotësimin e standardeve evropiane të angazhohemi pra bashkërisht, Kuvendi, Qeveria, gjyqësori, por edhe qytetari. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kohën!

Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Sadri Ferati.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë, të gjithë atyre që sot integrimi evropian i duket si iluzion e Qeveria e Kosovës si megalomane dhe bëjnë zhurmë rreth Raportit të Progresit, njëjtë e patën mendimin edhe kur kryeministri i Kosovës premtoi rritjen e pagave për arsimtarët, policët dhe shërbyesit tjerë civilë.

Të njëjtin mendim dhe të njëjtën zhurmë skeptikët e bënë edhe atëherë kur filloi autostrada Morinë – Mendare. Dhe, unë mendoj që janë këta dy shembuj të mjaftueshëm që qytetari i Kosovës të zgjedhë mes skepticizmit dhe realitetit në Kosovë.

Unë sot e kam përcjell me shumë vëmendje debatin në këtë Kuvend dhe të them të drejtën disa herë i jam lutur Zotit dhe iu kam falënderuar se është fat që Raportin nuk e kanë shkruar deputetët e opozitës, se edhe 50 vjet Kosova s’e kishte parë me sy liberalizimin e vizave. Ky raport do të kishte një emër tjetër sot dhe jo Raport i Progresit.

Qeveria e Kosovës, me angazhim të pakontestueshëm i ka vënë vetes prioritetet që nuk është sfidë e lehtë për t’u arritur e që janë cekur edhe në Raportin e Progresit, dhe falë angazhimit të Qeverisë së Kosovës dhe me theks të veçantë Ministrisë së Integritimit, Kosova në fund të këtij viti do ta marrë edhe udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, që edhe kjo për dike më herët ka qenë vetëm një iluzion.

Unë nuk do të zgjas më shumë për raportin, se u tha shumë sot në këtë seancë, por vetëm edhe kisha një kërkesë për deputetin Burim Ramadani, e lus që të dhënat dhe data bazën për drogën dhe të gjitha ato që i përmendi më herët t’ia dorëzojë organeve të hetuesisë, sepse do ta kursente buxhetin e Kosovës për investigime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Replikë, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Shumë shkurt, për shkak se disa elemente tash po bëhen edhe qesharake. Nuk e kam ndërmend të flas për atë pjesë të drogës se ato i ka dhënë

Komisioni Evropian, por do elemente që po shihen veç t'i qoj me postë në Evropë, se ndryshe nuk shkojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Dhe diskutuesi i fundit për sonte është deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Me qenë se jam diskutuesi i fundit, nuk do të rezimoj në emër të gjithëve, siç kanë qenë disa pretendime, po do të fokusohen në një çështje të shkurtër që po kam dëshirë ta ndaj bashkë me të tjerët.

Raporti i Progresit, realisht nuk e ka befasuar askënd, të gjithë ata që kemi qenë prezentë, e kemi pritur përafërsisht, e mira është që të gjithë po pajtohem se është një raport real.

Unë gjatë leximit të raportit dhe gjatë dëgjimeve kam vërejtur dy grupe të mëdha të sfidave të progresit siç janë ato: demokratizimi i shoqërisë, zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, situata në veri dhe politizimi i shoqërisë kosovare, në rend të parë i administratës shoqërore, që sikur sillemi se janë sfida tepër të rënda dhe është rëndë t'i sfidosh, por Kosova ka kohë deri të hyjë në Evropë, prandaj do të sfidohemi një ditë tjetër me ato, që unë mendoj nuk është qasje e mirë, ngase të gjithë këto standarde në rend të parë do t'i kemi në përdorim për jetën tonë, të qytetarëve dhe të shtetit dhe pastaj këto do të konkurrojnë gjatë vlerësimeve në të ardhmen për Kosovën.

Dhe një pjesë e sfidave që unë do t'i kisha quajtur të lehta, siç është në faqen 8 -qasja në dokumente zyrtare, pastaj raporti i Këshillit të Lartë Mbikëqyrës ku 40% të atyre vendimeve nuk janë implementuar, pastaj funksionalizimi i KPM-së dhe RTK-së dhe disa çështje tjera që thjesht kanë mund të mos jenë fare në këtë raport të progresit po të kish pasur vullnet të mirë dhe po të ishin implementuar këto.

Ajo çka është brengosëse është qasja që ne po i bëjmë sot Raportit të Progresit. Ne para një viti kemi pasur një raport dhe një diskutim, kemi pasur një plan të veprimit dhe kanë qenë të identifikuar të gjithë aktorët. Me keqardhje që sot nuk u mundësua që të shkohet radhazi të shihet cilët kanë qenë aktorët të ngarkuar me ato çështje, cilin duhet ta bëjmë t'i japim komplimente, dhe cilit duhet t'i themi që të jetë më i përkushtuar në të ardhmen.

Krejt këtë desha të investoj që edhe plani që tash duhet të miratohet nga të gjithë aktorët, plani i veprimit që 12 mujori i ardhshëm të na gjejë vërtet në një progres të mirëfilltë, jo as për të shkruar që të hymë nesër në Evropë nëse shkruan dikush, as nëse shkruan tjetri se do të vonohemi tepër, po të jetë një plan veprimi i cili edhe na takon dhe do të jetë real. Cila do të jetë dobia nga gjithë ky debat, vërtet do të jetë dobia nëse i shtrojmë me përkushtim të gjitha sfidat që realizohen këtu, të jemi real se cili është progresi i prituri në 12 mujorin e ardhshëm dhe sigurisht që të ketë përkushtim, por edhe të ketë përgjegjësi? Prandaj, edhe një herë duhet të ritheksoj që qasja që të gropëzohen sfidat në ato që janë të vështira dhe i lëmë për më vonë dhe ato që janë të lehta, hajt se i plotësojmë kur të duam, nuk është e pranueshme. Ju faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

BERAT BUZHALA: Të nderuar parlamentarë dhe qeveritarë,

Prej kur u publikua Raporti i Progresit, kemi qenë të privilegjuar dhe kemi pasur nderin që të dëgjojmë lloj - lloj komenti – ama bash lloj - lloj komenti- për dhe lidhur me Raportin e Progresit.

Duke filluar prej atyre komenteve që i bëjnë qytetarët para kamerave dikur në fshatrat dhe qytetet e Kosovës, e deri tek komentet e bëra këtu, që në fakt do të duhej të ishin me të kualifikuara, por dorën në zemër shpesh nuk dallojnë për nga cilësia prej një komenti që e dëgjova në Klan Kosovë, kur një qytetar i lemeritur nga emocionet që po fliste para kamerës e pyeste gazetarin: “Çka është ky raporti i progresit?” “A është diçka për Mitrovicën?”

Mirëpo fajin për mungesë informatash nuk besoj që e ka ai qytetar, në shpinën e të cilit mund të rëndojnë të gjitha problemet e kësaj toke. Besoj që ne këtu- të gjithëve së bashku – na takojnë meritat kryesore për zellin dhe suksesin e treguar në hutimin e opinionit publik.

Tash a flet Raporti i Progresit për Mitrovicën? Për Korrupsionin? Vizat? Anëtarësimin në Bashkimin Evropian? Apo sa kuintal grurë i ka paguar një hektar në rrafshin e Dukagjinit e sa në Llap? A për trafikim të organeve? Ndoshta për gurëthyes? A për import të mallrave nga Serbia? Për pushimet verore në Durrës, Ulqin dhe Turqi? A për pikat kufitare 1 dhe 31?

Me një fjalë qytetarët janë ata që presin të informohen prej nesh. Kurse mua më duhet t’u them se janë shumë të pafat. Për shkak të zhurmës së madhe dhe të kakofonisë që mbretëron, qytetarët më shumë gjasa do të kanë të mësojnë çka po ngjet në Greqinë fqinje se sa këtu. Pas këtij debati, sigurisht do të mbesin edhe më të painformuar se sa kanë qenë.

Kur ne këtu fillojmë se flasim për Raportin e Progresit, ndërsa pas 1 minute dalim në raporte personale, e pas 5 minutash në raporte ndërpersonale, normalisht që qytetari kurrë nuk do ta kuptojë se tash a shkruhen të gjithë këto në Raportin e Progresit. Kryetari i Kuvendit në një seancë të kaluar tha se 80 për qind e deputetëve nuk e kanë lexuar raportin. Po e lë në kreativitetin e secilit që t’ia qëllojë se sa për qind e qytetarëve të Republikës së Kosovës e kanë lexuar atë raport.

Unë nuk po them se këtu nuk janë thënë dhe nuk po thuhet të vërteta prej të gjitha palëve, mirëpo e vërteta prej të gjitha palëve është e përshtatur, e redaktuar dhe e censuruar sipas shijeve dhe preferencave partiake.

Sepse këtu tash e kemi të vërtetën për Raportin e Progresit sipas Qeverisë, e kemi të vërtetën e raportit sipas deputetëve të koalicionit qeverisës, sipas LDK-së, sipas AAK-së, sipas Vetëvendosjes dhe një të vërtetë të tijën sigurisht do ta ruajë edhe kryetari i

Kuvendit. E në fakt do të duhej të ishte vetëm një e vërtetë, atë që e ka shkruar dora apo duart e përpiluesit të raportit. E aty, pra në atë raport, definitivisht nuk thuhet se për shkak të problemeve në qiell përkohësisht parajsa është zhvendosur në Republikën tonë, por gjithashtu nuk thuhet që është zhvendosur as Ferri.

Aty pak a shumë thuhet se Kosova është pjesë e Ballkanit kryeneç, e kufizuar me fqinjë po ashtu kryeneç dhe të papërgjegjshëm si Serbia, që po e saboton me anë të strukturave paralele- e që për ne janë kriminale – procesin e shtetndërtimit dhe shtetzhvillimit. Sigurisht që thuhet se edhe autoritetet vendore duhet të punojnë më shumë – shumë me shumë – për të zënë hapin e nevojshëm. Por nuk thuhet që në Prishtinë i madh i vogël ia ka futur gjumit.

Pra në Raportin e Progresit, madje që në fillim të tij, thuhet se Prishtina ka bërë hapa konstruktiv dhe që i hapin rrugën e integritit në Bashkimin Evropian me qasjen që ka treguar në dialog me Serbinë. Çka do të shkruante në këtë raport, nëse ta zëmë edhe deputetët e koalicionit qeverisës do të votonin përkrah kolegëve të opozitës lidhur me dialogun. Padyshim se përpiluesi ose përpiluesit e raportit në at rast nuk do të eksitoheshin nga gëzimi.

Në Raportin e Progresit, pothuajse në secilën pikë të tij, flitet për hapa të progresit. Diku thuhet se është bërë progres, diku se është bërë një progres i kufizuar e diku që është bërë pak progres. Mirëpo pothuajse askund nuk shkruan që nuk është bërë progres. Pra me gjithë telashet në rrafshin e integritetit territorial, koalicioni qeverisës ka arritur që në këtë vit të shkurtuar qeverisës – dihet pse ka qenë viti qeverisës me i shkurtër – që ta mbajë trendin në binarët pozitiv. Unë frikësohem edhe ta mendoj se cili do të ishte bilanci Kosovë – BE nëse vendin do ta qeverisnin rryma tjera politike, që në thelb janë antievropiane dhe antiperendimore, sepse pikëpamjet dhe ideologjia e tyre në shumicën e herëve janë kundër çfarëdo vlere që njeh dhe përfaqëson civilizimi evropian dhe perëndimor .

Pra kemi të bëjmë me një dallim esencial, organik: Kjo qeveri, kabineti qeveritar, koalicioni qeverisës dallimet në raport me Bashkimin Evropian dhe në raport me vlerat evropiane i kanë kualitative, por nuk i kanë ideologjike. Janë gabime dhe lëshime standarde me vendet tjera që na rrethojnë, ose me ato vende tjera që përpara nesh e kanë formësuar këtë proces dhe i kanë bërë të njëjtat gabime që ne po i bëjmë tash, por që pas disa viteve e kanë siguruar një vend në familjen evropiane.

Për shembull, për mendimin tim, është e pafalshme neglizhenca që tregohet në respektimin e secilit ligj që ka kaluar nga ky Kuvend. Pra do të duhej të respektohet Ligji për ndalimin e pirjes së duhanit në ambiente të mbyllura, apo Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, apo kuotat e ndotjes së ambientit. Këtu qeveria duhet të angazhohet maksimalisht, sepse vërtet dëshiron që vendin ta dërgojë në familjen evropiane-e unë besoj që dëshiron.

Kurse në anën tjetër, kritikët, apo alternativa potenciale e kësaj qeverisjeje është në kundërshtim kapital dhe ka probleme serioze me atë çka është zemra e Bashkimit Evropian dhe me atë se çka përfaqëson kjo familje e madhe evropiane.

Këtu në këtë Kuvend pra, nga ata që sot e kritikojnë qeverinë e vendit, votohet kundër procesit të privatizimit – synohet të mbahet edhe më tutje ekonomia e centralizuar, e planifikuar dhe e kontrolluar, votohet kundër dialogut, ani pse kërkesë dhe vlerë ultimate e BE-së është pikërisht dialogu. Pra këtu është votuar dhe vazhdon të votohet kundër atyre shtyllave mbi të cilat qëndron Evropa kapitaliste dhe liberale këto 50 – 60 vitet e fundit.

Ky është pra dallimi, e që nuk është i vogël. Madje është dallim i rrezikshëm.

Gabimet dhe lëshimet e qeverisë janë kryesisht të karakterit të përzgjedhjes së kuadrove dhe neglizhencës dhe në raste të caktuara edhe të paditurisë. Opozita mund të ketë edhe kuadro, e edhe përkushtim, por jam i bindur që i mungon vetëm një gjë - kontinuiteti i duhur për të zbatuar politikën dhe manifestet. Evropa dhe Bashkimi Evropian nuk janë trualli i përshtatshëm për kultivimin – po e them pak më butë – të politikave izolacioniste.

KRYETARI: Fjalën e ka ministria për Integritet Evropian, Vlora Çitaku.

VLORA ÇITAKU: Faleminderit, shumë!

I nderuar kryetar,

Deputetë,

Kolegë ministra, zëvendëskryeministra,

Unë nuk do të bëj rezymë as përmbyllje, thjesht dua t'ju falënderoj për debatin jashtëzakonisht konstruktiv. Ishte e qartë gjatë tërë ditës që i tërë spektri politikë kosovar ka një konsensus për agjendën evropiane, mirëpo ky konsensus i cili në këtë fazë është vetëm nominal, duhet të dekonstruktohet në një agjendë shumë intensive të përbashkët për përmbushjen e obligimeve dhe detyrimeve që kemi.

Agjenda evropiane nuk kërkon vetëm konsensus, agjenda evropiane kërkon bashkëveprim, agjenda evropiane kërkon koordinim, kërkon konsistencë dhe kërkon kohezion.

Agjenda evropiane do ta përcjellë Kosovën tani e shumë vite më tutje, andaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që ne të kemi një agjendë të përbashkët e cila do t'u lihet trashëgimi jo vetëm Qeverisë që do të pasojë këtë, por edhe qeverive tjera në të ardhmen. Faleminderit, shumë! Edhe unë, me tërë kolegët e mi ministra, do t'i marrim shumë seriozisht dhe debati i sotëm do të jetë udhërrëfyes për përmbushjen e detyrimeve që i kemi përpara. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Prezentë kemi 55 deputetë, që nuk mund të hymë në procedurën e votimit të rekomandimeve që i ka përgatitur Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike. Por, mendoj që ne si Kuvend duhet ta kemi planin e veprimit dhe në të ardhmen këto rekomandime mund të jenë pjesë e këtij dokumenti që duhet të miratohen në Kuvend së shpejti. Sigurish, Kuvendi është duke punuar dhe Komisioni për Integritet Evropian

është duke punuar dhe sigurisht që ne do ta miratojmë një dokument të quajtur: ” Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për të gjeturat në Raportin e Progresit të vitit 2011”

Deputeti Ismet Beqiri, e ka fjalën pasi ka dhënë disa rekomandime.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë veç do t’ ju kisha lutur që në seancën që vjen, në fillim të seancës këto rekomandime mund të hidhen në votim dhe të jenë rekomandime të votuara. Domethënë, nuk është ndonjë problem, me qenë se ne debatin e zhvilluam, e përfunduam, ne mund t’i votojmë në seancën e radhës në fillim, asgjë të keqe s’ka edhe e kryejmë, të mos të them edhe një obligim, po vërtet dalim gjithë ne si edhe më serioz, sepse rezulton, së paku me një dokument edhe me disa qëndrime që janë në favor edhe në interes të gjithë neve, pa dallim partish politike këtu edhe grupimesh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Edhe pse realisht nuk ka qenë pjesë e kërkesës, megjithatë unë mendoj që do t’ia vlente të votohen edhe këto rekomandime, por po them ne si Kuvend kemi për obligim të nxjerrim dokumentin që do të duhet ta përcjellim realizimin e këtyre të gjeturave në Raportin e Progresit.

Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e vlerëson këtë debat në mënyrë pozitive dhe mendoj që është i dobishëm nga çdo drejtim që është munduar të analizohet me propozimet e veta dhe duke marrë shkas nga rekomandimet që i sjell Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, mendoj që janë vija tani më të dizajnuara, ka disa vite të Qeverisë për këto pika të cila me disa nuanca që duhet të eliminohen. Ne mendojmë që Grupi jonë disa vërejtje të cilat ne mund t’i paraqesim që në të ardhmen Kuvendi i Kosovës, në përputhshmëri edhe me fjalimin e juaj, të formojë çdo 4 muaj një grup, i cili do të jetë nga gjithë aktorët pjesëmarrës, së bashku me Ministrinë e Integrimeve Euroatlantike dhe të jetë paraprijëse e takimeve 6 mujore të grupeve të Bashkimit Evropian dhe mund t’i paraprijë me qëndrim zyrtar nga aktorët përgjegjës për implementimin e të gjitha këtyre projekteve që është edhe angazhim i Qeverisë dhe i shoqërisë së Kosovës.

Në këtë mënyrë unë mendoj që pas çdo takimi në një seancë të rregullt të raportohet mbi të arriturat dhe nga vetë institucionet e Kosovës dhe të jetë edhe paraprijëse për Raportin e Progresit.

KRYETARI: Faleminderit!

Po, ne e kemi Komisionin për Integrimet Evropiane, kemi Ministrinë për Integrimet Evropiane dhe ne do ta kemi Planin e veprimit dhe Komisioni për çdo 3 muaj ka obligim ta bëjë një raport.

Mirupafshim!

Përgatiti: **Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës**